



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI USHTRUAR NË AGJENCINË
KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
NË
AGJENCINË
KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

Tiranë 2023

PËRMBAJTJA

Nr.	EMËRTIMI	Faqe
I.	Hyrja	
	I.a Titulli	4
	I.b Marrësi	4
	I.c Objektivat dhe qëllimi	4
	I.d Identifikimi i çështjes	4-5
	I.e Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar	5
	I.f Përgjegjësitë e audituesve	5
	I.g Kriteret e vlerësimit	5
	I.h Standardet e auditimit	6
	I.i Metoda e auditimit	6
	I.j Dokumentimi i auditimit	6-7
II.	Përshkrimi i Auditimit	
	1 Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	
	2 Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit	
	2.1 Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit	
	2.2 Hartimi dhe zbatimi i marrëveshjeve të lidhura me institucionet, sistemet e të cilave administrohen nga AKSHI	
	2.3 Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave a. Respektimi i strukturave organike të miratuara. b. Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve. Realizimi i fondit të pagave. c. Respektimi i dispozitave ligjore për rekrutimin dhe largimin e punonjësve nga puna. Plotësimi i vendeve të lira me kontrata të përkohshme pune. Zbatimi i Vendimeve të Gjykatave.	
	2.4 Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës	
	2.5 Prokurimet e fondeve publike a. Identifikimi i nevojave për mallra dhe shërbime b. Hartimi i specifikave teknike, përlllogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit c. Zbatimi i kontratave dhe Marrëveshjeve në nivel shërbimi	
	2.6 Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar, kontrollit dhe Auditit të Brendshëm	
III	Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	
IV	Gjetjet dhe Rekomandimet	
V	Lista e Dokumenteve të Auditimit	

✂ **LISTA E SHKURTIMEVE**

RSH	- Republika e Shqipërisë
KLSH	- Kontrolli i Lartë i Shtetit
INTOSAI	- Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
SAI	- Institucioni Suprem i Auditimit
AKSHI	- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
VKM	- Vendim i Këshillit të Ministrave
PBB	- Produkti i Brendshëm Bruto
TIK	- Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
SHI	- Shoqëria e Informacionit
NJTIK	- Njësitë e Teknologjisë së Informacionit e të Komunikimit
DDOS	- Distributed Denial-of-Service
BE	- Bashkimi Evropian
GOVNET	- Government Network (Rrjeti qeveritar)
E-GOV	- Electronic Government
SSL	- Secure Sockets Layer
ASCYDA	- Automated System for Customs Data
MNSH	- Marrëveshje Nivel Shërbimi
TI (IT)	- Teknologji Informacioni
NJQV	- Njësia e Qeverisjes Vendore
SHI	- Shërbimi Informacioni
BCP	- Business Continuity Plan
BCC	- Business Continuity Center
DRC	- Disaster Recovery Center
OE	- Operator Ekonomik
PKI	- Public Key Infrastructure
IP	- Internet Protocol
VPN	- Virtual Private Network
KVO	- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
SiZIN	- Sistemit të Integruar të Zyrës me Një Ndalesë
SiTTV	- Sistemi i integruar i Taksave dhe Tarifave Vendore
LAN	- Local area network

I. HYRJE

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 730/1, datë 06.07.2021 i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi 13.12.2021 deri në 30.05.2022, në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, ku periudha e audituar është 01.01.2017 deri në 31.12.2021, u krye auditimi me objekt Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, nga audituesit:

1. R.Xh, përgjegjës grupi;
2. E.C, Anëtare;
3. J.G, Anëtare;
4. E.Xh, Ekspert i jashtëm;

I.a Titulli: Auditimi i rregullshmërisë dhe përputhshmërisë në AKSHI.

I.b Marrësit: Zj. M.K në cilësinë e Drejtorit të përgjithshëm të AKSHI-t

I.c Objektivat dhe qëllimi

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, datë 27.11.2014, zhvilloi auditimin e teknologjisë së informacionit në AKU, IQ dhe AKSHI, nga data 17.09.2021 deri më datë 28.12.2021.

Objektivi i Auditimit dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat e prokurimeve, shpenzimet vjetore të buxhetit, etj.

Qëllimi i Auditimit është vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë, në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

I.d Identifikimi i çështjeve:

Drejtimit e këtij auditimi janë bazuar në programin protokolluar me nr. 730/1, datë 06.07.2021:

1. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit

2. Hartimi dhe zbatimi i marrëveshjeve të lidhura me institucionet, sistemet e të cilave administrohen nga AKSHI

3. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.

- d. Respektimi i strukturave organike të miratuara.
- e. Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve. Realizimi i fondit të pagave.
- f. Respektimi i dispozitave ligjore për rekrutimin dhe largimin e punonjësve nga puna. Plotësimi i vendeve të lira me kontrata të përkohshme pune. Zbatimi i Vendimeve të Gjykatave.

4. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës

5. Prokurimet e fondeve publike

- d. Identifikimi i nevojave për mallra dhe shërbime
- e. Hartimi i specifikave teknike, përllogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit
- f. Zbatimi i kontratave dhe Marrëveshjeve në nivel shërbimi

6. Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar, kontrollit dhe Auditit të Brendshëm

I.e Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, më poshtë AKSHI, është institucion publik qendror, person juridik, me seli në Tiranë, në varësi të Kryeministrit, i cili aktivitetin e etij e mbështet kryesisht në VKM nr.673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar, i cili financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme, përfaqëson pronarin shtet dhe administron çdo sistem dhe infrastrukturë hardware dhe software në fushën TIK, për institucionet dhe organet e administratës buxhetore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, si dhe institucionet jobuxhetore për të cilat do të përdoren tarifa shërbimi.

AKSHI ofron politika, strategji dhe rregullon sektorin TIK, duke përjashtuar fushën e komunikimeve elektronike si dhe ofron shërbime TIK dhe shërbime elektronike për qytetarët, bizneset dhe administratën publike. AKSHI ndjek dhe zbaton politikat dhe strategjitë e hartuara nga DSIK-ja për pajisjet, sistemet në të cilat përpunohet informacion i klasifikuar “sekret shtetëror”, NATO, BE, shtete dhe organizata të tjera ndërkombëtare dhe kryen mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar.

I.f Përgjegjësitë e audituesve

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2017 deri në 31.12.2021, duke i kushtuar vëmendje çështjeve që lidhen me zbatimin e rregullshmërisë dhe përputhshmërisë.

Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban programi i auditimit nr. 730/1, datë 06.07.2021 i miratuar nga Kryetari i KLSH. Në realizimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH si dhe legjislacionin në të cilin mbështetet aktiviteti financiar institucional i AKSHI-t, si dhe pretendimeve të AKSHI, paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023.

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, Vendime të KM, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përcaktojnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet.

I.g Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim janë bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC, Manualët e Auditimit, Rregulloret, Udhëzimet e KLSH-së si dhe Akte të tjera ligjore apo nënligjore që kanë rezultuar të nevojshëm gjatë auditimit renditur si më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 162-165);
- Ligji nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe aktet ligjore në zbatim të tij;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar;
- Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”;
- Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”;
- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”;
- Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar;

- VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar;
- VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- Udhëzimi nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për hartimin e Marrëveshjes të Nivelit të Shërbimit”, i ndryshuar;
- Rregulloret përkatëse të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit;
- Kontratat e lidhura të subjektit nën auditim;
- Inventarin e aktiveve;
- Aktet ligjore/nënligjore/rregullative që përcaktojnë regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave;

I.h Standardet e auditimit

Rregullorja e Brendshme “Mbi Organizimin dhe Funksionimin Administrativ të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH, Nr. nr. 97, datë 30.09.2020; Rregullorja e Brendshme “Për procedurat e auditimit të KLSH”; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), “Standardet e Kontrollit të KLSH”, “Manualeve” si dhe udhëzimeve dhe rregullave të nxjerra në zbatim të tyre.

I.i Metodatat e auditimit

Metodat mbi auditimin e përputhshmërisë që grupi i auditimit ka ndjekur, janë si mëposhtë:

- *Intervista* - Janë zhvilluar intervista në subjekt me personat përgjegjës, kombinuar me evidencat përkatëse;
- *Raporte dhe informacione* - Është konsideruar shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante, që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe drejtimet e auditimit;
- *Verifikimi në sistem* - Janë kryer verifikime me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
- *Të kombinuara* - Bazuar në vlerësimin e audituesit;

I.j Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH si dhe në manualin e auditimit të Përputhshmërisë dhe Rregullshmërisë në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me drejtimet e auditimit;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Subjekti i përfshirë në këtë auditim është Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit. AKSHI është krijuar sipas “Vendimit Nr. 673, Datë 22.11.2017 “Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, duke ushtruar kompetencat dhe përgjegjësitë si më poshtë vijon:

- Administron infrastrukturën e-Gov si dhe infrastrukturën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) për institucionet dhe organet e administratës buxhetore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, si dhe institucionet jo buxhetore për të cilat aplikohen tarifa shërbimi;
- Rregullon sektorin TIK si dhe është ofrues i shërbimeve TIK dhe i shërbimeve elektronike për qytetarët, bizneset dhe administratën publike;
- Ngre, mirëmban dhe administron sisteme dhe aplikacione të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, infrastrukturën e qendëruar dhe infrastrukturën TIK, përfshirë edhe ato të klasifikuara si “sekret shtetëror”, për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave;
- Ndërmerr, kryesisht ose mbi bazën e kërkesave të institucioneve të administratës shtetërore të interesuara, nisma për procesin e riinxhinimit elektronik të shërbimeve nëpërmjet platformës qeveritare të ndërveprimit, në varësi të nevojës për përmirësim të procedurave, riorganizimit të proceseve të punës, me qëllim thjeshtimin, rritjen e eficiencës dhe efikasitetit të administratës publike, si edhe të zhvillimeve teknologjike;
- Bashkërendon projektet në fushën e shoqërisë së informacionit, që zbatohen në të gjitha institucionet publike;
- Promovon teknologji të reja, harton strategji dhe plan-veprime për zbatimin e politikave në fushën e teknologjisë së informacionit e të komunikimit elektronik e-GOV.
- Organizon, kryen prokurimet e qendëruara dhe lidh kontratat për sistemet, pajisjet software dhe hardware, mirëmbajtjen, si dhe shërbimet e internetit dhe intranetit.

AKSHI nga ana strukturore është e ndarë në 15 drejtori ku secila prej tyre ka në përbërje sektorët përkatës.

Objekti i veprimtarisë së AKSHI-t janë:

- Zbatimin e politikave e të strategjive, për zhvillimin e sektorit të shoqërisë së informacionit (më poshtë SHI) dhe në veçanti të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (më poshtë TIK);
- Bashkërendimin e programeve në fushën e SHI-së dhe në veçanti të TIK-ut;
- Nxitjen e investimeve në fushën e SHI-së;
- Hartimin e praktikave për ushtrimin e kompetencave që i jepen ministrit nga legjislacioni në fushën e komunikimeve elektronike;
- Promovimin e teknologjive të reja në fushën e TIK;
- Dhënien e kontributit në edukimin dhe nxitjen e përdorimit të TIK-ut nga publiku.

AKSHI administron çdo sistem dhe infrastrukturë hardware dhe software në fushën TIK, për institucionet dhe organet e administratës buxhetore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, si dhe institucionet jo buxhetore për të cilat do të përdoren tarifa shërbimi.

AKSHI ofron politika, strategji dhe rregullon sektorin TIK, duke përjashtuar fushën e komunikimeve elektronike.

Gjithashtu AKSHI është ofrues i shërbimeve TIK dhe i shërbimeve elektronike për qytetarët, bizneset dhe administratën publike.

AKSHI është administrator i çdo sistemi TIK që ka si përdorues institucionet apo organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave.

Në përbërje të AKSHI-t, pranë çdo institucioni dhe organi të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, krijohen dhe funksionojnë njësitë e teknologjisë së informacionit e të komunikimit (NJTIK), si strukturë organizativo-teknike për projektimin, zbatimin dhe administrimin e qeverisjes elektronike, në institucion, nëpërmjet teknologjisë së informacionit e të komunikimit (TIK).

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, është institucion publik qendror, i cili ofron politika, strategji dhe rregullon sektorin TIK, dhe konkretisht:

- Promovon teknologji të reja, harton strategji dhe plan veprime për zbatimin e politikave në fushën e teknologjisë së informacionit e të komunikimit elektronik e-GOV.
- Zhvillon politika e strategji në sektorin e shoqërisë së informacionit dhe në veçanti të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit si dhe nxit investimet në fushën e SHI-së.
- Riorganizon dhe menaxhon strukturat përgjegjëse TIK, në institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave.
- Ofron shërbime të përqendruara nëpërmjet teknologjisë së informacionit e komunikimit (TIK) për qeverisjen elektronike, për administratën shtetërore, qytetarët dhe bizneset.

Rëndësia e produkteve të subjektit Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) luajnë një rol të veçantë në zhvillimin e një ekonomie konkurruese të bazuar në njohuri dhe inovacion. Kjo teknologji mundëson sigurimin e një cilësie më të lartë të jetës për qytetarët, ndihmon në lehtësimin dhe efikasitetin e proceseve të biznesit si dhe në rritjen e efektivitetit dhe transformimin e qeverisjes.

2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit

a. Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

Financimi i AKSHIT-it për shpenzimet për paga, sigurime, mallra dhe shërbime (llogaria 600, 601., 602, 606 dhe 230-231) realizohet nga buxheti i shtetit.

Buxheti i miratuar për AKSHI-it paraqitet vetëm në një program buxhetor, në kodin 1087006.

Projekt Buxheti

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, AKSHI ka përgatitur dhe dorëzuar kërkesat e shpenzimeve të politikave ekzistuese si dhe, propozimet për politika të reja, në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë brenda datës 1 shtator të çdo viti, sipas kërkesave dhe afateve të parashikuara në UMF nr. 7, datë 28.02.2018 si dhe në udhëzimet vjetore të Ministrit të Financave.

Nga auditimi i Investimeve të planifikuara në PBA dhe planet vjetor të institucionit u konstatua:

- Për projektin “Ngritja e Sistemit të Dixhitalizimit të Bibliotekës Kombëtare” nuk figuron të jetë Planifikuar në PBA 2018-2020 dhe në PBA 2019-2021, si projekt i parashikuar. Kontrata është nënshkruar me datën 27.12.2018, me nr. 7742, në shumën 122,721,000 lekë.

Implementimi për këtë kontratë ka pasë afat 9 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Prokurimi është bërë në kushtet e mungesës së fondeve disponibël, duke shkaktuar detyrime

të prapambetura, vërtetuar kjo nga pagesa e parë e kryer për këtë projekt në Mars 2020 në shumën 73,764,000 lekë, që referohet faturës së datës 10.12.2019.

Urdhër Prokurimi dhe kontrata nuk rezultojnë të regjistruar në SIFQ në vitin 2018. Kjo kontratë është regjistruar në SIFQ, me datë 10.03.2020, dhe është planifikuar në PBA 2020-2022, si projekt i ri.

- Për projektin “*Përmirësim i Sistemit të Provimit të Shtetit për Profesionet e Rregulluara (SPSH)*” nuk figuron të jetë Planifikuar në PBA 2018-2020 dhe në PBA 2019-2021 faza III si projekt i parashikuar. Kontrata është nënshkruar me datën 15.01.2019, me nr. 235, në shumën 102,840,000 lekë.

Afati i implementimit në vlerën prej 78,360,000 lekë ka pasë afat 4 muaj nga data e lidhjes së kontratës. Kjo kontratë është regjistruar në SIFQ, me datë 05.03.2020, dhe është planifikuar në PBA 2020-2022, si projekt i ri. Prokurimi është bërë në kushtet e mungesës së fondeve disponibël duke shkaktuar detyrime të prapambetura, vërtetuar kjo nga pagesa e parë e kryer për këtë projekt në Mars 2020 në shumën 6,348,000 lekë dhe vlerën 72,012,000 lekë transaksion që referohet faturës së datës 09.04.2019 dhe 26.07.2019. Angazhimi prej 78,360,000 lekë, që ka të bëjë me implementimin është marrë pa fonde buxhetore disponibël.

- Për projektin “*Ngritja e regjistrimit elektronik të ekspertëve*” nuk figuron të jetë Planifikuar në PBA 2019-2021, si projekt i parashikuar. Kontrata është nënshkruar me datën 13.05.2019, me nr. 2497, në shumën 136,000,000 lekë. Afati i implementimit në vlerën prej 84,234,832 lekë ka pasur afat 3 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Kjo kontratë është regjistruar në SIFQ, me datë 24.04.2020, dhe është planifikuar në PBA 2020-2022, si projekt i ri. Prokurimi është bërë në kushtet e mungesës së fondeve disponibël, duke shkaktuar detyrime të prapambetura, vërtetuar kjo nga pagesa e parë e kryer për këtë projekt në Prill 2020 në shumën 7,079,020 lekë që i referohet faturës së datës 10.06.2019 dhe në vlerën 76,904,687 lekë që i referohet faturës së datës 13.12.2019.

- Për projektin “*Ngritja e Sistemit, kryerja e shërbimit të risk assessment dhe data loss prevention*”. Kontrata është nënshkruar me datën 11.03.2019, me nr. 1283, në shumën totale 238,788,072 lekë, ku vlera prej 193,332,600 lekë, ka pasur afat implementimi 3 muaj. Pagesa e parë e kryer për këtë projekt në Mars 2020 në shumën 193,332,600 lekë, që i referohet faturës së datës 03.04.2019 dhe 03.06.2019.

Kjo kontratë është regjistruar në SIFQ, me datë 05.03.2020 dhe është planifikuar në PBA 2020-2022, si projekt i ri.

- Për projektin “*Paraqitja në versionin 360 gradë dhe broshurat përkatëse për 54 site turistike*” dhe “*Shërbim ekspozimi në virtual tour 3D*”. Kontrata është nënshkruar me datën 19.04.2019, përkatësisht me nr. 2082, në shumën prej 29,131,478 lekë me afat realizimi 11 javë, amenduar me 30 ditë, me kontratën nr. prot 2951, datë 31.05.2019, si dhe me nr. 2102 në shumën prej 80,548,147 lekë me afat realizimi 48 muaj.

Vlera prej 29,131,478 lekë është paguar nga AKSHI me datën 17.12.2019 dhe 30.12.2019. Nga analiza e zërave të investimeve si dhe rialokimet e fondeve buxhetore të realizuara gjatë vitit, nga AKSHI nuk figuron rialokim fondi për këtë projekt.

Kontrata tjetër “*Shërbim ekspozimi në virtual tour 3D*” është shërbim me afat 48 muaj, vlerë e cila është planifikuar në PBA 2020-2022 në zërin 231 “*Investime*”. Nga AKSHI, ky zë është planifikuar gabim në artikullin buxhetor 231 “*Investime*”, pasi blerja e “*Shërbimit ekspozimi në virtual tour 3D*” duhet të ishte planifikuar në artikullin buxhetor 602 “*Mallra e shërbime*”.

- Për projektet “*Ngritja e sistemit të menaxhimit të informacionit për ARK*”.

- Me shkresën nr. 4489, datë 29.06.2021, AKSHI ka kërkuar në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë miratimin e fondit prej 35,000,000 lekë, për realizimin e këtij projekti të ri.

- Me shkresën nr. 3436/1 datë 15.12.2021, AKSHI ka kërkuar në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë pakësimin e fondit prej 35,000,000 lekë, për projektin “Ngritja e sistemit të menaxhimit të informacionit për ARK”.

Sa më sipër këto veprime bien në kundërshtim me:

VKM 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”.

Udhëzimit nr.9 dt. 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 64 dhe pika 157.

Ligjit nr.9936 dt.26.6.2008 “Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 40, 43 dhe neni 50.

- Udhëzimin Plotësues të Ministrit të Financave nr. 1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019” pika 22 germa a; e dhe f.

b. Realizimi i planit të buxhetit

Viti 2019

Realizimi i buxhetit të AKSHI-it, për vitin 2019, krahasuar me kërkesat e vitit 2019, të përcjella nga institucioni sipas dokumentit të PBA 2019-2021, alokimit fillestar të buxhetit dhe atij të ndryshuar paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

000/lekë

Emërtimi		Kërkesa PBA 2019-2021	Plani fillestar i miratuar 2019	Plani i rishikuar 2019	Realizimi	Realizimi %
Shpenzime operative (A)	Paga	399,408	374,316	319,316	228,987	72%
	Sigurime	66,701	61,415	56,415	43,977	78%
	Shërbime	2,382,043	1,906,038	2,039,874	2,072,455	102%
	Transferta (605)	22,000	21,000	21,000	353	2%
	Transferta (606)	0	0	610	50	8%
Total (A)		2,870,152	2,362,769	2,437,215	2,345,821	96%
Shpenzime kapitale (B)	Investime	1,199,700	712,000	1,085,522	1,079,906	99%
TOTAL (A)+(B)		4,069,852	3,074,769	3,522,737	3,425,727	97%

Burimi: AKSHI, përpunuar nga grupi i auditimit

Në total **për vitin 2019**, sipas PBA 2019-2021 janë kërkuar nga AKSHI 4,069,852 mijë lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 3,074,769 mijë lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar 3,522,737 mijë lekë, nga ku rezultojnë të kryer shpenzime dhe investime nga institucioni në vlerën 3,425,727 mijë lekë, pra më një përqindje realizimi prej **97%** përkatësisht:

- Për shpenzimet operative, rezultojnë të realizuara shpenzime nga institucioni në vlerën 2,345,821 mijë lekë, pra më një përqindje realizimi prej 96%.

Nga analiza e llogarive rezulton se llogaria 602 “Mallra dhe shërbime” është realizuar në një vlerë më të madhe se fondet e vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit, veprime në kundërshtim me Ligjin nr.9936 dt.26.6.2008 “Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 40.

- Për shpenzimet kapitale, rezultojnë të realizuara nga institucioni në vlerën 1,079,906 mijë lekë, pra më një përqindje realizimi prej 99%.

Ndryshimet e planit të buxhetit për vitin 2019, duke u nisur nga buxheti fillestar sipas ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, ka ardhur si pasojë e ndryshimeve buxhetore në zbatim të Aktit Normativ nr. 2, datë 02.10.2019, “Për disa ndryshime në 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, si dhe shkresave për rialokim fondesh, ku është bërë miratimi i kalimit të fondeve nga një projekt në një projekt tjetër ekzistues ose të ri.

Viti 2020

Realizimi i buxhetit të AKSHI-it, për vitin 2020, krahasuar me kërkesat e vitit 2020, të përcjella nga institucioni sipas dokumentit të PBA 2020-2022, alokimit fillestar të buxhetit dhe atij të ndryshuar paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

000/lekë

Emërtimi		Kërkesa PBA 2020-2022	Plani fillestar i miratuar 2020	Plani i rishikuar 2020	Realizimi	Realizimi %
Shpenzime operative (A)	Paga	374,316	343,816	308,816	279,044	90%
	Sigurime	61,415	61,415	52,415	45,964	88%
	Shërbime	4,737,152	2,549,408	3,680,000	3,286,417	89%
	Transferta (605)	22,000	21,000	21,000	131	1%
	Transferta (606)			500	95	19%
Total (A)		5,194,883	2,975,639	4,062,731	3,611,650	89%
Shpenzime kapitale (B)	Investime	1,233,674	1,380,514	2,044,524	2,041,253	99.8%
TOTAL (A)+(B)		6,428,557	4,356,153	6,107,255	5,652,902	93%

Burimi: AKSHI, përpunuar nga grupi i auditimit

Në total **për vitin 2020**, sipas PBA 2020-2022, janë kërkuar nga AKSHI 6,428,557 mijë lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 4,356,153 mijë lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar 6,107,255 mijë lekë, nga ku rezultojnë të kryer shpenzime operative dhe investime nga institucioni në vlerën 5,652,902 mijë lekë, pra më një përqindje realizimi prej **93%** përkatësisht:

- Për shpenzimet operative, rezultojnë të realizuara shpenzime nga institucioni në vlerën 3,611,650 mijë lekë, pra më një përqindje realizimi prej 89%.

- Për shpenzimet kapitale, rezultojnë të realizuara nga institucioni në vlerën 2,041,253 mijë lekë, pra më një përqindje realizimi prej 99.8%.

Ndryshimet e planit të buxhetit për vitin 2020, duke u nisur nga buxheti fillestar sipas ligjit nr. Nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, ka ardhur si pasojë e ndryshimeve buxhetore në zbatim të Aktit Normativ Nr.6, datë 21.3.2020, “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, Aktit Normativ Nr.15, datë 15.4.2020, Aktit Normativ Nr.28, datë 2.7.2020 dhe Aktit Normativ Nr. 34, datë 16.12.2020 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar.

Viti 2021

Realizimi i buxhetit të AKSHI-it, për vitin 2021, krahasuar me kërkesat e vitit 2021, të përcjella nga institucioni sipas dokumentit të PBA 2021-2023, alokimit fillestar të buxhetit dhe atij të ndryshuar paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

000/lekë

Emërtimi		Kërkesa PBA 2021-2023	Plani fillestar i miratuar 2021	Plani i rishikuar 2021	Realizimi	Realizimi %
Shpenzime operative (A)	Paga	411,023	293,816	293,816	292,072	99%
	Sigurime	63,915	61,415	51,415	48,546	94%
	Shërbime	3,777,042	2,100,964	3,100,964	3,039,510	98%
	Transferta (605)	21,000	21,000	21,000	119	1%
	Transferta (606)			500	204	41%
Total (A)		4,272,980	2,477,195	3,467,695	3,380,451	97%
Shpenzime kapitale (B)	Investime	1,102,744	1,043,744	1,672,563	1,755,515	105%
TOTAL (A)+(B)		5,375,724	3,520,939	5,140,258	5,135,966	100%

Burimi: AKSHI, përpunuar nga grupi i auditimit

Në total **për vitin 2021**, sipas PBA 2021-2023 janë kërkuar nga AKSHI 5,375,724 mijë lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 3,520,939 mijë lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar 5,140,258 mijë lekë, nga ku rezultojnë të kryer shpenzime operative dhe investime nga institucioni në vlerën 5,135,966 mijë lekë, pra më një përqindje realizimi prej **100%** përkatësisht:

- Për shpenzimet operative, rezultojnë të realizuara shpenzime nga institucioni në vlerën 3,380,451 mijë lekë, pra më një përqindje realizimi prej 97%.

- Për shpenzimet kapitale, rezultojnë të realizuara nga institucioni në vlerën 1,755,515 mijë lekë, pra më një përqindje realizimi prej 105%. Vlera prej 5% mbi planin është realizimi i projekti “Sistemi i bazës së të dhënave për trafikun detar”, ku në planin vjetor është planifikuar vlera e TVSH në shumën prej 7,158,852 lekë dhe vlera shtesë prej 82,960,929 lekë është paguar nga grandit “International Operations-Eurasia UK Border Force”.

Ndryshimet e planit të buxhetit për vitin 2021, duke u nisur nga buxheti fillestar sipas ligjit nr. nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, ka ardhur si pasojë e ndryshimeve buxhetore në zbatim të Aktit Normativ nr.4, datë 05.02.2021, të Aktit Normativ nr.18, datë 12.04.2021, Aktit Normativ nr.26, datë 22.06.2021 “Për disa ndryshime në Ligjin 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”’.

Titulli i Gjetjes:	Mungesa e raporteve të monitorimit 4-8-12 mujore, si dhe e argumenteve për rialokim/rishpërndarje fondi.
Situata	<p>1. Nga auditimi konstatohet se, për vitet objekt auditimi, mungojnë raportet e monitorimit 4-8-12 mujore të buxhetit të AKSHI-it, të cilat dërgohen në ministrinë e linjës.</p> <p>Monitorimet dhe raportimet për ekzekutimin e buxhetit konsistojnë në rakordimet mujore dhe vjetore me degën e thesarit, duke mos lidhur realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre. Mungesa e raporteve të monitorimit 4-8-12 mujore, si dhe relacioneve shpjeguese cenojnë monitorimin e performancës financiare të objektivave të politikës së programit të synuara dhe produkteve të parashikuara në buxhetin vjetor, si dhe mungesën e marrjeve të masave korrigjuese që duhet të ndërmerren për përmirësimin e situatës.</p> <p>Sa më sipër, veprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 65, si dhe me Udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore” pikën 41 dhe 42 kapitulli III.</p> <p>2. Nga auditimi i shkresave/kërkesave të bëra nga AKSH për rialokim/rishpërndarje fondi gjatë një periudhe ushtrimore konstatohet mungesa e argumenteve nga njësia të rishpërndarjes së tyre, edhe pse një pjesë e këtyre rialokim/rishpërndarje fondi kanë prekur parashikimet e bëra në PBA-të. Veprime këto në kundërshtim me:</p> <p>Udhëzimin Plotësues të Ministrit të Financave nr. 1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019” pika 35, nr. 2, datë 20.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020” pika 33 dhe nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021” pika 34.</p> <p>3. Gjithashtu u konstatua se, AKSHI nuk ka evidentuar detyrimet e prapambetura, si ato të trashëguara ashtu edhe ato të krijuara rishtazi. Trajtimi i tyre duhet të konsiderohet si prioritet, duke e bashkëshoqëruar me paraqitjen e argumenteve lidhur me krijimin e tyre si edhe masat që parashikohet të merren për likuidimin e tyre. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin Plotësues nr. 2 datë 19.01.2018 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018”, Udhëzimin Plotësues të Ministrit të Financave nr. 1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, Udhëzimin Plotësues të Ministrit të Financave nr. 2, datë 20.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020” dhe Udhëzimin Plotësues të Ministrit të Financave nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021” kapitulli III ‘Raportimi i detyrimeve të prapambetura’.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligji Nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 65, si dhe Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”, si dhe Udhëzimet Plotësues “Për zbatimin e Buxhetit në vite”,
Ndikimi/Efekti:	Si rezultat i mungesës së raporteve të monitorimit të buxhetit: - nuk bëhet e mundur ndjekja e arritjes së qëllimit dhe objektivave të synuar, sipas deklaratës së politikës së programit, për shkak të mos krahasimit të treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik; - nuk bëhet e mundur evidentimi nëse realizimi i produkteve është në përputhje me planin, në mënyrë që të kryhen propozime/rekomandime për ndërmarrjen e

	veprimeve korigjuese nëpërmjet alokimit të burimeve; - nuk kryhet analiza krahasimore e realizimit të fondeve me periudhat e mëparshme; - nuk sigurohet informacion për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit.
Shkaku:	Mungesë veprimesh nga strukturat përgjegjëse.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	AKSHI të marrë masa në vazhdimësi, që të përpilojë raportet e monitorimit 4, 8, 12 mujore, ku të relatohet në lidhje me realizimin e treguesve në raport me parashikimin, si dhe në raportet 8 mujore të jepën informacionet shtesë për parashikimin e realizimeve të pritshëm deri në fund të vitit, si për produktet edhe për shpenzimet, për të evidentuar nëse ky parashikim është më i lartë apo më i ulët se plani fillestar i parashikuar, me qëllim menaxhimit sa më efektiv të fondeve buxhetore, si dhe ndërmarrjen në kohë të veprimeve korigjuese duke ndryshuar alokimin e burimeve, si dhe duke evidentuar impaktin e mundshëm në performancën e objektivave të lidhura me to.

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:

Raportet e monitorimit 4, 8, 12 mujore janë përgatitur nga Sektori i Financës. Në këto raporte janë relatuar realizimet e treguesve buxhetor për çdo artikull dhe për çdo projekt në rastin e Art.231. Këto raporte janë prezantuar në takimet me titullarin dhe drejtuesit e drejtorive. Në rast mosrealizimi të projekteve është kërkuar rishpërndarja e tyre nëpërmjet rialokimeve. AKSHI është projekt pilot dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk na janë kërkuar raporte monitorimi, pasi tashmë janë të gjitha të dhënat në sistem.

Raportet e monitorimit 4, 8 dhe 12 mujore, për vitet objekt kontrolli, ju dorëzuan grupit të auditimit.

AKSHI përgjatë vitit dhe sidomos në 4 mujorin e fundit, pas analizës së bërë nga drejtuesit e drejtorive dhe titullari, ka kërkuar disa herë rialokime fondesh pikërisht për një menaxhim më efektiv të fondeve buxhetore dhe për të arritur një realizim 100% të fondeve.

Përsa i përket rishpërndarjes së fondeve gjatë vitit buxhetor, duke prekur dhe parashikimet e PBA, kjo ka ardhur si rezultat i natyrës së punës së AKSHI-t, urgjencave dhe domosdoshmërisë për projekte të reja. Rishpërndarja e fondeve është bërë duke i argumentuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nevojat emergjente për fonde.

Po të shohim analizën e realizimit të fondeve për vitet objekt kontrolli, Art. 602 dhe Art. 231 janë realizuar rreth 100%. Ky realizim vërteton saktësinë e hartimit të projektbuxheteve.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Pretendimet se janë hartuar raporte monitorimi, të cilat janë dorëzuar grupit të auditimit është marrë në konsideratë, duke ju ritheksuar se pavarësisht se nëse ato janë apo jo të gjitha të ngarkuara në sistem, apo se ato nuk u janë kërkuar nga MFE, raportet periodike të monitorimit ashtu sikurse hartohen edhe duhet të paraqiten në MFE.

2.2 Hartimi dhe zbatimi i marrëveshjeve të lidhura me institucionet, sistemet e të cilave administrohen nga AKSHI

AKSHI disponon 17 marrëveshje aktive, me institucionet si më poshtë, ku në një rast marrëveshja është nënshkruar me një institucion të pavarur, më konkretisht me AMF.

Nr.	Subjekti	Nr. Prot.	Data
1.	Ministria e Kulturës	nr. 424 prot.	25.01.2018
2.	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	nr. 496 prot.	29.01.2018
3.	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	nr. 420 prot.	24.01.2018
4.	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	nr. 465 prot.	26.01.2018

5.	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	nr. 654 prot.	06.02.2018
6.	Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes	nr. 936 prot.	26.02.2018
7.	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	nr. 1374 prot.	21.03.2018
8.	Kryeministria	nr. 228 prot.	12.01.2018
9.	Ministria e Brendshme	nr. 4018 prot.	16.08.2018
10.	Ministria e Mbrojtjes	nr. 1723 prot.	11.04.2018
11.	Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë	nr. 1286 prot.	15.03.2018
12.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	nr. 1284 prot.	15.03.2018
13.	Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare	nr. 1445 prot.	26.03.2018
14.	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor	nr. 2409/2 prot.	06.06.2019
15.	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	nr. 1745/1 prot.	08.04.2019
16.	Agjencia e Prokurimit Publik	nr. 1836 prot.	08.04.2019
17.	Ministria e Drejtësisë	nr. 3179 prot.	03.07.2020

I. Hartimi i marrëveshjeve të lidhura me institucionet, sistemet e të cilave administrohen nga AKSHI

Marrëveshjet e nënshkruara ndërmjet AKSHI-t dhe institucioneve më sipër ndryshojnë nga emri i institucionit, data dhe nënshkrimi. AKSHI ka nënshkruar marrëveshje dhe me një institucion i cili nuk është në varësinë e Këshillit të Ministrave, që është AMF, për të cilën nuk kanë qendëruar asete dhe as strukturën e IT, por ofrojnë vetëm disa shërbime si:

- Email;
- Active Directory;
- Internet.

Nga auditimi mbi marrëveshjet e nënshkruara ndërmjet AKSHI-t dhe institucioneve u konstatua se ato janë të njëjta për nga përmbajtja në të gjitha rastet pavarësisht specifikave që ka secili institucion në lidhje me shërbimet IT të katalogut të shërbimeve miratuar me VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar.

Në marrëveshjen tip është dokumentuar fakti se AKSHI konsideron kontraktimin e shërbimeve të mëposhtme:

- Administrimi i incidenteve;
- Administrimi i problemeve;
- Administrimi i Disponueshmërisë;

Nga auditimi rezulton se kontraktimi i shërbimeve nuk mund të jetë i njëjtë për çdo institucion me të cilin disponon një marrëveshje për shkak se, secili prej tyre ka specifikat e veta dhe rëndësinë e tij.

Në këtë dokument nuk gjendet asnjë specifikë mbi:

- Cilat shërbime TIK është lidhur kjo marrëveshje;
- Çfarë sasive informacioni ka;
- Rëndësinë që institucioni përfitues i shërbimit ka;
- Çfarë shërbimesh i ofron vetë AKSHI dhe çfarë shërbimesh me burime të jashtme (outsourcë), etj.;

Marrëveshja është quajtur “Marrëveshje e Nivelit të Shërbimit SLA”, ndërkohë nga auditimi konstatohet se nuk është dokumentuar sipas elementëve të marrëveshjes që përcakton i vetmi udhëzim në fuqi që disponojmë i Ministrit për Inovacionin dhe Administratën Publike me nr.1159, datë 17.3.2014 “Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit”.

Marrëveshja nuk përmban elementë të aneksit nr.1 të udhëzimit përmendur më sipër në lidhje me:

- Qëllimi i marrëveshjes, dokumentuar në pikën 2;
- Përshkrimi i detajuar shërbimeve, dokumentuar në pikën 5;

- Specifikimet teknike, dokumentuar në pikën 5;
- Dokumentacionin e plotë për komponentët e shërbimit, dokumentuar në pikën 7;
- Trajtimi i informacionit kofidencial, dokumentuar në pikën 9;
- Menaxhimi i vazhdueshmërisë së shërbimit, dokumentuar në pikën 8/e;
- Raporti i shërbimit dhe vlerësimet periodike, dokumentuar në pikën 8/dh;
- Ndërprerja e MNSH-së, dokumentuar në pikën 13;

Titulli i gjetjes:	Marrëveshjet e nënshkuara ndërmjet AKSHI-t dhe institucioneve janë të njëjta për nga përmbajtja megjithëse secili prej tyre ka specifikat e veta.
Situata:	<p>Nga auditimi mbi marrëveshjet e nënshkuara ndërmjet AKSHI-t dhe institucioneve u konstatua se ato janë të njëjta për nga përmbajtja në të gjitha rastet pavarësisht specifikave që ka secili institucion në lidhje me shërbimet IT të katalogut të shërbimeve miratuar me VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar.</p> <p>Nga auditimi mbi marrëveshjet e nënshkuara ndërmjet AKSHI-t dhe institucioneve u konstatua se nuk përmbajnë elementë të aneksit nr.1 të udhëzimit, përmendur më sipër në lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Qëllimi i marrëveshjes, dokumentuar në pikën 2; - Përshkrimi i detajuar shërbimeve, dokumentuar në pikën 5; - Specifikimet teknike, dokumentuar në pikën 5; - Dokumentacionin e plotë për komponentët e shërbimit, dokumentuar në pikën 7; - Trajtimi i informacionit kofidencial, dokumentuar në pikën 9; - Menaxhimi i vazhdueshmërisë së shërbimit, dokumentuar në pikën 8/e; - Raporti i shërbimit dhe vlerësimet periodike, dokumentuar në pikën 8/dh; - Ndërprerja e MNSH-së, dokumentuar në pikën 13;
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Marrëveshja tip; - VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar; - Udhëzimi i Ministrit për Inovacionin dhe Administratën Publike me nr.1159, datë 17.3.2014 “Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit”.
Efekti:	Shërbimet e ofruara nga AKSHI nuk mund të jenë të njëjta për çdo institucion me të cilin disponon një marrëveshje për shkak të specifikave dhe rëndësisë që ka çdo institucion.
Shkaku:	Mungesa e dhënies së rëndësisë së duhur.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	AKSHI, si institucion dhënës i shërbimeve TIK, të marrë masa për rikonceptimin e marrëveshjeve aktuale të nënshkuara me institucionet duke vendosur në marrëveshje zërat specifikë dhe të detajuar të shërbimit që i ofrohen realisht institucioneve bazuar në specifikat që kanë. Gjithashtu, në marrëveshje të dokumentohen komunikimet elektronike ndërtuar mbi të dhënat për cdo sistem të cdo institucioni, ndarja e përgjegjësisë mbi këto të dhëna, mënyrat se si garantohen këto të dhëna si dhe vazhdimësia e ofrimit të shërbimit në rast ndërprerje duke siguruar në këtë mënyrë institucionet përfituese të shërbimeve TIK për integritetin e të dhënave dhe ruajtjen e tyre.

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:

Marrëveshjet e nënshkruara ndërmjet AKSHI-t dhe institucioneve të tjera janë të njëjta pasi katalogu i shërbimeve që AKSHI ofron është i njëjtë për çdo institucion.

Rekomandimi i lënë nga ana juaj do të merret në konsideratë dhe do merren masat e menjëhershme për rishikimin e këtyre marrëveshjeve.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Gjetja dhe rekomandimi janë pranuar dhe subjekti ka marrë angazhimin për zbatimin në vijueshmëri të saj.

Marrëveshja e Nivelit të Shërbimit (SLA) është një marrëveshje e lidhur midis përfituesit të shërbimeve (institucioneve) dhe palës ofruese të shërbimeve IT, që përcakton midis të tjerash treguesit e cilësisë dhe performancës për shërbimet e ofruara sipas kërkesës së përfituesit të tyre, kërkesat teknike për mirëmbajtjen, disponueshmërinë e shërbimeve, kohën mesatare të përgjigjes ndaj defekteve, kohën mesatare të riparimit të defekteve, hapat që ndiqen në rast defektesh, mënyrën e monitorimit të vijueshëm të ofrimit të shërbimit, përgjegjësitë respektive të palëve, etj., si dhe shërbimet që ofrohen sipas aneksit bashkëlidhur marrëveshjes.

Në vlerësimin tonë, sipas elementëve të marrëveshjes së sipërcituar është qartësisht e identifikueshme se çfarë rrjedh nga kjo marrëveshje dhe sesa e gjerë është ajo në përfshirjen e të gjitha shërbimeve dhe plotësimin e çdo kërkesë të institucioneve përfituese.

Theksojmë se, të gjitha specifikat e secilit institucion përfitues me të cilat AKSHI ka nënshkruar një “SLA”, janë të përfshira në marrëveshje. Nevojat apo specifikat e secilit institucion përfitues janë objekt ndryshimi në mënyrë të vazhdueshme dhe për këtë arsye “SLA” është një marrëveshje e konsideruar “Marrëveshje TIP” e cila përfshin një gamë të gjerë shërbimesh.

E rëndësishme për të dyja palët në këtë “SLA” është që të plotësohen kërkesat e secilit institucion përfitues dhe nga rezultatet e deritanishme nuk rezulton të kemi patur ndonjë ankesë në lidhje me ofrimin e shërbimeve, objekt i “SLA”, një fakt ky që tregon se “SLA” nuk sjell keqkuptime apo paqartësi gjatë zbatimit të saj.

AKSHI ka të implementuara platforma monitorimi/raportimi/alertimi për të gjithë komponentët e infrastrukturës së saj në tërësi, duke përfshirë rrjetin, serverat, parametrat fizik të Datacenter-it (temperatura, lagështia, statusi elektrik, etj). Çdo komponentë i përshkruar më sipër është ndarë në përgjegjësi sipas drejtorive përkatëse si dhe suportohet nga kontrata “SLA” përkatëse.

Udhëzimi i Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr.1159, datë 17.03.2014 “Për hartimin e Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit”, të ndryshuar, është hartuar në zbatim të Vendimit nr.710, datë 21.08.2013 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdimësisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, vendim ky që në varësi të zhvillimeve dhe dinamikës së fushës së teknologjisë dhe informacionit ka pësuar ndryshime në vitin 2016 dhe në vitin 2021.

Tanimë, çdo institucion i cili ka ose do të zhvillojë një sistem në fushën e teknologjisë dhe informacionit, që ofron shërbime për qytetarët, për biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbim informacioni për administratën publike ndërmjet sistemeve elektronike, gjatë hartimit të termave të referencës, të cilat i dërgon për miratim pranë AKSHI-t, përfshin domosdoshmërisht afatin e mirëmbajtjes dhe të gjitha përcaktimet ligjore të përcaktuara në VKM nr.710/2013 si dhe në Udhëzimin nr.1159/2014.

Sqarojmë gjithashtu se, në Rregulloren nr.1, datë 17.01.2022 “Për sigurinë e informacionit” është përcaktuar qartë se Oficeri i Sigurisë së Informacionit është pjesë e personelit të AKSHI-t.

Me nr. 4460 prot., datë 08.07.2022 AKSHI i është drejtuar të gjitha institucioneve që të marrin të gjitha masat e nevojshme për të përfshirë në strukturën e tyre organizative sektorin për ruajtjen e të dhënave për sistemet e tyre në zbatim të përcaktimeve ligjore të VKM nr. 673/2017, duke qënë se përgjegjës për të dhënat janë institucionet që administrojnë sistemet ku ruhen këto të dhëna.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Pretendimet dhe argumentimi tekniko-ligjor i bërë nga ana juaj është vlerësuar dhe marrë në konsideratë, referuar edhe në shkresën tuaj nr. 4460, datë 08.07.2022, drejtuar të gjitha institucioneve për të përfshirë në strukturat e tyre organizative sektorin për ruajtjen e të dhënave për sistemet e tyre, si përgjegjës për vetadministrimin e sistemeve ku ruhen këto të dhëna.

II. Zbatimi i marrëveshjeve të lidhura me institucionet, sistemet e të cilave administrohen nga AKSHI.

Në marrëveshjen tip është dokumentuar fakti se AKSHI si ofrues i shërbimit duhet të krijojë/diskutojë me përfituesin e shërbimit një agjendë periodike kontrollesh si më poshtë:

1. Javore
 - a. Kontroll i logeve të serverëve;
 - b. Kontroll i statistikave të storage;
 - c. Kontroll i statistikave për programe;
 - d. Kontroll i disqeve për problem në rast nevoje;
 - e. Të kryejë mirëmbajtje pro aktive;
2. Mujore
 - a. Testim/kontroll i kompletuar i pjesëve më kritike të infrastrukturës së klientit;
 - b. Kontroll i detajuar i gjithë log-eve hardëare/software;
 - c. Rishikimi i të dhënave mbi performancën e serverave;
 - d. Rekomandime për upgrade të mundshme hardëare.

Nga auditimi nuk rezulton asnjë agjendë periodike kontrollesh e dokumentuar me secilin subjekt që disponon një marrëveshje dhe asnjë dokumentim nëse janë realizuar kontrollet, ashtu sikurse citohet në marrëveshje, të cilat janë përmendur më sipër.

Ajo çfarë ofrohet për sistemet dhe të dhënat nga ana e AKSHI-t është:

- Software/hardware: Instalim/modifikim/riparim i aplikacioneve dhe pjesëve fizike të PC-ve;
- Asistencë sistemesh: Asistencë teknike për pyetje/ çështje që kanë të bëjnë me sisteme të ndryshme;
- Backup i lokalizuar: Backup të të dhënave;
- Hartimi i manualeve: Hartimi i manualeve për sisteme të ndryshme të cilat i vijnë në ndihmë përdoruesve të sistemeve;
- Trajnime: Trajnime stafi mbi sisteme të ndryshme sipas nevojës;

Titulli i gjetjes:	Përshkrimet e punës për specialistët TIK të AKSHI-t përmbajnë detyra të cilat nuk janë në përputhje me shërbimet e katalogut të miratuar me VKM nr.673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar.
Situata:	Nga auditimi mbi zbatimin e marrëveshjeve, rezulton se: <ul style="list-style-type: none"> - Nuk është dokumentuar asnjë agjendë periodike kontrollesh e dokumentuar nga AKSHI me secilin subjekt që disponon një marrëveshje dhe asnjë dokumentim nëse janë realizuar kontrollet, ashtu sikurse citohet në marrëveshje, të cilat janë përmendur më sipër;

	<ul style="list-style-type: none"> - Nuk përcaktohet për specialistët TIK të AKSHI-t, të drejtat që kanë në të dhënat nën administrimin e institucioneve krijuar me ligjet e tyre organike. - Në përshkrimet e punës së punonjësve, u konstatua se në disa raste ata kanë detyra funksionale/përshkrime pune jo në përputhje me shërbimet e katalogut të miratuar me VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar dhe jo në përputhje me marrëveshjen në ato raste që disponohet. <p>Disa nga rastet ku punonjësit kanë në detyrat e tyre sektoriale apo individuale tejkalim të kompetencave që parashikon VKM nr. 673 si dhe marrëveshja ndërmjet palëve janë:</p> <p><i>Në drejtorinë TIK të MFE</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përpunimi i informacionit financiar në Ministrinë e Financave si dhe dizenjimi, implementimi, administrimi, përditësimi dhe mirëmbajtja e bazës së të dhënave financiare si dhe aplikacionit financiar mbështetur në kërkesat funksionale të drejtorive përkatëse dhe mënyrën e shkëmbimit të informacionit në këto drejtori; - Parashikon investimet e reja, bazuar në zgjidhje bashkëkohore, hardëare dhe software; - Krijimi dhe gjenerimi i raporteve të reja nga sistemet financiare të Ministrisë së Financave, në varësi të kërkesave të drejtorive përkatëse; <p><i>Në sektorin TIK të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgjegjësi i sektorit planifikon nevojat për softëare, hardware të institucionit; - Specialisti siguron këshillim teknik dhe planifikim sistemesh; <p><i>Agjencia e Prokurimit Publik</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgjegjësi i sektorit planifikon nevojat për softëare, hardware të institucionit; - Specialisti siguron këshillim teknik për planifikim sistemesh;
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Marrëveshja tip; - VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar;
Efkti:	Tejkalim kompetencash, risk në sigurinë e të dhënave, risk në planifikimin e projekteve TIK.
Shkaku:	Mungesa e dhënies së rëndësisë së duhur
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	AKSHI, si institucion dhënës i shërbimeve TIK, të marrë masa për dokumentimin e kontroleve periodike që kryejnë specialistët e tij në institucionet ku ofrohen shërbime të TIK. Gjithashtu, të rishikohen dhe ripërcaktohen detyrat funksionale të punës që çdo punonjës i AKSHI-t kryen në këto institucione.

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se: Marrëveshja SLA përcakton të drejta dhe detyrime të palëve dhe të gjitha pikat e përcaktuara në këtë marrëveshje për sa kohë shërbimi i ofruar është 24 orë /7 ditë të javës, pra, pa ndërprerje, raportimet janë në mënyrë të vazhdueshme dhe kryhen nëpërmjet komunikimeve

të brendshme në kohë reale ndërmjet palëve. Për rrjedhojë, të gjitha problematikat që mund të hasen, zgjidhen menjëherë nëpërmjet komunikimit të brendshëm të sipër cituar duke mbajtur në dijeni eprorët respektiv.

Në asnjë pikë të marrëveshjes nuk përcaktohet mënyra e dokumentimit të problemeve dhe zgjidhja e tyre duke qënë se aktualisht, të gjitha institucionet përfituese kanë një staf të AKSHI-t të dedikuar dhe të atashuar pranë ambjenteve të tyre për të ofruar suportin e nevojshëm për çdo rast që do të jetë e nevojshme.

Gjithashtu, duke qënë se proceset e përditshme të punës janë shumë dinamike nga të dyja palët si dhe duke marrë në konsideratë faktin që është rënë dakord që të zgjidhet kjo rrugë komunikimi dhe raportimi vlerësojmë se përmbushet plotësisht rekomandimi i dhënë mbi dokumentimin e kontrollove dhe monitorimit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Angazhimi i subjektit për të zbatuar në vijueshmëri rekomandimin me qëllim dokumentimin e kontrollove dhe monitorimit, është marrë në konsideratë nga grupi i auditimit.

Përgjegjësia e AKSHI-t dhe institucioneve të tjera përfituese të shërbimeve është e mirëpërcaktuar në VKM 673/2017 ku në pikën 6 shkronja «y») është përcaktuar se AKSHI është përgjegjës për infrastrukturën teknike dhe të dhënat janë pronësi e vetë institucionit përfitues. *Citojmë : Regjistrat e të dhënave të këtyre institucioneve që përbëhen nga bazat e të dhënave mbeten nën administrim të institucioneve respektive.*

Me shkresa të vazhdueshme drejtuar institucioneve si dhe shkresën e fundit Nr.4460 Prot., datë 08.07.2022, (të cilën e gjeni bashkëlidhur), AKSHI i ka kërkuar institucioneve të marrin masat për zbatimin e VKM-së si dhe të përcaktimit në strukturat e tyre organike një strukturë përgjegjëse për rregjistrin e të dhënave. Kjo pasi janë vetë institucionet të cilat popullojnë me të dhëna sistemet, për të cilat teknikisht është përgjegjës AKSHI, të cilat mbajnë përgjegjësinë lidhur me të dhënat që këto sisteme mbajnë.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Pretendimi se me shkresën nr. 4460, datë 08.07.2022, u është kërkuar institucioneve të marrin masat për zbatimin e kuadrit ligjor rregullator në fuqi, si dhe për sa kohë suporti i AKSHI-t ofrohet në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë, administrimi i dokumentacionit nuk ka ndonjë vlerë të shtuar në mbarëvajtjen e këtyre proceseve teknike të punës, është marrë në konsideratë nga grupi i auditimit.

2.3 Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.

- a. Respektimi i strukturave organike të miratuara.
- b. Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve. Realizimi i fondit të pagave.
- c. Respektimi i dispozitave ligjore për rekrutimin dhe largimin e punonjësve nga puna. Plotësimi i vendeve të lira me kontrata të përkohshme pune. Zbatimi i Vendimeve të Gjykatave.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, është institucion publik qendror, person juridik, me seli në Tiranë, në varësi të Kryeministrit. AKSHI është krijuar me *VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”*.

AKSHI drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e kësaj agjencie. Pranë AKSHI-t krijohet dhe funksionon bordi për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (BTIK), si organ këshillimor për zhvillimin e politikave e të strategjive kombëtare për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit. Bordi asistohet në punën e tij nga një sekretariat teknik.

1. Mbi zbatimin e Strukturës së miratuar në AKSHI:

Nga auditimi rezultoi se gjatë periudhës objekt auditimi struktura dhe organika e agjencisë ka ndryshuar disa herë. Kjo pasi prej vitit 2017 dhe në vazhdim Drejtorisë qendrore i janë bashkuar dhe strukturat e sektorit IT në institucione të tjera. Konkretisht:

- *Me urdhrin nr. 177 datë 10.10.2017* është miratuar struktura organike me një numër total punonjësish prej 153.

- *Me urdhrin nr. 105 datë 31.07.2018* është miratuar struktura dhe organika e institucionit AKSHI me një numër total prej 315 punonjësish. Institucionet e shtuara AKSHI-t janë si më poshtë:

Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Inspektorati Qendror, Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (aparati i MB), Agjencia e Trajtimin të Pronave, Qendra e Botimeve Zyrtare, Shërbimi i Provës, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, Qendra Kombëtare e Biznesit, Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Instituti i Integritimit të ish të përndjekurve politike, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, Departamenti i Administratës Publike, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (miratuar), Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare, Agjencia Kombëtare e Turizmit, Biblioteka Kombëtare, Instituti i Monumenteve të Kulturës, Muzeu Historik Kombëtar, Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Instituti i Shëndetit Publik, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, Qendra Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore, Drejtoritë rajonale të shëndetësisë.

-*Me urdhrin nr. 174 datë 24.12.2019* ku numri i punonjësve ka ndryshuar në 332 punonjës, duke iu bashkuar strukturës së AKSHI-t dhe institucionet e mëposhtme:

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Pyjeve dhe Ujërave, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, punonjës Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Përgjithshme Detare, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Teatri Kombëtar i Operës Baletit dhe Ansambli Popullor, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit, Agjencia e Prokurimit Publik.

-*Me urdhrin nr. 20 datë 03.02.2020* ka pasur disa ndryshime në strukturën e miratuar me urdhrin nr. 174 datë 24.12.2019 duke iu bashkuar strukturës së AKSHI-t dhe institucionet e mëposhtme: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Autoriteti Rrugor Shqipëtar, Drejtoria e Përgjithshme Detare, Teatri Kombëtar i Operës Baletit dhe Ansambli Popullor, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (aparati i MB).

Struktura e planifikuar dhe realizuar për periudhën objekt auditimi 2019- 2021 është si më poshtë vijon:

Struktura sipas Viteve	Numri i institucioneve	Plan	Fakt
Struktura 2017	AKSHI	101	71
<i>Ndryshime me VKM nr.177 datë 10.10.2017</i>	+12	153	73
Struktura 2018	+32	153	111
<i>Ndryshime nr. 105 datë.31.07.2018</i>		315	143
Struktura 2019	+53	315	230
<i>Ndryshime nr.174 datë 24.12.2019.</i>		332	231
<i>Struktura 2020 Ndryshime nr.20 datë. 03.02.2020</i>	+59	332	253
Struktura 2021	+60	332	255

Tabela 1: Struktura dhe ndryshimet për periudhën e auditimit

Nga auditimi nuk janë konstatuar tejkalim i numrit të punonjësve sipas strukturave të miratuara. Megjithatë ka rezultuar se për periudhën objekt auditimi AKSHI qendror dhe Sektorët e IT në institucione kanë shumë pozicione vakante të paplotësuara me staf, ku mesatarisht për 3 vitet e fundit numri i vendeve vakante është 85 pozicione pune. Edhe pse në faqjen zyrtare ka pasur vazhdimisht postime për vende vakante për profilin IT, plotësimi i vendeve të punës ka qenë i vështirë. Kjo mund të shihet dhe si pasojë e numrit të madh të dorëheqjeve të ndodhura muajt e fundit me justifikimin e punësimit në sektorin privat. Aktualisht, në AKSHI-n qendror janë 29 vende vakante për pozicionet përgjegjës sektori dhe specialist dhe janë shpallur 8 njoftime punësimi në faqjen zyrtare. Ndërkohë që në Drejtorinë e Marrëdhënieve E-GOV me Institucionet, TIK në MFE, TIK e Tatimeve, TIK e Doganave, TIK e MSHMS, TIK e Gjendjes Civile dhe TIK e MD janë 52 vende vakante dhe janë shpallur 12 vende vakante. Mosplotësimi i pozicioneve punës sipas strukturës së miratuar, ndjekja e praktikës së autorizimit të punonjësve në dy pozicione drejtuese njëkohësisht dhe krijimi i një numri kaq të madh të vendeve vakante përbën pengesë për kryerjen e punës me eficiencë dhe mbulimin 100% të nevojave nga të gjithë Sektorët e AKSHI-t.

Titulli i gjetjes:	Përditësimi i Rregullores së brendshme
Situata:	Rregullorja e brendshme e AKSHI-t është miratuar nga Këshilli i Ministrave me nr.1900 datë 16.04.2020 dhe gjatë kësaj kohe nuk është përshtatur me ndryshimet në strukturën organizative dhe Kodin e Etikës duke mos ndihmuar në mirëfunksionimin e brendshëm të saj. Nga auditimi është konstatuar se, në rregulloren e brendshme nuk është përcaktuar qarte përshkrimi i punës për çdo pozicion, duke bërë të vështirë identifikimin e detyrave dhe të drejtave që ka çdo punonjës i agjencisë. Janë përcaktuar vetëm funksionet apo detyrat e disa pozicioneve dhe jo përshkrimi i punës për çdo pozicion. Rregullorja e brendshme vazhdon të jetë e njëjta sipas organizimit të mëparshëm të agjencisë pavarësisht se ka pasur ndryshime të strukturës organizative. Gjithashtu, nga auditimi është konstatuar se si pasojë e krijimit të pozicioneve vakante disa punonjës krahas detyrave funksionale të ushtrojnë përgjegjësi dhe detyra të një pozicioni tjetër të autorizuar nga titullari. Ndjekja e kësaj praktike, nuk është e parashikuar dhe e trajtuar në Rregulloren e Brendshme të AKSHI-t. Për menaxhimin e punës në institucion, është e rëndësishme që në Rregulloren e brendshme të trajtohen praktikatat që do të ndiqen në rast se një pozicion pune është vakant dhe është pozicion kyç për të cilin duhet të zëvendësohet në mënyrë të përkohshme deri në momentin e rekrutimit të një punonjësi të ri.
Kriteri:	Neni 21, Kreu IV, dhe Kreu XV, Kontrata Kolektive të Punës, Kodi i punës
Efekti:	Pengesë për mirëfunksionimin e brendshëm
Shkaku:	Ka pasur ndryshime të shpeshta në strukturë
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Titullari i institucioni, të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim, përditësimin dhe miratimin e Rregullores së Brendshme dhe Kodin Etik për organizimin dhe funksionimin e institucionit referuar ndryshimeve që ka pësuar struktura vitet e fundit, me qëllim mirë funksionimin dhe mirë organizimin e institucionit në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe kushtetuese.

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:

Me miratimin e strukturës së re, me Urdhër të Kryeministrit Nr.191, datë 18.11.2022 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit“, AKSHI është në proces draftimi të rregullores së brendshme, pjesë e së cilës janë dhe përshkrimet e punës, ku konkretizohen në mënyrë të detajuar detyrat dhe përgjegjësitë për secilin sektor dhe drejtori.

Me shkresën nr.1101 prot., datë 27.02.2022 është ngrit grupi i punës për hartimin e Rregullores së Brendshme.

Paralelisht jemi duke draftuar edhe Kodin e Etikës pjesë e të cilit do të bëhet edhe Politika Antirryshfet sipas standardit ISO 37001, me të cilin AKSHI u certifikua në vitin 2022.

Gjithashtu, me Vendimin nr.61, datë 8.02.2023, Këshilli i Ministrave ka miratuar propozimin e projektligjit “Për Qeverisjen Elektronike” për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Me hyrjen në fuqi të ligjit, AKSHI do të rishikoj të gjitha aktet nënligjore që kanë lidhje me fushë përgjegjësinë e saj.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Gjetja dhe rekomandimi janë pranuar dhe subjekti ka marrë angazhimin për zbatimin në vijueshmëri të tyre.

2. Mbi rekrutimin e punonjësve sipas kriterëve të përcaktuara.

Marrëdhëniet e punës së punonjësve të AKSHI-it rregullohen me Kodin e Punës dhe niveli i pagave është i rregulluar me VKM nr.187 datë 08.03.2017 “Miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve” dhe VKM nr. 717 datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”.

Gjatë periudhës objekt auditimi ka pasur disa procedura e përfundimit të marrëdhënieve të punës dhe disa procedura rekrutimi. Procesi i rekrutimit të punonjësve kryhet nga vetë institucioni i AKSHI-t. Në faqen zyrtare të institucionit tek rubrika “Njoftime”, bëhen shpalljet për pozicione vakante, ku përcaktohen kriteret dhe detyrat e pozicionit të punës. Kandidatët fitues të fazës së parë kalojnë në fazën e testimit dhe intervistës deri në shpalljen e fituesve final. Lidhur me aktivitetin e AKSHI-t për dy vitet e fundit mbi punësimet e reja dhe procedurat e përfundimit të marrëdhënieve të punës paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Vitet	Largime nga puna (shkurtime)	Largime me doreheqje	Largime nga puna që kanë hapur proces gjyqësor	Punësime të reja
Viti 2020	3	27	0	26
Viti 2021	6	28	0	25

Tabela 2: Procedurat e rekrutimit dhe largimit nga puna/ Burimi MIE

Kryesisht, në dy vitet e fundit në institucionin e AKSHI-t janë vënë re shtimi i numrit të dorëheqjeve si pasojë e mundësive të reja të punësimit në sektorin privat. Për periudhën e pandemisë Covid 19, gjatë vitit 2020- 2021 me vendimin e Kryeministrit nr. 700 datë 09.09.2020 dhe nr. 1151 datë 24.12.2020 pranë AKSHI-t janë punësuar 5 punonjës me kontratë të përkohshme për mirëmbajtjen e Portalit e-albania si pasojë e fluksit të madh të përdoruesve. Në vitin 2020, 3 punonjësit e larguar nga puna janë si pasojë e përfundimit të afatit të kontratës kurse në vitin 2021, është përfundimi i kontratave të përkohshme për 5 punonjësit e rekrutuar me kohë të pjesshme dhe 1 largim me mase disiplinore.

3. Mbi organizimin dhe mbajtjen e dosjeve të personelit.

Nga auditimi i 10 dosjeve të personelit të audituara me përzgjedhje nuk u konstatuan parregullsi në përmbajtjen e dosjeve. Në dosje ishin të gjithë dokumentet e specifikuar në kontratat individuale të punës. Vlerësimi i performancës së punonjësve bëhet çdo 6 muaj dhe dy vlerësime të njëpasnjëshme përbën shkak për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës.

4. Mbi auditimin e shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore:

Shpenzimet e pagave dhe sigurimeve të paguara gjatë periudhës objekt auditimi dhe strukturës së miratuar dhe realizuar ndër vite në institucionin e AKSHI-t paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Viti	Struktura e miratuar		Shpenzime pagash		Shpenzime sigurime sh&Sh	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
2017	153	105	114,760,000	84,486,301	19,035,000	13,469,386
2018	315	154	254,276,000	139,782,906	38,704,000	22,749,852
2019	332	231	319,316,000	228,987,346	56,415,000	43,976,965
2020	315	245	308,816,000	279,043,536	52,415,000	45,963,547
2021	332	251	293,816,000	292,072,424	51,415,000	48,546,075

Tabela 3: Shpenzimet e pagave dhe Kontributet për periudhën e auditimit

Përlllogaritja e pagës bëhet referuar VKM nr.187 datë 08.03.2017 për “Miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve” e cila përfshinë: Paga e grupit , Paga bazë për klasë/ shtesa për pozicioni, Shtesë page për vjetërsi pune, Shtesë page për natyrë të veçantë pune, Shtesë page për funksion drejtues/ për gradë/ për kushte të vecanta shërbimi.

Nga auditimi i dokumenteve për pagat e punonjësve të AKSHI-t (bordero, listepagesa dhe listeprezenca etj) per Vitin 2017: muajt Mars, Gusht dhe Dhjetor, Viti 2020: muajt Mars, Gusht dhe Dhjetor dhe Viti 2021: muajt Mars, Gusht dhe Dhjetor nuk u konstatuan parregullsi.

Nga auditimi i listëpagesave për institucionin AKSHI, rezultoi se përgatitja e tyre është mbështetur në listë prezencat mujore, të plotësuara nga çdo drejtori apo sektor. Listë prezencat mujore për përgatitjen e borderove për punonjësit e institucionit janë bërë në mënyrë të përmbledhur, me numrin e ditëve të punës për çdo muaj të paraqitur nga drejtoritë apo sektorët përkatës.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH në lidhje me parregullsitë e konstatuara për pagat në AKSHI, për vitin 2018 dhe 2019, ka rezultuar se janë rikthyer të gjitha detyrimet e konstatuara për punonjësit si dhe janë mbajtur detyrimet e paguara gabim për periudhën 2018-2019 referuar shkresës nr.7805/1 datë 22.11.2021 “Dërgim informacioni”.

5. Mbi auditimin e Shpenzimeve gjyqësore për largim nga puna:

Nga informacioni i marrë nga drejtoria juridike, ka rezultuar se për proceset gjyqësore të realizuara për periudhën objekt auditimi nuk ka pasur asnjë çështje gjyqësore të përfunduar në gjykatën e Apelit dhe për pasojë nuk ka pasur shpenzime gjyqësore për largim nga puna për këto çështje. Nga auditimi i shpenzimeve ka rezultuar se për periudhën objekt auditimi janë likuiduar shpenzime gjyqësore në vitin 2017 për tre vendime gjyqësore: Vendimi nr.2238 prot dt.14.07.2016, Vendimi nr.2198 prot dt.13.07.16 dhe Vendimi nr.140786-2017-1395 dt.05.04.17 në formën e dëshmperblimit në vlerën totale 3,588,193 lekë dhe një shpenzim në vitin 2018 për Vendimin nr.3140 dt.10.10.2016 në vlerën 535,215 lekë. Në total për periudhën objekt auditimi (2017-2021) vlera e shpenzimeve gjyqësore për largim padrejtësisht nga puna ka qenë në vlerën totale 4,123,408 lekë dhe janë realizuar gjatë viteve 2017-2018. Lidhur me ecurinë e procese gjyqësore për largim padrejtësisht nga puna paraqitet në tabelën e mëposhtme venë në dispozicion nga drejtoria juridike.

Vitet	Numri i çështjeve gjyqësore	Statusi (i fituar /jo/proces)
Viti 2017	5	4 të fituara ne shkallën e parë, 1 pjesërisht e fituar në shkallë të parë, 4 në proces (Ankim nga pala humbese në shkallë të dytë)
Viti 2018	4	2 të fituara në shkallë të parë, 1 pjesërisht e fituar në shkallë të parë, 1 humbur në shkallë të parë, 4 në proces - 2 (Ankim AKSHI) - 2 (Ankim nga pala humbese)

Viti 2019	5 +3	2 të fituara në shkallën e parë, 2 të humbura si palë e tretë në shkallë të parë, 1 pjesërisht e fituar në shkallë të parë, 3 të fituara në Apel nga viti 2017 - 2018 2 në proces (Ankim nga pala humbëse)
Viti 2020	2	2 të fituara në shkallë të parë
Viti 2021	5	4 të fituara në shkallë të parë, 1 në proces gjyqësor 2 në proces Ankim nga pala humbëse)

Tabela 4: Ecuria e procese gjyqësore për periudhën e auditimit

2.4 Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës

Me qëllim vlerësimin e rregullshmërisë së kryerjes së pagesave, u përzgjedhën për auditim mbi bazë të numrit të transaksioneve, muajt korrik, tetor dhe dhjetor të viteve objekt auditimi.

1. Nga auditimi i të dhënave të eksportuara nga SIFQ në lidhje me pagesat e kryera nga AKSHI për periudhën objekt auditimi, u konstatuan gjithsej 3005 raste në vlerën totale 10.4 miliard lekë, pagesat e të cilave janë kryer në tejkalim të afatit 30 ditor nga data e furnitorit, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7, afatet për autoritet publike, pika a) parashikon që kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit dhe procesimit të pagesës në degën e thesarit.

Saktësisht e ndarë sipas viteve, situata paraqitet si më poshtë:

Viti	Numri i rasteve	Vlera totale e faturave (Në lekë)
2017	153	612,651,829
2018	540	1,557,955,014
2019	352	1,178,407,973
2020	1317	3,953,255,927
2021	643	3,118,714,848
Totali	3005	10,420,985,591

Burimi: AKSHI (përpunuar nga grupi i auditimit)

Nga rastet më sipër vlerësojmë më problematike pagesat për faturat e viteve të mëparshme, nga ku rezultojnë 629 raste në total në vlerën **2,695,340,451** lekë, të detajuar si më poshtë:

Viti	Viti i faturës	Numri i rasteve	Vlera totale e faturave (Në lekë)
2017	2016	7	45,890,609
2018	2015	2	240
	2016	5	685,065
	2017	30	99,901,005
2019	2015	2	55,136
	2016	2	396,344
	2017	1	195,148
	2018	85	630,607,201
2020	2018	2	12,102,933
	2019	412	1,511,105,727
2021	2018	1	1,722,000
	2019	1	393,000
	2020	79	392,286,043
Totali		629	2,695,340,451

Burimi: AKSHI (përpunuar nga grupi i auditimit)

Moskryerja në kohë e detyrimeve kontraktuale, krahas shkeljes së dispozitave ligjore, ndikon negativisht në akumulimin e detyrimeve të prapambetura, çka mund të krijojë vështirësi në zbatimin e buxhetit.

Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi, A.Z, S.D, dhe E.S në cilësinë e nëpunësit zbatues sipas periudhave respektive.

2. Nga auditimi i saktësisë të urdhërshpenzimeve për muajt e marrë në shqyrtim, u konstatua se mungon dokumentacioni i plotë justifikues i shpenzimit të kryer nga ana e AKSHI-t, saktësisht:

2.a. Për të gjitha praktikat e pagesave ku është përfituar një mall apo shërbim nga një procedurë prokurimi, mungon urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim (përfshijë këtu rastet ku grupi është përcaktuar në kontratë).

2.b. Mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Kjo problematikë është më e theksuar gjatë viteve 2017 – 2019 dhe ulet në vitet në vijim, detajuar sipas viteve me poshtë.

Për vitin 2017. Për të gjitha urdhërshpenzimet e muajit korrik si dhe për 43 raste për muajt tetor dhe dhjetor 2017, konkretisht:

- USH nr. 473, datë 02.10.2017;
- USH nr. 476, datë 02.10.2017;
- USH nr. 472, datë 02.10.2017;
- USH nr. 436 – 437, datë 27.09.2017, nr. 468, datë 02.10.2017, nr. 524, datë 16.10.2017. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga Y.Ç, E.K, E.H dhe K.H;
- USH nr. 467, datë 02.10.2017;
- USH nr. 438 - 441, datë 26.09.2017. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga N.R, R.K, B.A dhe E.B.
- USH nr. 505, datë 09.10.2017. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga S.Zh dhe A.L;
- USH nr. 509, datë 16.10.2017. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga N.R, L.Ç, B.A dhe E.B.
- USH nr. 512, datë 09.10.2017. Fatura e dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga S.Zh dhe E.Y;
- USH nr. 514, datë 12.10.2017. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga J.R dhe E.B;
- USH nr. 475, datë 02.10.2017, nr. 520 - 521, datë 16.10.2017, nr. 536, datë 23.10.2017. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga F.H;
- USH nr. 525, datë 16.10.2017. Raporti i dorëzuar është nënshkruar nga M.P. Fatura e dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga M.P dhe N.R;
- USH nr. 523, datë 12.10.2017. Fatura e dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga E.S;
- USH nr. 510 - 511, datë 06.10.2017, nr. 519, datë 12.10.2017. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga Xh.Gj;
- USH nr. 526, datë 16.10.2017. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga M.P dhe D.A;
- USH nr. 466, datë 02.10.2017, nr. 532, datë 24.10.2017. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga E.L, E.M dhe F.H;
- USH nr. 469, datë 02.10.2017. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar E.Rr, E.L, I.D, K.H, M.Ç;
- USH nr. 474, datë 02.10.2017. Raporti i dorëzuar është nënshkruar nga A.H dhe N.R;
- USH nr. 488, datë 09.10.2017. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga J.R dhe G.D;
- USH nr. 477, datë 02.10.2017. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga YÇ dhe A.H;
- USH nr. 480, datë 03.10.2017. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga E.K dhe O.Dh;
- USH nr. 481, datë 09.10.2017, nr. 697, datë 28.12.2017. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga I.D dhe G.D;
- USH nr. 513, datë 09.10.2017. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga E.M, B.Adhe E.R;
- USH nr. 471, datë 27.09.2017, nr. 696, datë 28.12.2017. Raporti i dorëzuar nga operatori

ekonomik është nënshkruar nga M.S dhe E.K;

- USH nr. 479, datë 28.09.2017, nr. 691, datë 28.12.2017. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga G.D, E.K dhe D.Xh;
- USH nr. 489, datë 09.10.2017. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga L.Ç, E.S, K.H dhe E.Y;
- USH nr. 699, datë 28.12.2017;
- USH nr. 695, datë 28.12.2017. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga G.D dhe K.D;

Për vitin 2018, u konstatuan në total 274 raste, konkretisht:

- USH nr. 477, datë 05.07.2018, nr. 707, datë 08.10.2018, nr. 752, datë 25.10.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga F.H dhe R.K;
- USH nr. 476, datë 05.07.2018, nr. 706, datë 08.10.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga F.H;
- USH nr. 475, datë 05.07.2018, nr. 705, datë 08.10.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga F.H, E.L dhe E.M;
- USH nr. 474, datë 05.07.2018, nr. 715, datë 08.10.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga B.A dhe E.K;
- USH nr. 472, datë 05.07.2018, nr. 911, nr. 926, datë 27.12.2018, nr. 959, datë 28.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga B.A dhe E.M;
- USH nr. 469, datë 05.07.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga K.H, Y.Ç dhe E.H;
- USH nr. 468, datë 05.07.2018, nr. 503, datë 26.07.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga J.R;
- USH nr. 467, datë 05.07.2018, nr. 703, datë 08.10.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga K.H dhe E.K;
- USH nr. 466, datë 05.07.2018, nr. 696, datë 08.10.2018, nr. 927, datë 27.12.2018, nr. 946, datë 28.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga D.Xh dhe E.K;
- USH nr. 465, datë 05.07.2018, nr. 686, datë 08.10.2018, nr. 896, datë 27.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga O.Dh dhe E.K;
- USH nr. 464, datë 05.07.2018, nr. 708, datë 08.10.2018, nr. 751, datë 25.10.2018, nr. 910, datë 27.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga M.P dhe N.R;
- USH nr. 463, datë 05.07.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga M.P dhe D.A;
- USH nr. 443 - 444, datë 19.06.2018, nr. 741 - 744, datë 24.10.2018, nr. 838 - 839, datë 06.12.2018, nr. 982 - 989, nr. 992 - 994, datë 28.12.2018, nr. 1039 - 1041, datë 31.12.2018, nr. 1019 - 1023, nr. 1025 - 1031, nr. 1045 - 1053, nr. 1070 - 1074, nr. 1076, nr. 1082, nr. 1097 - 1099, datë 28.12.2018, nr. 1150, datë 28.12.2018, nr. 1110 - 1111, nr. 1121 - 1125, nr. 1134 - 1135 dhe nr. 1137 - 1143, datë 31.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga J.Ç;
- USH nr. 436 - 439, datë 19.06.2018, nr. 733 - 738, datë 24.10.2018, nr. 747 - 749, datë 25.10.2018, nr. 837, datë 06.12.2018, nr. 976 - 980, nr. 997, datë 28.12.2018, nr. 1059 - 1062, nr. 1064 - 1065, nr. 1067 - 1069, nr. 1077, nr. 1079, nr. 1081, datë 28.12.2018, nr. 1035 - 1037, nr. 1084, nr. 1086, datë 31.12.2018, nr. 1155-1159, datë 31.12.2018, nr. 1114 - 1120, nr. 1126-1128 dhe nr. 1130-1133, datë 31.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga D.A;
- USH nr. 435, datë 19.06.2018, nr. 516 - 517, datë 26.07.2018, nr. 755 - 758, datë

25.12.2018, nr. 1044, nr. 1056 - 1058, datë 31.12.2018, nr. 1000, nr. 1002 - 1004, nr. 1008 - 1009, nr. 1011 - 1018, nr. 1093 - 1095, datë 28.12.2018, nr. 1108 - 1109, datë 28.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga B.S;

- USH nr. 433 - 434, datë 19.06.2018, nr. 745 - 746, datë 24.10.2018, nr. 840, datë 13.12.2018, nr. 999, datë 28.12.2018, nr. 1005 - 1007, nr. 1042, datë 31.12.2018, 1043, nr. 1096, datë 28.12.2018, nr. 1112 - 1113, datë 31.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga E.M;

- USH nr. 507, datë 26.07.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga S.Zh dhe E.Y;

- USH nr. 508, datë 26.07.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga S.Zh dhe A.L;

- USH nr. 499, datë 24.07.2018. Bashkëlidhur USH gjendet vetëm fatura e dorëzuar nga OE, e cila nuk është nënshkruar nga ndjekësi/t e kontratës. Mungon procesverbali i marrjes në dorëzim;

- USH nr. 712, datë 08.10.2018, nr. 1170, datë 31.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga M.F dhe E.Y;

- USH nr. 711, datë 08.10.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga B.M dhe R.K;

- USH nr. 680, datë 01.10.2018, nr. 704, datë 08.10.2018, nr. 900, datë 27.12.2018, nr. 1179, datë 31.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Fatura e dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga K.D dhe R.K;

- USH nr. 702, datë 08.10.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga E.R, E.M dhe B.A;

- USH nr. 701, datë 08.10.2018, nr. 1168, datë 31.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga M.F dhe A.L;

- USH nr. 699, datë 08.10.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga YÇ, E.K, E.H, K.H dhe A.L;

- USH nr. 697 - 698, datë 25.10.2018, nr. 739 - 740, datë 24.10.2018, nr. 754, datë 25.10.2018, nr. 958, nr. 995, datë 28.12.2018, nr. 1038, datë 31.12.2018, nr. 1153, datë 28.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga Xh.Gj;

- USH nr. 750, datë 25.10.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga J.R dhe S.A;

- USH nr. 717, datë 09.10.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga G.P, E.K dhe B.A;

- USH nr. 719, datë 09.10.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga R.K, J.C dhe J.R;

- USH nr. 718, datë 09.10.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga J.R dhe S.A;

- USH nr. 836, datë 06.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga S.A;

- USH nr. 835, datë 06.12.2018, nr. 895, datë 27.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga G.P, A.Ll dhe G.H;

- USH nr. 834, datë 06.12.2018, nr. 899, datë 31.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga R.K dhe A.Sh;

- USH nr. 833, datë 06.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga R.K dhe A.M;

- USH nr. 831, datë 06.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga Y.Ç, E.K, E.H dhe K.H;

- USH nr. 829, datë 06.12.2018, nr. 932, datë 27.12.2018, nr. 1178, datë 31.12.2018, mungon

procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga G.H;

- USH nr. 931, datë 27.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga YÇ dhe E.H. Mungon nënshkrimi nga K.H dhe E.K;
- USH nr. 898, datë 27.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga R.K, B.M dhe A.M;
- USH nr. 894, datë 27.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga R.K, J.R dhe G.P;
- USH nr. 888 - 893, datë 27.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga E.Q;
- USH nr. 930, datë 27.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga E.Y. Mungon nënshkrimi i M.F;
- USH nr. 929, datë 27.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga A.L. Mungon nënshkrimi i M.F;
- USH nr. 921 - 923, datë 27.12.2018. Bashkëlidhur USH gjendet vetëm fatura e dorëzuar nga OE, e cila nuk është nënshkruar nga ndjekësi/t e kontratës. Mungon procesverbali i marrjes në dorëzim;
- USH nr. 961, datë 28.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga E.M, D.Ç dhe E.L;
- USH nr. 956, nr. 960, datë 28.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga B.A;
- USH nr. 957, datë 28.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga G.P, R.K dhe E.S;
- USH nr. 954 - 955, datë 28.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga G.H dhe E.K;
- USH nr. 947, datë 28.12.2018. Bashkëlidhur USH gjendet vetëm fatura e dorëzuar nga OE, e cila nuk është nënshkruar nga ndjekësi/t e kontratës. Mungon procesverbali i marrjes në dorëzim, si dhe raporti i shërbimit;
- USH nr. 945, datë 28.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga O.Dh, E.K, E.Q dhe E.S;
- USH nr. 1001, nr. 1033 - 1034, nr. 1054, nr. 1063, nr. 1066, nr. 1075, nr. 1078, nr. 1080, datë 28.12.2018, nr. 1083, nr. 1085, nr. 1087 - 1089 dhe nr. 1091, datë 31.12.2018. Mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik fatura nuk janë të nënshkruara nga ndjekësi/t e kontratës;
- USH nr. 1166, datë 31.12.2018. Bashkëlidhur USH gjendet vetëm fatura e dorëzuar nga OE, e cila është nënshkruar nga V.B dhe E.M. Mungon procesverbali i marrjes në dorëzim, si dhe raporti i dorëzuar nga OE;
- USH nr. 1154, datë 31.12.2018, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Fatura dhe Raporti nuk janë të nënshkruara nga asnjë punonjës i AKSHI-t;
- USH nr. 1145 - 1146 dhe nr. 1149, datë 28.12.2018. Bashkëlidhur USH gjendet vetëm fatura e dorëzuar nga OE. Mungon procesverbali i marrjes në dorëzim si dhe raporti mujor i mirëmbajtjes. Fatura është firmosur vetëm nga A.M. Mungon firma e personit tjetër të ngarkuar për ndjekjen e kontratës A.LI (referuar kontratës nr. 4488, datë 07.09.2018);
- USH nr. 1144, nr. 1147 - 1148, datë 31.12.2018. Mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti mujor i mirëmbajtjes është firmosur vetëm nga A.M. Mungon firma e personit tjetër të ngarkuar për ndjekjen e kontratës A.LI (referuar kontratës nr. 4488, datë 07.09.2018);

Për vitin 2019, u konstatuan në total 50 raste, konkretisht:

- USH nr. 486, datë 16.07.2019, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga B.P dhe A.M;

- USH nr. 484, datë 16.07.2019, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga P.L;
- USH nr. 436, datë 02.07.2019, dhe nr. 482, datë 16.07.2019, nr. 860, datë 23.12.2019, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga E.K dhe O.Dh;
- USH nr. 431, nr. 433 – 435, datë 02.07.2019, dhe nr. 478 - 481, datë 16.07.2019, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga Xh.Gj;
- USH nr. 447, datë 16.07.2019, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga D.Xh dhe E.D;
- USH nr. 437, datë 16.07.2019, nr. 845, datë 03.12.2019, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga R.K, G.H dhe S.S;
- USH nr. 432, datë 02.07.2019, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga D.Xh dhe K.H.;
- USH nr. 427, datë 02.07.2019, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga P.L;
- USH nr. 495, datë 24.07.2019, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga R.K dhe G.H;
- USH nr. 669 - 670, nr. 690 - 691, datë 18.10.2019, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga P.L dhe A.M;
- USH nr. 817 - 819, datë 16.12.2019, nr. 824, nr. 826 -833, datë 17.12.2019, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga A.L;
- USH nr. 918 - 921, datë 31.12.2019, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga G.P;
- USH nr. 923 -936, nr. 940, datë 31.12.2019, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga K.D dhe R.K;
- USH nr. 913 - 915, datë 31.12.2019, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga G.P, A.LI dhe G.H;
- USH nr. 854, datë 20.12.2019, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Fatura e dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga E.Z;
- USH nr. 941 - 943, datë 31.12.2019, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Fatura e dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga E.K dhe D.Xh;

Për vitin 2020, u konstatuan në total 35 raste, konkretisht:

- USH nr. 839, datë 16.07.2020, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga A.D dhe M.P;
- USH nr. 870, datë 29.07.2020, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga V.B;
- USH nr. 871, nr. 879, datë 29.07.2020, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga M.T;
- USH nr. 872, datë 29.07.2020, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga E.D dhe I.R;
- USH nr. 873 - 874, nr. 886, datë 29.07.2020, nr. 1022, datë 05.10.2020, nr. 1024, datë 06.10.2020, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga Xh.Gj;
- USH nr. 1147, datë 28.10.2020, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga D.Xh;
- USH nr. 1158 - 1160, datë 28.10.2020, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga P.L dhe A.M;
- USH nr. 1181, datë 29.10.2020, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i

dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga R.K, A.M dhe B.M;

- USH nr. 1182, datë 29.10.2020, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga G.P;
- USH nr. 1036, nr. 1038, datë 09.10.2020, nr. 1387, datë 03.12.2020, nr. 1614 - 1615, datë 31.12.2020, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga I.R dhe R.D;
- USH nr. 1463 - 1466, datë 14.12.2020, nr. 1595 - 1597, datë 31.12.2020, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga E.M dhe B.A;
- USH nr. 1488, datë 17.12.2020, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga A.D dhe M.P;
- USH nr. 1509, datë 28.12.2020, nr. 1603, datë 31.12.2020, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga E.S dhe G.P;
- USH nr. 1510 - 1511, datë 28.12.2020, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga K.D;
- USH nr. 1558, datë 31.12.2020, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga P.L dhe A.M;
- USH nr. 1578, datë 31.12.2020, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Fatura e dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga D.K;

Për vitin 2021, u konstatuan në total 22 raste, konkretisht:

- USH nr. 608, datë 26.07.2021, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga D.Xh dhe I.R;
- USH nr. 931 - 940, datë 20.12.2021, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga D.A dhe B.L;
- USH nr. 910 - 911, datë 15.12.2021, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga E.Ç dhe I.Q;
- USH nr. 952 - 953, datë 23.12.2021, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga E.Q dhe A.H;
- USH nr. 968 – 973, nr. 975, datë 31.12.2021, mungon procesverbali i marrjes në dorëzim. Raporti i dorëzuar nga operatori ekonomik është nënshkruar nga B.K, A.V, A.T dhe A.O;

2.c. Mungon dokumentacioni i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për kryerjen e shpenzimeve të rasteve të udhëtimeve jashtë vendit, konkretisht:

- USH nr. 538, datë 23.10.2017, “Udhëtim jashtë shtetit”, vlera 64,800 lekë. Bashkëlidhur USH mungojnë elementët për vërtetësinë e kryerjes së shërbimit, si biletat e udhëtimit apo konfirmim për marrjen pjesë në aktivitet.
- USH nr. 962, datë 28.12.2018, “Udhëtim jashtë shtetit”, vlera 368,015 lekë. Bashkëlidhur USH mungon urdhri apo autorizimi i titullarit për kryerjen e shërbimit. Mungojnë elementët për vërtetësinë e kryerjes së shërbimit, si biletat e udhëtimit apo konfirmim për marrjen pjesë në aktivitet.
- USH nr. 949, datë 28.12.2018, “Udhëtim jashtë shtetit”, vlera 70,812 lekë. Bashkëlidhur USH mungon urdhri apo autorizimi i titullarit për kryerjen e shërbimit. Mungojnë elementët për vërtetësinë e kryerjes së shërbimit, si biletat e udhëtimit apo konfirmim për marrjen pjesë në aktivitet.
- USH nr. 948, datë 28.12.2018, “Udhëtim jashtë shtetit”, vlera 70,812 lekë. Bashkëlidhur USH mungon urdhri apo autorizimi i titullarit për kryerjen e shërbimit. Mungojnë elementët për vërtetësinë e kryerjes së shërbimit, si biletat e udhëtimit apo konfirmim për marrjen pjesë në aktivitet.
- USH nr. 475, datë 05.07.2019, është kryer pagesa për bileta avioni në vlerën 95,202 lekë. Krahas itinerarit të udhëtimit, nuk ka asnjë dokumentacion për arsyet e kryerjes së udhëtimit si dhe nuk ka dokumenta justifikues të kryerjes së shërbimit.

- USH nr. 841, datë 03.12.2019, është kryer pagesa për bileta avioni në vlerën 110,700 lekë. Krahas itinerarit të udhëtimit, nuk ka asnjë dokumentacion për arsyet e kryerjes së udhëtimit si dhe nuk ka dokumenta justifikues të kryerjes së shërbimit.

- USH nr. 842, datë 03.12.2019, është kryer pagesa për bileta avioni në vlerën 84,132 lekë. Krahas itinerarit të udhëtimit, nuk ka asnjë dokumentacion për arsyet e kryerjes së udhëtimit si dhe nuk ka dokumenta justifikues të kryerjes së shërbimit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

- Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 të Ministrit të Finacave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 52, ku citohet: “Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë nëse fletëhyrja ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si procesverbali i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, fletëhyrje origjinale, procesverbal i marrjes në dorëzim të mallit, etj”.

- Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 të Ministrit të Finacave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 35 ku citohet: “Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në:

a) *Dokumente autorizuese* - janë ato dokumente që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomik e që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues. Të tilla janë urdhrat e blerjeve, kontratat, urdhri për krijimin e komisioneve, urdhër për nxjerrje jashtë përdorimit, etj.

b) *Dokumente vërtetuese* - vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.

c) *Dokumente të kontabilitetit* - janë dokumentet përmbledhëse, ose regjistrat kontabël (libri i madh, librat analitikë, kartelat e aktiveve, etj.) të çdo lloji forme, bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese”.

- Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 të Ministrit të Finacave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 36 ku citohet: “Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë, si dhe atë të mashtrimeve”.

- VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Neni 77 “Mbikëqyrja e kontratës”, pika 3 “Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi”.

Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi, A.Z, S.D, dhe E.S në cilësinë e nëpunësit zbatues sipas periudhave respektive, si dhe grupet e marrjes në dorëzim.

3. Nga auditimi u konstatua se AKSHI për periudhën objekt auditimi ka paguar vlerën **574,991 lekë shërbimin e telefonisë nga 3 operatorë ekonomikë privat, në mungesë të kontratës, dhe pa kryer procedurë prokurimi, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 4 “Fusha e zbatimit”, konkretisht:**

a. Për V.Al (telefoni) janë paguar **190,134 lekë**, saktësisht për vitin 2017 janë kryer 23 pagesa në vlerën totale 106,134 lekë, për vitin 2018 janë kryer 23 pagesa në vlerën totale 67,200 lekë, për vitin 2019 janë kryer 11 pagesa në vlerën totale 13,200 lekë, dhe për vitin 2020 janë kryer 3 pagesa në vlerën totale 3,600 lekë. Për këtë shërbim nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si dhe nuk ka asnjë kontratë të lidhur ndërmjet AKSHI-t dhe V.Al.

b. Për Al Sa (telefoni) janë paguar **174,000 lekë**, saktësisht për vitin 2017 janë kryer 10 pagesa në vlerën totale 60,000 lekë, për vitin 2018 janë kryer 9 pagesa në vlerën totale 54,000 lekë, dhe për vitin 2019 janë kryer 10 pagesa në vlerën totale 60,000 lekë. Për këtë shërbim nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si dhe nuk ka asnjë kontratë të lidhur ndërmjet AKSHI-t dhe Al Sa.

c. Për Al tel (telefoni) janë paguar **210,857 lekë**, saktësisht për vitin 2017 janë kryer 11 pagesa në vlerën totale 78,768 lekë, 2018 janë kryer 11 pagesa në vlerën totale 78,768 lekë, dhe për vitin 2019 janë kryer 9 pagesa në vlerën totale 53,321 lekë. Për këtë shërbim nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si dhe nuk ka asnjë kontratë të lidhur ndërmjet AKSHI-t dhe Al tel.

Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi A.Z, S.D, dhe E.S në cilësinë e nëpunësit zbatues sipas periudhave respektive.

4. Nga auditimi u konstatua se me USH nr. 690, datë 28.12.2017 është paguar vlera 8,327,213 lekë në favor të operatorit ekonomik “M.sha”. Në total (sëbashku me pagesat e mëparshme) në favor të OE janë paguar 11,327,213 lekë. Kontrata me nr. 3290 prot., datë 31.10.2017 me objekt “Mbi Promovimin e Çertifikatave Elektronike, familjare dhe personale të DPGJC”, lidhur mes AKSHI-t dhe OE rezulton të jetë me vlerë 12,960,000 lekë. Diferenca ndërmjet vlerës së kontratës dhe vlerës së paguar vjen si pasojë e faktit se realizimi i kontratës nuk është i plotë. Saktësisht në formularin e ofertës kohëzgjatja e shërbimeve është 2 muaj, ndërkohë nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur urdhër shpenzimit rezulton se realizimi është bërë për 1 muaj e 21 ditë. Diferenca e ditëve është zbritur në pagesën e kryer nga AKSHI.

Nga sa më sipër rezulton se kontrata *nuk është realizuar sipas kushteve të nënshkruara*. Në këto kushte, kur kontrata nuk realizohet sipas parashikimeve, si dhe mungon procesverbali i marrjes në dorëzim.

Për këtë mbajnë përgjegjësi S.D në cilësinë e nëpunësit zbatues, G.D dhe K.D në cilësinë e ndjekësve të kontratës.

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:

Kontrata e lidhur me operatorin ekonomik “M.sha” me Nr. 3290 Prot., datë 31.10.2017 me objekt “Mbi Promovimin e Çertifikatave Elektronike, familjare dhe personale të DPGJC”, lidhur mes tij dhe AKSHI-t, me vlerë 12,960,000 lekë është një kontratë e cila është lidhur për një periudhë 2 mujore. Realizimi i kësaj kontrate u bë për një periudhë 1 muaj e 20 ditë ku operatori ekonomik nuk u pagua për pjesën e mbetur të kontratës.

Konkretisht, referuar edhe në përshkrimin e bërë nga ana juaj, diferenca e ditëve është zbritur në pagesën e kryer nga AKSHI, por nuk rezulton të jetë mbajtur si penalitet garancia 10% e sigurimit të kontratës.

Referuar akteve rregullatore në fushën e prokurimit publik, penaliteti prej 10% mbahet në rastet kur kontrata nuk është realizuar sipas kërkesave. Nuk vlerësojmë se jemi përpara këtij rasti, pasi operatori ekonomik e përmbushi detyrimin e tij edhe më përpara kohës së përcaktuar. Në rast se do të kishim vonesa dhe realizimi i kësaj kontrate do të ishte bërë pas kësaj periudhe 2 mujore, atëherë do të ishim në kushtet e mbajtjes se garancisë. E konsiderojmë këtë rekomandim si të pambështetur në ligj.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Pretendimet e paraqitura janë vlerësuar dhe marrë në konsideratë nga grupi i auditimit, duke bërë edhe pasqyrimin e tyre në Raportin Përfundimtar të auditimit.

5. Nga auditimi u konstatua se me USH nr. 713, datë 08.10.2018, është kryer pagesa 68,001 lekë në favor të OE “E.G Shpk”. Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur, u konstatua se kjo vlerë përbën diferencë të faturës tatimore me nr. 223066595 datë 16.05.2017 me vlerë 548,218.6 lekë. Sipas fletëhyrjes së magazinës nr. 20 datë 16.05.2017, rezulton se furnizimi për mallrat e prokuruar nuk është bërë i plotë, pasi janë dorëzuar 200 copë A4 (me vlerë 68,001 lekë) më pak nga sa kërkuar. Për këtë arsye në vitin 2017 janë paguar vetëm 480,217 lekë. Pas një korrespondence ndërmjet OE dhe AKSHI-t, është kryer pagesa e mbetur e faturës fillestare të dorëzuar nga OE, por nuk ka dokumentacion që të vërtetojë se është plotësuar diferenca e mallit të munguar. OE kërkon vlerën e mbetur pasi pretendon se fatura e tij është nënshkruar, ndërkohë sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim dhe fletëhyrjes në magazinë kanë ardhur vetëm mallra në vlerën 480,217 lekë. Në të tilla kushte, kur kemi një faturë të nënshkruar, edhe pse lëvrimi nuk rezulton të jetë i rregullt, është paguar vlera **68,001 lekë**. Kjo vlerë **përbën dëm ekonomik** për buxhetin e shtetit pasi është përfituar pa të drejtë nga OE “E.G Shpk”.

Për këtë mbajnë përgjegjësi, A.Z në cilësinë e nëpunësit zbatues, dhe K.D në cilësinë e ndjekësit i cili ka nënshkruar faturën tatimore edhe pse kjo e fundit nuk është konform mallit të lëvruar.

6. Në zbatim të kontratës nr. 2082 prot., datë 19.04.2019, lidhur me OE “AB Shpk”, me vlerë 24,276,232 lekë pa TVSH ose 29,131,478 lekë me TVSH, me objekt “Paraqitje në version 360° dhe broshurat përkatëse për 94 site turistike”, është kryer pagesa me 3 pjesë, të cilat janë sipas urdhër shpenzimeve si më poshtë:

- USH nr. 805, datë 17.12.2019, është paguar vlera 2,829,456 lekë, sipas faturës së OE me nr. serial 76814602, datë 05.08.2019. Akti i marrjes në dorëzim me nr. 4692/1 prot., datë 05.08.2019, nënshkruar nga E.S dhe D.Xh.

- USH nr. 806, datë 17.12.2019, është paguar vlera 15,622,531 lekë, sipas faturës së OE me nr. serial 76814583, datë 10.07.2019. Akti i marrjes në dorëzim me nr. 3766/1 prot., datë 10.07.2019, nënshkruar nga E.S dhe A.L.

- USH nr. 807, datë 17.12.2019, është paguar vlera 10,679,491 lekë, sipas faturës së OE me nr. serial 76814557, datë 21.06.2019. Akti i marrjes në dorëzim me nr. 3367/1 prot., datë 21.06.2019, nënshkruar nga E.S dhe A.L.

Referuar kushteve të përgjithshme të kontratës, neni 3 “Kohëzgjatja e kontratës”, citohet: “Zbatimi i kontratës do të fillojë me lidhjen e kontratës dhe do të vazhdojë për 11 javë implementim”. Duke qenë se kontrata është nënshkruar në datën 19.04.2019, afati maksimal i realizimit të kontratës është data **05.07.2019**.

Me shkresën nr. 2917 prot., datë 30.05.2019 OE ka kërkuar një shtyrje të afatit prej 30 ditësh, kërkesë e bazuar në nenin 19, pika 4, të kontratës së lidhur. Ky nen citon: “*Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e forcës madhore*”. Argumenti i paraqitur nga OE është: “*Duke qenë se lista e 94 zonave të propozuara për kryerjen e këtij shërbimi ende nuk na është vënë në dispozicion, edhe pse kanë kaluar 4 javë nga nisja e projektit si dhe duke qenë se afati kohor për zbatimin e projektit është shumë i shkurtër, kërkojmë zbatjen e afatit për një periudhë prej 30 ditësh nga data e dorëzimit të kësaj shkrese*”.

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:

Duke qenë se lista e 94 zonave të propozuara për kryerjen e këtij shërbimi u vendos në dispozicion me vonesë dhe duke pasur parasysh se afati i realizimit të kontratës ishte i shkurtër nga ana e OE u kërkuar një shtyrje e afatit të përfundimit të kontratës.

Në kushtet kur ka një marrëveshje mes të dy palëve dhe kërkesa e OE është pranuar nga AK atëherë nuk vlerësojmë se jemi në mospërmbushje të kushteve të kontratës dhe për pasojë, nuk mund të kemi vlerë të mbajtur për realizim me vonesë kontrate.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në vlerësimin e grupit të auditimit argumenti i përdorur nga ana juaj është vlerësuar dhe marrë në konsideratë, me argumentin se: Kemi një marrëveshje midis palëve të cilat kanë të drejtën të modifikojnë dhe të ndryshojnë afatet. Në këtë rast nuk mund të aplikohen penaltitete për një marrëveshje që është lidhur e miratuar midis palëve.

7. Nga auditimi i dokumentacionit të pagesave, u konstatua se USH nr. 454 - 456, datë 04.07.2019 kanë bashkëlidhur vetëm faturën e operatorit ekonomik të panëshkruar nga grupi i marrjes në dorëzim. Nisur nga këto pagesa u shqyrtua i gjithë dokumentacioni i zbatimit të kësaj kontrate, i cili rezultoi me po të njëjtën problematikë. Pagesat janë kryer në zbatim të kontratës nr. 715, datë 11.02.2019 të lidhur ndërmjet AKSHI-t dhe OE "InsMB", me vlerë 730,060 lekë pa TVSH ose 876,072 lekë me TVSH. Operatori ekonomik nuk ka dorëzuar raporte shërbimi, në kundërshtim me nenin 6 të kushteve të veçanta të kontratës "Kërkesat e raportimit", ku citohet "Gjatë zgjatjes së kontratës, kontraktori duhet të sigurojë raportime mujore për Autoritetin Kontraktor sipas formularit të mëposhtëm: procesverbal sipas përcaktimeve të specifikimeve teknike bashkëlidhur kontratës". Mungesa e procesverbaleve të marrjes në dorëzim dhe mungesa e nënshkrimit të faturave nga personat përgjegjës për zbatimin e kontratës, janë në kundërshtim me nenin 8 të kushteve të veçanta të kontratës, ku për kryerjen e pagesës citohet "Pas konfirmimit nga personi i autorizuar nga AKSHI për ndjekjen e kryerjes së shërbimeve dhe do të kryhet me këste mujore".

Sa më sipër vlerësojmë se kushtet e kontratës rezultojnë të papërmushura dhe të pakonfirmuara. **Vlera e paguar prej 876,072 lekë me TVSH për vitin 2019 është e pajustificuar dhe përbën dëm ekonomik.**

Për këtë mbajnë përgjegjësi E.S në cilësinë e nëpunësit zbatues, si dhe I.Xh dhe E.K në cilësinë e personave të autorizuar për ndjekjen e kontratës.

8. Nga auditimi i veprimeve me bankë rezultuan parregullsi për pagesat e kontratës nr. 1120 prot., datë 19.02.2020 "Loti 2 Shërbim interneti dhe Intraneti për institucionet Publike, seksioni SHSSH" lidhur me OE "A. sha". Saktësisht për:

- USH nr. 875, datë 29.07.2020, me vlerë 11,040 lekë;
- USH nr. 876, datë 29.07.2020, me vlerë 13,800 lekë;
- USH nr. 877, datë 29.07.2020, me vlerë 13,800 lekë;
- USH nr. 878, datë 29.07.2020, me vlerë 13,800 lekë;
- USH nr. 1089, datë 20.10.2020, me vlerë 13,800 lekë;
- USH nr. 1011, datë 02.10.2020, me vlerë 13,800 lekë;
- USH nr. 1411, datë 04.12.2020, me vlerë 13,800 lekë;
- USH nr. 1607, datë 31.12.2020, me vlerë 13,800 lekë;
- USH nr. 1610, datë 31.12.2020, me vlerë 13,800 lekë;

Në raportin e dorëzuar nga operatori ekonomik konstatohet se në kolonën "Disponueshmëria e shërbimit (SLA)" ka mungesë. **Pra sipas vetë raportit të dorëzuar nuk ka pasur shërbim.**

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:

Referuar kontratës Nr.1120 Prot., datë 19.02.2020 me objekt Loti 2 "Shërbimi internetit dhe intranetit për institucionet publike" – Seksioni SHSSH Internet, për implementimin e shërbimit në drejtorinë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë (Zyra e Kempeve), referuar dhe dokumentacionit mujor me Nr. 1490 Prot., datë 01.04.2020, protokolluar me tonën me Nr.1729 Prot., datë 01.04.2020, shërbimi është instaluar dhe aktivizuar më datë 06.03.2020, datë kjo e cila konfirmohet edhe nga korrespondenca si bashkëlidhur (e-mail datë 06/03/2020) me institucionin dhe operatorin ekonomik.

Në vijim, për implementimin dhe zbatimin e kontratës OE “Alb” ka provuar se e ka ofruar shërbimin me SLA = 100 % për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës, dhe për këtë na ka vendosur në dispozicion (print screen/foto) grafikun e përdorimit të trafikut të internetit nga platforma e monitorimit të shërbimit prej institucionit si edhe export, print screen/foto nga platforma e ndjekjes së problematikave dhe incidenteve ku verifikohet se shërbimi për këtë lidhje për periudhën 06.03.2020-31.12.2020 nuk është reklamuar asnjë incident dhe nga institucioni nuk ka patur asnjë problematikë.

Sa më sipër, bashkëlidhur do të gjeni dhe konfirmimin nga IT e Institucionit Z. B.H ku konfirmohet se shërbimi ka qenë aktiv gjatë periudhës 06.03.2020 deri më 31.12.2020.

Për këtë arsye konfirmojmë që nuk ka asnjë dëm ekonomik në këtë rast, pjesa e raportit që ka mungesë shënimi do të thotë që nuk ka patur rënie/mungesë internet në atë periudhë.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Pretendimet e paraqitura, shoqëruar me dokumentacionin referues janë vlerësuar dhe marrë në konsideratë nga grupi i auditimit duke bërë edhe reflektimet përkatëse në raportin përfundimtar të auditimit.

9. Nga auditimi u konstatua se me USH e mëposhtme janë paguar në total **20,035 lekë** për ISSH si gjobë për deklaram të vonuar, konkretisht:

- USH nr. 642, datë 01.10.2019, pagesë 289 lekë “Gjobë deklaram i vonuar, Janar 2015”.
- USH nr. 643, datë 01.10.2019, pagesë 1,903 lekë “Gjobë deklaram i vonuar, Tetor 2015”.
- USH nr. 644, datë 01.10.2019, pagesë 2,843 lekë “Gjobë deklaram i vonuar, Nëntor 2015”.
- USH nr. 645, datë 01.10.2019, pagesë 5,000 lekë “Gjobë deklaram i vonuar, Maj 2017”.
- USH nr. 646, datë 01.10.2019, pagesë 5,000 lekë “Gjobë deklaram i vonuar, Qershor 2017”.
- USH nr. 647, datë 01.10.2019, pagesë 5,000 lekë “Gjobë deklaram i vonuar, Janar 2018”.

Për këtë mbajnë përgjegjësi S.D në cilësinë e nëpunësit zbatues në periudhat e deklaruara me vonesë.

10. Nga auditimi u konstatuan 3 raste të pagesave pjesore të faturave, në kundërshtim me ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor ku njohja e shpenzimit bëhet në castin e konstatimit dhe pagesa e tij bëhet brenda 30 ditëve. Evidentimi i këtyre rasteve u krye nga të dhënat e SIFQ, duke e kryer testimin mbi masën totale. Më poshtë paraqiten rastet e konstatuara:

- USH nr. 668, datë 11.10.2019, me anë të të cilit i kërkohet thesarit kryerja e pagesës 47,900,000 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur konstatohet se fatura tatimore e paraqitur nga operatori ekonomik ka vlerën 137,766,948 lekë;
- USH nr. 912, datë 31.12.2019, me anë të të cilit i kërkohet thesarit kryerja e pagesës 75,000 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur konstatohet se fatura tatimore e paraqitur nga operatori ekonomik ka vlerën 95,000 lekë;
- USH nr. 1536, datë 31.12.2020, me anë të të cilit i kërkohet thesarit kryerja e pagesës 6,439,362,000 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur konstatohet se fatura tatimore e paraqitur nga operatori ekonomik ka vlerën 38,699,046 lekë;

Theksojmë se kjo ka efekt në krijimin e detyrimeve të prapambetura në kushtëzimin e procesimit të transaksioneve të pjesshme në sistem, veprime që nuk japin siguri për vlerën reale të shpenzimeve apo investimeve të raportuara.

11. Nga auditimi, u konstatua se për vitin 2021, janë zhvilluar 2 procedura me vlerë të vogël, me objekt dhe mallra të ngjashme, duke copëzuar fondin. Vlera e tyre totale e kalon limitin e blerjeve me vlera të vogla, në kundërshtim me neni 28 pika 2 të ligjit ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku citohet “Nuk lejohet pjesëtimi apo ndarja e vlerës së kontratës publike për shmangien nga dispozitat e parashikuara në këtë ligj”.

Procedura	Vlera e kontratës (Në lekë)
Blerje dollapë, dollapë klasifikator dhe dosje për dollapë klasifikator	650,000
Blerje pajisje për zyrat	810,000

Sa më sipër mban përgjegjësi E.S në cilësinë e përgjegjësit të prokurimeve për vitin 2021.

Titulli i gjetjes:	Kryerja e pagesave në shkelje të afatit 30 ditor.
Situata:	Nga auditimi i të dhënave të eksportuara nga SIFQ në lidhje me pagesat e kryera nga AKSHI për periudhën objekt auditimi, u konstatuan gjithsej 3005 raste në vlerën totale 10.4 miliard lekë , pagesat e të cilave janë kryer në tejkalim të afatit 30 ditor nga data e furnitorit, veprim në kundërshtim me Ligjin Nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7, afatet për autoritet publike, pika a) parashikon që “kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit dhe procesimit të pagesës”. Moskryerja në kohë e detyrimeve kontraktuale, krahas shkeljes së dispozitave ligjore, ndikon negativisht në akumulimin e detyrimeve të prapambetura, çka mund të krijojë vështirësi në zbatimin e buxhetit.
Kriteri:	Ligji Nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”.
Efekti:	Krijimin e detyrimeve të prapambetura.
Shkaku:	Kryerja me vonesë e pagesave për kontratat e lidhura.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Sektori i Financës në vijimësi të marrë masa për shlyerjen brenda afatit 30 ditor të detyrimeve të lindura, me qëllim shmangien e krijimit të detyrimeve të prapambetura.

Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi, A.Z, S.D, dhe E.S në cilësinë e nëpunësit zbatues sipas periudhave respektive.

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:
 AKSHI ka patur probleme me likuidimin e faturave brenda afatit 30 ditor, pasi faturat dhe raportet për projektet e implementimit apo mirëmbajtjes vinin me vonesë pranë sektorit të financës. Kjo vonesë vinte për shkak se raportet dhe faturat vinin në AKSHI fizikisht, ndjekësit e kontratës të cilët kryesisht janë nëpër institucione sillnin vonesa për firmosjen e tyre, këto reflektoheshin në vonesa në likuidimin e faturave.
 Mosdorëzimi i plotë i dokumentacionit nga operatori apo ndjekësit e kontratës, për të vazhduar me shlyerjen e detyrimit. Mungesa e fondeve, ku AKSHI-it i akordohet buxhet më i ulët sesa ka kërkuar, pavarësisht shkresave të shumta për Fonde përgjatë vitit.
 Duke pasur parasysh sa më sipër, vonesa AKSHI ngriti “Sistemit të menaxhimit të kontratave” i cili rezultoi të ishte shumë efikas, duke minimizuar vonesat në likuidim, dhe duke arritur të mos ketë asnjë vonesë të tillë për vitin 2022do të rishikoj të gjitha aktet nënligjore që kanë lidhje me fushë përgjegjësinë e saj.
Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Pretendimet se likuidimet me vonesë të faturave kanë ardhur si rezultat i paraqitjes me vonesë të tyre nga subjektet të cilat i depozitonin ato dorazi, apo edhe mos dorëzimi i plotë i tyre është marrë në konsideratë.

Titulli i gjetjes:	Mangësi dokumentuese në praktikat e urdhër shpenzimeve.
Situata:	<p>Nga auditimi i praktikave të urdhër shpenzimeve për muajt e përzgjedhur mbi bazë risku, u konstatua se mungon dokumentacioni i plotë justifikues i shpenzimit të kryer nga ana e AKSHI-t, në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 30, datë 27.12.2011 të Ministrit të Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 35, 36 dhe 52, si dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Neni 77 “Mbikëqyrja e kontratës”, pika 3.</p> <p>Konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për të gjitha praktikat e pagesave ku është përfituar një mall apo shërbim nga një procedurë prokurimi, mungon urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim (përfshijë këtu rastet ku grupi është përcaktuar në kontratë); - Mungon procesverbali i marrjes në dorëzim në 424 raste. Kjo problematikë është më e theksuar gjatë viteve 2017 – 2019 dhe ulet në vitet në vijim; c. Mungon dokumentacioni i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për kryerjen e shpenzimeve të rasteve të udhëtimeve jashtë vendit në 7 raste.
Kriteri:	Udhëzimi Nr. 30, datë 27.12.2011 të Ministrit të Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
Efekti:	Nuk krijohet siguria e arsyeshme mbi rregullshmërinë e procedurave të ndjekura për pagesat.
Shkaku:	Nuk respektohen dispozitat për dokumentacionin e nevojshëm të urdhër shpenzimeve.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Spektori i Financës në vijimësi të marrë masa për plotësimin e praktikave të urdhër shpenzimeve me dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si procesverbali i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, fletëhyrje origjinale, procesverbal i marrjes në dorëzim të mallit, etj.

Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi, A.Z, S.D, dhe E.S në cilësinë e nëpunësit zbatues sipas periudhave respektive, si dhe grupet e marrjes në dorëzim.

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:

Financa mbas konstatimit se në vitet e mëparshme ka patur raste ku mungonte procesverbali i marrjes në dorëzim në AKSHI, pasi ky procesverbal ndodhej në institucionin përfitues, ka marrë masat e nevojshme që dhe AKSHI të ketë 1 kopje të procesverbalit të marrjes në dorëzim.

Gjithashtu janë marrë masa që në vazhdim i gjithë dokumentacioni justifikues të jetë në AKSHI, në asnjë rast nuk do të ketë mungesë të këtij dokumentacioni.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Gjetja dhe rekomandimi janë pranuar dhe subjekti ka marrë angazhimin për zbatimin në vijueshmëri të tyre.

Titulli i gjetjes:	Likujdim faturash për shërbime të pa prokuruar dhe në mungesë të kontratave.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se AKSHI për periudhën objekt auditimi ka paguar vlerën 574,991 lekë shërbimin e telefonisë nga 3 operatorë ekonomikë privat, në mungesë të kontratës, dhe pa kryer procedurë prokurimi, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 4 “ <i>Fusha e zbatimit</i> ”. Konkretisht për V.Al janë paguar 190,134 lekë, për Al Sa janë paguar 174,000 lekë, dhe për Al tel janë paguar 210,857 lekë.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
Efekti:	Nuk krijohet siguria e arsyeshme mbi rregullshmërinë e procedurave të ndjekura për pagesat.
Shkaku:	Mungesa e kryerjes të procedurave të prokurimit dhe kontratave të lidhura.
Rëndësia:	E ulët
Rekomandimi:	Në vijimësi AKSHI të marrë masa për kryerjen procedurës së prokurimit për shërbime të cilat janë objekt i ligjit për prokurimin publik. Sektori i Financës në vijimësi të marrë masa për mos likuidimin e faturave në mungesë të kontratave të lidhura.

Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi, A.Z, S.D, dhe E.S në cilësinë e nëpunësit zbatues sipas periudhave respektive.

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:
 AKSHI ka marrë masa që asnjë faturë të mos likujdohet pa patur kontrata të lidhura. Përsa i përket pagesës së vlerës prej 574,991 lekë për shërbimin e telefonisë nga 3 operatorë telefonikë, ju bëjmë me dije se këto janë kontrata të shumë viteve më parë.
 Për operatorin telefonik A.S.C. ekziston kontrata nr.869 Prot, datë 01.11.2011 « Kontratë shërbimi « Blerje shërbim telefonie ». Po të njëjta janë dhe kontratat e dy operatorëve të tjerë të cilat janë të vitit 2011. Bashkëlidhur do të gjeni kontratën e ASC TrCo.
Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Gjetja dhe rekomandimi janë pranuar dhe subjekti ka marrë angazhimin për zbatimin në vijueshmëri të tyre.

Titulli i gjetjes:	Pagesë për një shërbim të pakryer.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se pagesa për faturën tatimore me nr. 223066595 datë 16.05.2017 me vlerë 548,218.6 lekë nuk është bërë e plotë pasi operatori ekonomik “E.G Shpk” ka dorëzuar 200 copë A4 (me vlerë 68,001 lekë) më pak nga sa kërkuar, vërtetuar kjo me procesverbalin e marrjes në dorëzim dhe fletëhyrjes së magazinës nr. 20 datë 16.05.2017. Për këtë arsye në vitin 2017 janë paguar në favor të “E.G Shpk” vetëm 480,217 lekë. Pas një korrespondence ndërmjet OE dhe AKSHI-t, është kryer pagesa e mbetur e faturës fillestare të dorëzuar nga OE, por nuk ka dokumentacion që të vërtetojë se është plotësuar diferenca e mallit të munguar. OE kërkon vlerën e mbetur pasi pretendon se fatura e tij me vlerë 548,218.6 lekë është nënshkruar nga marrësi në dorëzim, ndërkohë sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim dhe fletëhyrjes në magazinë kanë ardhur vetëm mallra në vlerën 480,217 lekë.

	Në të tilla kushte, duke qenë se fatura është nënshkruar, edhe pse lëvrimi nuk rezulton të jetë i rregullt, është paguar vlera 68,001 lekë . Kjo vlerë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit pasi është përfituar pa të drejtë nga OE “E.G Shpk”.
Kriteri:	VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
Efekt:	Dëm ekonomik në vlerën 68,001 lekë.
Shkaku:	Nënshkrim i faturës tatimore, edhe pse furnizimi ishte jo i plotë.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	AKSHI të kërkojë në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës 68,001 lekë nga “E.G Shpk”. Kjo vlerë përbën dëm ekonomik pasi është paguar për një furnizim të pa kryer.

Për këtë mbajnë përgjegjësi A.Z në cilësinë e nëpunësit zbatues, dhe K.D në cilësinë e ndjekësit i cili ka nënshkruar faturën tatimore edhe pse kjo e fundit nuk është konform mallit të lëvruar.

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:
Për të shmangur shpenzimet gjyqësore, AKSHI do t’i drejtohet shoqërisë “E.G”sh.p.k., për arkëtimin e vlerës 68,001 lekë në llogarinë bankare të AKSHI-t.
Nëse kjo vlerë nuk do të arkëtohet brenda afatit që do të vendoset, atëherë AKSHI të kërkojë në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative.
Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Gjetja dhe rekomandimi janë pranuar dhe subjekti ka marrë angazhimin për zbatimin në vijueshmëri të tyre.

Titulli i gjetjes:	Pagesë për një shërbim të pakryer.
Situata:	Nga auditimi i pagesave të kryera në zbatim të kontratës nr. 715, datë 11.02.2019 të lidhur ndërmjet AKSHI-t dhe OE “InsMB”, me vlerë 730,060 lekë pa TVSH ose 876,072 lekë me TVSH, u konstatua se operatori ekonomik nuk ka dorëzuar raporte shërbimi, në kundërshtim me nenin 6 të kushteve të veçanta të kontratës “Kërkesat e raportimit”, ku citohet “Gjatë zgjatjes së kontratës, kontraktori duhet të sigurojë raportime mujore për Autoritetin Kontraktor sipas formularit të mëposhtëm: procesverbal sipas përcaktimeve të specifikimeve teknike bashkëlidhur kontratës”. Gjithashtu mungojnë procesverbalet e marrjes në dorëzim dhe faturat nuk janë të nënshkrimit nga personat përgjegjës për zbatimin e kontratës, në kundërshtim me nenin 8 të kushteve të veçanta të kontratës, ku për kryerjen e pagesës citohet “Pas konfirmimit nga personi i autorizuar nga AKSHI për ndjekjen e kryerjes së shërbimeve dhe do të kryhet me këste mujore”. Sa më sipër, duke qenë se kushtet e kontratës rezultojnë të pa përmbushura dhe të pakonfirmuara nga personat përgjegjës, vlerësojmë se vlera e paguar prej 876,072 lekë me TVSH për vitin 2019 është e pajustificuar dhe përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.
Kriteri:	VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kontrata nr. 715, datë 11.02.2019.
Efekt:	Dëm ekonomik në vlerën 876,072 lekë.
Shkaku:	Operatori ekonomik nuk ka përmbushur kontratën.
Rëndësia:	E lartë

Rekomandimi:	AKSHI të kërkojë në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës 876,072 nga “InsMB”. Kjo vlerë përbën dëm ekonomik si pasojë e realizimit me vonesë të kontratës.
---------------------	---

Për këtë mbajnë përgjegjësi E.S në cilësinë e nëpunësit zbatues, si dhe I.Xh dhe E.K në cilësinë e personave të autorizuar për ndjekjen e kontratës.

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:

InsMB ka patur kontratë me AKSHI për implementimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit Financiar sistem me të cilin ka punuar dhe vazhdon të punojë Sektori i Financës dhe magazina e AKSHI-t. Për ndjekjen e këtij projekti ishin caktuar dy punonjëse të financës E.K dhe I.Xh, punonjëse që kanë punuar gjatë gjithë kohës me këtë sistem. Duke qënë se kanë qënë të angazhuara dhe duke parë që nuk kanë patur asnjë problem me sistemin kanë vazhduar me pagesat duke neglizhuar firmosjen e raporteve dhe procesverbaleve mujore.

Pra shërbimi është kryer në mënyrë korrekte nga InsMB dhe për këtë shërbim është bërë dhe pagesa prej 876,072 lekë nga ana e AKSHI-t.

Pavarësisht se kontrata e mirëmbajtjes me IMB ka përfunduar, sektori i financës vazhdon të punojë me programin ALPHA pa asnjë problem apo mangësi.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në vlerësimin e grupit të auditimit argumenti i përdorur nga argumenti i përdorur nga ana juaj. Grupi i auditimit ka konstatuar se mungojnë procesverbalet e marrjes në dorëzim dhe faturat nuk janë të nënshkrimit nga personat përgjegjës për zbatimin e kontratës, në kundërshtim me nenin 8 të kushteve të veçanta të kontratës, ku për kryerjen e pagesës citohet “*Pas konfirmimit nga personi i autorizuar nga AKSHI për ndjekjen e kryerjes së shërbimeve dhe do të kryhet me këste mujore*”, në këtë mënyrë nuk justifikohet pagesa në favor të kontraktorit.

Nga auditimi u konstatuan 3 raste të pagesave pjesore të faturave, në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku njohja e shpenzimit bëhet në çastin e konstatimit dhe pagesa e tij bëhet brenda 30 ditëve. Evidentimi i këtyre rasteve u krye nga të dhënat e SIFQ, duke e kryer testimin mbi masën totale. Konkretisht:

-USH nr. 668, datë 11.10.2019, me anë të të cilit i kërkohet thesarit kryerja e pagesës 47,900,000 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur konstatohet se fatura tatimore e paraqitur nga operatori ekonomik ka vlerën 137,766,948 lekë.

-USH nr. 912, datë 31.12.2019, me anë të të cilit i kërkohet thesarit kryerja e pagesës 75,000 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur konstatohet se fatura tatimore e paraqitur nga operatori ekonomik ka vlerën 95,000 lekë.

-USH nr. 1536, datë 31.12.2020, me anë të të cilit i kërkohet thesarit kryerja e pagesës 6,439,362,000 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur konstatohet se fatura tatimore e paraqitur nga operatori ekonomik ka vlerën 38,699,046 lekë.

Pagesat pjesore ka efekt në krijimin e detyrimeve të prapambetura në kushtëzimin e procesimit të transaksioneve të pjesshme në sistem, veprime që nuk japin siguri për vlerën reale të shpenzimeve apo investimeve të raportuara.

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:

Përpara kryerjes së çdo prokurimi njësie e prokurimit, në zbatim të udhëzimit të Ministrit të Financave mbi zbatimin e buxhetit, merr konfirmimin për angazhimin e fondeve buxhetore. I gjithë dokumentacioni shoqëruar dhe vërtetues i pasjes së fondeve buxhetore në momentin e

marrjes së angazhimit, në respektim të udhëzimit të Ministrit të Financave mbi zbatimin e buxhetit, ka qënë pjesë e dosjes e cila i është vënë në dispozicion grupit të auditimit.

Lidhur me pagesat e kryera, bashkëlidhur do të gjeni të gjithë dokumentacionin provues lidhur me kryerjen e këtyre pagesave.

AKSHI që nga viti 2020 nuk ka bërë asnjë prokurim pa marrë konfirmim me shkrim nga Drejtoria e Financës për angazhimin e fondeve buxhetore.

Gjithashtu, ndër masat që ka marrë AKSHI për zbatimin e këtij rekomandimi është që prej muajit Janar 2023, me hartimin dhe të rregjistrimit të parashikimeve publike për vitin 2023, për çdo prokurim të parashikuar, përpara publikimit të procedurës në sistemin e APP, do kërkojë informacion me e-mail tek sektori Financës lidhur me fondet e vëna në dispozicion. Sektori i Financës miraton me shkrim fondin përkatës për fillimin e procedurës.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Pretendimet e paraqitura, shoqëruar me dokumentacionin referues janë vlerësuar dhe marrë në konsideratë nga grupi i auditimit duke bërë edhe reflektimet përkatëse në raportin përfundimtar të auditimit.

Titulli i gjetjes:	Copëzim fondi për dy procedura me vlera të vogla.
Situata:	Nga auditimi, u konstatua se për vitin 2021, janë zhvilluar 2 procedura me vlerë të vogël, me objekt dhe mallra të ngjashme, duke copëzuar fondin. Konkretisht “Blerje dollapë, dollapë klasifikator dhe dosje për dollapë klasifikator” me vlerë kontrate 650,000 lekë dhe “Blerje pajisje për zyrat” me vlerë kontrate 810,000 lekë. Vlera e tyre totale e kalon limitin e blerjeve me vlera të vogla, në kundërshtim me neni 28 pika 2 të ligjit ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku citohet “ <i>Nuk lejohet pjesëtimi apo ndarja e vlerës së kontratës publike për shmangien nga dispozitat e parashikuara në këtë ligj</i> ”.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
Efekti:	Copëzim fondi.
Shkaku:	Zhvillimi i ndarë i procedurave.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Njësia e prokurimit në vijimësi të tregojë kujdes gjatë zhvillimit të procedurave me vlera të vogla, duke respektuar limitin total vjetor të mallrave të njëjta apo të ngjashme.

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:

Gjatë hartimit të Rregjistrimit të Parashikimeve për vitin 2023, janë analizuar dhe identifikuar nevojat kryesore vjetore të AKSHI-t duke mbajtur në konsideratë realizimet e prokurimeve përgjatë vitit 2022 për të bërë dhe një rakordim më efikas të këtyre nevojave.

Sqarojmë se procedurat me vlerë të vogël të realizuara janë të ndryshme por që përmbajnë një element të përbashkët, pra vlenë për tu theksuar se në procedurën e realizuar “Blerje pajisje për zyrat” e cila është realizuar në kushtet e një emergjence pasi u miratuan ndryshimet strukturore për AKSHI-n dhe për të siguruar mbarëvajtjen e punës të institucionit është përfshirë vetëm një zë, e njëjta vlera totale e këtij zëri në të dyja procedurat që nuk kalon vlerën e blerjes së vogël, si rrjedhojë procedura nuk mund të konsiderohet si copëzim i fondit pasi janë procedura të ndryshme.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Gjetja dhe rekomandimi janë pranuar dhe subjekti ka marrë angazhimin për zbatimin në vijueshmëri të tyre.

2.5 Auditimi i Llogarive vjetore

Në zbatim të pikës 4 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë

1. Formati 1- Pasqyra e pozicionit financiar;
2. Formati 2- Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve;
3. Formati 3- Pasqyra e flukseve monetare;
4. Formati 4- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto;
5. Formati 5- Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore;
6. Formati 6- Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre;
7. Formati 7- Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto (si dhe regjistri i aktiveve);
8. Formati 8- Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

a. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” .

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi, përjashtuar disa mangësi të trajtuara në vijimësi.

Auditimi u krye në lidhje me dy drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit, si dhe kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin e përgjithshëm (ku janë regjistruar dhe veprimet e bankës), konform udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Për çdo vit të veçantë të periudhës objekt auditimi, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe kërkesave të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018, pasqyrat financiare janë përpiluar dhe dërguar në afat për miratim në Degën e Thesarit Tiranë.

Rezultoni se, veprimet kontabël janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi. Llogaritë vjetore, si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve të programit dhe ato të realizuara nga AKSHI, situacione këto të rakorduara me degën e Thesarit.

PF është shoqëruar me relacionin shpjegues, sipas udhëzimit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), me situacionin përfundimtar të shpenzimeve si dhe llogaridhënien vjetore.

Në bazë të të dhënave kontabël përkatëse janë përpiluar Pasqyrat e llogaridhënies vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor që janë raportuar.

- për vitin 2020 janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 1938, datë 25.03.2021 “Për dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor” duke respektuar afatet ligjore.

Sa sipër ka gjetur zbatimin paragrafi 117, i Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, që përcakton se;

“Njësitë e qeverisjes qendrore janë të detyruara të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore individuale të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksionit dhe pas marrjes së konfirmimit nga kjo e fundit, një kopje dërgohet në ministrinë apo institucionin qendror përkatës sipas varësisë, dhe një kopje tjetër në zyrën e statistikave të rrethit”.

Nga ana tjetër, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit i është raportuar rregullisht Degës së Thesarit.

b. Plotësia e pasqyrave financiare, për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

Auditimi i llogarive performancës financiare

Nga auditimi i gjendjes së llogarive rezultoi se, evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konfirmo rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike dhe ato analitike.

Totali i ardhurave të funksionimit në “Pasqyrën e Përformancës” është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit (formati nr.2).

Për vitin 2020 paraqiten si më poshtë vijon:

i. Të ardhurat (grupi A, pasqyra F2) = 3,613 milionë lekë

ii. Shpenzimet (grupi B, kolona 74 e F2) = 3,612 milionë lekë

iii. Rezultati i ushtrimit (llog.85) = 0.776 milionë lekë

Totali ii + iii = 3,613 milionë lekë

Për vitin 2020, llogaria 63 “Ndryshimit të gjendjes së inventarit” në Formatin nr. 1 të Pasqyrave Financiarë Vjetore, (diferenca midis tepricës më 31.12.2019 me 31.12.2020, përkatësisht 5,092 mijë – 4,316 mijë), rezulton e barabartë sa llogaria 63 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit” në Pasqyrën nr. 2 “Performancë financiare e institucionit” prej (776) mijë lekë.

c. Analiza e posteve kryesore të pasqyrës së “Pozicionit Financiar”.

Nga auditimi dhe verifikimi i llogarive të pasqyrës rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me pasqyrat financiare dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike.

Sipas pasqyrës së pozicionit financiar vjetore rezulton se:

- “Aktivet afatgjata” zënë 99% të vlerës totale të aktivit, ndërsa “Aktivet Afatshkurtra” zënë 1% të totalit.

Aktivet qarkulluese

Aktivet Afatshkurtra përbëhet nga shuma e nën rubrikave që përfaqësojnë: mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, gjendje inventari qarkullues, llogari të arkëtueshme dhe të tjera aktive afatshkurtra.

Lekë				
Nr.	Ref. Llogarive	Emërtimi	Viti 2020	Viti 2019
2		I. Aktivet Afat shkurtra	56,918,020	37,388,230
3		1.Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre	7,615,671	7,615,671
4	531	Mjete monetare në Arkë		
6	520	Disponibilitete në Thesar	24,466,271	7,615,671
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	5,092,214	4,316,157
12	31	Materiale	5,092,214	4,316,157
13	32	Inventar i imët		
21		3.Llogari te Arkëtushme	27,359,535	25,456,402
22	411	Klientë e llogari të ngjashme		

23	423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba		
24	431	Tatim e Taksa		
32	468	Debitorë të ndryshëm		
33	4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	27,359,535	25,456,402
36		4.Të tjera aktive afatshkurtra		
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme		

Burimi: AKSHI, përpunuar nga grupi i auditimit

- Llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”: Sipas UMFE nr. 8, datë 09.03.2018, Pika 49: Njësitë të cilat trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk do të kryejnë mbylljen e llogarisë së disponibiliteteve në thesar dhe kjo llogari do të pasqyrohet për tepricën debitorë të saj në aktivet e Pasqyrës së Pozicionit Financiar. Gjithashtu, llogaria 520 nuk mbyllet edhe për gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466), si dhe për sponsorizimet e tjera të trashëgueshme.

Pasqyrimi në vlerën në vlerën 24,466,271 lekë përfaqëson derdhjet gabim nga individë/biznese për pagesat elektronike për marrjen e shërbimit për “Nënshkrim elektronik” dhe “Certifikatë elektronike”, të cilat janë kapitalizuar nga thesari në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

Klasa 3 “Gjendja e inventarit”, në fund të vitit 2020, rezulton në vlerën 5,092,214 lekë. Në krahasim me vitin 2019 është rritur në vlerën 776,057 lekë, nga rritja e zërit “Materiale” po në këtë vlerë. Diferenca (776,057) lekë përkon me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

Pasqyrimi në pozicionin financiar i të drejtave dhe detyrimeve.

Llogari të arkëtueshme:

- Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetit debitor” paraqitet në vlerën 27,359,535 lekë dhe përfaqëson detyrimet që ka AKSHI ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2020, përkatësisht për pagat në vlerën 17,814,629 lekë, për tatim taksa në vlerën 2,162,340 lekë, për sigurime shoqërore në vlerën 6,568,121 lekë dhe sigurime shëndetësore në vlerën 814,445 lekë.

Situata e Detyrimeve të Prapambetura:

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” nuk është paraqitur drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar. AKSHI ka njohur shpenzimet në momentin e likuidimit të faturave ndaj palëve të treta dhe jo në momentin e konstatimit të detyrimit.

Titulli i Gjetjes:	<i>Mosnjohja e detyrimeve sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara</i>
Situata:	<p>Nga auditimi i zërave të aktiveve afatshkurta u konstatua se llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” nga AKSHI është paraqitur në vlerën 0 lekë çdo vit financiar.</p> <p>Nga analiza e pagesave të realizuara në SIQF u konstatua se AKSHI në vitin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2018 ka likuiduar fatura të lëshuara në vitet 2015,2016 dhe 2017; - 2019 ka likuiduar fatura të lëshuara në vitet 2016,2017 dhe 2018; - 2020 ka likuiduar fatura të lëshuara në vitet 2019 dhe 2018, <p>vlerat e të cilave nga institucioni duhet të ishin kontabilizuar si detyrime në momentin e lëshimit të faturave tatimore nga furnitori (të marrjes së mallrave dhe shërbimeve në dorëzim), dhe jo në momentin e momentin e likuidimit të faturave ndaj palëve të treta.</p> <p>Sa më sipër, AKSHI ka njohur shpenzimet në momentin e likuidimit të faturave ndaj palëve të treta dhe jo në momentin e konstatimit të detyrimit veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Paragrafi 3.3 “Klasa 4 përfaqëson në</p>

	<i>përgjithësi ngjarjet apo fenomenet që kanë ndodhur dhe duhet të trajtohen kontabilisht, sipas parimit të të drejtave e detyrimeve të konstatuara</i> . Nga pikëpamja e kontabilitetit, regjistrimet për detyrimet e prapambetura nga AKSHI duhet të ishte pasqyruar duke: • Debituar llogarinë përkatëse 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura” dhe • Kredituar llogarinë përkatëse 467 “Kreditorë të ndryshëm”.
Kriteri:	Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 61, Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, paragrafi 3.3.
Ndikimi/Efekti:	Mosnjohja e shpenzimeve/investimeve në momentin e konstatimit të tyre, po në momentin që likuidohen detyrimet ndaj palëve të treta jep një pamje jo të drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të institucionit, si dhe ndikon në një planifikim jo të drejtë të nevojave të institucionit për fonde buxhetore.
Shkaku:	Njohja e shpenzimeve dhe investimeve në momentin e likuidimit të faturave ndaj palëve të treta dhe jo në momentin e marrjes së shërbimit/mallit në dorëzim.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Spektori i Financës të marrë masa në vazhdimësi, që në momentin e marrjes së dokumentacionit financiar nga palët e treta, të bëjë regjistrimin kontabël duke kredituar llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe duke debituar llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura”.

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:

Spektori i Financës synon që çdo detyrim të shlyhet brenda afateve ligjore, kur për arsye të ndryshme kjo nuk ndodh. Me mbylljen e vitit Financiar këto detyrime të prapambetura regjistrohen në Sitemin e SIFQ, si dhe i dërgohen me shkresë zyrtare dhe email Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Degës së Thesarit Tiranë. (bashkëlidhur komunikimet).

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Gjetja dhe rekomandimi janë pranuar dhe subjekti ka marrë angazhimin për zbatimin në vijueshmëri të tyre.

Aktivet afatgjata

Në analizë aktivet:

Në formatin nr. 1 “Aktivet e Afatgjata” në vlerën neto prej 5,026 milionë lekë, janë të pasqyruara sipas zërave më poshtë, “Aktive Afatgjata jo materiale” në vlerën neto 1,314 milion dhe “Aktive Afatgjata materiale” në vlerën neto 3,712 milion lekë.

<i>Lekë</i>				
Nr.	Ref. Llogarive	Emërtimi	Viti 2020	Viti 2019
42		II. Aktivet Afat gjata	5,026,692,630	4,348,406,786
43	20	1. Aktivet Afatgjata jo materiale	1,314,450,596	1,660,832,291
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kërkime	153,408,072	181,752,236
46	203	Koncesione, Patenta, Licenca e te ngjashme	1,161,042,524	1,479,080,055
47	21	2. Aktivet Afatgjata materiale	3,712,242,034	2,687,574,495
48	210	Toka, Troje, Terrene	63,208,109	3,335,945
49	211	Pyje, Plantacione		
50	212	Ndërtesa e Konstruksione	313,214,841	329,473,258
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	191,115,391	218,015,569
52	214	Instalime teknike, makineri e pajisje	2,849,901,833	1,972,545,309
53	215	Mjete Transporti	2,188,855	2,736,069
54	216	Rezerva Shtetërore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	256,241,035	125,096,375
57	24	Aktive afatgjata te dëmtuara	36,371,970	36,371,970
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
62		4. Investime		

63	230	Për Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Për Aktive Afatgjata materiale		

Burimi: AKSHI, përpunuar nga grupi i auditimit

- Llogaria 202 “*Studime dhe kërkime*” paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën neto prej 153,408,072 lekë, përbërë nga vlera e softwareve dhe sistemeve.

- Llogaria 203 “*Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme*”, paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën neto prej 1,161,042,524 lekë, ku sipas regjistrimit të aktiveve përfshin vlerën e programeve kompjuterike, Software, Licenca etj. Gjatë vitit 2020 ka pësuar rritje në vlerën bruto prej 28,683,659 lek, si rezultat i kalimit kapital pa pagesë, nga APP të pajisjeve për sistemin e ri dhe të vjetër të Prokurimit Elektronik në vlerën prej 27,313,559 lekë dhe të pajisjeve për ‘Datacenter Rack 11’ në vlerën 334,356 lekë, nga Ministria e Kulturës të ‘Licencave E-galaxy’ në vlerën prej 1,035,744 lekë, si dhe pakësim në vlerën prej 381,118.8 lekë i një “Cisco 2921-SEC/K9” kaluar tek UK Pogradec.

Vlera e paraqitur në Formatin nr.7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” përputhet me vlerën e konstatuar nga Komisioni i Inventarizimit.

Titulli i Gjetjes:	Llogaria 210 “ <i>Toka, Troje, Terrene</i> ”.
Situata:	<p>Nga auditimi i zërave të aktiveve afatgjata u konstatua se</p> <p>- Llogaria 210 “<i>Toka, Troje, Terrene</i>” paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën neto prej 63,208,109 lekë. Gjatë vitit 2020 ka pësuar rritje në vlerën bruto prej 59,872,164 lekë, si rezultat i kalimit kapital pa pagesë, nga APP të pajisjeve për sistemin e ri dhe të vjetër të Prokurimit Elektronik (site primare) vendosur në “Datacenter server” në vlerën 57,763,993 lekë, si dhe i kalimit kapital pa pagesë, nga Ministria e Kulturës të sistemit të biletarisë elektronike (vendosur në datacenter server), të cilat kanë të bëjnë me server dhe licenca të regjistruara nga magazina në vlerën neto prej 2,108,171 lekë. Këto aktive janë keqklasifikuar që në momentin e regjistrimit, pasi nuk kemi të bëjmë me toke, troje terrene, por me aktive, të cilat janë implementuar në sisteme ekzistuese, të cilat kanë rritur vlerën e tyre. Mos pasqyrimi dhe kontabilizimi i saktë i aktiveve ka ndikuar në vlerën e fondit neto të institucionit si dhe vlerën neto të aktiveve.</p> <p>Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “<i>Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme</i>”, Klasa 2 “<i>Aktivitet Afatgjata</i>”, me paragrafi 3.6 “<i>Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto</i>” dhe me VKM-në nr. 25, datë 20.01.2011 “<i>Për disa ndryshime të vendimit nr. 248 datë 10.04.1998 për miratimin e planit kontabël publik</i>”.</p>
Kriteri:	<p>Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “<i>Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme</i>”, paragrafi 3.6.</p> <p>VKM-në nr. 25, datë 20.01.2011 “<i>Për disa ndryshime të vendimit nr. 248 datë 10.04.1998 për miratimin e planit kontabël publik</i>”.</p>
Ndikimi/Efekti:	Mos pasqyrimi dhe kontabilizimi i saktë i aktiveve ka ndikuar në vlerën e fondit neto të institucionit si dhe vlerën neto të aktiveve.
Shkaku:	Keq klasifikimi i regjistrimit kontabël nga AKSHI të aktiveve
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	- Sektori i financës së AKSHI-it të marrë masa për sistemimin e shumës 59,872,164 lekë nga llogaria 210 “ <i>Toka, Troje, Terrene</i> ” në llogarinë 214 “ <i>Instalime Teknike makineri, pajisje</i> ”, zë në të cilën janë regjistruar “ <i>Datacenter-at</i> ”.

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:

Janë kosto historike të mbartura ndër vite, AKSHI është duke parë të gjitha mënyrat për sistemimin e këtyre diferencave.

AKSHI do të ngrëjë një grup pune për verifikimin e rekomandimeve të lëna, nga do të identifikohen përgjegjësit për të cilët do të merren masa.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Gjetja dhe rekomandimi janë pranuar dhe subjekti ka marrë angazhimin për zbatimin në vijueshmëri të tyre.

- Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione”, paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën neto prej 313,214,841 lekë, përbërë nga vlera e godinës së AKSHI-it. Gjatë vitit 2020 ka pësuar rritje në vlerën bruto prej 219,825 lekë si rezultat i riparimeve të brendshme të godinës realizuar me blerje të vogël.

- Llogaria 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore”, paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën neto prej 191,115,391 lekë, ku sipas regjistrimit të aktiveve përfshin vlerën e kabëllave të fibrave, implementim dhe instalime software, instalime fizike të lidhjes së kamerave dhe pajisjeve të rrjetit Lan etj. Gjatë vitit 2020 ka pësuar rritje në vlerën bruto prej 178,800 lekë nga blerja e një “Trau elektrik”, si dhe kalimit kapital pa pagesë nga APP, në vlerën bruto prej 17,717,203 lekë të pajisjeve për sistemin e ri dhe të vjetër të Prokurimit Elektronik (SPE).

Vlera e paraqitur në Formatin nr.7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” përputhet me vlerën e konstatuar nga Komisioni i Inventarizimit.

- Llogaria 214 “Instalime Teknike makineri, pajisje”, paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën neto prej 2,849,901,833 lekë. Gjatë vitit 2020 ka pësuar ndryshime, si rezultat i blerjeve të realizuara gjatë vitit në vlerën prej 1,836,919,084 lekë, si dhe nga kalimi kapitali pa pagesë nga Inspektorati Qendror në vlerën 62,070,047.52 lekë, nga APP në vlerën prej 56,081,981 lekë dhe nga Ministria e Kulturës në vlerën prej 755,769 lekë.

Titulli i Gjetjes:	Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike). Llogaria 214 “Instalime Teknike makineri, pajisje”.
Situata:	Nga auditimi i zërave të aktiveve afatgjata u konstatua se Vlera e paraqitur në Formatin nr. 7/a ‘Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)’ nuk përputhet me vlerën e konstatuar nga Komisioni i Inventarizimit, e cila rezulton në vlerën prej 4,584,430,819, me një diferencë në shumën bruto prej 72,721,176 lekë më pak se vlera e paraqitur në pasqyrën financiare, vlerë për të cilën komision nuk ka bërë krahasimi me vlerën e regjistruar në librat përkatës të sektorit të financës, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 85 germa b, ku citon “Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës, të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe, për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë procesverbalet”. - Gjithashtu nga analiza e lëvizjes së aktiveve me kalim kapitali pa pagesë u konstatua se, AKSHI ka të dokumentuar me dokumentacion bashkëngjitur, bazuar në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, në kapitullin III të udhëzimit “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, vetëm vlerën prej 4,934,277 lekë. Nga komisioni i inventarizimit të “Datacenter” është vendosur shuma prej 410,221,868 lekë, si dalje nga magazina pa numër sasive, vlerë e cila është e pa dokumentuar me dokumentacion justifikues.

	<p>- Në Formatin nr.7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” nga sektori i financës pakësimi është pasqyruar në vlerën 552,881,443 lekë me një vlerë më shumë prej 137,725,298 lekë, vlerë për të cilën nuk ka asnjë koment dhe dokumentacion shoqëruës.</p> <p>Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre” dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Klasa 2 “Aktivet Afatgjata”, me paragrafi 3.6 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”.</p>
Kriteri:	Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”; Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Klasa 2 “Aktivet Afatgjata”, me paragrafi 3.6.
Ndikimi/Efekti:	Veprimet kontabël të pasqyruara nga Sektori i financës në “Pasqyrën financiare” kanë efekte material dhe jo të përhapura, duke ndikuar në rezultatin e Institucionit dhe në pasqyrimin jo të drejtë të fondeve neto të tij.
Shkaku:	Mospasqyrim, dhe kontabilizim të vlerave të aktiveve në mënyrë të drejtë.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	<p>- Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të AKSHI-it të analizojnë rezultatin e dalë nga komisioni inventarizimit dhe për diferencat e konstatuara, nga krahasimi i vlerës së aktiveve të pasqyruara në pasqyrat financiare dhe atyre të rezultuara nga inventarizimi për llogarinë 214 “Instalime Teknike makineri, pajisje” në vlerën prej 72,721,176 lekë, të nxjerrin arsyet dhe përgjegjësitë ndaj personave përgjegjës.</p> <p>- Nëpunësi Zbatues dhe Sektori i Financës së AKSHI-it të marrin masat, që përpara se të bëjë reflektimin e pakësimit të aktive në kontabilitet nga lëvizjet kapitale pa pagesë brenda apo jashtë sistemit, të disponojë të gjithë dokumentacionin përkatës të kalimit kapital të aktiveve, me qëllim evidentimin e saktë të vlerave të aktiveve në kontabilitet.</p> <p>Gjithashtu të marrin masa për të analizuar dhe të argumentuar vlerën e reflektuar në llogarinë 214 “Instalime Teknike makineri, pajisje” më shumë prej (137,725,298) lekë, duke nxjerr arsyet dhe përgjegjësitë ndaj personave përgjegjës.</p> <p>Sa mësipërm bazuar në vendimmarrjen e këtyre strukturave të bëhen sistemimet në kontabilitet dhe për diferencat e paargumentuara ligjërisht të ndiqet masat në organet e tjera ligj zbatuese.</p>

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:

Janë kosto historike të mbartura ndër vite, AKSHI është duke parë të gjitha mënyrat për sistemimin e këtyre diferencave.

AKSHI do të ngrejë një grup pune për verifikimin e rekomandimeve të lëna, nga do të identifikohen përgjegjësit për të cilët do të merren masa.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Gjetja dhe rekomandimi janë pranuar dhe subjekti ka marrë angazhimin për zbatimin në vijueshmëri të tyre.

- Llogaria 215 “Mjete Transporti”, paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën neto prej 2,188,855 lekë dhe përfaqëson vlerën automjeteve në dispozicion të AKSHI-it, e cila nuk ka ndryshime nga viti paraardhës.

- Llogaria 218 “Inventar ekonomik”, paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën neto prej 256,241,035 lekë. Ky zë ka pësuar ndryshime gjatë vitit, si rezultat i kalimit kapital pa pagesë nga APP të pajisjeve për sistemin e ri dhe të vjetër të Prokurimit Elektronik nën administrimin e AKSHI-it në vlerën bruto prej 102,614,561 lekë dhe blerje të realizuara nga AKSHI në vlerën prej 85,229,185 lekë. Si dhe pakësim në vlerën prej 501,120 lekë, kalim kapitali pa pagesë nga AKSHI tek Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare në datën 23.09.2020.

Titulli i Gjetjes:	Llogaria 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”.
Situata:	<p>Nga auditimi i zërave të aktiveve afatgjata u konstatua se</p> <p>- Llogaria 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara” paraqitet në vlerën neto prej 36,371,970 lekë dhe mbartet nga viti paraardhës. Nga inventarizimi kjo vlerë është dalë në shumën prej 30,695,701 lekë, me një diferencë prej 5,676,269 lekë më pak se sa është paraqitur në Formatin nr.7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”.</p> <p>Komisioni i inventarizimit është shprehur se nuk ka diferenca mes kontabilitetit dhe inventarizimit. Si rrjedhojë komision nuk ka bërë krahasimin e vlerës së këtyre aktiveve me vlerën e regjistruar në librat përkatës të sektorit të financës, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 85 germa b, ku citon “Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës, të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe, për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë procesverbalet”.</p> <p>- Në llogarinë 24 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të Ministrisë së Linjës” u konstatua kontabilizimi i shumës prej 1,564,222 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me blerje ‘pajisje zyrash’ bërë hyrje nga AKSHI në magazine me datën 25.11.2019.</p> <p>Sa mësipërm institucioni ka vepruar në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” paragrafi 2.3 Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik pika 18.</p>
Kriteri:	Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”; Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Klasa 2 “Aktivet Afatgjata”, me paragrafi 3.6.
Ndikimi/Efekti:	Veprimet kontabël të pasqyruara nga Sektori i financës në “Pasqyrën financiare” kanë efekte material dhe janë të përhapura, duke ndikuar në rezultatin e Institucionit dhe në pasqyrimin jo të drejtë të fondeve neto të tij.
Shkaku:	Mos pasqyrim dhe kontabilizim të vlerave të aktiveve në mënyrë të drejtë.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	- Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të AKSHI-it të analizojnë rezultatin e dalë nga komisioni inventarizimit dhe për diferencat e konstatuara, nga krahasimi i vlerës së aktiveve të pasqyruara në pasqyrat financiare dhe atyre të rezultuara nga inventarizimi për llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara” në vlerën prej 5,676,269 lekë, të nxjerrin arsyet dhe përgjegjësitë ndaj personave përgjegjës.

	<p>- Sektori i financës të marrë masa menjëherë, për sistemimin e shumës prej 1,564,222 lekë, duke debituar llogarinë përkatëse 218 ‘<i>Inventar ekonomik</i>’ dhe duke kredituar llogarinë përkatëse 24 ‘<i>Aktive afatgjata të dëmtuara</i>’.</p> <p>- Sektori i financës të marrë masa për të sistemuar të gjithë aktivet e regjistruara në 124 ‘<i>Aktive afatgjata të dëmtuara</i>’, pasi nuk kemi të bëjmë me aktive të dëmtuara po me aktive të cilat janë gjendje punë dhe janë të transferuara si kalim kapital pa pagesë nga institucionet e tjera.</p>
--	---

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:

AKSHI ka identifikuar rastet dhe do marrë masa që këto raste mos të përsëriten. Llogaritë do të sistemohen në pasqyrat financiare të vitit 2022.

AKSHI do të ngrejë një grup pune për verifikimin e rekomandimeve të lëna nga do të identifikohen përgjegjësit për të cilët do të merren masa.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Gjetja dhe rekomandimi janë pranuar dhe subjekti ka marrë angazhimin për zbatimin në vijueshmëri të tyre.

Titulli i Gjetjes:	Mos klasifikimi i aktiveve sipas llogarive të përcaktuar në planin kontabël publik.
Situata:	<p>Nga auditimi i zërave të pasqyrës së aktivitetit për vitet 2019 - 2020 u konstatua se, një pjesë e aktiveve, që nga momenti i blerjes nuk janë klasifikuar në llogarinë e duhur, duke ndikuar në vlerën e fondit neto të institucionit si dhe vlerën neto të aktiveve, për faktin se amortizimi është llogaritur mbi vlerën kontabël të llogarive dhe jo në bazë grupi për secilën nga aktivet, por pa ndikim materiale në rezultatin e pasqyrave financiare.</p> <p>- Gjatë analizës së zërave për secilën llogari u konstatua se një pjesë e pajisjeve ‘<i>Pajisjeve kompjuterike, si kompjuter, printer, fotokopje etj</i>’ janë klasifikuar në llogarinë 214 ‘<i>Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune</i>’ veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 ‘<i>Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme</i>’ pika 36, dhe me VKM-në nr. 25, datë 20.01.2011 ‘<i>Për disa ndryshime të vendimit nr. 248 datë 10.04.1998 për miratimin e planit kontabël publik</i>’.</p> <p>Për këto aktive është llogaritur amortizimi vjetor 20% dhe jo 25% mbi vlerën e mbetur duke ndikuar në vlerën e fondit neto të institucionit si dhe vlerën neto të aktiveve.</p> <p>- Gjithashtu u konstatua se institucioni pas procesit të vlerësimit ka vlerësuar për jashtë përdorimi aktivet e llogarisë 214 në vlerën neto prej 9,936,898 lekë (amortizim i akumuluar 118,773,171 lekë) dhe e llogarisë 218 në vlerën neto 1,856,289 lekë (amortizim i akumuluar 9,866,856 lekë) raportuar me raportin përmbledhës me nr. 8176, datë 31.12.2019. Nga AKSHI këto vlera janë lënë ende tek zërat e aktiveve gjendje pune, duke ndikuar në mos pasqyrimin e drejtë të fondit neto të institucionit si dhe vlerën neto të aktiveve.</p> <p>Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 ‘<i>Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme</i>’, si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 ‘<i>Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik</i>’ Paragrafi 103-109. Aktivet kalojnë në llogarinë 24 pasi ato janë vlerësuar për jashtë përdorimi dhe deri në momentin e asgjësimit apo të tjetërsimit të tyre mbahen nga institucioni duke bërë daljen nga Inventari i institucionit dhe mbajtjen e tyre në magazinë me një fletë hyrje</p>

	rikupero.
Kriteri:	VKM-ja nr. 25 datë 20.01.2011 “Për disa ndryshime të vendimit nr. 248 datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik “ Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” pika 36; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Paragrafi 103-109
Ndikimi/Efekti:	Nga AKSHI këto vlera janë lënë ende tek zërat e aktiveve gjendje pune, duke ndikuar në mos pasqyrimin e drejtë të fondit neto të institucionit si dhe vlerën neto të aktiveve gjendje.
Shkaku:	Mos mbajtja e aktiveve të vlerësuar për jashtë përdorimi në llogarinë 24 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara” deri në momentin e asgjësimit apo të tjetërsimit të tyre.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	- Sektori i Financës së AKSHI-it të marri masat për klasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël dhe vlerësimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve. - Sektori i Financës së AKSHI-it të marri masa për kreditimin e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën bruto prej 128,710,069 lekë dhe llogarisë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën bruto prej 11,7129,145 lekë dhe debitimin e llogarisë 219 “Amortizimi i akumuluar i aktiveve afatgjata” në vlerën 128,640,027 lekë dhe të llogarisë 24 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara”, për vlerën neto prej 11,793,187 lekë, të cilat janë vlerësuar jashtë përdorimi.

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:

AKSHI ka identifikuar rastet dhe do marrë masa që këto raste mos të përsëriten. Llogaritë do të sistemohen në pasqyrat financiare të vitit 2022.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Gjetja dhe rekomandimi janë pranuar dhe subjekti ka marrë angazhimin për zbatimin në vijueshmëri të tyre.

Pasivet Afatshkurtra

Nga llogaritë e pasivit për vitin 2020, konstatohet se pasivi përbëhet 100% nga pasive afatshkurtra në vlerën 51,825 lekë.

		<i>lekë</i>		
67		1. Llogari të Pagueshme	51,825,806	33,072,073
68	401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to		
69	42	Detyrime ndaj personelit	17,814,629	16,758,932
72	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	2,162,340	1,973,569
73	432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqërore	6,568,121	5,980,629
76	436	Sigurime Shëndetësorë	814,445	743,272
77	436	Sigurime Suplementare		
81	466	Kreditore për mjete në ruajtje		
82	467	Kreditore të ndryshëm	24,466,271	7,615,671
83	4341	Operacione me shtetin (detyrime)		
84	49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim(-)		

Burimi: AKSHI, përpunuar nga grupi i auditimit

- Llogaria 42 “Personeli dhe llogari të lidhur me to“ në vlerën 17,814,629 lekë, përfaqëson pagat e muajit Dhjetor 2020, që paguhen në janar të vitit 2021.

- Llogaria 431 “Personeli dhe llogari të lidhur me to” në vlerën 2,162,340 lekë përfaqëson tatimin e pagave të muajit Dhjetor 2020, të cilat paguhen në Janar të vitit 2021.

- Llogaria 435 & 436 “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore“ përfaqëson kontributin e sigurimit shoqëror në shumën prej 6,568,121 lekë dhe e sigurimit shëndetësor në shumën 814,445 lekë të muajit Dhjetor 2020, të cilat paguhen në muajin Janar 2021.
- Llogaria 466 “Kreditore për mjete në ruajtje” në shumën prej 24,466,271 lekë përfaqëson derdhjet gabim nga individë/biznese për pagesat elektronike për marrjen e shërbimit për “Nënshkrim elektronik” dhe “Çertifikatë elektronike”.

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” është paraqitur çdo vit në vlerën 0 lekë.

Nga AKSHI nuk janë regjistruar faturat e shërbimeve të muajit dhjetor të vitit, të cilat likuidohen në janar të vitit pasardhës. Sektori i financës i ka njohur këto shpenzimet në momentin e likuidimit të faturave ndaj palëve të treta dhe jo në momentin e konstatimit dhe realizimit të shërbimit veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Paragrafi 3.3 “Klasa 4 përfaqëson në përgjithësi ngjarjet apo fenomenet që kanë ndodhur dhe duhet të trajtohen kontabilisht, sipas parimit të të drejtave e detyrimeve të konstatuara”. Nga Sektori i Financës duhet të ishte bërë veprimi kontabël duke debituar llogarinë 602 “Blerje mallrash e shërbimesh” dhe kredituar llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

Aktivitet neto/ fondet:

		<i>Lekë</i>	
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	5,031,784,844	4,352,722,943
101	Teprica(Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	5,031,008,787	4,350,423,941
12	Rezultatet e mbartura		
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	776,057	2,299,002
111	Rezerva		
115	Nga Fondet e veta te investimeve		
E	TOTALI I PASIVEVE (B+C)	5,083,610,650	4,385,795,016

Burimi: AKSHI, përpunuar nga grupi i auditimit

Titulli i Gjetjes:	<i>Llogaria 12 “Rezultati i mbartur nga funksionimi”.</i>
Situata	Nga auditimi i fondeve të konsoliduar në “Pasqyrën e pozicionit financiar” të AKSHI-it u konstatua se llogaria nr. 12 “Rezultati i mbartur nga funksionimi” paraqitet në vlerën 0 lekë. Në fakt kjo llogari duhet çdo vit të pasqyrohet sa “Rezultati i ushtrimit nga funksioni” + “Rezultatet e mbartura” të periudhës ushtrimore paraardhëse. Në fillim të vitit ushtrimor, nga AKSHI duhet të saktësohej pozicioni i çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm (2019) dhe të realizohej transaksioni i transferimit të tepricës së llogarisë 85 “Rezultat i veprimtarisë ushtrimore” në llogarinë 12, “Rezultat i mbartur”. Veprime këto në mospërputhje me Udhëzimin i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” paragrafi 2.3 “Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik”.
Kriteri:	Udhëzimin i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” paragrafi 2.3.
Ndikimi/Efekti:	Mos pasqyrim i saktë i llogarive, e cilat nuk ka efekt material në pasqyrën financiare.
Shkaku:	Keq klasifikim të llogarive.
Rëndësia:	E ulë
Rekomandime:	Sektori i Financës të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, duke tranzituar rezultatin e viti ushtrimor në llogarinë 85, “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore”, si dhe duke tranzituar shumat e evidentuara në llogarinë 85, “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” të vitit paraardhës në

	llogarinë 12 “Rezultate të mbartura nga funksioni”, për një pasqyrim më të drejtë të kundër partisë së disponibiliteteve në thesar, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.
--	---

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:

AKSHI ka identifikuar rastet dhe do marrë masa që këto raste mos të përsëriten. Llogaritë do të sistemohen në pasqyrat financiare të vitit 2022.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Gjetja dhe rekomandimi janë pranuar dhe subjekti ka marrë angazhimin për zbatimin në vijueshmëri të tyre.

Paraqitja e drejtë e “Aktivet neto/ fondet” duhet të ishte:

			<i>Lekë</i>
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	5,031,784,844	4,352,722,943
101	Teprica(Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	5,028,709,785	4,350,423,941
12	Rezultatet e mbartura	2,299,002	
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	776,057	2,299,002
111	Rezerva		
115	Nga Fondet e veta te investimeve		
E	TOTALI I PASIVEVE (B+C)	5,083,610,650	4,385,795,016

Burimi: AKSHI, përpunuar nga grupi i auditimit

d. Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël.

Auditimi u fokusua në rregullshmërinë e kryerjes së procesit të inventarizimit sipas Udhëzimit nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

Nga auditimi u konstatua se AKSHI ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 26 ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësoj një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur ...” dhe neni 31, citohet “ ...për objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit ne m², numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës...”.

Nisur nga rëndësia dhe materialiteti sasior dhe në natyrë të aspekteve të menaxhimit material dhe mundësisë për veprime të pajustificuara, ky aspekt është audituar shtrirë për periudhën 2018-2019-2020.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar se për periudhën 2018-2019-2020, çdo vit janë realizuar proceset e inventarizimit parashikuar në Paragrafi nr. 74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar që sanksionin se:

“Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të **paktën një herë në vit** ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës” dhe neni 31, citohet “ ...për objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit ne m², numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës.

Regjistrimi i aktiveve është kryer konform Kreut III, "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Hyrja e aktiveve për çdo rastë dokumentohet me flete hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, konform pikës 37, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Dalja e aktiveve për çdo rast, janë kryer konform pikës 38, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar.

Më konkretisht:

Procesi i inventarizimit të aktiveve, për vitin 2018- 2019 -2020 është kryer nga komisioni i ngritur sipas urdhrat të Titullarit të Institucionit "Për krijimin e komisionit të inventarizimit fizik të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe aktiveve qarkulluese në ruajtjen (magazinë) të AKSHI-t" përkatësisht me nr. 751, datë 27.11.2018, me nr. 451, datë 27.11.2019 dhe nr. 6556, datë 03.12.2020.

Komisionit të Inventarizimit i është ngarkuar të verifikojë gjendjen fizike dhe cilësore të aktiveve në ngarkim/ përdorim, të hartojë procesverbalin përkatës, të bëjë krahasimet me librat e kontabilitetit dhe të japë mendim për diferencat që mund të lindin.

Komisioni është bazuar në të dhënat e regjistrit kontabël për kryerjen e inventarizimit të pasurisë. Për sa më sipër është vepruar në bazë të përcaktimeve të paragrafit nr.26, të Udhëzimit të MF me nr.30/2011, ku përcaktohet se:

"Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo kanë administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar".

Në dosje janë depozituar kartelat/fletët e inventarit të çdo punonjësi, të nënshkuara rregullisht nga komisioni i inventarizimit dhe persona materialisht përgjegjës.

Nga auditimi i dosjeve të inventarizimit u konstatua se Komisionit të Inventarizimit nuk ka mbajtur procesverbal, me përgjegjësin material, ku të ishte fiksuar numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljes së fundit, si dhe hapja dhe mbyllja e magazinës në prani të komisionit dhe përgjegjësit material, veprime në kundërshtim me paragrafin 82 të UMFE nr. 30/2011, i ndryshuar.

Nga komisioni i inventarizimit në fund të procesit ka përgatitur raportin mbi inventarizimin për gjendjen e aktiveve në përdorim, si dhe për vlerat materiale, (për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike), ku së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit është dorëzuar tek nëpunësi autorizues për veprime të mëtejshme, veprime në përputhje me paragrafin 85/c të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar.

Vlera e konstatua nga Komisioni i Inventarizimit për aktivet e llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" është 4,584,430,819 lekë, ndërsa vlera e regjistruar në librat përkatës të sektorit të financës është në vlerën prej 4,657,151,995 lekë me një diferencë prej 72,721,176 lekë. Komisioni i inventarizimit është shprehur se nuk ka diferencë mes kontabilitetit dhe inventarizimit. Si rrjedhojë komisioni nuk ka bërë krahasimin e vlerës së këtyre aktiveve me vlerën e regjistruar në librat përkatës të sektorit të financës, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 85 germa b. (Trajtuar me hollësisht tek aktivet afatgjata).

Titullari i institucionit pas realizimit të procesit të inventarizimit ka ngritur "Komisionin për vlerësimin e aktiveve të konstatuara jashtë përdorimi nga komisioni i inventarizimit".

Titulli i Gjetjes:	Vlerësimi i aktive për jashtë përdorim.
Situata:	Nga auditimi i dosjeve të inventarizimit u konstatua se:

	<p>- Komisionit të Inventarizimit nuk ka mbajtur procesverbal, me përgjegjësin materiale, ku të ishte fiksuar numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljes së fundit, si dhe hapja dhe mbyllja e magazinës në prani të komisionit dhe përgjegjësit material, veprime në kundërshtim me paragrafin 82 të UMFE nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.</p> <p>- Komisioni i vlerësimit i ngritur me urdhrin e titullarit me nr. 752, datë 14.11.2018 ka vlerësuar për jashtë përdorimi aktivet e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerë të mbetur 7,050,946 lekë (amortizim të akumuluar 108,900,353 lekë.) dhe aktivet e llogarisë 218 “Inventar ekonomik” në vlerë të mbetur 2,416,765 lekë (amortizim të akumuluar 9,249,240 lekë.)</p> <p>Për vitin 2019, komisioni i vlerësimit i ngritur me Urdhrin e Titullarit me nr. 7417, datë 02.12.2019 ka vlerësuar për jashtë përdorimi aktivet e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerë të mbetur 9,936,898 lekë (amortizim të akumuluar 118,773,171 lekë.) dhe aktivet e llogarisë 218 “Inventar ekonomik” në vlerë të mbetur 1,858,269 lekë (amortizim të akumuluar 9,866,856 lekë).</p> <p>Komisioni i vlerësimit për aktivet e institucionit në fund të procesit të vlerësimit, nuk ka mbajtur procesverbale në vete për secilin aktiv të vlerësuar të dëmtuar dhe jashtë përdorimi, ku të ishin përcaktuar shkaqet e daljes jashtë përdorimi të këtyre aktiveve, vlera e mbetur e tyre pas amortizimit të akumuluar, si dhe kriterin mbi bazën e të cilit është bërë vlerësimi i aktiveve, veprime në kundërshtim me paragrafin 102-105 të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar. Në fund të procesit komisioni i vlerësimit ka mbajtur relacionin e vlerësimit, por nuk ka relatuar procedura e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës, veprime në kundërshtim me paragrafin 106 të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar.</p>
Kriteri:	Udhëzimi i MFE nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Paragrafi 82; 102-106.
Ndikimi/Efekti:	Në evidentimin e saktë të vlerave të aktiveve dhe administrimin e tyre në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.
Shkaku:	Moszbatim i pikave të përcaktuar në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, nga komisioni i inventarizimit.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	- Komisioni i vlerësimit i ngritur nga Titullari i Institucionit të AKSHI-it të marrë masa në vazhdimësi, që për çdo aktive të vlerësuar të dëmtuar dhe jashtë përdorimi, të mbajë procesverbale në vete, ku të përcaktohet shkaqet e daljes jashtë përdorimi të aktiveve, vlerën e mbetur të tyre pas amortizimit të akumuluar, si dhe kriterin mbi bazën e të cilit është bërë vlerësimi i tyre.

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:

Një ndër masat për zbatimin e këtij rekomandimi është se këtë vit në Urdhërin e ngritjes së Komisionit është përcaktuar si një ndër detyrat që duhet të kryej ky komision.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Gjetja dhe rekomandimi janë pranuar dhe subjekti ka marrë angazhimin për zbatimin në vijueshmëri të tyre.

Sektori i financës pas procesit të vlerësimit, këto vlera i ka lënë ende tek zërat e aktiveve gjendje pune, duke ndikuar në mospasqyrimin e drejtë të fondit neto të institucionit si dhe vlerën neto të aktiveve, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë

09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” paragrafi 103-109.

2.6 Prokurimet e fondeve publike

1. Për procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbimet e ndërlidhjes së DPGJC me zyrat e saj rajonale”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe dokumentacionit në sistemin e prokurimeve të APP, u konstatua:

Nga auditimi u konstatua se për këtë objekt, janë zhvilluar 2 procedura prokurimi si më poshtë:

1. Procedurë e hapur

Fondi limit 196,975,408 lekë.

Data e publikimit 25.09.2019

Data max për dorëzimin e ofertave 21.10.2019

Njoftimi i fituesit 12.11.2019

Lidhja e kontratës 05.12.2019

Vlera e kontratës (pa TVSH): 189,947,520 lekë.

2. Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës

Fondi limit 24,621,926 lekë.

Data e publikimit 15.10.2019.

Data max për dorëzimin e ofertave 18.10.2019.

Njoftimi i fituesit 22.10.2019.

Lidhja e kontratës nr. 6481 prot., datë 22.10.2019.

Vlera e kontratës (pa TVSH): 23,487,600 lekë.

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Shërbimet e ndërlidhjes së dpgjc me zyrat e saj rajonale (e hapur).		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 55, nr. 5734 prot., datë 25.09.2019	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 247, nr. 3448 prot., datë 25.06.2018	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 103, nr. 1399 prot., datë 18.03.2019. A.R Xh.Gj E.M
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur”	M.Ç E.D I.R	
5.Fondi Limit (pa tvsh) 196,975,408 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 189,947,520 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 7,027,888 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 21.10.2019	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10.Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b) S’kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK-s’ka; APP-s’ka; KPP-s’ka	12. Përgjigje e Ankesës nga AK -	13. Përgjigje e Ankesës nga APP apo AKKP
b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. 7504 prot., Datë 05.12.2019	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 227,937,024 lekë	16. Likuiduar deri -
17- Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli/Shërbimi -	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 24 muaj	19.Zgjatja e kontratës me..... ditë -

b. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Shërbimet e ndërlidhjes së dpgjc me zyrat e saj rajonale. (negocim pa shpallje)		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 58, nr. 6304 prot., datë 15.10.2019	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 247, nr. 3448 prot., datë 25.06.2018 M.Ç E.D I.R	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 394, nr. 6306 prot., datë 15.10.2019. B.B Xh.Gj E.H
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Negocim pa shpallje”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 24,621,926 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 23,487,600 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1,134,326 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 18.10.2019	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10.Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK-s’ka; APP-s’ka; KPP-s’ka	12. Përgjigje e Ankesës nga AK -	13. Përgjigje e Ankesës nga APP apo AKKP
b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. 6481 prot., Datë 22.10.2019	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 28,185,120 lekë	16. Likuiduar deri -
17- Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli/Shërbimi -	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar deri në datën 31.12.2019	19.Zgjatja e kontratës me..... ditë -

Zhvillimi i procedurave

Nga auditimi u konstatua se në datën 25.09.2019 në APP është publikuar procedura e hapur me objekt “*Shërbimet e ndërlidhjes së DPGJC me zyrat e saj rajonale*” Për Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile me fond limit 196,975,408 lekë pa TVSH.

Ndërkohë në datën 15.10.2019 nga ana e njësisë së prokurimit e përbërë nga E.S, M.D dhe D.Gj është hartuar një Memo, drejtuar Drejtorit dhe zv/Drejtorit të Përgjithshëm të AKSHI-t, ku kërkohet fillimi i një procedure tjetër për mbulimin e lidhjes së DPGJC me zyrat e saj rajonale, deri në përfundimin e procedurës së hapur me këtë objekt prokurimi, pasi ofrimit të këtij shërbimi i kishte përfunduar afati.

Përlllogaritja e fondit limit për 3 muaj shërbim është kryer duke e krahasuar me vlerën e fondit limit të përlllogaritur për procedurën e parë për 24 muaj. Pra nëse vlera limit për procedurën që do të zgjasë 24 muaj është 196,975,408 lekë, për 3 muaj është përlllogaritur matematikisht fondi limit 24,621,926 lekë.

Po në datën 15.10.2019 është nënshkruar Urdhri i Prokurimit nr. 58, me nr. 6304 prot., datë 15.10.2019, duke zgjedhur llojin “Me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, me po të njëjtin objekt “*Shërbimet e ndërlidhjes së DPGJC me zyrat e saj rajonale*” për Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile me fond limit 24,621,926 lekë pa TVSH. Zgjedhja e procedurës është bazuar në nenin 33 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pika 2/c, ku citohet “*kur për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor, afati kohor i parashikuar në nenin 43 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 për njoftimin e kontratës për procedurat e hapura, të kufizuara ose me negocim, me publikim, nuk mund të respektohet. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktor. Kushtet dhe rrethanat e përdorimit të kësaj procedure përcaktohen në rregullat e prokurimit*”.

Në vlerësimin e grupit të auditimit, ky rast nuk përbën një rast të një nevoje ekstreme, shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme. Kontrata për këtë shërbim, e lidhur në vitin 2017, dhe e

përfunduar në vitin 2019, nuk ka si të jetë e paparashikueshme që do të mbarojë në vitin 2019. Aq më tepër që po zhvillohet një procedurë e hapur për këtë shërbim, pra nuk ka se si të jetë e paparashikueshme. Madje për përfundimin e kontratës AKSHI është vënë në dijeni me shkresën nr. 1591 prot., datë 17.09.2019, protokolluar tek AKSHI me nr. 5539 prot., datë 18.09.2019. Në këtë shkresë ndër të tjera citohet se me shkresën nr. 1125 prot., datë 21.06.2019, Ministria e Brendshme ka njoftuar AKSHI-n lidhur me përfundimin e kontratave. Në nenin e përmendur më sipër citohet se *“Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktor”*, ndërkohë ky rast është i tillë, pasi AKSHI ka qenë në dijeni të situatës prej datës 21.06.2019.

Mbi këtë analizë, vlerësojmë se AKSHI nuk duhet ta kishte zhvilluar këtë procedurë prokurimi me negociim pa shpallje. Madje të dyja procedurat e zhvilluara me këtë objekt, duhet të ishin zhvilluar si një e vetme. Vlera totale e fondit limit të dy procedurave është 221,597,334 lekë, vlerë e cila sipas nenit 8.1/a të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, klasifikohet mbi kufirin e lartë monetar. Referuar Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, neni 3.28 *“Kufi monetar është vlera monetare, sipas së cilës, në përputhje me këtë ligj apo me rregullat e prokurimit publik, përcaktohet procedura e prokurimit që do të përdoret nga autoriteti kontraktor”*. Klasifikimi mbi kufirin e lartë monetar i një procedure prokurimi nisur nga përllogaritja e fondit limit, do të detyronte Autoritetin Kontraktor që për këtë procedurë prokurimi të ndiqeshin hapa të tjera referuar dispozitave ligjore. Saktësisht sipas Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar:

- Neni 38.2 *“Njoftimet për prokurimet me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, botohen në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në të paktën një gazetë me shpërndarje në Europë”*.
- Neni 43 *“Në procedurën e hapur, me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, afati për paraqitjen e ofertave është jo më pak se 52 ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik”*.

Ndarja e kësaj kontrate është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, neni 28.2, ku citohet *“Nuk lejohet pjesëtimi apo ndarja e vlerës së kontratës publike për shmangien nga dispozitat e parashikuara në këtë ligj”*. Copëzimi i fondit ka sjellë shmangien e dispozitave ligjore të trajtuara më sipër, çka në këtë rast ka ndikuar në shmangien e konkurrencës së operatorëve ekonomik, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, neni 2/ç *“Qëllimi i këtij ligji është të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik”*.

Përcaktimi i fondit limit për procedurën me negociim pa shpallje.

Përllogaritja e fondit limit për 3 muaj shërbim (për procedurën me negociim pa shpallje) është kryer duke e krahasuar me vlerën e fondit limit të përllogaritur për procedurën e hapur për 24 muaj. Pra nëse vlera limit për procedurën që do të zgjasë 24 muaj është 196,975,408 lekë, për 3 muaj është përllogaritur matematikisht fondi limit 24,621,926 lekë.

Specifikimet teknike të procedurës përfshijnë edhe zëra të tjerë, krahas shërbimit të ndërlidhjes, si lëvrim dhe konfigurim të pajisjeve hardëare që do të përdoren për shërbimin, trajnim të punonjësve, implementim të linjave backup, instalim kamerash në çdo gjendje civile, instalimi i videocall i përbërë nga 4 monitore, workstation, software i menaxhimit të pamjeve etj. Pra vlera e fondit limit 196,975,408 lekë ka të përfshirë jo vetëm shërbimin e ndërlidhjes, por edhe disa elemente të tjerë që e rrisin vlerën, dhe pjestimi i vlerës me 24 muaj, me qëllim përcaktimin e vlerës mujore, nuk është i arsyetuar.

Së dyti, vlera limit e ofrimit të shërbimit të ndërlidhjes në rastin e parë, është përcaktuar duke marrë në konsideratë edhe shërbimet shtesë sipas risive në kontratën e këtij viti, ndërkohë që

ofrimi i shërbimit për 3 muajt e kontraktuar, vazhdon vetëm me infrastrukturën dhe pajisjet e mëparshme. Pra edhe në këtë këndvështrim, nëse nga vlera 196,975,408 lekë do të zbriteshin shërbimet dhe lëvrimet shtesë, përsëri pjestimi i vlerës së mbetur me 24 muaj, me qëllim përcaktimin e vlerës mujore, nuk do të ishte i arsyetuar.

Së treti, nga njësia e prokurimit, është përlogaritur për 3 muaj vlera e fondit limit në shumën 24,621,926 lekë pa TVSH, edhe pse shërbimi kërkohet që të ofrohet deri në datën 31.12.2019. Pra edhe nëse kontrata do të ishte lidhur ditën kur u përlogarit vlera, koha e shërbimit do të ishte 2.5 muaj. Ndërkohë kontrata është lidhur me vlerën 23,487,600 lekë pa TVSH, në datën 22.10.2019 me afat deri në datën 31.12.2019, pra 2 muaj e 10 ditë. Nëse do të përdorim logjikën e përdorur nga njësia e prokurimit për përcaktimin e fondit limit mbi bazë mujore, atëherë fondi limit, duhet të ishte 19,150,386 lekë. Diferenca ndërmjet vlerës së kontratës së lidhur dhe fondit limit të përlogaritur nga grupi i auditimit prej **5,204,656 lekë** (e llogaritur me TVSH) përbën **efekt financiar negativ** për buxhetin e shtetit.

Për këtë mbajnë përgjegjësi njësia e prokurimit dhe hartimit të fondit limit e përbërë nga E.S, M.D dhe D.Gj.

Hartimi i specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta.

Kriteret e veçanta të vendosura nga grupi i punës për hartimin e kriterëve të veçanta, janë si më poshtë:

2. *Certifikatat që Operatori ekonomik zotëron për standardet më poshtë, në përputhje me objektin e prokurimit të kësaj procedure:*

- *ISO 9001:2008 (ose e përditësuar) për menaxhimin e cilësisë.*
- *ISO 27001:2008 (ose e përditësuar) për menaxhimin e sigurisë së informacionit.*
- *ISO/IEC 20000-1:2011 (ose e përditësuar) për menaxhimin e shërbimeve.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim të vlefshëm për ofrimin e shërbimit Internet nga AKEP, për të gjitha teknologjitë e kërkuara në specifikime teknike.*
- *Operatori ekonomik të paraqesë Liçencë të lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për transmetim të dhënash si dhe lejen e përdorimit të frekuencave të licencuara nga AKEP që do të përdoren sipas specifikimeve teknike.*

3. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë listën e detajuar për çdo zyre të gjendjes civile, sipas tabelës në specifikimet teknike, e cila të përmbajë:*

- *Teknologjinë e përdorur për lidhjen online përkatësisht për çdo zyrë.*
- *Modelin e pajisjes fundore që do të vendoset në çdo zyrë (shoqëruar me katalogët përkatës)*
- *Modelin e kamerës që do të vendoset në çdo zyrë (shoqëruar me katalogët përkatës).*

4. *Ne rast se, operatori ekonomik midis të tjerave, për zgjidhjen teknike të këtij shërbimi përdor teknologjinë e një operatori tjetër (Fiber, Satelitore, ADSL, etj), atëherë duhet të paraqesë kontratën e lidhur ndërmjet tyre.*

5. *Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, për planifikimin dhe menaxhimin me profesionalizëm të punës, duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:*

a) *Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi 100 (njëqind) punonjës (20 prej të cilëve të jenë inxhinierët e përmendur më poshtë) për 6 mujorin e fundit, kjo e vërtetuar me Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore shoqëruar me list-pagesat për periudhën e mësipërme.*

b) *Operatori ekonomik duhet të ketë një numër prej minimalisht 20 punonjës, personel teknik i diplomuar në degët informatike, ose elektronike, ose telekomunikacion, ose teknologji informacioni, ose elektrike, që do të angazhohet në implementimin e projektit, duke pasur njohuri të kombinuar sipas kërkesave të mëposhtme:*

- *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si kordinator për sigurimin teknik në fazën e projektimit dhe zbatimit.*
- *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Site Safety Officer Training, ose ekuivalente.*
- *Të paktën 3 (tre) inxhinierë të certifikuar me CCNA Routing and Switching, ose ekuivalente.*

- Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar në WiFi network design (në rast se përdoret komunikimi wireless).
- Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar në teknologjinë Internet via Satellite (në rast se përdoret komunikimi satelitor).
- Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar në teknologji video surveillance.
- Të paktën 10 punonjës të certifikuar për instalim rrjeti data dhe/ose fibër.

Personeli i mësipërm duhet të ketë marrëdhënie pune me operatorin ekonomik për periudhen e 6 mujorit te fundit, e vërtetuar kjo me formularin e E-sig të listepagesave.

6. Operatori duhet të disponojë strukturë Helpdesk të dedikuar, të kontaktueshëm 24/7/365, e vërtetuar kjo me një vetëdeklarim.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi për pajisjet që do të përdorë për realizimin e shërbimit të monitorimit Audio-Video.

1. Numri i kërkuar i punonjësve, “minimumi 100 (njëqind) punonjës (20 prej të cilëve të jenë inxhinierët e përmendur më poshtë) për 6 mujorin e fundit” nuk është i argumentuar.

Nëse merret i mirëqenë argumentimi i drejtë dhe i plotë i certifikatave të kërkuara, numri i punonjësve të kërkuar duhej të përputhej pikërisht me numrin e kualifikimeve, ose në të kundërt duhej të evidentohet arsyeja pse duhen minimalisht 100 punonjës. Gjithashtu grupi i punës për hartimin e kriterëve të veçanta, ka argumentuar kërkesën për certifikimet e punonjësve por nuk ka argumentuar arsyen e numrit të tyre në çdo rast. Në vlerësimin tonë kërkesa e më shumë se 1 punonjësi për çdo certifikim është e paarsyetuar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” nenin 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, ku citohet “Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

2. Nga grupi i hartimit të kriterëve të veçanta është kërkuar “Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si kordinator per sigurimin teknik ne fazën e projektimit dhe zbatimit”, “Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar per Site Safety Officer Training, ose ekuivalente” dhe “Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar në teknologji video surveillance”, të cilat në vlerësimin e grupit të auditimit nuk janë të nevojshme për zbatimin e kontratës.

Vendosja e këtyre kriterëve është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike”, pika 1 dhe 2, ku citohet: “1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara” dhe “2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik”. Këto kriterë në vlerësimin tonë janë diskriminuese, duke ndikuar negativisht në pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi M.Ç, E.D dhe I.R, në cilësinë e grupit të hartimit të specifikimeve teknike.

Vlerësimi i ofertave dhe kualifikimi i operatorëve ekonomik.

- Procedura me negociim pa shpallje

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, përcaktuar me urdhrin nr. 394, nr. 6306 prot., datë 15.10.2019, i përbërë nga B.B, Xh.Gj dhe S.A, në datën 22.10.2019 ka mbajtur procesverbalin për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave për procedurën me negociim pa shpallje, ku është kualifikuar vetëm operatori ekonomik A.shpk, edhe pse ky i fundit nuk ka dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar plotësimin e 3 kriterëve:

- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si kordinator per sigurimin teknik ne fazën e projektimit dhe zbatimit.
- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar per Site Safety Officer Training, ose ekuivalente.
- Të paktën 10 punonjës të certifikuar për instalim rrjeti data dhe/ose fibër.

Mungesën e dokumentacionit për këto kritere, KVO e ka konsideruar si devijim jo thelbësor, për arsye se:

“Për punonjësit që plotësojnë kriteret e mësipërme, janë paraqitur certifikimet kualifikuese të vlefshme për të provuar eksperiencën e tyre në përmbushjen e kërkesave teknike sipas TORS. Për punonjësit që plotësojnë kriteret e mësipërme, vërtetohet se janë punonjës të kompanisë duke rezultuar në të gjithë formularët e-sig për 6 muajt e fundit, në përputhje me kërkesat e procedurës.

Duke konsideruar se kompania ka 2 kontrata të ngjashme me të njëjtin objekt prokurimi në vitet 2015 dhe 2017, për të cilat bazuar në vërtetimin e realizimit të kontratës ku konfirmohet se kontratat janë realizuar me sukses dhe përfunduar brenda afateve ligjore të përcaktuara mes palëve kontraktuese, lëshuar nga DPGJC, provohet se pavarësisht mungesës së përcjelljes së dokumentacionit të diplomave për punonjësit që plotësojnë kritere e mësipërme, kompania ka kapacitetet e nevojshme teknike dhe njerëzore për realizimin me sukses të kërkesave sipas TORS”.

Në vlerësimin e grupit të auditimit, konsiderimi si devijim jo thelbësor i mungesës së këtyre 3 çertifikatave të kërkuara, është i pa bazuar në argumenta bindëse dhe të pranueshme. Mungesa e 3 nga 7 llojet e çertifikatave të kërkuara, nuk mund të përbëjë devijim jo thelbësor, pasi në këtë rast mungojnë 43% e certifikimeve. Certifikime të cilat mund të kenë frenuar operatorë të tjerë për të marrë pjesë. Kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik A.shpk, në mungesë të plotësimin të kriterëve të vendosura, është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, ku citohet “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi B.B, Xh.Gj dhe S.A, në cilësinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

- Procedura e hapur

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, përcaktuar me urdhrin nr. 397, nr. 6345 prot., datë 17.10.2019, i përbërë nga A.R, Xh.Gj dhe E.M, në datën 14.11.2019 ka mbajtur procesverbalin për vlerësimin e ofertave për procedurën e hapur, ku është kualifikuar vetëm operatori ekonomik A.shpk, edhe pse ky i fundit nuk ka dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar plotësimin e 3 kriterëve:

- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si kordinator per sigurimin teknik ne fazën e projektimit dhe zbatimit.
- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar per Site Safety Officer Training, ose ekuivalente.
- Të paktën 10 punonjës të certifikuar për instalim rrjeti data dhe/ose fibër.

Mungesën e dokumentacionit për këto kritere, KVO e ka konsideruar si devijim jo thelbësor, për arsye se:

“Për punonjësit që plotësojnë kriteret e mësipërme, janë paraqitur certifikimet kualifikuese të vlefshme për të provuar eksperiencën e tyre në përmbushjen e kërkesave teknike sipas TORS. Për punonjësit që plotësojnë kriteret e mësipërme, vërtetohet se janë punonjës të kompanisë duke rezultuar në të gjithë formularët e-sig për 6 muajt e fundit, në përputhje me kërkesat e procedurës.

Duke konsideruar se kompania ka 2 kontrata të ngjashme me të njëjtin objekt prokurimi në vitet 2015 dhe 2017, për të cilat bazuar në vërtetimin e realizimit të kontratës ku konfirmohet

se kontratat janë realizuar me sukses dhe përfunduar brenda afateve ligjore të përcaktuara mes palëve kontraktuese, lëshuar nga DPGJC, provohet se pavarësisht mungesës së përcjelljes së dokumentacionit të diplomave për punonjësit që plotësojnë kritere e mësipërme, kompania ka kapacitetet e nevojshme teknike dhe njerëzore për realizimin me sukses të kërkesave sipas TORS.

Duke konsideruar rëndësinë e procedurës për ofrimin e shërbimevetë DPGJC në të gjithë Shqipërinë, si lloji i shërbimeve publike më thelbësore për qytetarët, anulimi dhe rishpallja e procedurës si pasojë e mungesës së përcjelljes së dokumentacionit të diplomave për punonjësit që plotësojnë kriteret e mësipërme, do të shkaktonte një impakt financiar dhe kohor të lartë, si dhe mungesë të plotë të shërbimit në të gjitha sportelet e DPGJC në Shqipëri.

Duke konsideruar vlerësimin e të gjitha ofertave të përcjella nga operatorët nëpërmjet sistemit elektronik të APP, si dhe duke analizuar ofertat financiare, gjykohet se kualifikimi i operatorit “A”, për arsytet e mësipërme, do të shkaktonte mundësinë për kualifikim të një operatori me ofertë financiare më të lartë, si dhe duke gjykuar se mungesa e përcjelljes së dokumentacionit të diplomave, nuk është i vetmi kriter i përcaktuar në TORS si i nevojshëm për provimin e kapacitetit njerëzor dhe teknik të punonjësve, kjo mungesë nuk është konsideruar si kusht i detyrueshëm dhe thelbësor për skualifikimin e operatorit.

Bazuar në argumentimin e mësipërm, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në unanimitet ka gjykuar dhe konsideruar se mungesa e dokumentacionit të diplomave për punonjësit që plotësojnë kriteret e mësipërme, është devijim jo thelbësor për ofertën e paraqitur nga operatori “A”.

Në vlerësimin e grupit të auditimit, konsiderimi si devijim jo thelbësor i mungesës së këtyre 3 çertifikatave të kërkuara, është i pa bazuar në argumenta bindëse dhe të pranueshme. Mungesa e 3 nga 7 llojet e çertifikatave të kërkuara, nuk mund të përbëjë devijim jo thelbësor, pasi në këtë rast mungojnë 43% e certifikimeve. Certifikime të cilat mund të kenë frenuar operatorë të tjerë për të marrë pjesë. Kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik A.shpk, në mungesë të plotësimin të kritereve të vendosura, është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, ku citohet “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi A.R, Xh.Gj dhe E.M, në cilësinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për të dy procedurat vlerësojmë se vendimmarrja e gabuar, është pasojë e mosargumentimit të kritereve të përcaktuara në DST nga autoriteti kontraktor dhe konkretisht njësia e hartimit të tyre, kritere të cilat kanë sjellë edhe vendimmarrjen nga KVO duke vlerësuar si jo thelbësore mungesën e çertifikatave të cilat nuk duhet të ishin pjesë e kërkesave, pasi jo detyrimisht ekzistenca e tyre siguron apo garanton ofrimin e shërbimit dhe cilësinë e tij.

2. Për procedurën e prokurimit me objekt: “Përmirësimi i sistemit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit “Dua Punë”.

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Përmirësimi i sistemit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit “Dua Punë”. OE – C.P. Shpk		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 65, nr. 7081 prot., datë 13.11.2019	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 194, nr. 2734 prot., datë 22.05.2019 D.Xh E.R A.M K.M	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 446, nr. 7303 prot., datë 22.11.2019, i ndryshuar. A.Dh I.Sh G.P
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur”		

	B.N	
5.Fondi Limit (pa tvsh) 107,047,200 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 106,801,000 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 246,200 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 09.12.2019	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10.Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b) S'kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK-s'ka; APP-s'ka; KPP-s'ka	12. Përgjigje e Ankesës nga AK -	13. Përgjigje e Ankesës nga APP apo AKKP
b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. 7967 prot., Datë 30.12.2019	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 128,161,200 lekë	16. Likuiduar deri -
17- Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli/Shërbimi dt. 28.09.2020	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 9 muaj implementim dhe 24 muaj mirëmbajtje	19.Zgjatja e kontratës me..... ditë -

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe dokumentacionit në sistemin e prokurimeve të APP, u konstatua:

Hartimi i specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta.

Kriteret e vendosura nga grupi i punës për hartimin e kriterëve të veçanta, janë si më poshtë:

2.Operatori ekonomik duhet te jete i certifikuar sipas

- *ISO 9001:2015 ose ISO 9001:2008 për menaxhimin e cilësisë,*
- *ISO 27001:2013 për menaxhimin e sigurisë se informacionit,*
- *ISO 20000-1 për menaxhimin e shërbimeve.*

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, për numrin e punonjësve të siguruar për 3 mujorin e fundit. Operatori ekonomik duhet të ketë një numër prej mesatarisht 20 (njetet) punonjës të siguruar, ku përfshihet një personel teknik i diplomuar ne degët informatike, elektronike, telekomunikacion, teknologji informacioni, elektrike, qe do te angazhohet ne implementimin e projektit, me keto kompetenca:

- a. 2 (dy) specialist të certifikuar për mbështetjen e projektit sipas praktikave të ITIL ose ekuivalente.*
- b. 2 (dy) specialist të certifikuar në nivel MCSD ose ekuivalente për aplikacione Web/mobile.*
- c. 1 (një) specialist të certifikuar për analizë dhe shfaqje të dhënash Power BI.*
- d. 1 (një) specialist të certifikuar në nivel MCSA ose ekuivalent për databazë.*
- e. 1 (një) specialist të certifikuar për konfigurimin e sistemit operativ windows Server 2012 apo ekuivalent me të.*
- f. 1 (një) specialist të certifikuar për testim software.*
- g. 1 (një) specialist te certifikuar si Auditor per sistemet e menaxhimit te sigurise se informacionit ISO 27001.*
- h. 1 (nje) punonjes te certifikuar nga prodhuesi i serverave.*
- i. 1 (nje) punonjes te certifikuar ne nivel MCSE Productivity ose ekuivalent.*
- j. 1 specialist te certifikuar ne teknologjine e mbrojtjes se rrjetit dhe aplikacioneve ne nivel profesional (NSE Security Professional ose ekuivalent).*

Sa më sipër, në vlerësimin e grupit të auditimit, konstatohet se:

1. Numri i kërkuar i punonjësve, prej mesatarisht 20 për 3 muajt e fundit nuk është i argumentuar, lidhur me kriteret (certifikatat) e kërkuara për kualifikimet e punonjësve, ku mjaftojnë 12 (ose më pak nëse i njëjti punonjës ka më shumë se 1 certifikatë).

Gjithashtu grupi i punës për hartimin e kriterëve të veçanta, ka argumentuar kërkesën për certifikimet e punonjësve por nuk ka argumentuar arsyen e numrit të tyre në çdo rast. Në vlerësimin tonë kërkesa e më shumë se 1 punonjësi për çdo certifikim është e paarsyetuar, në mospërputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” nenin 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, ku citohet “Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

2. Kriteri “1 (një) specialist të certifikuar si Auditor për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO 27001”, është i papërshtatshëm dhe i panevojshëm për këtë procedurë prokurimi. Në DST është kërkuar që operatori ekonomik duhet të ketë ISO 27001, pra është i certifikuar në këtë fushë. Kërkesa për pasjen e një Leed Auditor është kriter i pajustificuar, duke ndikuar negativisht në pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike”, pika 1 dhe 2, ku citohet: “1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara” dhe “2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik”.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi D.Xh, E.R, A.M, K.M dhe B.N, në cilësinë e grupit të hartimit të specifikimeve teknike.

3. Për procedurën e prokurimit me objekt: “Ngritja e regjistrit elektronik të ekspertëve”.

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Ngritja e regjistrit elektronik të ekspertëve.		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 15, nr. 927 prot., datë 22.02.2019	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 682, nr. 5711 prot., datë 18.10.2018 J.Ç S.S A.F	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 103, nr. 1399 prot., datë 18.03.2019, i ndryshuar. B.B M.Sh E.H
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 116,666,665 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 113,333,333 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 3,333,332 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 20.03.2019	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10.Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) S’kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK-s’ka; APP-s’ka; KPP-s’ka	12. Përgjigje e Ankesës nga AK -	13. Përgjigje e Ankesës nga APP apo AKKP
b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. 2497 prot., Datë 13.05.2019	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 136,000,000 lekë	16. Likuiduar deri -
17- Situacioni Përfundimtar/ 03.09.2019	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 3 muaj implementim dhe 48 muaj mirëmbajtje	19.Zgjatja e kontratës me 20 ditë -

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe dokumentacionit në sistemin e prokurimeve të APP, u konstatua:

Hartimi i specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta.

Kriteret e veçanta të vendosura nga grupi i punës për hartimin e kriterëve të veçanta, janë si më poshtë:

- *Certifikatat që Operatori ekonomik zotëron për standardet më poshtë, në përputhje me objektin e prokurimit të kesaj procedure:*
ISO 9001:2015 ose ISO 9001:2008 për menaxhimin e cilësisë (ose e përditësuar);
ISO 27001:2013 për menaxhimin e sigurisë së informacionit (ose e përditësuar);
ISO 20000-1 për menaxhimin e shërbimeve (ose e përditësuar);
- *Të paktën 2 specialistë të certifikuar nga prodhuesi i serverave për planifikim dhe dizejnim të zgjidhjeve për pajisjet që do të ofrojë.*
- *Të paktën 1 specialist të certifikuar për rrjetin, niveli profesional CCNP ose ekuivalent,*
- *Të paktën 1 specialist të certifikuar me ITIL ose ekuivalent për shërbimet e kërkuara.*
- *Të paktën 1 menaxher projekti me të paktën 5 vjet eksperiencë i certifikuar me titullin PM ose ekuivalent.*
- *Të ketë të paktën 1 punonjës të certifikuar si Microsoft Certified Solution Developer ose ekuivalent për Zhvillim Aplikacionesh (APP Builder). Të paraqiten certifikatat përkatëse.*
- *Të ketë të paktën 1 punonjës të certifikuar si Microsoft Certified Solution Associate ose ekuivalent për Aplikime në web (web Application). Të paraqiten certifikatat përkatëse.*

Sa më sipër, në vlerësimin e grupit të auditimit, konstatojmë se:

1. Grupi i punës për hartimin e kriterëve të veçanta, ka argumentuar kërkesën për certifikimet e punonjësve, por nuk ka argumentuar arsyen e numrit të tyre në rastin e “2 (dy) specialistë të certifikuar nga prodhuesi i serverave për planifikim dhe dizejnim të zgjidhjeve për pajisjet që do të ofrojë”. Në vlerësimin tonë kërkesa e më shumë se 1 punonjësi për këtë certifikim është e paarsyetuar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” nenin 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, ku citohet “Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjrisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

2. Nga ana e grupit të hartimit të kriterëve të veçanta është kërkuar “1 menaxher projekti me të paktën 5 vjet eksperiencë i certifikuar me titullin PM ose ekuivalent”. Në procesverbalin e mbajtur nga grupi i punës për argumentimin e kriterëve, citohet arsyeja pse duhet një PM, por nuk jepet asnjë argument mbi kriterin “5 vjet eksperiencë”. Vendosja e këtij kriteri është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike”, pika 1 dhe 2, ku citohet: “1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara” dhe “2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik”. Ky kriter në vlerësimin tonë është diskriminues, duke ndikuar negativisht në pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi J.Ç, S.S dhe A.F, në cilësinë e grupit të hartimit të specifikimeve teknike.

Marrja në dorëzim

Në kontratën me nr. 2497 prot., datë 13.05.2019 cilësohet se vlera 136,000,000 lekë me TVSH, ndahet në 84,234,832 lekë implementim me afat 3 muaj dhe 51,765,168 lekë mirëmbajtje me afat 4 vjeçar.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se afati i implementimit nuk është zbatuar. Pra dorëzimi i sistemit nuk është kryer në datën 13.08.2019, konkretisht:

- Me akt dorëzimin nr. 3063 prot., datë 10.06.2019 janë dorëzuar pajisjet fizike të listuara në kontratë: 4 servera, 2 switch dhe 1 fotokopje, me vlerë 5,899,184 lekë (brenda afatit).
- Raporti i OE me nr. 5156/2 prot., datë 03.09.2019 “Mbi zbatimin e kontratës nr. 2497 prot., datë 13.05.2019” (**21 ditë me vonesë**).
- Memo me nr. 5156 prot., datë 03.09.2019, përparatit nga J.Ç dhe A.F, drejtuar zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Akshi-t D.Sh, për dijeni Drejtorit të Financës së Akshi-t E.S dhe njësisë së prokurimit. Në memo, relatohet mbi ecurinë e zbatimit të kontratës, duke cituar se operatori ekonomik nuk ka paraqitur faturën tatimore të shitjes, vlerësuar si veprim në kundërshtim me nenin 10 “Pranimi i shërbimeve”, pika 10.4, ku citohet: “Çdo furnizim do të shoqërohet me faturën tatimore të shitjes si dhe me akt dorëzimin, i cili do të nënshkruhet nga përfaqësuesit e palëve. Brenda 3 ditësh nga data e çdo dorëzimi, Autoriteti Kontraktor do të nënshkruaj procesverbalin e pranimit të çdo parti produktesh”.
- Me akt dorëzimin nr. 7698/1 prot., datë 13.12.2019, janë dorëzuar sistemi dhe kryerja e trajnimeve, me vlerë 76,904,687 lekë (**4 muaj me vonesë, ose 122 ditë**), shoqëruar me faturën tatimore nr. 1353, datë 13.12.2019.
- Fletë hyrja në magazinë nr. 74, datë 24.12.2019.
- Urdhër shpenzimi nr. 461, datë 24.04.2020, ku vlera e paguar është 76,904,687 lekë.

Nga sa më sipër, rezulton se ndaj operatorit ekonomik nuk është mbajtur penalitet, edhe pse janë shkelur afatet për realizimin e kontratës, veprim në kundërshtim me nenin 20 të kontratës “Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar”, pika a, ku citohet: “Dëmet e likuidueshme për kryerjen e vonuar të shërbimeve do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore: a) Për kontratat me periudhë zbatimin jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës”.

Me shkresën nr. 777 prot., datë 08.08.2019, protokolluar në AKSHI me nr. 4801 prot., datë 08.08.2019, OE ka kërkuar listën e emrave dhe pozicioneve për trajnimet. AKSHI është përgjigjur me shkresën me nr. 480/1 prot., datë 08.08.2019. Por për këtë kërkesë, referuar relacionit të grupit të marrjes në dorëzim, si dhe pretendimit të OE, nuk ka pasur përgjigje nga institucioni përfitues brenda afatit 13.08.2019 për listën e personave që duhet të trajnohenin, si Ministri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtori i Përgjithshëm, Drejtor, Përgjegjës, Përgjegjës dhe stafi i gjykatave.

Me shkresën nr. 4801/2 prot., datë 09.08.2019, AKSHI i është drejtuar edhe një herë Ministrisë së Drejtësisë lidhur me kërkesën për përcaktimin e stafit që do të trajnohet. Po në të njëjtën ditë, OE ka kërkuar shtyrje afati për zbatimin e kontratës me shkresën nr. 784/1 prot., datë 09.08.2019, protokolluar në AKSHI me nr. 4838 prot., datë 09.08.2019.

Në vijim, grupi i punës i përbërë nga J.Ç dhe A.F, po në datën 09.08.2019, ka përparatit një Memo ku vë në dijeni Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorin e Përgjithshëm të AKSHI-t. Nga ana e autoritetit kontraktor rezulton se është miratuar shtyrja e afatit me 20 ditë (deri datë 02.09.2019), me Amendimin nr. 4848 prot., datë 09.08.2019.

Së pari, theksojmë se shtyrja e afatit të zbatimit të kontratës nuk është ligjore, pasi nuk përputhet me arsyet që do të çonin në shtyrje të kontratës referuar përcaktimeve të nenit 19 të kontratës. Jemi në rastin e një neglizhence institucionale (nëse merret e mirëqenë se kronologjia e ngjarjeve është sipas relacionit të vënë në dispozicion), dhe aspak në rastin e një force madhore dhe as në rastin e rrethanave të tjera të cilat janë në interesin publik.

Së dyti, OE ka kërkuar listën e punonjësve për trajnim vetëm 5 ditë para përfundimit, por për ta realizuar trajnimin (referuar dokumentacionit të paraqitur), i janë dashur 25 ditë (nga data 09.08.2019 deri 02.09.2019), pra gjithsesi, edhe nëse përgjigjen nga Ministria e Drejtësisë do ta kishte marrë po ditën kur ka bërë kërkesën, përsëri nuk do të mund ta përfundonte në afat kontratën.

Së treti, kërkesa për shtyrje afati është bërë të nesërmen e ditës së këkesës për listën e trajnimeve, pa pritur afatin 15 ditor për kthimin e përgjigjes, afat i përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative. Kujtojmë se afati i zbatimit të kontratës është 3 muaj, dhe koha për të zbatuar dhe respektuar kornizat ligjore ka qenë e mjaftueshme.

Sa më sipër, vlerësojmë se shtyrja e afatit maksimal të zbatimit të kontratës prej 20 ditësh, është e pavlefshme. Për vonesën prej 21 ditësh referuar raportit përfundimtar AKSHI duhet të penalizonte OE në vlerën **6,459,994 lekë** (21 ditë x 0.004 x 76,904,687 lekë).

Krahas sa më sipër, nga auditimi u konstatua se OE nuk rezultoi ta ketë dorëzuar faturën tatimore në datën e dorëzimit të raportit përfundimtar. Madje, edhe pasi grupi i marrjes në dorëzim është shprehur se nuk e merr në dorëzim sistemin pa faturë tatimore, përsëri e ka vonuar atë, duke e sjellë faturën tatimore në datën 13.12.2019, datë në të cilën është mbajtur akti i marrjes në dorëzim. Në këto kushte, grupi i auditimit vlerëson se data e cila duhet të konsiderohet data e dorëzimit përfundimtar të sistemit është data 13.12.2019. Për këtë vonesë, AKSHI duhet të kishte mbajtur penalitetet në vlerën prej **37,529,487 lekë** (122 ditë x 0.004 x 76,904,687 lekë), vlerë e cila përbën veprime në kundështrim me 3E^{-të} për buxhetin e shtetit dhe duhet të ishin kërkuar për tu dëmshpërblyer nga OE “BN E”.

Zbatimi i kontratës

Në datën 21.04.2022, grupi i auditimit verifikoi realizimin e sistemit, në prani të përfaqësuesve të AKSHI-t M.Ç, R.G dhe A.F. Nga verifikimi, u konstatuan mangësitë:

1. “Moduli i vlerësimit të aplikimit” nuk është si modul më vete, por pjesë e funksionaliteteve të “Moduli i çështjeve gjyqësore”, në kundërshtim me pikën 13.1 të TORS;
2. Sistemi nuk ka modulet “Moduli i përditësimit të të dhënave dhe korrigjimit të gabimeve” dhe “Moduli i çaktivizimit/pezullimit/heqjes së ekspertit nga regjistri”, në kundërshtim me pikën 13.1 të TORS;
3. Në sistem nuk janë implementuar fushat “gjinia” dhe “vendlindja”, çka bën që të mos gjenerohet raport mbi këto fusha, sipas kërkesave të pikës 13.1/a të TORS mbi raportet e detyrueshme të sistemit.
4. Raportet gjenerohen vetëm në formatin PDF, në kundërshtim me pikën 13.1/a të TORS.

Marrja në dorëzim e sistemit duke mos qenë konform TORS, është në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 77 “Mbikëqyrja e kontratës”, ku citohet: “1. Gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor dhe organe të tjera shtetërore, të autorizuar me ligj, (nëse është rasti) mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe legjislacionin në fuqi. 2. Mospërbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën shkak për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike sipas përcaktimeve të pikës 3/ç të nenit 13 të LPP-së. Në këtë rast, autoriteti kontraktor ka detyrimin të dërgojë në APP kërkesën për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike brenda 3 (tre) muajve nga zgjidhja e kontratës apo përfundimi i afatit të zbatimit të saj, përfshirë këtu edhe periudhën e garancisë. 3. Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi”.

Për këtë mbajnë përgjegjësi S.S, A.F dhe M.S, në cilësinë e grupit të marrjes në dorëzim.

Sa më sipër konstatojmë se operatori ekonomik nuk e ka realizuar kontratën sipas parashikimeve, duke mos i përfunduar të gjitha modulet dhe kërkesat. Vlera e moduleve të cilat nuk janë realizuar është **17,497,938 lekë me TVSH**, vlerë e cila në këtë fazë mund të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhej të paguhej nga OE “BN E shpk”.

Gjithashtu, nga verifikimi u konstatua se nga ana e gjykatave/gjykatësve sistemi nuk përdoret. Si pasojë e mospërdorimit nga kjo hallkë e rëndësishme për funksionimin e sistemit, rezultoi se 3 nga 11 modulet e kërkuara në TORS janë të papopulluara:

1. “Moduli i çështjeve gjyqësore”;
2. “Moduli i vlerësimit të ekspertit për çdo proces gjyqësor”;
3. “Moduli i përzgjedhjes së ekspertit nga gjykata”;

Mungesa e popullimit të moduleve të mësipërme, krahas mos vënies në përdorim të tyre sjell edhe mangësi në proceset e tjera të sistemit si:

1. “Moduli Arkiva/Dosjet” mbetet me të dhëna jo të plota për ekspertët, pasi nuk plotësohet informacioni lidhur me “vlerësimet, historikun dhe veprimtarinë e pikëzimit”;
2. 4 nga 11 raportet e kërkuara në TORS, mbeten të pa aplikueshme, saktësisht:
 - Raport për çështjet dhe numrin total të çështjeve ku ka marr pjesë një ekspert;
 - Raport të numrit të herëve që një ekspert është thërritur nga një gjykatë apo gjykatës;
 - Raport statistikor mbi rezultatet e ekspertëve bazuar në vlerësimet e bëra rast pas rasti sipas sistemit të miratuar të pikëzimit;
 - Raport – analize vjetore mbi të dhënat e sistemit të pikëzimit duke evidentuar gjetjet dhe probematikat ndaj ekspertëve;
3. Qëllimi i përcaktuar në pikën 2.2 të TORS “Implementimi i një sistemi vlerësimi dhe pikëzimi me qëllim monitorim e kontroll më të lehtë si dhe transparencë të lartë të veprimtarisë së ekspertëve në gjykata”, mbetet i pazbatueshëm.

Ndërkohë që sistemi pas rreth 2.5 viteve nga marrja në dorëzim mbetet i pa përdorur plotësisht nga gjykatat/gjykatësit, kontrata në lidhje me mirëmbajtjen e sistemit vazhdon të paguhet e plotë sikurse sistemi të ishte plotësisht i përdorur.

4. Për procedurën e prokurimit me objekt: “Sistemi i dixhitalizimit të monitorimit dhe raportimit të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve” për Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”.

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemi i dixhitalizimit të monitorimit dhe raportimit të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve” për Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”.		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 61, nr. 6687 prot., datë 30.10.2019	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 307, nr. 4647 prot., datë 02.08.2019 E.Z A.Sh J.O	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 446, nr. 7303 prot., datë 22.11.2019, i ndryshuar. E.M O.V I.Sh
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 146,207,809 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 145,745,000 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 462,809 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 25.11.2019	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 2 OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK-s’ka; APP–s’ka; KPP-s’ka	12. Përgjigje e Ankesës nga AK -	13. Përgjigje e Ankesës nga APP apo AKKP -
b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		

14.Lidhja e kontratës Nr. 7967 prot., Datë 30.12.2019	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 174,894,000 lekë	16. Likuiduar deri -
17- Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli/Shërbimi dt. 15.06.2020	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 6 muaj implementim dhe 48 muaj mirëmbajtje	19.Zgjatja e kontratës me..... ditë -

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe dokumentacionit në sistemin e prokurimeve të APP, u konstatua:

Hartimi i specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta.

Kriteret e vendosura nga grupi i punës për hartimin e kritereve të veçanta, janë si më poshtë:

“1. Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi 2 punonjës të çertifikuar implementimin e serverave nga prodhuesi.

2. Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi 2 punonjës të çertifikuar si Administrator sistemi.

3. Operatori ekonomik duhet të jetë i specializuar nga prodhuesi në fushën e Serverave.

4. Operatori ekonomik duhet të jetë i specializuar nga prodhuesi në fushën e Sistemit të Operimit OS.

5. Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi 1 punonjës të çertifikuar për Storage në nivel Architekt.

6. Operatori Ekonomik duhet të ketë minimumi 1 punonjës të çertifikuar për Servers në nivel Architekt.

7. Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 punonjës të çertifikuar në menaxhimin e projektit.

8. Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi 3 punonjës të çertifikuar në Administrimin e Databaza-ve.

9. Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 punonjës të certifikuar si Zhvillues programues në nivelin Architekt.

Personeli i mësipërm duhet të ketë aktualisht një marrëdhënie pune me ofertuesin jo më pak se 6 (gjashtë) muaj, e vërtetuar kjo me formularet E-sig të listë pagesave të konfirmuara pranë autoriteteve tatimore”.

Grupi i punës për hartimin e kritereve të veçanta, ka argumentuar kërkesën për certifikimet e punonjësve por nuk ka argumentuar arsyen e numrit të tyre në çdo rast. Në vlerësimin tonë kërkesa e më shumë se 1 punonjësi për çdo certifikim është e paarsyetuar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” nenin 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, ku citohet “Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

Gjithashtu nga ana e grupit të hartimit të kritereve të veçanta është kërkuar që punonjësit e mësipërm duhet të jenë marrëdhënie pune me operatorin ekonomik jo më pak se 6 muaj. Vendosja e këtij kriteri është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike”, pika 1 dhe 2, ku citohet: “1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara” dhe “2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik”. Ky kriter nuk është i

nevojshëm për të siguruar përmbushjen e kontratës, duke ndikuar negativisht në pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi E.Z, A.Shdhe J.O, në cilësinë e grupit të hartimit të specifikimeve teknike.

Vlerësimi i ofertave dhe kualifikimi i operatorëve ekonomik.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomik. Njëri prej tyre nuk ka dorëzuar dokumentacion dhe ofertë ekonomike, duke u skualifikuar. Ndërsa OE “H shpk” është shpallur fitues, pasi sipas vlerësimit të komisionit të vlerësimit të ofertave, ka plotësuar të gjitha kërkesat e vendosura.

Grupi i auditimit verifikoi dokumentacionin elektronik dhe fizik të paraqitur nga operatori ekonomik i shpallur fitues, dhe konstatoi se nuk i ka përmbushur të gjitha kërkesat. Konkretisht:

Në pikën 2.2 “Kapaciteti teknik” kërkohet “*Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të tenderit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit*”. Për përmbushjen e kësaj pike, operatori ekonomik ka dorëzuar:

1. Kontratën nr. 11807 prot., datë 29.12.2016, me objekt “Krijimi i moduleve të reja dhe i raportimeve për Formularët e Bashkimit Ndërkufitar në sistemin e QKB-së dhe aplikimet online për Bashkimin Ndërkufitar dhe shërbimeve të tjera”, me vlerë 41,649,890 lekë pa TVSH (28,583,330 lekë investimi dhe 13,066,560 lekë për mirëmbajtje), të lidhur ndërmjet QKB dhe BOE “H shpk”, “K shpk” dhe “AB shpk”. Bashkëlidhur nuk ndodhet marrëveshja midis OE për këtë kontratë. Gjithsesi janë paraqitur 26 fatura tatimore me vlerë totale 8,493,264 lekë (me TVSH), të lëshuara nga OE “H shpk”, përshkrimi i të cilave është “*Shërbim mirëmbajtje për muajin ...*”. Gjithashtu është dokumenti i vërtetimit të realizimit të kontratës *deri në datën 08.08.2019*, lëshuar nga QKB.

Nisur nga faturat, rezulton se OE “H” ka realizuar vetëm pjesën e mirëmbajtjes së kontratës, pra kjo kontratë mund të konsiderohet e ngjashme vetëm për pjesën e mirëmbajtjes, por jo për ngritjen e sistemit të kërkuar.

2. Kontratën nr. 6923/1 prot., datë 08.09.2016, me objekt “Mirëmbajtja e sistemit elektronik të QKR-së”, me vlerë 48,630,000 lekë pa TVSH, të lidhur ndërmjet QKB dhe BOE “H shpk” dhe “I.A”. Bashkëlidhur nuk ndodhet marrëveshja midis OE për këtë kontratë. Gjithsesi janë paraqitur 34 fatura tatimore me vlerë totale 24,257,284 lekë (me TVSH), të lëshuara nga OE “H shpk”, përshkrimi i të cilave është “*Shërbim mirëmbajtje për muajin ...*”. Gjithashtu është dokumenti i vërtetimit të realizimit të kontratës *deri në datën 08.08.2019*, lëshuar nga QKB.

Kjo kontratë është vetëm si MNSH, pra mund të konsiderohet e ngjashme vetëm për pjesën e mirëmbajtjes, por jo për ngritjen e sistemit të kërkuar.

3. “Marrëveshje për blerje shërbimesh” ndërmjet OE “H shpk” dhe kompanisë “E.H S.A”, ku sipas saj ndër të tjera citohet “E. dhe Ofruesi i shërbimeve në këtë mënyrë lidhin këtë marrëveshjenë lidhje me prokurimin nga E. të shërbimeve mbështetëse HW për IT dhe komunikimit të të dhënave të përdorura në funksionimin e shërbimeve të telekomunikacionit nga ofruesi i shërbimit”. Kontrata është lidhur në vitin 2010, me afat deri në vitin 2014, por kjo kontratë është zgjatuar disa herë deri në vitin 2018.

Për këtë kontratë janë paraqitur faturat tatimore me përshkrim “*Shërbime mirëmbajtje nga H për periudhën...*” si më poshtë:

-Fatura nr. 34, datë 04.03.2016, me vlerë 10,400,946 lekë (*jashtë afatit 3 vjeçar nga data e publikimit të tenderit*).

-Fatura nr. 53, datë 03.06.2016, me vlerë 9,741,790 lekë (*jashtë afatit 3 vjeçar nga data e publikimit të tenderit*).

-Fatura nr. 112, datë 05.09.2016, me vlerë 9,686,855 lekë (jashtë afatit 3 vjeçar nga data e publikimit të tenderit).

-Fatura nr. 165, datë 03.12.2016, me vlerë 9,571,351 lekë.

-Fatura nr. 39, datë 03.03.2017, me vlerë 9,524,165 lekë.

-Fatura nr. 67, datë 02.06.2017, me vlerë 8,965,960 lekë.

-Fatura nr. 109, datë 04.09.2017, me vlerë 8,921,833 lekë.

-Fatura nr. 159, datë 04.12.2017, me vlerë 8,935,873 lekë.

Kjo marrëveshje është një marrëshje për shërbime mirëmbajtje, pra mund të konsiderohet e ngjashme vetëm për pjesën e mirëmbajtjes, por jo për ngritjen e sistemit të kërkuar.

4. Kontratë shërbimi me nr. 8236/8 prot., datë 20.07.2015, me objekt “Shërbimi, mirëmbajtje për pajisjet ekzistuese të sistemit të thesarit”, për një periudhë 10 mujore, me vlerë 8,340,000 lekë pa TVSH, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave dhe BOE “H shpk” dhe “C shpk”.

Kjo kontratë dhe zbatimi i saj janë jashtë afatit 3 vjeçar nga data e publikimit të tenderit, dhe nuk vlen si eksperiencë gjatë 3 viteve të fundit.

Nga sa më sipër, konstatohet se OE “H shpk” i shpallur fitues nuk ka përmbushur pikën 2.2 “Kapaciteti teknik” për punë të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të tenderit, pasi eksperiencat e tij lidhen vetëm me pjesën e mirëmbajtjes, dhe jo me ngritje dhe implementim sistemi (çka përbën dhe vlerën më të madhe të kontratës), duke u shpallur fitues në mënyrë të padrejtë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, ku citohet “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi E.M, I.Sh dhe O.V, në cilësinë e komisionit të vlerësimit të ofertave.

Zbatimi i kontratës.

Me akt marrjen në dorëzim nr. 2894/1 prot., datë 15.06.2020, janë marrë në dorëzim sipas kontratës:

- Zhvillimi i sistemit informatik të administrimit të aseteve të UK, monitorimit të projekteve në këtë sektor dhe planifikimit të nevojave për investime në të ardhmen (90,463,000 lekë pa TVSH);

- Instalimi, konfigurimi i pajisjeve fizike (520,000 lekë pa TVSH);

- Trajnimi i përdoruesve (150,000 lekë pa TVSH).

Total 109,359,600 lekë.

Dorëzimi i sistemit rezulton të jetë kryer brenda afatit të përcaktuar kontratë.

Në datën 20.04.2022, grupi i auditimit verifikoi realizimin e sistemit, në prani të përfaqësuesve të AKSHI-t M.Ç, B.A dhe A.D. Nga verifikimi, u konstatuan mangësitë:

1. Mungon “Moduli Gis për shfaqjen në hartë të aseteve”, në kundërshtim me pikën 2.3 të TORS;

2. Për sa i përket “Modulit të inventarizimit fizik të aseteve të ujësjellës kanalizimeve”, mungon opsioni për “Dokumentimin me fotografi të të gjitha pasurive të dukshme”, si dhe aplikimi i “vendndodhjes fizike të secilit objekt në hartë” ishte i pamundur, në kundërshtim me pikën 13.1 të TORS;

3. Sistemi nuk kishte mundësinë e gjenerimit të raporteve:

• Raporte për totalin e investimeve të ndërmarra për cdo shoqëri të ujësjellës kanalizimeve;

• Raporte për totalin e të ardhurave nga cdo shoqëri e ujësjellës kanalizimeve;

• Raporte për detyrimet e cdo shoqërie të ujësjellës kanalizimeve;

në kundërshtim me pikën 13.2 të TORS;

4. Sistemi nuk komunikonte me sistemet e QKB dhe ASIG, në kundërshtim me pikën 7 të TORS.

Marrja në dorëzim e sistemit duke mos qenë konform TORS, është në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 77 “Mbikëqyrja e kontratës”, ku citohet: “1. Gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor dhe organe të tjera shtetërore, të autorizuar me ligj, (nëse është rasti) mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe legjislacionin në fuqi. 2. Mospërbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën shkak për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike sipas përcaktimeve të pikës 3/ç të nenit 13 të LPP-së. Në këtë rast, autoriteti kontraktor ka detyrimin të dërgojë në APP kërkesën për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike brenda 3 (tre) muajve nga zgjidhja e kontratës apo përfundimi i afatit të zbatimit të saj, përfshirë këtu edhe periudhën e garancisë. 3. Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi”.

Për këtë mbajnë përgjegjësi E.Z, A.Sh, A.J dhe J.O, në cilësinë e grupit të marrjes në dorëzim.

Sa më sipër konstatohet se operatori ekonomik nuk e ka realizuar kontratën sipas parashikimeve. Për këtë arsye (duke qenë se vlera ekonomike e sistemit nuk është e ndarë sipas moduleve), AKSHI duhet të mbante vlerën e garancisë për sigurimin e kontratës **11,735,160 lekë** nga OE “H shpk”, e cila në rastin që nuk i është mbajtur.

Gjithashtu u konstatua se për gjithë periudhën kur sistemi ka funksionuar (afërsisht 2 vite), ka pasur një përdorim mjaft të ulët në drejtim të popullimit të tij me të dhëna, çka ka çenuar realizimin e qëllimit për të cilin u ndërtua.

Për këtë periudhë, ka patur rreth 1800 logime, ndër të cilat shumica e tyre janë të Administratorit të sistemit, çka vërteton mungesën e angazhimit për vënien në efikasitet të sistemit. Kjo mungesë e angazhimit u konstatua edhe nga fakti i mos gjenerimit të një pjese të raporteve si pasojë e mungesës së rekordeve.

Sipas relacioneve paraprake për nevojën për këtë sistem dhe TORS, citohet:

“Objektivi i Përgjithshëm

Objektivi i përgjithshëm i projektit është ndërtimi i një sistemi të integruar informatik për administrimin e aseteve të ujësjellës-kanalizimeve. Përmes këtij sistemi do të mundësohet identifikimi, regjistrimi dhe më tej vlerësimi i gjendjes së aseteve të shoqërisë publike të ujësjellës-kanalizimeve, duke pasur në këtë mënyrë dhe një pasqyrë të investimeve të realizuara deri tani dhe planifikimin e nevojave për investime në të ardhmen.

Ky objektivi lidhet me pritshmërinë që qeverisja qendrore do të krijojë një sistem për raportimin dhe monitorimin mbi gjendjen e aseteve ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve, investimeve të realizuara deri më tani dhe planifikimin e nevojave për investime në ndërtimin/rehabilitimin/zgjerimin e sistemeve të ujësjellës kanalizimeve, duke forcuar në këtë mënyrë kapacitetet e administratës publike për menaxhimin e zbatimit të masterplanit kombëtar sektorial.

Sistemi ka për qëllim automatizimin e procesit të identifikimit, regjistrimit dhe mirëmbajtjes së aseteve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve për të ndihmuar në:

- Zhvillimin e një platforme kombëtare të aseteve të ujësjellës-kanalizimeve dhe përdorimin e këtij informacioni për hartimin e programeve dhe politikave kombëtare të mbështetura në evidencë;*
- Bashkërendimi i përpjekjeve midis institucioneve në nivel qendror dhe vendor për përmirësimin e monitorimit të investimeve në këtë sektor dhe planifikimin në vijimësi;*
- Kontroll dhe monitorim i projekteve të financuara nga buxheti i shtetit ose donatorë në fushën e ujësjellës kanalizimeve;*

• Programim të investimeve për sektorin bazuar në prioritetet e Masterplan dhe projektet e depozituara në AKUM”.

Aktualisht, edhe pse kanë kaluar rreth 2 vite nga marrja në dorëzim, objektivat dhe qëllimi i sistemit mbeten të pamaterializuara, duke çenuar vlerën e investuar për ngritjen e sistemit. Ndërkohë kontrata në lidhje me mirëmbajtjen e sistemit vazhdon të paguhet e plotë sikurse sistemi të ishte plotësisht i përdorur, pagesa të cilat në këto kushte vlejné më shumë për përmbushjen e kontratës nga ana e AK, se sa në dobi të sistemit dhe përdoruesve.

Sa më sipër duke qenë se vlera ekonomike e sistemit nuk është e ndarë sipas moduleve), AKSHI duhet të mbante vlerën e garancisë për sigurimin e kontratës 11,735,160 lekë, e cila në rastin që nuk i është mbajtur, dhe përbën veprime në kundërshtim me 3E^{-të} dhe të paguhej nga OE “H shpk”.

5. Për procedurën e prokurimit me objekt: “Upgrade i sistemit qëndror e DPSHTRR, pajisjet HW dhe aplikimit e DPSHTRR. Ridizenjim i infrastrukturës HW dhe ndërtimi i sistemit të menaxhimit. Upgrade i sistemeve operative të serverave dhe databazës e-DPSHTRR. Upgrade i sistemit informatik e DPSHTRR, përmirësimi i funksionaliteteve aktuale, shtim shërbimesh”)

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Upgrade i sistemit qëndror edpshttr, pajisjet HW dhe aplikimit edpshttr. Ridizenjim i infrastrukturës HW dhe ndërtimi i sistemit të menaxhimit. Upgrade i sistemeve operative të serverave dhe databazës edpshttr. Upgrade i sistemit informatik edpshttr, përmirësimi i funksionaliteteve aktuale, shtim shërbimesh”.		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 61, nr. 6687 prot., datë 30.10.2019	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 582, nr. 4758 prot., datë 20.09.2019 E.K A.N G.Ç	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 225, nr. 3151 prot., datë 12.06.2019, i ndryshuar. Dh.L E.L A.Q
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 107,554,120 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 100,988,920 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 6,565,200 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 13.06.2019	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10.Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE (BOA) b) S’kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK-s’ka; APP-s’ka; KPP-s’ka	12. Përgjigje e Ankesës nga AK -	13. Përgjigje e Ankesës nga APP apo AKKP -
b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. 4721 prot., Datë 06.08.2019 (amenduar)	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 121,186,704 lekë	16. Likuiduar deri -
17- Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli/Shërbimi dt. 21.05.2020	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 6 muaj implementim dhe 24 muaj mirëmbajtje	19.Zgjatja e kontratës Deri 21.05.2020

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe dokumentacionit në sistemin e prokurimeve të APP, u konstatua:

Hartimi i specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta.

Kriteret e veçanta të vendosura nga grupi i punës për hartimin e kritereve të veçanta, janë si më poshtë:

“1- Për shkak të rëndësisë së veçante që ka sistemi aplikativ e DPSHTRR dhe infrastruktura e tij mbështetëse, si sistemi themelor me të cilën institucioni zbaton proceset e përditshme të punës, Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë që zotëron të gjitha kapacitetet menaxheriale në fushën e cilësisë, shërbimeve, të sigurisë së informacionit apo sigurisë në punë duke paraqitur certifikatën - BS PAS 99:2012 – Integrated Management Systems.

2- Operatori ekonomik duhet të jetë partner zyrtar dhe i specializuar nga prodhuesi Microsoft në disa drejtime teknike si vijon:

- a) Specializimin DataCenter;
- b) Specializimin Data platform;
- c) Specializimin Application Development;
- d) Specializimin Learning;

Për të vërtetuar specializimet e lartpërmendura duhet që kompania të paraqesë certifikata apo dokument tjetër zyrtar, ose një kopje të printuar të faqes së prodhuesit ku tregohet që kompania është partnere zyrtare si edhe ku listohen specializimet e mësipërme të kompanisë.

3- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga prodhuesi, ku dëshmohet që Operatori është i autorizuar për shitjen dhe mirëmbajtjen e pajisjeve hardware Server, Storage, pajisje network për territorin e Shqipërisë.

4- Operatori Ekonomik duhet të ketë aftësi teknike për zbatimin e shërbimeve që kërkohen në Shtojcën Specifikimet teknike. Në mënyrë të veçantë Operatori duhet të paraqesë vërtetimet e mëposhtme:

a) OE duhet të ketë të paktën partneritet te nivelit Premier ose ekuivalent me prodhuesin e pajisjeve te rrjetit të ofruara dhe të paraqesë specializimet Advanced Enterprise Networks Architecture dhe Advanced Security Architecture Specialization ose ekuivalente të tyre në fushën e sigurisë dhe Enterprise Networks.

b) OE duhet të ketë status specializimi të paktën të nivelit Gold ose ekuivalente për pajisjet Servera dhe Storage.

c) OE duhet të jetë servis i autorizuar nga prodhuesi për këto pajisje.

Kërkesat e mësipërme duhet të dëshmojnë nëpërmjet certifikatave të lëshuara nga prodhuesi apo deklaratave/publikimeve në faqen zyrtare të prodhuesit.

5- Operatori Ekonomik duhet të kenë në stafin e tij si të punësuar me kohë të plotë, me qëllim ofrimin me profesionalizëm të shërbimeve të suportit të infrastrukturës hardëare, të paktën:

a) Një menaxher projektsh të certifikuar në fushën e menaxhimit të projekteve (Project Management Professional PMP) nga PMI dhe ITIL ose ekuivalente.

b) Dy specialistë të nivelit profesional ku të paktën njëri prej tyre i certifikuar për Implementimin e Sigurisë të rrjetit, dhe një për dizejnimin e komunikimit në rrjete, të certifikuar nga Cisco.

c) Dy specialistë të certifikuar nga prodhuesi i sistemit operativ Microsoft Server për suportin dhe mbështetjen dhe administrimin e sistemit operativ Microsoft. Të dëshmojnë me certifikatat e lëshuara nga prodhuesi ose Transcript.

d) Dy specialistë të certifikuar për platformë virtualizimi Microsoft, të certifikuar nga prodhuesi. Të dëshmojnë me certifikatat e lëshuara nga prodhuesi ose Transcript.

e) Dy specialistë të certifikuar për sistemet HP (Servera dhe Storage) të nivelit Solution Architect të certifikuar nga Prodhuesi.

f) Një specialist të personelit të shërbimeve, të trajnuar e të certifikuar për “ITIL v3 Foundation” ose ekuivalente.

g) Një specialist të certifikuar nga prodhuesi për administrimin e Microsoft SQL server, si baza e të dhënave në përdorim nga sistemi.

h) Një specialist të certifikuar si analist biznesi për software (Software Business Analyst).

i) Një specialist të certifikuar për testimin e softëare-ve.

j) Një specialist të certifikuar për të dhënë trajnim mbi teknologjitë Microsoft.

k) Pesë specialistë të certifikuar nga prodhuesi për zhvillim softëare-i të paktën të nivelit MCSD. Të dëshmojnë me certifikatat e lëshuara nga prodhuesi ose Transcript”.

Sa më sipër, konstatojmë se:

1. Grupi i punës për hartimin e kriterëve të veçanta, ka argumentuar kërkesën për certifikimet e punonjësve, por nuk ka argumentuar arsyen e numrit të tyre në çdo rast. Në vlerësimin tonë kërkesa e më shumë se 1 punonjësi për çdo certifikim është e paarsyetuar, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” nenin 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, ku citohet “Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

2. Grupi i auditimit vlerëson se kriteri që Operatori ekonomik duhet të jetë partner zyrtar dhe i specializuar nga prodhuesi Microsoft në disa drejtime teknike si specializimi Learning, është i panevojshëm për realizimin e kontratës, duke ndikuar negativisht në konkurrencë për këtë procedurë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike”, pika 1 dhe 2, ku citohet: “1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara” dhe “2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik”.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi E.K, A.N dhe G.Ç, në cilësinë e grupit të hartimit të kriterëve të veçanta.

6. Prokurim i parashikuar dhe realizuar, me objekt “Blerje shërbim automatizimi dhe monitorimi aktiviteti për inspektorët - Për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”, me datë zhvillimi të procedurës 25.06.2020, me referencë 59482.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës që është prokuruar:

Qëllimi i këtij projekti është sigurimi i një shërbimi për automatizimin dhe monitorimin e inspektorëve të Administratës Tatimore në terren. Me anë të këtij procesi synohet të rritet edhe efikasiteti i vetë inspektorëve duke i dhënë mundësinë këtyre të fundit të kenë informacionin e duhur në momentin e duhur mbi urdhrat e punës si dhe informacionin e nevojshëm mbi subjektet tatimpaguese në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Projekti synon të informojë në kohë reale administratën tatimore për çdo lëvizje dhe inspektim të inspektorëve si dhe çdo rast kur inspektorët largohen nga zona ose qëndrojnë për një kohë me të gjatë se koha e specifikuar në një zonë ose në një subjekt, etj.

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi: nr. 19, datë 01.06.2020	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: K.P A.A L.K	4. Komisioni i llogaritjes se fondit limit: K.P A.A L.K
2. Fondi Limit (pa TVSh) 106,200,000 lekë: Mirëmbajtje 106,200,000 Lekë për 1 vit.	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: E.S M.D D.Gj	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: D.F I.Sh D.K
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”, me mjete elektronike”	9. Operatori fitues: BOE “I&C” sh.p.k dhe “IVA E” sh.p.k	10. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 6,309,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 25.06.2020		

	Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 99,891,000 lekë: Mirëmbajtje 99,891,000 lekë	
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: 1 (një) Bashkim Operatorësh	12. Operatore të Kualifikuara: 1 (një)	13. Operatorë të s'kualifikuara:
14. Ankimimet: Nuk ka	15. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	16. Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka
17. Lidhja e kontratës: nr. 3815, Datë 18.08.2020	18. Vlera e kontratës (me TVSh): Mirëmbajtje 119,869,200 lekë	19. Afati i kontratës 12 muaj

a. Identifikimi i nevojave për mallra dhe shërbime

Me shkresën nr. 7882 prot., datë 24.12.2019, AKSHI i kërkon Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve fondet e parashikuara për këtë projekt për vitin 2020 dhe një përfaqësues me qëllim ngritjen e grupit të punës për hartimin e termave të referencës, studimin e tregut si dhe hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim.

b. Hartimi i specifikave teknike, përlllogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit

Me urdhrin e zëvendës drejtorit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.01.2020 është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike, studimin e tregut, përlllogaritjen e fondit limit si dhe hartimin e kriterëve të veçanta për procedurën “Blerje shërbim automatizimi dhe monitorim aktiviteti për inspektorët”.

Grupi i punës, me tre punonjës të AKSHI-t ka si afat për përfundimin e hartimit të termave të referencës, realizimit të studimit të tregut datën 05.02.2020. Me shkresën nr. 1707 prot., datë 01.04.2020 grupi i punës ka përfunduar hartimin e specifikimeve teknike.

Fondi limit është përlllogaritur bazuar në pikën 2.a “Çmimet e tregut”, të nenit 59 në VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, rezulton të jetë 106,200,000 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr. 2464 prot., datë 21.05.2020, grupi i punës ka dokumentuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, ku për **kapacitetin teknik është kërkuar:** Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga hapja e tenderit, shërbime të ngjashme me objektin e këtij prokurimi të paktën në vlerën totale 40% të fondit limit.

Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin e shërbimit sipas specifikimeve teknike të projektit, është kërkuar se OE duhet të vërtetojë që ka të punësuar **prej tre muajsh nga data e fillimit të kësaj procedure** një personel teknik prej të paktën 15 punonjësish, nga të cilët:

- Të paktën **5** punonjës të diplomuar për Inxhinieri Elektronike ose Telekomunikacion.
- Të paktën **1** punonjës të certifikuar database administrator në nivel MCSA/MCSE ose ekuivalente për zhvillim aplikacionesh web.
- Të paktën **1** punonjës të certifikuar database administrator në nivel MCSA/MCSE ose ekuivalente për bazën e të dhënave që do të përdoret në zgjidhjen e ofruar.
- Të paktën **1** punonjës të certifikuar kontabël i miratuar ose ekspert kontabël për të garantuar saktësinë e proceseve të punës me karakter tatimor që do të ofrojë sistemi.
- Të paktën **1** punonjës të certifikuar PMP ose ekuivalente nga një institucion i njohur në nivel ndërkombëtar, që do të luajnë rolin e menaxherit të projektit në të gjithë komponentët e tij.

Hartuesit e specifikimeve teknike të cilët janë dhe hartuesit e kriterëve të veçanta të kualifikimit kanë mbajtur procesverbal për argumentimin e kriterëve të vendosura mbi kapacitetin teknik. Argumentimi i grupit për kërkesën me të paktën 5 punonjës të diplomuar për Inxhinieri Elektronike ose Telekomunikacion është se OE duhet të vërtetojë që ka stafin e duhur për instalimin e sistemit, vënien në punë dhe asistimin e AK gjatë kohëzgjatjes së kontratës. Duke parë sasinë e pajisjeve që do të vihen në punë dhe rëndësinë e sistemit, është gjykuar se të paktën 5 punonjës janë të nevojshëm për të garantuar ecurinë e nevojshme të kontratës.

Nga auditimi mbi specifikimet teknike u konstatua se, sasia e pajisjeve nuk përcaktohet në dokumentimin e proceseve të punës tek specifikimet teknike dhe as tek procesverbali argumentues hartuar nga grupi për kapacitetin teknik duke mos dhënë në këtë mënyrë informacion se cili është volumi i punës që pritet të realizohet me këtë procedurë.

Në specifikimet teknike, pika 7 “Kërkesat funksionale për shërbimin” citohet se: *Shërbimi që kërkohet me anë të këtij projekti duhet t’i japë zgjidhje problemit të monitorimit të inspektorëve në terren duke ofruar një zgjidhje informatike (software).*

Për sa më sipër, vendosja e kriterëve për 5 punonjës të diplomuar në Inxhinieri Elektronike ose Telekomunikacion, të punësuar për 3 muajt e fundit, jo vetëm që nuk është argumentuar por nuk është në përputhje dhe me objektin e procedurës, e cila është plotësisht një sistem informatik, duke ulur konkurrencën e pjesëmarrësve në këtë prokurim, në kundërshtim me:

- Nenin 28, pika 2 në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar;
- Nenin 46, pika 1 dhe 3 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Nga auditimi mbi specifikimet teknike u konstatua se, termat e referencës në këtë procedurë janë hartuar nga specialistë të AKSHI-t sipas aneksit 2 “Mirëmbajtje-për-projektet-tik-hardware-dhe-software”, miratuar si standard për mirëmbajtjet, megjithëse bazuar në specifikimet teknike ajo që kërkohet është një sistem informatik i cili ka dhe mirëmbajtje, që do të thotë se hartimi duhej të ishte bazuar në Aneksin 1 dhe jo në Aneksin 2, miratuar nga AKSHI.

Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi 3 anëtarët që kanë hartuar specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit: K.P, A.A, L.K.

Me urdhrin e prokurimit nr. 19, datë 01.06.2020, protokolluar me shkresën nr. 2588 prot., datë 01.06.2020 është urdhëruar fillimi i procedurës “Blerje shërbim automatizimi dhe monitorim aktiviteti për inspektorët”, me fond limit 106,200,000 lekë pa TVSH.

Vlerësimi i Ofertave:

Me urdhrin e titullarit nr. 159, datë 24.06.2020 është krijuar komisioni i vlerësimit të ofertave i cili ka për detyrë hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të paraqitura për procedurën e sipërpërmendur.

Dy anëtarë të KVO, D.K dhe I.Sh, kanë vlerësuar se BOE “I.M.C sh.p.k” me NIPT L dhe “I.sh.p.k” me NIPT J, plotësojnë kapacitetet ligjore, kapacitetet financiare dhe kapacitetet teknike të kërkuara nga AK në dokumentet standarte të tenderit.

Anëtari tjetër, D.F njëkohësisht dhe kryetar i KVO, nuk ka qenë dakord në plotësimin e kriterit të kërkuar për “OE duhet të ketë të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga hapja e tenderit, shërbime të ngjashme me objektin e këtij prokurimi të paktën në vlerën totale 40% të fondit limit”.

Nisur nga marrëveshja I. sh.p.k nuk ka paraqitur kontratë të ngjashme me natyrën e këtij tenderi që janë zhvillim dhe automatizim software, duke qenë se ky OE do të jetë përgjegjës për krijimin e 6 moduleve software kërkuar në specifikimet teknike:

- Sistemi Qendror;
- Servisi i monitorimit të levizjes;

- Servisi i sinkronizimit të të dhënave;
- Servisi i live tracking dhe i njoftimeve;
- Servisi i sinkronizimit të të dhënave për biznesin;
- Aplikacioni i inspektorëve.

KVO ka vendosur me dy vota pro dhe një kundër shpalljen fitues të BOE “I.M.C sh.p.k” dhe “I. sh.p.k”.

Në specifikimet teknike konstatohet se zgjidhja e kërkuar është informatike (software) dhe përmbushja e kriterit me shërbime të ngjashme në të paktën 40% të vlerës së fondit limit, duhet të plotësohet nga të dy OE, sipas përqindjeve të punimeve përcaktuar në marrëveshjen ndërmjet palëve.

Dokumentacioni që ka dorëzuar BOE në këtë procedurë prokurimi sipas marrëveshjes së BOE, përqindja e pjesëmarrjes është 20% që do të realizohet nga OE I.M.C sh.p.k dhe 80% do të realizohet nga I. sh.p.k.

Kjo do të thotë se:

- OE I.M.C sh.p.k, nevojitet të ketë kryer shërbime të ngjashme në masën 0.08% të fondit limit ose në vlerën 8,496,000 lekë pa TVSH;
- OE I.sh.p.k, nevojitet të ketë kryer 0.32% të fondit limit ose në vlerën 33,984,000 lekë pa TVSH.

Ndarja që kanë dakordësuar BOE për realizimin e kontratës është si më poshtë:

I.M.C sh.p.k	I.sh.p.k
20%	80%
Komunikimi me sistemet e tjera (moduli i ndërveprimit)	Sistemi Qendror Servisi i monitorimit të lëvizjes Servisi i sinkronizimit të të dhënave Servisi i live tracking dhe i njoftimeve Servisi i sinkronizimit të të dhënave për biznesin Aplikacioni i inspektorëve

Nga auditimi mbi dokumentacionin që ka dorëzuar BOE lidhur me kontratat e ngjashme, u konstatua se:

- OE I.M.C sh.p.k ka realizuar një kontratë të ngjashme në vlerën 142,218,739 lekë pa TVSH. Kërkesa nga ky OE është përmbushur pasi ai rezulton se ka realizuar kontrata të ngjashme mbi vlerën që ka detyrim.
- OE I.sh.p.k ka paraqitur fatura për pajisje fiskale, por nuk ka paraqitur asnjë kontratë të ngjashme në zgjidhje informatike (software), që do të thotë se kërkesa nga ky OE nuk është përmbushur.
- OE I.M.C sh.p.k disponon punonjësit e kërkuar me certifikimet MCSE, MCSD dhe PMP, duke përmbushur kapacitetin teknik për punonjësit e kërkuar për realizimin e kontratës.
- OE I.sh.p.k disponon stafin me 1 Kontabilist të miratuar, 4 Inxhinier Elektronik, 1 Inxhinier Mekatronik, 2 Inxhinier Elektronik, 1 Inxhinier Elektrik dhe një Teledidaktikë. OE I. sh.p.k. nuk disponon punonjësit e certifikuar për realizimin e kontratës çfarë do të thotë se nuk përmbush kapacitetin teknik për punonjësit e kërkuar për realizimin e kontratës.

Për sa më sipër, BOE është kualifikuar fitues megjithëse nuk plotëson tërësisht kapacitetin teknik kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit, në kundërshtim me:

- Nenin 46, pika 1.b e Ligjit nr. 9643 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku citohet se “Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe

personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”;

- Nenin 74, pika 3 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar”, ku citohet se “Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

Për këtë mbajnë përgjegjësi dy nga tre anëtarët e KVO, I.Sh dhe D.K, të cilët kanë vlerësuar se BOE përmbush kapacitetin teknik duke e shpallur atë fitues për këtë procedurë prokurimi. Zbatimi i kësaj kontrate është trajtuar nga KLSH në një auditim përputhshmërie të ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tiranë për periudhën 01.01.2018 – 31.10.2021.

7. Prokurim i realizuar, me objekt “e Kontroll, Sistemi i kontrollit të subjekteve që kanë kontratë me FSDKSH”, me datë zhvillimi të procedurës 11.06.2020, me referencë 58396.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës që është prokuruar.

Ndërtimi i këtij sistemi ka për qëllim automatizimin e procesit të ruajtjes, procesimit, marrjes dhe analizimit të informacionit që lidhet me lidhjen e kontratës për farmaci dhe depo farmaceutike dhe proceset e veprimtarisë kontrolluese të FSDKSH për subjektet që kanë kontratë me FSDKSH-në.

Nëpërmjet këtij sistemi të regjistrimit elektronik synohet të arrihen:

1. Optimizimi i proceseve të kontrollit duke respektuar parimet mbi të cilat ai mbështetet si dhe zbatimin me përpikëri të detyrimeve kontraktuale që FSDKSH ka me të tretët.
2. Përmirësim i menaxhimit të proceseve të brendshme të punës në funksion të kontrollit të subjekteve të cilët kanë kontratë me FSDKSH, duke siguruar në kohë reale statusin aktual të proceseve aktivë në çdo nivel;
3. Përmirësimi dhe garantimi i transparencës dhe monitorimit të aktivitetit të Drejtorisë së Kontrollit dhe sektorëve të Kontrollit në zbatim të objektivave.
4. Përdorim eficient i informacionit të qendëruar dhe ndikim të drejtpërdrejtë në vendimmarrje bazuar në analiza të detajuara.

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi: nr. 18, datë 18.05.2020	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: D.L F.B A.Th E.C B.H	4. Komisioni i llogaritjes se fondit limit: B.M A.Th F.B
2. Fondi Limit (pa TVSh) 156,584,000 lekë: Mirëmbajtje 59,999,998,6 Lekë për 48 muaj.	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: E.S M.D D.Gj	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: A.Z S.A I.Sh
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”, me mjete elektronike”	9. Operatori fitues: OE “S.&S” sh.p.k. Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 94,068,696 lekë: Mirëmbajtje 59,510,304 lekë	10. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 3,005,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 11.06.2020	11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: I&C S.&S	12. Operatore të Kualifikuar: 1 (një)
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: I&C S.&S	12. Operatore të Kualifikuar: 1 (një)	13. Operatorë të s’kualifikuar: 1 (një)
14. Ankimimet: Nuk ka	15. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	16. Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka

17. Lidhja e kontratës: nr. 3277, datë 10.07.2020	18. Vlera e kontratës (me TVSh): Mirëmbajtje 153,579,000 lekë	19. Afati i kontratës do të vazhdojë 3 muaj implementim dhe 48 muaj mirëmbajtje.
---	---	---

a. Identifikimi i nevojave për mallra dhe shërbime

Marrëdhëniet me subjektet e ndryshëm publikë dhe privatë, të cilët ofrojnë shërbime në sektorin e shëndetësisë, FSDKSH i rregullon me lidhjen e kontratave periodike me to. Kontratat lidhen nga Zyra Qendrore dhe nga Zyrat Vendore. Për monitorimin dhe kontrollin e këtyre kontratave është ngritur Drejtoria e Kontrollit në FSDKSH si dhe çdo Drejtori Rajonale ka sektorin e vetë të Kontrollit. Për të filluar një praktikë kontrolli Drejtoria e Kontrollit (sektori i kontrollit në Drejtorinë Rajonale) mbështeten në planifikimin vjetor të punës së tyre dhe në të dhëna paraprake që marrin nga Drejtoritë e tjera në FSDKSH si mund të jenë Drejtoria e Rimbursimit, Drejtoria e Informacionit dhe Analizës Statistike, Drejtoria e Kujdesit Parësor dhe Spitalor dhe jo vetëm. Shkëmbimi i informacionit midis këtyre struktura realizohet me anë të komunikimit me e-mail dhe shkresor. Për specialistët e kontrollit ruajtja e dokumentacioneve kryhet në kompjuterët personale dhe ky informacion nuk është i organizuar për të gjithë Zyrën Qendrore dhe Zyrat Vendore. Kjo mënyrë sjell punë dyfishe si për strukturat të cilat përpunojnë informacion ashtu dhe për vetë kontrolluesit si edhe komplikon procedurat për subjektet që kanë lidhur apo duan të lidhin kontrate. Pra, FSDKSH nuk disponon një sistem elektronik për menaxhimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit dhe sektorët e kontrollit të Drejtorive Rajonale si dhe trajtimin e aplikimeve për lidhjen e kontratës me subjektet farmaceutike dhe depot. Menaxhimi i këtyre veprimtarive është bërë në formë shkresore.

b. Hartimi i specifikave teknike, përlllogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit

Me specifikimet teknike të kësaj procedure konstatohet se kërkohet një sistem informatik si dhe pajisjet fizike për ngritjen e sistemit me afat implementimi 3 muaj nga nënshkrimi i kontratës. Sipas kohës së implementimit në specifikimet teknike rezulton se, ngritja e sistemit të kontrollit për subjektet që kanë kontratë me FSDKSH do të bëhet në muajin e parë dhe të dytë të implementimit ndërkohë që prej muajit të dytë deri në të tretin do të zhvillohen fazat e tjera.

Nr.	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3	M4-M51
1	Lëvrimi i pajisjeve dhe kapaciteteve teknike				
2	Ngritja e sistemit të kontrollit për subjektet që kanë kontratë me FSDKSH				
3	Faza e zhvillimit				
4	Faza implementimit				
5	Faza e integritimit dhe testimit				
6	Trajnimi i përdoruesve				
7	Fillimi i SLA				

Nga auditimi rezulton se në specifikimet teknike, koha e implementimit të projektit për zhvillimin e sistemit nuk është bërë në renditjen e duhur, duke filluar së pari me ngritjen e sistemit dhe më pas me elementet e tjerë që janë: faza e zhvillimit, faza e implementimit, faza e integritimit dhe testimit si dhe trajnimi i përdoruesve. Ngritja e sistemit nuk mund të bëhet pa përfundimin e zhvillimit, implementimit, integritimit dhe testimit të tij.

Për këtë mbajnë përgjegjësi hartuesit e specifikimeve teknike: D.L, F.B, A.Th, E.C, B.H.

Fondi limit është përlllogaritur bazuar në pikën 2.a “Çmimet e tregut”, të nenit 59 në VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, rezulton të jetë 156,584,000 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr. 2464 prot., datë 21.05.2020, grupi i punës ka dokumentuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, ku për **kapacitetin teknik është kërkuar:**

Operatori ekonomik të ketë një numër prej mesatarisht 6 (gjashtë) punonjës të siguruar, ku përfshihet një personel teknik i diplomuar në një prej degëve të Inxhinierisë Elektronike, Inxhinieri Informatike, Teknologji Informacioni, Informatikë, Informatikë Matematikë, Inxhinieri Matematike dhe Informatike, Informatikë Ekonomike, Telekomunikacion, Inxhinieri Telekomunikacion që do të angazhohen në implementimin e projektit.

- Të paktën 1 punonjës të akredituar si menaxher projekti ose ekuivalente.
- Të paktën 1 punonjës të certifikuar për "ITIL Foundation" ose ekuivalente.
- Të paktën 1 punonjës të certifikuar për Testues të Akredituar Programi ose ekuivalente.
- Të paktën 3 punonjës të certifikuar si Microsoft Specialist në Programming HTML5 ose ekuivalente.
- Të paktën 2 punonjës të certifikuar si Microsoft Certified Solution Developer për Zhvillim Aplikacionesh ose ekuivalente.
- Të paktën 2 punonjës të certifikuar si Microsoft Certified Solution Developer për Aplikime në ëeb ose ekuivalente.
- Të paktën 2 punonjës të certifikuar si database administrator për administrimin e bazës së të dhënave ose ekuivalente.
- Të paktën 1 punonjës të certifikuar si Microsoft Certified Solution Developer për Menaxhim të Ciklit të Aplikacionit (Application Lifecycle Management) ose ekuivalente.
- Të paktën 1 punonjës të certifikuar si Microsoft Certified Solution Expert për Menaxhim të Dhënash dhe Analize (Data Management and Analytics).
- Të paktën 1 punonjës për Administrim të Windows Server ose ekuivalente.
- Të paktën 2 punonjës të certifikuar për arkitekturën SOA.

Personeli i mësipërm duhet të ketë marrëdhënie pune me OE për periudhën e 3 mujorit të fundit, e vërtetuar kjo me formularin e E-sig të listë pagesave.

Hartuesit e kriterëve të veçanta të kualifikimit kanë mbajtur procesverbal për argumentimin e kriterëve të vendosura mbi kapacitetin teknik.

Nga auditimi konstatohet se:

- Vendosja e termit “*ekuivalente*” është përdorur dhe në rastet kur nuk ekziston një ekuivalente si në rastin e certifikimit ITIL Foundation, Administrim të Windows Server apo Programming HTML5. Njohuritë për këto drejtime nuk kanë ekuivalentë.
- Nuk argumentohet numri i 6 punonjësve të diplomuar në një prej degëve të Inxhinierisë Elektronike, Inxhinieri Informatike, Teknologji Informacioni, Informatikë, Informatikë Matematikë, Inxhinieri Matematike dhe Informatike, Informatikë Ekonomike, Telekomunikacion, Inxhinieri Telekomunikacion që do të angazhohen në implementimin e projektit, kur për zgjedhjen e OE të duhur janë renditur dhe 11 kriterë të tjera që lidhen me zhvillimin e sistemit të kërkuar.
- Kriteri i vendosur për 1 punonjës të certifikuar si Microsoft Certified Solution Developer për Menaxhim të Ciklit të Aplikacionit (Application Lifecycle Management) ose ekuivalente, jo vetëm që nuk ka ekuivalentë, por ky certifikim mbulon dhe testimin e software megjithëse është kërkuar 1 punonjës të certifikuar për Testues të Akredituar Programi ose ekuivalente. Pra në total janë vendosur dy kriterë që mbulojnë teste të softëare, megjithëse bëhet fjalë vetëm për fazën e implementimit të projektit që është maksimalisht 3 muaj.
- Kriteri për 1 punonjës të certifikuar si Microsoft Certified Solution Expert për Menaxhim të Dhënash dhe Analize (Data Management and Analytics) si dhe 2 (dy) punonjës të certifikuar si database administrator për administrimin e bazës së të dhënave, janë kriterë të mbivendosura

për të njëjtën detyrë të projektit, duke rritur në këtë mënyrë numrin e punonjësve në 3 për të njëjtin qëllim.

- Kriteri për “të paktën 2 punonjës të certifikuar si database administrator për administrimin e bazës së të dhënave ose ekuivalente” është gjithashtu një kriter që nuk mund të ketë ekuivalentë për arsye se ky kriter është i lidhur drejtpërdrejtë me zgjidhjen informatike që do të ofrohet nga OE. Pra, në disa raste konstatohet se abuzohet me termin “ekuivalentë” pasi vendosja e këtij termi nuk e zgjeron pjesëmarrjen nëse certifikimi është specifikuar.

- Nuk është argumentuar kërkesa që Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar si shërbime të ngjashme me objektin e këtij prokurimi të paktën në vlerën totale 40 % të fondit limit.

Për sa më sipër, vendosja e kriterëve të veçanta nuk është në proporcion me objektin e prokurimit, në kundërshtim me neni 26, pika 5 nenin 28, pika 2 dhe neni 61, pika 2 në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; si dhe nenin 46, pika 1 dhe 3 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe për këtë mbajnë përgjegjësi 3 anëtarët që kanë hartuar kriteret e veçanta të kualifikimit: B.M, F.B, A.Th.

Me urdhrin e prokurimit nr. 18, datë 18.05.2020, protokolluar me shkresën nr. 2403 prot., datë 18.05.2020 është urdhëruar fillimi i procedurës “e Kontroll, Sistemi i kontrollit të subjekteve që kanë kontratë me FSDKSH”, me fond limit 156,584,000 lekë pa TVSH, nga të cilat 96,584,001.4 lekë pa TVSH janë vlerë implementimi, ndërsa 59,999,998.6 lekë pa TVSH ose afërsisht 38.3% e vlerës janë mirëmbajtje.

Vlerësimi i Ofertave:

Me urdhrin e titullarit nr. 152, datë 10.06.2020 është krijuar komisioni i vlerësimit të ofertave i cili ka për detyrë hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të paraqitura për procedurën e sipërpërmendur, i cili në datën 11.06.2020 ka mbajtur dhe procesverbalin për hapjen e ofertave në këtë procedurë prokurimi.

Pjesëmarrës në këtë procedura kanë qenë dy operatorë ekonomik:

- S.&S sh.p.k me NIPT L1 me vlerë financiare 153,579,000 lekë pa TVSH;
- I&C sh.p.k me NIPT L0 me vlerë financiare 155,017,490 lekë pa TVSH;

Në përfundim KVO ka vendosur shpalljen fitues të OE me vlerën më të ulët në kushtet kur të dy operatorët janë kualifikuar.

Nga auditimi mbi ofertën teknike të OE të shpallur fitues u konstatua se, nuk është në përputhje me specifikimet teknike pasi mungojnë 2 nga 5 kërkesat për komunikimet me sistemet e tjera dhe më konkretisht:

- Portali qeveritar e-Albania;
- Gjeoportalin Kombëtar të ASIG.

Për këtë mbajnë përgjegjësi 3 anëtarët e KVO: A.Z, S.A dhe I.Sh.

c. Zbatimi i kontratave dhe marrëveshjeve në nivel shërbimi

Me urdhrin e titullarit të AKSHI-t nr. 193, datë 13.07.2020 janë caktuar ndjekësit e kontratës me nr. 3277, datë 10.07.2020 “e Kontroll, Sistemi i kontrollit të subjekteve që kanë kontratë me FSDKSH”, të cilët janë:

- A.S - Specialist, Sektorit i IT për Shëndetësinë (QKTMB).
- M.P - Specialist, Sektorit i IT për Shëndetësinë (ISHP).

Nga auditimi mbi marrjen në dorëzim u konstatua se:

- Akt marrja në dorëzim përveç Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit është nënshkruar dhe nga përfaqësuesi për autoritetin përfitues megjithëse nuk ka asnjë dokument që përcakton se kush nënshkruan për autoritetin përfitues.

- Raporti përfundimtar që ka paraqitur OE nuk është i njëjtë me propozimin teknik, në lidhje me modulet e kërkuara në këtë sistem, sepse në testet e pranimit (acceptance test) nuk janë

modulet sipas propozimit teknik të fituesit. Ndjekësit e kontratës kanë nënshkruar një listë modulesh ashtu siç kërkohet dhe ashtu siç është ofertuar, megjithëse OE ka sjellë module të tjera të sistemit që ka propozuar.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e marrjes në dorëzim u konstatua se,:

1. Nuk është bërë marrja në dorëzim për pikën 6.5 të propozimit teknik “Komunikimi me sistemet e tjera”:

- DPGJC;
- QKB;
- ASHK.

2. Nuk janë përmbushur kërkesat e raportimit, pika 6.4.1 e Propozimit teknik, në lidhje me raportimet brenda 2 javësh si dhe draft raporti përfundimtar.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi specialistët e ngarkuar për ndjekjen e kontratës A.S dhe M.P, si dhe mos përmbushja e detyrimit kontraktor në lidhje me raportimin si dhe me Komunikimin me sistemet e tjera është përgjegjësi e OE, S.&S me NIPT LI.

8. Prokurim i parashikuar dhe realizuar, me objekt “Implementimi i platformës elektronike e-Transport për DPSHTRR”, me datë zhvillimi të procedurës 18.08.2020, me referencë 65898.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës që është prokuruar

DPSHTRR, ka vlerësuar gjendjen aktuale dhe problematikat e transportit ndërqytetës, ku dhe ka lind nevoja e riorganizimit dhe dixhitalizimit të këtij sektori. Marrja e masave lehtësuese ka pasur si qëllim rritjen e nivelit të shërbimit për udhëtarët, ofrimin e lehtësirave për operatorët për krijimin e një tregu që zhvillohet në bazë të kriterëve të përcaktuara qartë por edhe konkurrencës së ndershme. Ndërhyrja në sektorin e transportit ndërqytetës kërkon bashkëpunimin korrekt të shumë institucioneve siç janë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Instituti i Transportit, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Shoqatat që përfaqësojnë operatorët, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi: nr. 29, datë 20.07.2020	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: Dh.L O.C S.H	4. Komisioni i llogaritjes se fondit limit: Dh.L O.C S.H
2. Fondi Limit (pa TVSh) 198,748,233 lekë: Vlera e implementimit 138,746,900 lekë Mirëmbajtje 60,001,333 Lekë për 48 muaj.	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: E.S M.D D.Gj	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: A.H A.Sh A.C
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”, me mjete elektronike”	9. Operatori fitues: OE “C.P” sh.p.k. Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 188,652,000 lekë: Mirëmbajtje 56,952,000 lekë	10. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 10,096,233 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 13.08.2020	11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: S.&S sh.p.k C.P sh.p.k	12. Operatore të Kualifikuar: 1 (një)
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: S.&S sh.p.k C.P sh.p.k	13. Operatorë të s’kualifikuar: 1 (një)	14. Ankimimet: Nuk ka
14. Ankimimet: Nuk ka	15. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	16. Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka

17. Lidhja e kontratës: nr. 4698 prot, datë 24.09.2020	18. Vlera e kontratës (me TVSh): 226,382,400 lekë	19. Afati i kontratës do të vazhdojë 12 muaj implementim dhe 48 muaj mirëmbajtje.
--	---	--

a. Identifikimi i nevojave për mallra dhe shërbime

Me anë të sistemit informatik që është planifikuar dhe zhvilluar, është synuar t'u jepet zgjidhje problematikave kryesore në transportin ndërqytetës, të cilat janë identifikuar nga DPSHTRR dhe konsistojnë në:

- Rrjeti aktual i transportit është i keq organizuar, i copëzuar, me linja që mund të dublojnë njëra-tjetrën;
- Mungesë e të dhënave reale mbi fluksin e udhëtarëve;
- Mungesë e funksionimit të terminaleve (edhe në qytetet kryesore);
- Mungesë e funksionimit të agjencive të biletave ose agjenci jo efçente;
- Mungesa e stacioneve të qëndrimit, ndikim në rritjen e numrit të aksidenteve rrugore;
- Mungesë informacioni për pasagjerët mbi linjat dhe oraret;
- Treg informal i shërbimit dhe mundësi për evazion fiskal;
- Shfrytëzim i ulët i kapaciteteve dhe ndotje e lartë e mjedisit;
- Mungesë iniciativash lehtësuese për nxitjen e investimeve në flotën e mjeteve;
- Ndikim në rritjen e numrit të aksidenteve rrugore.

Ky projekt është në regjistrin e planifikimit për vitin 2020 venë në dispozicion të grupit të auditimit.

b. Hartimi i specifikave teknike, përlllogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit

Fondi limit është përlllogaritur bazuar në pikën 2.a “Çmimet e tregut”, të nenit 59 në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, rezulton të jetë 198,748,233 lekë pa TVSH, nga të cilat 138,746,900 lekë pa TVSH janë vlerë implementimi, ndërsa 60,001,333 lekë pa TVSH ose afërsisht 30.2% e vlerës, është mirëmbajtje.

Me shkresën nr. 3413 prot., datë 17.07.2020, grupi i punës ka dokumentuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, ku për **kapacitetin teknik është kërkuar:** Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar si më poshtë.

- ISO 27001:2013 për menaxhimin e sigurisë së informacionit ose e përditësuar;
- ISO 20000-1 për menaxhimin e shërbimeve ose e përditësuar;
- ISO 9001:2015 ose ISO 9001:2008 për menaxhimin e cilësisë ose e përditësuar.

Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, për planifikimin dhe menaxhimin me profesionalizëm të punës, duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

Operatori ekonomik duhet të ketë një numër prej mesatarisht 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës të siguruar, ku përfshihet një personel teknik i diplomuar në një prej degëve: informatike, elektronike, telekomunikacion, teknologji informacioni, që do të angazhohet në implementimin e projektit, me këto kompetenca:

- 1 punonjës të certifikuar si Auditor për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO 27001;
- 1 punonjës të certifikuar në planifikimin e transportit;
- 1 punonjës të certifikuar për mbështetjen e projektit sipas praktikave të ITIL ose ekuivalente;
- 1 punonjës të certifikuar për analizë software;
- 1 punonjës të certifikuar për menaxhimin e projekteve;
- 1 punonjës të certifikuar për testim softëare;

- 2 punonjës të certifikuar në nivel MCSD ose ekuivalente për aplikacione;
- 1 punonjës të certifikuar për analizë dhe shfaqje të dhënash Power BI;
- 1 punonjës të certifikuar për administrim databaze;
- 1 punonjës të certifikuar në nivel MCSE Productivity ose ekuivalent;
- 1 punonjës të certifikuar në teknologjinë e mbrojtjes së rrjetit dhe aplikacioneve në nivel profesional (NSE Security Professional ose ekuivalent).

Personeli i mësipërm duhet të ketë marrëdhënie pune me operatorin ekonomik për periudhën e 3 mujorit të fundit, e vërtetuar kjo me formularin e E-sig të listë pagesave të deklaruara dhe të konfirmuara nga administrata tatimore.

Hartuesit e kriterëve të veçanta të kualifikimit kanë mbajtur procesverbal për argumentimin e kriterëve të vendosura mbi kapacitetin teknik.

*Nga auditimi konstatohet se, në kriteret e veçanta të kualifikimit në lidhje me **kapacitetin teknik janë vendosur kriteret të cilat nuk janë në përputhje me objektin e prokurimit si:***

- 1 punonjës certifikuar si Auditor për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO 27001, për arsye se ky kualifikim ka të bëjë me auditimin e subjekteve private apo shtetërore që kërkojnë të pajisen me standardet ISO 27001, gjë që nuk është pjesë e specifikimeve teknike e rrjedhimisht as në përputhje me objektin e prokurimit;
- 1 punonjës të certifikuar në planifikimin e transportit, për arsye se proceset e punës janë dorëzuar nga institucioni dhe janë bërë pjesë e specifikimeve teknike. Nuk ndodh në kushte normale që një subjekt privat që zhvillon programe informatike të ketë në stafin e tij dhe punonjës të certifikuar në planifikimin e transportit.
- 1 punonjës të certifikuar në teknologjinë e mbrojtjes së rrjetit dhe aplikacioneve në nivel profesional (NSE Security Professional ose ekuivalent).

Nga auditimi mbi dokumentacionin e mbajtur nga grupi që ka hartuar kriteret e veçanta të kualifikimit, u konstatua se nuk argumentohet teknikisht numri i punonjësve të kërkuar me anë të kriterit "Operatori ekonomik duhet të ketë një numër prej mesatarisht 15 punonjës të siguruar".

- Nuk është argumentuar kërkesa që Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar si shërbime të ngjashme me objektin e këtij prokurimi të paktën në vlerën totale 40 % të fondit limit.

Për sa më sipër, kriteret e veçanta hartuar nga grupi i hartimit të specifikimeve nuk janë në përputhje me objektin e prokuruar, duke sjellë dhe kufizim të pjesëmarrësve në tender, në kundërshtim me neni 26, pika 5, neni 28, pika 2 dhe neni 62, pika 2 në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar; si dhe neni 46, pika 1 dhe 3 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe për këtë mbajnë përgjegjësi 3 anëtarët që kanë hartuar specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit: Dh.L, O.C, S.H.

Vlerësimi i Ofertave:

Me urdhrin e titullarit nr. 220, datë 17.08.2020 është krijuar komisioni i vlerësimit të ofertave i cili ka për detyrë hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të paraqitura për procedurën e sipërpërmendur, i cili në datën 18.08.2020 ka mbajtur dhe procesverbalin për hapjen e ofertave në këtë procedurë prokurimi.

Pjesëmarrës në këtë procedurë kanë qenë dy operatorë ekonomik:

- S.&S sh.p.k me NIPT L, me vlerë financiare 193,268,000 lekë pa TVSH;
- C.P sh.p.k me NIPT K0, me vlerë financiare 188,652,000 lekë pa TVSH;

Në përfundim KVO ka vendosur shpalljen fitues të C.P sh.p.k me NIPT K0, me vlerë financiare 188,652,000 lekë pa TVSH si OE që ka përmbushur kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kërkuara në këtë procedurë.

c. Zbatimi i kontratave dhe marrëveshjeve në nivel shërbimi

Me urdhrin e titullarit të AKSHI-t nr. 291, datë 28.09.2020 janë caktuar ndjekësit e kontratës me nr. 4698, datë 24.09.2020 “Implementimi i platformës elektronike e-Transport për DPSHTRR”, të cilët janë:

- Dh.L - Përgjegjëse Sektori, Sektorit IT në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
 - S.S– Specialist, Sektori i Regjistrimit dhe Standardeve të Databazave Shtetërore.
 - O.C – Përfaqësues nga DPSHTRR caktuar me shkresën nr. 17306/1 prot., datë 17.09.2020.
- Kërkesat mbi raportimin janë përmbushur në afatet si më poshtë:*

Raporti Fillestar është dorëzuar nga OE tek AKSHI, protokolluar me shkresën nr. 5051, datë 05.10.2020, i cili është nënshkruar nga 3 specialistët ndjekës të kontratës, pra brenda afatit të përcaktuar në kontratë si dhe në grafikun e lëvrimit.

Drafti i raportit përfundimtar është dorëzuar nga OE tek AKSHI, protokolluar me shkresën nr. 5781, datë 07.09.2021, i cili është nënshkruar nga 3 specialistët ndjekës të kontratës, pra brenda afatit të përcaktuar në kontratë si dhe në grafikun e lëvrimit.

Raporti final si dhe manualët e përdorimit të sistemit janë dorëzuar nga OE tek AKSHI, protokolluar me shkresën nr. 6176, datë 23.09.2021, i cili është nënshkruar nga 3 specialistët ndjekës të kontratës, pra brenda afatit të përcaktuar në kontratë si dhe në grafikun e lëvrimit. *Afati kohor për implementimin e projektit është zbatuar në përputhje me kohën e përcaktuar dhe sipas detyrave specifike që lindin nga ky projekt dokumentuar në specifikimet teknike.*

9. Prokurim i parashikuar dhe realizuar, me objekt “Përmirësimi i sistemit VMS-për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, me datë zhvillimi të procedurës 30.10.2020, me referencë 74140:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës që është prokuruar:

Sistemi VMS është sistem satelitor i mbyllur që transmeton të dhënat e anijeve të peshkimit çdo dy orë kur janë në lëvizje dhe çdo 4 orë kur ato janë të ankoruara në port. Sistemi VMS ka përfunduar implementimin në vitin 2011 dhe aktualisht ka nevojë që në mënyrë emergjente të investohet në përditësimin dhe mirëmbajtjen e tij. Në total janë 220 anije peshkimi mbi 12 metra të regjistruara në Republikën e Shqipërisë. Me anë të këtij sistemi kryhej monitorimi dhe gjurmimi i anijeve të peshkimit të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, por që prej muajit prill 2017 nuk transmetojnë asnjë sinjal në qendrën e kontrollit në QNOD.

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 41, datë 01.10.2020	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: R.K A.Dh IS	4. Komisioni i llogaritjes se fondit limit: A.Dh M.K IS
2. Fondi Limit (pa TVSh) 159,658,950 lekë: Implementim 149,822,046 Lekë Mirëmbajtje 9,836,904, Lekë për 24 muaj.	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: E.S M.D D.Gj	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: A.H M.F L.K
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”, me mjete elektronike”	9. Operatori fitues: BOE “IS& IT & E. Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 151,374,507 lekë: Mirëmbajtje 9,398,496 lekë	10. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 8,284,443 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 30.10.2020	11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: IS& IT & E Ac&K	12. Operatore të Kualifikuar: 1 (një)
		13. Operatore të s’kualifikuar: 1 (një)

14. Ankimimet: Ankim nga OE A&K	15. Përgjigje Ankesës nga AK Kthim përgjigje me nr. 6428/1 prot., datë 07.12.2020	16. Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka
17. Lidhja e kontratës: Datë 23.12.2020	18. Vlera e kontratës (me TVSh): 181,649,408.4 Lekë	19. Afati i kontratës do të vazhdojë 6 muaj implementim dhe 24 muaj mirëmbajtje.

a. Identifikimi i nevojave për mallra dhe shërbime

Pajisjet qendrore të këtij sistemi ndodhen në Qendrën Operacionale Detare - Durrës. QNOD është qendër raportimi dhe informacioni; qendër komandimi dhe kontrolli për operacionet detare, e cila shërben dhe si qendër kombëtare për kërkim-shpëtimin në det.

Të gjitha anijet mbi 12m gjatësi kanë detyrim për ta pasur të instaluar sipas ligjit nr. 64/2012 për peshkimin dhe të drejtën për marrjen e të dhënave dhe monitorimin e anijeve të peshkimit e ka vetëm autoriteti përgjegjës për këtë detyrë sipas ligjit (QNOD). Të drejtën për të bërë ndërhyrje apo mirëmbajtjen dhe ndërrimin e kësaj aparature e ka vetëm enti i përcaktuar nga ministria.

Ky sistem është instaluar fillimisht në vitin 2011 si donacion i BE- së por dhe si një nga kushtet për t'u plotësuar nga shteti jonë pjesë e 5 kritereve për çeljen e negociatave dhe e anëtarësimit nga BE-ja. Ky sistem tashmë është i vjetëruar dhe ka limite në funksionalitete, por edhe pajisjet janë me parametra të ulëta dhe të amortizuara nga koha.

Sipas termave të referencës, objektivi i këtij projekti është përmirësimi dhe zhvillimi i sistemeve aktuale të monitorimit dhe gjurmimit të flotës shqiptare të peshkimit e më gjerë, si dhe optimizimi i kostove të këtyre shërbimeve. Ky objektivi do të realizohet nëpërmjet përmirësimit të sistemit aktual VMS (Sistemi i Monitorimit të Anijeve), si dhe blerja dhe konfigurimet përkatëse të pajisjeve MTU nëpër anijet e peshkimit.

b. Hartimi i specifikave teknike, përlllogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit

Nga auditimi mbi specifikimet teknike, u konstatua se:

- Për këtë procedurë nuk është kërkuar asnjë kapacitet teknik i cili të realizojë kërkesën e specifikimeve teknike për integrimin me sisteme të tjera kombëtare, dokumentuar në specifikimet teknike, saktësisht pikën 2.2 "Qëllimi", pika 4.2 "Detyrat Specifike" si dhe pika 7 "Komunikimi me sisteme të tjera", bazuar në praktikat e ndjekura për procedurat e tjera të prokurimit;

- Nuk janë identifikuar sistemet me të cilat nevojitet të integrohet ky sistem që po prokurohet;

- Nuk është kërkuar asnjë kapacitet teknik për 230 pajisjet Transponder MTU që do të instalohen.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi hartuesit e specifikimeve teknike R.K, A.Dh dhe IS.

Fondi limit është përlllogaritur bazuar në pikën 2.a "Çmimet e tregut", të nenit 59 në VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", rezulton të jetë 198,748,233 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr. 4539 prot., datë 17.09.2020, grupi i punës ka dokumentuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, ku për **kapacitetin teknik është kërkuar:**

- 1 Drejtues Projektësh me çertifikatë PMP (të lëshuar nga PMI) dhe me çertifikatë ITIL ose ekuivalent;

- 1 punonjës të certifikuar për pajisjet hardëare server të nivelit Arkitekt ose ekuivalent që do të ofertohen nga OE;

- 1 punonjës të certifikuar ne nivel Database Administrator i vërtetuar me certifikatë të lëshuar nga prodhues të ndryshëm si Microsoft, ose Oracle ose ekuivalente;

- 1 punonjës të certifikuar në Windows Server, ose Linux, ose Unix, te niveli MCSA ose ekuivalent.

Specialistët e mësipërm duhet të jenë të disponueshëm gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës. Ofertuesi të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi për të gjitha paisjet për shitje, shërbim dhe servisim të produkteve VMS, Transponder, Server, workstation, Firewall, Laptop, UPS, Switch etj., si dhe shërbimeve respektive të përfshira në këtë objekt prokurimi për territorin e Shqipërisë.

Operatori Ekonomik duhet të zotërojë dhe paraqesë Çertifikatën e Partneritetit të lëshuar nga prodhuesi për produktet Software që do të ofertohej ku Operatori Ekonomik është i certifikuar për të kryer Aktivizime, Konfigurime dhe Support për sistemin VMS që do të ofertojë.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogët teknikë të të gjithë produkteve që kërkohen. Operoret ekonomik duhet të lëshojnë një deklaratë ku të marrin përsipër dhe montimin, instalimin, konfigurimin, testimin për pajisjet dhe sistemin në tërësi dhe të trajnojnë stafin përdorues të sistemit.

Për vlerësimin e saktë të ofertës teknike, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë fizikisht, në datën dhe orën e hapjes së ofertave:

1 Paisje Transponder (MTU) me të gjithë aksesorët për montim dhe venie në funksion.

Hartuesit e kritereve të veçanta të kualifikimit kanë mbajtur procesverbal për argumentimin e kritereve të vendosura mbi kapacitetin teknik.

Nga auditimi mbi kriteret e veçanta të kualifikimit, u konstatua se:

- Kërkesa për "specialistët që do të përmbushin kapacitetin teknik, janë kërkuar të jenë të disponueshëm gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës", ndryshe nga praktikat e tjera kur stafi teknik kërkohet të ketë qenë i punësuar për 3 apo 6 muajt e fundit.

- Nuk është argumentuar kërkesa që Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar si shërbime të ngjashme me objektin e këtij prokurimi të paktën në vlerën totale 40 % të fondit limit.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi hartuesit e specifikimeve teknike R.K, A.Dh dhe IS.

Me urdhrin e titullarit nr. 339, datë 29.10.2020 është krijuar komisioni i vlerësimit të ofertave i cili ka për detyrë hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të paraqitura për procedurën e sipërpërmendur, i cili në datën 11.06.2020 ka mbajtur dhe procesverbalin për hapjen e ofertave në këtë procedurë prokurimi.

Pjesëmarrës në këtë procedura kanë qenë dy operatorë ekonomik:

- E.C me NIPT L4 & I.S me NIPT L9 & IT Gj me NIPT K8, me vlerë financiare 151,374,507 lekë pa TVSH;
- A.C me NIPT J & K. me NIPT L1, me vlerë financiare 139,990,000 lekë pa TVSH;

KVO është mbledhur në datën 23.11.2020 për marrjen e vendimit të vlerësimit dhe ka vendosur kualifikimin e BOE E.C me NIPT L41 & I.S me NIPT L91 & IT Gj me NIPT K81, me vlerë financiare 151,374,507 lekë pa TVSH.

KVO ka vendosur s'kualifikimin për mos përmbushje të kritereve të veçanta të kualifikimit si dhe termave të referencës për BOE A.C me NIPT J9 & K. me NIPT L1.

Nga auditimi mbi dokumentacionin që disponon BOE i shpallur fitues, u konstatua se:

Sipas dokumentit të bashkimit të përkohshëm është identifikuar se kompania E do të kryejë punimet që i përkasin sistemit VMS (vessel monitoring system), si dhe instalimin, licencimin dhe konfigurimin e transponder MTU, trajnimin e përdoruesve dhe mirëmbajtjen.

E vetmja kërkesë specifike që lidhet me sistemin është 1 (një) punonjës i certifikuar në nivel Database Administrator i vërtetuar me certifikatë të lëshuar nga prodhues të ndryshëm si Microsoft, ose Oracle ose ekuivalente.

Argumentimi nga hartuesit e kritereve të veçanta të kualifikimit për këtë kualifikim është se: *“Sistemi që do të implementohet do të mbështetet mbi shtresën e bazës së të dhënave dhe për të suportuar aktivitetin e instalimit konfigurimit e mirëmbajtjes së saj nga një prej kompanive ndërkombëtare në fushën e databazave me anë të certifikimeve të nivelit të përmendur”*.

Dy punonjësit e angazhuar për këtë projekt që zotërojnë certifikatat e kërkuara që përmenden më sipër kanë marrëdhënie kontraktuale me dy operatorët e tjerë që janë I.S dhe IT Gj.k, por jo me operatorin E. C sh.p.k që do të ofrojë sistemin, i cili që të funksionojë duhet të shoqërohet me bazën e të dhënave.

Pra, OE E company sh.p.k nuk plotëson kërkesën për staf teknik, të certifikuar në nivel Database Administrator të vërtetuar me certifikatë të lëshuar nga prodhues të ndryshëm Microsoft, Oracle. Si rrjedhojë nuk plotëson stafin teknik gjithë BOE që është shpallur fitues, në kundërshtim me nenin 74, pika 3 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar”*, ku citohet se *“Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”*.

Për sa më sipër, BOE i shpallur fitues nga KVO nuk ka plotësuar kërkesat për:

- Përkthimin e katalogëve në gjuhën shqipe, sic kërkohet në dokumentet e tenderit e njëjtë me një nga arsyet e s’kualifikimit të BOE tjetër pjesëmarrës.

- OE E company sh.p.k nuk plotëson kërkesën për staf teknik, të certifikuar në nivel Database Administrator të vërtetuar me certifikatë të lëshuar nga prodhues të ndryshëm Microsoft, Oracle. Si rrjedhojë, gjithë BOE që është shpallur fitues nuk plotëson stafin teknik, në kundërshtim me nenin 74, pika 3 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar”*, ku citohet se *“Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”*. Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e KVO A.H, M.F dhe L.K.

BOE A&K, ka depozituar pranë AKSHI-t, brenda afatit ankesën për vendimin e KVO, protokolluar me nr. 6428, datë 01.12.2020, me anë të së cilës argumenton arsyet për të cilat është s’kualifikuar në lidhje me stafin teknik, të cilat janë:

- Disponon 1 punonjës të certifikuar për pajisjet në kategorinë **Server System Engineer** nga prodhuesi Fujitsu me të cilin kanë ndërtuar dhe ofertën;

- Disponon 1 punonjës të certifikuar si: **“462:Administering Microsoft SQL Server 2012/2014 Databases”**, certifikim i prodhuesit softëare Microsoft platforma e të cilit përdoret te programi/softi VMS që është paraqitur në ofertën software si pjesë e sistemit të kërkuar.

- Disponon 1 punonjës të certifikuar në **“Linux Administration General”**, nga kompania certifikuese Brainbench (Previsor Company), e njohur globalisht për sistemin Linux, platforma e të cilit është paraqitur në ofertën teknike.

BOE A&K ka argumentuar dhe 11 arsyet e s’kualifikimit sipas kërkesave të specifikimeve teknike, të cilat janë:

1. Kriteri për procesorin e Serverit për procesim është plotësuar nëpërmjet procesorit Intel Xeon Silver 4210, në faqen 3 të katalogut.
2. Kriteri për procesorin e Map Serverit është plotësuar nëpërmjet procesorit Intel Xeon Silver 4210, në faqen 3 të katalogut.
3. Kriteri për procesorin e Serverit për Databazë është plotësuar nëpërmjet procesorit Intel Xeon Silver 4210, në faqen 3 të katalogut.

4. Kriteri për procesorin e workstation + 2 monitor si dhe modeli i kartës grafike është plotësuar nëpërmjet procesorit Intel Xeon Silver 4208 dhe minimalisht nëpërmjet skedës grafike Nvidia Quadro P400 2GB në faqen 3 të katalogut.
5. Për TV 64'' ka sistem operativ por nuk është mart TV, sqarojmë se Fujitsu IW650 me madhësi të ekranit 65'', duke qenë se ka sistem operativ mund të instalohet pa pagesë një program që e kthen atë në Smart Tv. Ky produkt është me Touch Screen.
6. Për Switch 24 porta L2- Fujitsu VDX6740 është specifikuar seria por jo switch i ofruar, ka sqaruar se në serinë e ofruar bën pjesë dhe Switch VDX6740T që ka 48 porta RJ 45 1Gb/10Gb që tejkalon disa herë kërkesat teknike.
7. Për Firewall Quantum 6200 SECURITY Gateway – wan Port, sqarojmë se të gjitha portat janë të menaxhueshme sipas standartit Layer 3 dhe sicila nga ato të konfigurueshme në WAN, DMZ, ose LAN. Për këtë arsye nuk specifikohet në katalogun përkatës.
8. Kërkesa për Laptop Basic është plotësuar me modelin Fujitsu Lifebook E5510 me procesor Intel Core i510210U, në faqen 2 të katalogut.
9. Kërkesa për UPS për workstation është plotësuar me modelin Fujitsu model Rack/Tower 3000VA.
10. Për pajisjet Transponder MTU, sqaron se butonat "Test", "Support" dhe kjo pajisje e kryen automatikisht raportimin e pozicionit gjithmonë, ndërsa butonat janë që të ketë dhe një opsion raportimi në rast kur anija ankoron në mes të detit për arsye të ndryshme.
11. Operatori nuk ka kthyer përgjigje me sqarimet e kërkuara nga komisioni i vlerësimit sipas kërkesës për sqarim të datës 13.11.2020, ka sqaruar se nuk e ka parë pasi sistemi i APP nuk jep sinjal viziv apo akustik.

BOE ka sqaruar më tej vecoritë dhe përfitimet e pajisjes BlueTracker VMS që ka ofertuar, duke venë theksin tek cilësia dhe përfitimet që sjell kjo pajisje si dhe shembuj të vendeve që e kanë venë në funksion.

Me urdhrin nr. 396, datë 01.12.2020 të titullarit të AKSHI-t është urdhëruar pezullimi i procedurës deri në shqyrtimin e ankesës, për të cilin ngarkohet njësi e prokurimit në trajtimin e saj, të cilët janë:

- E.S me profesion Ekonomist;
- M.D me profesion Jurist;
- D.Gj me profesion Jurist;

Nga auditimi u konstatua se, për shqyrtimin e kësaj ankese, njësi e prokurimit e ngarkuar për zbatimin e këtij urdhri, nuk disponon ekspert të fushës, pasi të tre anëtarët i përkasin kualifikimeve Ekonomist dhe Jurist, por asnjë në fushën e teknologjisë së informacionit, në kundërshtim me nenin 78, pika 6, e VKM nr. 914 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ndryshuar me VKM nr.797 datë 29.12.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014", ku citohet se "Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, ku të paktën njëri është ekspert i fushës për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim".

Nga auditimi mbi shqyrtimin e ankesës së BOE si dhe trajtimin apo kthimin e përgjigjeve u konstatua se BOE nuk plotëson kriterin e kërkuar për 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel Database Administrator i vërtetuar me certifikatë të lëshuar nga prodhues të ndryshëm si Microsoft, ose Oracle ose ekuivalente, pasi punonjësi të cilit i referohet ankimesi ka marrë vetëm një provim por jo certifikimin e kërkuar.

c. Zbatimi i kontratave dhe marrëveshjeve në nivel shërbimi

Raporti fillestar është dorëzuar nga BOE mban datën 14.01.2011, ose 21 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës që ka qenë data 23.12.2020. Përmbajtja e këtij raporti nuk plotëson kushtet për të qenë një raport fillestar sipas specifikimeve teknike të kërkuara në tender.

Drafti i raportit përfundimtar nuk rezulton të jetë dorëzuar nga përfaqësuesi i BOE.

Raporti final është dorëzuar me nr. 3630 prot, datë 27.05.2021.

Raporte mujore progresive nuk rezultojnë të jenë dokumentuar me anë të të cilëve do të raportohej numri i ndërfaqeve të komunikimit që është arritur të implementohet, ecurinë sipas planifikimit dhe çdo problem tjetër të lindur përgjatë procesit,.

Grupi ka hartuar akt-marrje në dorëzim për kontratën me objekt “Përmirësimi i sistemit VMS-për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”.

A.H - Përgjegjës sektori, QNOD Sektori IT në Ministrinë e Mbrojtjes

I.S - Specialist Sektorit IT në MBZHR

A.B - Përgjegjës Sektori, Sektori i Inspektimit të Kontrollit të Peshkimit

E.V - Magazinier

Për këtë, ngarkohen me përgjegjësi ndjekësit e kontratës me nr. 6961, datë 23.12.2020 të cilët nuk kanë respektuar gjithë kërkesat mbi dokumentimin e kërkuar në specifikimet teknike të kësaj procedure prokurimi.

10. Prokurim i parashikuar dhe realizuar, me objekt “Mirëmbajtja e sistemit të ndihmës ekonomike - për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, me datë zhvillimi të procedurës 06.01.2020, me referencë 76660.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës që është prokuruar

Objekti kryesor i këtij shërbimi, është mirëmbajtja e Sistemit të Ndihmës Ekonomike, në çdo komponent të tij, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës në mbi 99.95%. Afati i shërbimit do të jetë për një periudhë 2 vjeçare.

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi: nr. 44, datë 15.10.2020	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: I.Q A.M M.T	4. Komisioni i llogaritjes se fondit limit: I.Q A.M M.T
2. Fondi Limit (pa TVSh) 102,911,743 Lekë, nga të cilat: Mirëmbajtje 102,911,743 Lekë për 24 muaj.	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: E.S M.D D.Gj	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: S.A I.Sh A.D
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”, me mjete elektronike”	9. Operatori fitues: BOE I.S& I. sh.p.k Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 91,163,040 Lekë	10. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 1,259,127 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 17.12.2020	11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: F sh.p.k BOE I.S sh.p.k & I. sh.p.k S. AT sh.p.k	12. Operatore të Kualifikuar: 1 (një)
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: F sh.p.k BOE I.S sh.p.k & I. sh.p.k S. AT sh.p.k	13. Operatore të s’kualifikuar: 2 (dy)	14. Ankimimet: Nuk ka
14. Ankimimet: Nuk ka	15. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	16. Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka
17. Lidhja e kontratës: nr. 48, datë 06.01.2021	18. Vlera e kontratës (me TVSh): 109,395,648 lekë	19. Afati i kontratës do të vazhdojë për 24 muaj mirëmbajtje.

a. Identifikimi i nevojave për mallra dhe shërbime

Qëllimi i këtij shërbimi, është mirëmbajtja e sistemit të ndihmës ekonomike, i hostuar në mjediset e AKSHI-t. Ky sistem menaxhon bazën e të dhënave shtetërore të ndihmës ekonomike si edhe procesin e aplikimit dhe dhënies së ndihmës ekonomike në të gjithë Shqipërinë.

b. Hartimi i specifikave teknike, përlogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit

Përlogaritja e fondit limit të kontratës për vitin 2020 është kryer duke ndjekur pikën 2.a “çmimet e tregut”, të nenit 59 në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke përlogaritur dhe dokumentuar një fond limit në vlerën 92,422,167 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 91,163,040 lekë pa TVSH.

Nga Autoriteti Kontraktor **nuk është argumentuar** mënyra e zgjedhur për përlogaritjen e vlerës limit sipas opsionit 2.a të nenit 59 në VKM nr.914, datë 29.12.2014, duke patur parasysh që jemi në kushtet e një procedure prokurimi për mirëmbajtje të një sistemi ekzistues.

Me shkresën nr. 5347 prot., datë 15.10.2020, grupi i punës ka dokumentuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, ku për **kapacitetin teknik është kërkuar:**

1. Certifikatat që operatori ekonomik zotëron për standardet më poshtë, në përputhje me objektin e prokurimit të kësaj procedure:

- BS PAS 99:2012 – For Integrated Management Systems
- 2. Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, për planifikimin dhe manaxhimin me profesionalizëm të punës, duhet të përmbushë kushtet e mëposhtem:
 - Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, për numrin e punonjësve të siguruar për 6 mujorin e fundit.
 - Operatori ekonomik duhet të ketë një numër prej mesatarisht 16 (gjashtëmbëdhjetë) punonjës të siguruar, ku të përfshihet staf teknik i kualifikuar me njohuri të kombinuara në kërkesat e mëposhtme:
 - Të paktën 1 menaxher projektsh të certifikuar në fushën e menaxhimit të projekteve (Project Management) me certifikatë PMP.
 - Të paktën 1 specialist të certifikuar për mbështetjen e projektit sipas praktikave të ITIL ose ekuivalente.
 - Të paktën 10 specialistë të certifikuar në nivel MCSD, ose ekuivalent.
 - Të paktën 2 specialistë të certifikuar në nivel MCSE (data management dhe analytics) ose ekuivalent.
 - Të paktën 2 specialistë të certifikuar në nivel MCSA (SQL Server) ose ekuivalent.
 - Të paktën 2 specialistë të certifikuar në nivel MCTS për Sharepoint ose ekuivalent.

Personeli i mësipërm duhet të ketë marrëdhënie pune me operatorin ekonomik jo me pak se 6 muaj para datës së tenderit, e vërtetuar kjo me formularin e E-sig të listepagesave të deklaruara. Hartuesit e kriterëve të veçanta të kualifikimit kanë mbajtur procesverbal për argumentimin e kriterëve të vendosura mbi kapacitetin teknik.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e mbajtur nga grupi që ka hartuar kriteret e veçanta të kualifikimit, u konstatua se:

- Nuk argumentohet teknikisht se si është arritur në numrin e kërkuar të punonjësve të kualifikuar për secilën kërkesë. Si shembull, kërkohet “*Të paktën 10 specialistë të certifikuar në nivel MCSD*” kërkesë e cila përmban llojin e certifikimit si dhe numrin e punonjësve që nevojitet ta disponojnë këtë kualifikim. Anëtarët, janë përpjekur të argumentojnë teknikisht llojin e kualifikimit, por nuk kanë argumentuar numrin prej 10 specialistëve të kërkuar.

- Nuk argumentohet teknikisht numri i 16 punonjësve të siguruar”.
- Nuk argumentohet teknikisht këkesa për 1 menaxher projektsh të certifikuar në fushën e menaxhimit të projekteve (Project Management) me certifikatë PMP”, duke patur parasysh se nuk jemi në një zhvillim të ri, por mirëmbajtje kur në të njëjtën kohë është kërkuar dhe kualifikimi ITIL. Në procedura të tjera prokurimi realizuar për mirëmbajtjen ka mjaftuar vetëm kualifikimi në ITIL për 1 punonjës.
- Nuk argumentohet teknikisht këkesa për 2 specialistë të certifikuar në nivel MCTS për Sharepoint ose ekuivalent”, duke qenë se jemi në mirëmbajtje dhe jo në zhvillim.
- Nuk argumentohet teknikisht këkesa për 2 specialistë të certifikuar në nivel MCSE (data management dhe analytics) ose ekuivalent”, duke qenë se jemi në mirëmbajtje dhe jo në zhvillim.
- Nuk argumentohet teknikisht kërkesa për 2 specialistë të certifikuar në nivel MCSA (SQL Server) ose ekuivalent”, duke qenë se jemi në mirëmbajtje dhe jo në zhvillim.
- Nuk është argumentuar kërkesa që Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar si shërbime të ngjashme me objektin e këtij prokurimi të paktën në vlerën totale 40 % të fondit limit.

Për sa më sipër, kriteret e veçanta hartuar nga grupi i hartimit të specifikimeve kanë sjellë kufizim të pjesëmarrësve në tender, me vetëm 1 pjesëmarrës, në kundërshtim me neni 26, pika 5, nenin 28, pika 2 dhe neni 61, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; si dhe nenin 46, pika 1 dhe 3 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e grupit që kanë hartuar kriteret e veçanta të kualifikimit: I.Q, A.M, M.T.

c. Zbatimi i kontratave dhe marrëveshjeve në nivel shërbimi

Me urdhrin nr. 93, datë 04.03.2021 janë caktuar si ndjekës të kontratës me nr. 48, datë 06.01.2021, për mirëmbajtjen e sistemit të ndihmës ekonomike, specialistët:

A.M - Specialist, Sektori IT për Mbrojtjen Sociale (MSHMS), zëvendësuar me E.C me urdhrin e titullarit të AKSHI-t me nr.427, datë 02.11.2021;

M.T - Specialist, Sektori IT për Mbrojtjen Sociale (MSHMS);

T.T– përfaqësues i MSHMS.

Për auditimin e dokumentacionit të mbajtur për zbatimin e kësaj kontrate, na u vunë në dispozicion 3 raporte:

- Raporti i mirëmbajtjes 06 janar – 5 shkurt 2021 protokolluar me nr.814, datë 08.02.2021;
- Raporti i mirëmbajtjes 06 maj – 5 qershor 2021 protokolluar me nr.3876, datë 08.06.2021;
- Raporti i mirëmbajtjes 06 tetor – 5 nëntor 2021 protokolluar me nr.7657, datë 08.11.2021;

Nga auditimi mbi raportet e mirëmbajtjes, u konstatua se në të tre raportet e zgjedhura nuk është dokumentuar raportimi mbi problematika të cilat kanë të bëjnë me informacionin e marrë në kohë reale me sistemin e Thesarit - për pagesat e ekzekutuara, si komponent kyç i zgjidhjes softëare konsideruar në specifikimet teknike.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi, ndjekësit e kontratës: A.M, M.T dhe T.T-përfaqësues i MSHMS.

11. Prokurim i parashikuar dhe realizuar, me objekt “Mirëmbajtja e sistemit të thesarit dhe blerjeve licenca Oracle”, me datë zhvillimi të procedurës 01.10.2020, me referencë 70730.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës që është prokuruar

Komponentët kryesorë të kësaj kontrate në formë të përmbledhur janë:

- a. Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemit të thesarit Oracle E-Business Suite R12 (12.1.3);
- b. Shërbimi i mirëmbajtjes të komponentëve hardëare ekzistues mbi të cilët mbështetet sistemi financiar i thesarit;

- c. Shërbimi i mirëmbajtjes për sistemet operative të instaluar në hardware-in e infrastrukturës së sistemit të thesarit;
- d. Shërbime upgrade të firmëare të serverave Oracle dhe të storage qendror HPE 3PAR;
- e. Suport i Ndërfaqeve per Integrim me ESB;
- f. Instalimi dhe mirëmbajtja e sistemit të backup-it në disk;
- g. Shtimi i hapësirës tek storage qendror.

Ky projekt është në regjistrin e planifikimit për vitin 2020 venë në dispozicion të grupit të auditimit.

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi: nr. 34, datë 04.09.2020	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: Xh.H E.B S.K	4. Komisioni i llogaritjes se fondit limit: Xh.H E.B S.K
2. Fondi Limit (pa TVSh) 149,600,000 lekë: Mirëmbajtje 149,600,000 Lekë për 24 muaj.	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: E.S M.D D.Gj	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: E.N E.Xh A.O
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”, me mjete elektronike”	9. Operatori fitues: BOE I.S sh.p.k & I. sh.p.k Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 141,999,215 lekë:	10. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 7,600,786 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 01.10.2020	11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: F. sh.p.k I.S sh.p.k & I sh.p.k	13. Operatorë të s’kualifikuar: 1 (një)
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: F. sh.p.k I.S sh.p.k & I sh.p.k	12. Operatore të Kualifikuar: 1 (një)	14. Ankimimet: Nuk ka
14. Ankimimet: Nuk ka	15. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	16. Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka
17. Lidhja e kontratës: nr. 5882, datë 04.11.2020	18. Vlera e kontratës (me TVSh): Mirëmbajtje 170,399,058 lekë	19. Afati i kontratës do të vazhdojë 24 muaj mirëmbajtje.

a. Identifikimi i nevojave për mallra dhe shërbime

Qëllimi i këtij prokurimi është sigurimi i një kontrate suporti dhe mirëmbajtje për funksionimin dhe përdorimin normal të infrastrukturës teknike të sistemit të thesarit duke përfshirë sistemin në qendër (HQ), dhe sistemin në qendrën e vazhdimësisë së biznesit (BCC).

b. Hartimi i specifikave teknike, përlllogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit

Në hartimin e specifikimeve teknike, për vitin 2020, nuk është vendosur rinovimi i licencave Oracle Discoverer Desktop Edition – Named User Plus Perpetual në sasinë prej 25 copë të tipit User Perpetual – Full Use dhe afat vlefshmërie deri në 30.09.2020, të cilat janë kërkuar në kontratën e mëparshme të vitit 2018, megjithëse këto licenca nuk rezultojnë të jenë në EOF (End Of Life).

Përlllogaritja e fondit limit të kontratës për vitin 2020 është kryer duke ndjekur pikën 2.a “çmimet e tregut”, të nenit 59 në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke përlllogaritur një fond limit në shumën 149,600,000 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 141,999,215 lekë pa TVSH.

Vlera e kontratës për mirëmbajtja e sistemit të thesarit dhe blerjeve licenca Oracle, lidhur në vitin 2018 ka qenë në shumën 133,470,403 lekë pa TVSH.

Nga auditimi mbi specifikimet teknike rezulton se ka pak ndryshime për të kryer një përlllogaritje të vlerës limit me studim tregu pasi shtesa shërbimi në kontratën e vitit 2020 janë:

- Një sistem backup-i në disk;
- Shtimi i hapësirës fizike e storage qendror 3PAR 22 copë.

Kriteret e veçanta të kualifikimit janë më të pakta në numër se ato të vitit 2018, çfarë tregon se realizimi i mirëmbajtjes nuk është vështirësuar dhe as është shtuar. Bazuar në këtë argumentim, grupi i auditimit vlerëson se anëtarët e grupit të përlllogaritjes së fondit limit duhet të kishin ndjekur metodën 2.b, të nenit 59 në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Nga Autoriteti Kontraktor **nuk është argumentuar** mënyra e zgjedhur për përlllogaritjen e vlerës limit sipas opsionit 2.a të nenit 59 në VKM nr.914, datë 29.12.2014, duke patur parasysh që jemi në kushtet e një procedure prokurimi për mirëmbajtje të një sistemi ekzistues.

Për këtë ngarkohen me përgjegjësi, anëtarët e grupit që kanë hartuar specifikimet teknike që janë: Xh.H, E.B, S.K.

Me shkresën nr. 3972 prot., datë 27.08.2020, grupi i punës ka dokumentuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, ku për **kapacitetin teknik është kërkuar:**

Operatori ekonomik duhet të ketë të angazhuar në projekt minimalisht 12 (dymbëdhjetë) ekspertë teknik, të kualifikuar që do të angazhohen në shërbimet e kërkuara të mirëmbajtjes, të cilët mund të kenë njohuri të kombinuara në kërkesat e mëposhtme:

- Të paktën 1 specialist të certifikuar për servera nga prodhuesi HPE si dhe për storage minimalisht niveli ASE, me qëllim ofrimin e shërbimeve të mirëmbajtjes në serverat dhe storage HPE të infrastrukturës së Thesarit. Kjo të dëshmohet me certifikatat përkatëse të lëshuara nga prodhuesi HPE;
- Të paktën 1 specialist të certifikuar nga prodhuesi Oracle për servera të serisë Sparc. Të dëshmohet me certifikatat Sparc Server Field Delivery Support ose SPARC Server Implementation Specialist të lëshuara nga prodhuesi Oracle;
- Të paktën 1 specialist të certifikuar nga prodhuesi Oracle për administrimin e sistemeve operative Oracle Solaris 11, ku minimalisht njëri prej tyre në nivel profesional. Të dëshmohet me certifikatat Oracle Solaris 11 System Administrator përkatëse të lëshuara nga prodhuesi Oracle;
- Të paktën 1 specialist të certifikuar nga prodhuesi për implementimin e sistemit të menaxhimit të bazave të të dhënave relacionale Oracle Database. Kjo të dëshmohet përmes certifikatave të lëshuara nga prodhuesi Oracle;
- Të paktën 1 specialiste të certifikuar nga prodhuesi për implementimin në cluster të sistemit të menaxhimit të bazave të të dhënave relacionale Oracle Database. Kjo të dëshmohet përmes certifikatave të lëshuara nga prodhuesi Oracle;
- Të paktën 1 specialist të certifikuar nga prodhuesi për programim në gjuhën procedurale të bazës së të dhënave Oracle Database (Oracle PL/SQL);
- Të paktën 1 specialist të certifikuar nga prodhuesi për implementimin e sistemeve të menaxhimit financiar (Financial Management Systems) Oracle E- Business Suite R12 të modulit e Librit të Madh (General Ledger), të pagueshmeve (Payables), të Arkëtueshmeve (Receivables), të Zinxhirit të Furnizimeve (Supply Chain);
- Të paktën 1 specialist i certifikuar nga prodhuesi për mbështetjen e sistemeve të menaxhimit financiar (Financial Management Systems) Oracle E- Business Suite. Të dëshmohen me certifikatat e lëshuara nga prodhuesi Oracle;
- Të paktën 1 person teknik të certifikuar nga prodhuesi për mbështetjen të përgjithshme të teknologjisë Oracle. Të dëshmohen me certifikatat e lëshuara nga prodhuesi Oracle;
- Të paktën 1 specialistë rrjeti të certifikuar, fusha routing dhe sëitching, me qëllim ofrimin e shërbimeve të suportit në rrjetin e infrastrukturës së Sistemit të Thesarit, të paktën njëri në nivel Profesional.

Për të garantuar nivelin e ekspertizës të specialistëve në këtë fushë, kërkohet që Operatori Ekonomik ta dëshmojë ekspertizën e specialistëve me certifikata të fushës.

Të paktën 1 specialist të certifikuar për ITIL ose ekuivalent me qëllim menaxhimin e shërbimeve të suportit dhe mirëmbajtjes, objekt i këtij prokurimi.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë të gjitha CV-të dhe certifikatat relevante për teknologjinë e ofruar të personelit të përfshirë në projekt;

Personeli i mësipërm duhet të ketë aktualisht një marrëdhënie pune me ofertuesin jo me pak se 6 (gjashtë) muaj, e vërtetuar kjo me formularët E-sig të listë pagesave të deklaruara dhe të firmosura nga inspektorët tatimore.

Hartuesit e kriterëve të veçanta të kualifikimit kanë mbajtur procesverbal për argumentimin e kriterëve të vendosura mbi kapacitetin teknik.

Nga auditimi mbi kriteret e veçanta të kualifikimit u konstatua se:

- Nuk argumentohet teknikisht numri prej 12 ekspertë teknik, të kualifikuar që do të angazhohen në shërbimet e kërkuara të mirëmbajtjes i punonjësve, ndërkohë kur kërkohen 11 njohuri të cilat punonjësit mund t'i kenë të kombinuara.
- Nuk argumentohet teknikisht kërkesa për 1 specialist të certifikuar nga prodhuesi për implementimin e sistemit të menaxhimit të bazave të të dhënave relacionale Oracle Database, sa kohë nuk jemi në implementim por në mirëmbajtje për të cilën gjithashtu është kërkuar një kualifikim, madje argumenti teknik i grupit nuk ndryshon ndërmjet implementimit dhe
- Nuk argumentohet teknikisht kërkesa për 1 specialist të certifikuar nga prodhuesi për implementimin e sistemeve të menaxhimit financiar (Financial Management Systems) Oracle E- Business Suite R12 të modulit e Librit të Madh (General Ledger), të pagueshme (Payables), të Arkëtueshme (Receivables), të Zinxhirit të Furnizimeve (Supply Chain), sa kohë nuk jemi në implementim, por në mirëmbajtje për të cilën gjithashtu është kërkuar një kualifikim.
- Nuk është argumentuar kërkesa për që Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar si shërbime të ngjashme me objektin e këtij prokurimi të paktën në vlerën totale 40 % të fondit limit.

Për sa më sipër, kriteret e veçanta hartuar nga grupi i hartimit të specifikimeve kanë sjellë kufizim të pjesëmarrësve në tender, me vetëm 1 pjesëmarrës, në kundërshtim me neni 26, pika 5, neni 28, pika 2 dhe neni 61, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; si dhe neni 46, pika 1 dhe 3 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi 3 anëtarët që kanë hartuar specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit: Xh.H, E.B, S.K.

12. Prokurim i parashikuar dhe realizuar, me objekt “Mirëmbajtja e sistemit të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile”, me datë zhvillimi të procedurës 21.01.2020, me referencë 47842.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës që është prokuruar

Qëllimi i këtij shërbimi është mirëmbajtja e Sistemit të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC). Sigurimin e disponueshmërisë së nevojshme në masën 99,9% të funksionimit të këtij sistemi si dhe për të realizuar një shërbim cilësor dhe bashkëkohor të gjendjes civile në Shqipëri.

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi: nr. 3, datë 21.01.2020	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: J.H D.K S.S	4. Komisioni i llogaritjes së fondit limit: J.H I.R S.S
2. Fondi Limit (pa TVSh) 199,425,000 lekë: Mirëmbajtje 199,425,000 Lekë për 24 muaj.	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: E.S M.D D.Gj	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: E.L E.D E.H
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”, me mjete elektronike”	9. Operatori fitues: BOE: X.G dhe I.S sh.p.k Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 199,000,000 lekë: Mirëmbajtje 199,425,000 lekë	10. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 425,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 17.02.2020	11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: BOE X.G dhe I.S	12. Operatore të Kualifikuar: 1 (një)
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: BOE X.G dhe I.S	13. Operatorë të s’kualifikuar: Asnjë	14. Ankimimet: Nuk ka
14. Ankimimet: Nuk ka	15. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	16. Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka
17. Lidhja e kontratës: Datë 14.04.2020	18. Vlera e kontratës (me TVSh): Mirëmbajtje 238,800,000 lekë	19. Afati i kontratës do të vazhdojë për 24 muaj mirëmbajtje.

a. Identifikimi i nevojave për mallra dhe shërbime

Objektivat kryesore të shërbimeve janë:

- Garantimi i kryerjes së të gjitha veprimeve informatike në RKGJC sipas ligjit në fuqi apo akteve juridike që detyrojnë apo sjellin ndryshime në RKGJC;
- Garantimi i disponueshmërisë së nevojshme në masën 99,9% të funksionimit të sistemit, sigurisë së të dhënave dhe korrektësisë së RKGJC-së;
- Garantimi i autentifikimit, autorizimit, i sigurisë së komunikimit dhe i shpejtësisë së komunikimit të përdoruesve të autorizuar për të kryer veprime në RKGJC.

Pavarësisht se kjo kontratë ka për objekt kryesor procesin e mirëmbajtjes dhe zhvillime të mëtejshme, DPGJC-ja nëpërmjet kësaj kontrate shërbimi do të përfitojë edhe shërbimet e mëposhtme:

1. Këshillim teknik dhe konsulencë;
2. Monitorimi Software;
3. Lokalizimi dhe Azhurnimi i Softëare të Sistemit;
4. Shërbime të tjera përmirësimi apo modifikimi të sistemit;
5. Trajnime për stafin sipas nevojës.

b. Hartimi i specifikave teknike, përlllogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit

Përlllogaritja e fondit limit të kontratës për vitin 2020 është kryer duke ndjekur pikën 2.a “çmimet e tregut”, të nenit 59 në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke përlllogaritur një fond limit në shumën 199,425,000 pa TVSH.

Nga Autoriteti Kontraktor **nuk është argumentuar** mënyra e zgjedhur për përlllogaritjen e vlerës limit sipas opsionit 2.a të nenit 59 në VKM nr. 914, datë 29.12.2014, duke patur parasysh që jemi në kushtet e një procedure prokurimi për mirëmbajtje të një sistemi ekzistues.

Me shkresën nr. 342 prot., datë 21.01.2020, grupi i punës ka dokumentuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, ku për **kapacitetin teknik është kërkuar:**

- Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitet profesional dhe teknike për të kryer këtë shërbim, operatori ekonomik konkurrues duhet të paraqesë referenca, të realizuar me zgjidhje të bazuar në arkitekturën SOA për zhvillim dhe mirëmbajtje pasi sistemi actual i cili do të mirëmbahet është bazuar në sistemin SOA;

- Operatori ekonomik duhet të ketë në staf të paktën 9 specialistë të kualifikuar për zhvillimin e sistemit ekzistues (i cili është i bazuar në gjuhën e programimit JAVA), duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme, të cilët në mënyrë të kombinuar të përmbushin kërkesat e mëposhtme për certifikime:

- Të paktën 1 specialist të certifikuar si JAVA PROGRAMMER nga ORACLE në nivelin profesional OCM (Oracle Certified Master, Java EE 6 Enterprise Architect) ose ekuivalent.

- Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 2 specialistë të certifikuar si JAVA PROGRAMMER nga ORACLE në nivelin profesional OCP (Oracle Certified Professional, Java SE 8 Programmer) ose ekuivalent.

- Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 6 specialistë të certifikuar si JAVA PROGRAMMER nga ORACLE në nivelin profesional OCA (Oracle Certified Associates, Java SE 8 Programmer) ose ekuivalent.

- Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 specialist të certifikuar me certifikatë “Certified Professional for Software Architecture“ minimalisht në nivelin Foundation (Foundation Level) ose ekuivalent.

- Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 2 punonjës personel teknik për mirëmbajtjen e bazave të dhënave nga të cilët një të certifikuar me certifikatë “IBM Certified Database Administrator” dhe një të certifikuar me certifikatën “ IBM Certified Database Associate” ose ekuivalent.

- Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 Menaxher Projekti të certifikuar PMP ose Scrum Master ose ekuivalente, për të siguruar menaxhimin me cilësi të projektit dhe shërbimeve të implementimit gjatë zhvillimit të projektit.

- Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 2 specialist të certifikuar në menaxhimin e mirëmbajtjes dhe SLA ITIL Certificate ose ekuivalente.

Hartuesit e kriterëve të veçanta të kualifikimit kanë mbajtur procesverbal për argumentimin e kriterëve të vendosura mbi kapacitetin teknik.

Nga auditimi mbi kriteret e veçanta të kualifikimit u konstatua se:

- Nuk është argumentuar kërkesa që Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar si shërbime të ngjashme me objektin e këtij prokurimi të paktën në vlerën totale 30 % të fondit limit.

- Nuk është argumentuar kërkesa për 1 specialist të certifikuar si JAVA PROGRAMMER nga ORACLE në nivelin profesional OCM (Oracle Certified Master, Java EE 6 Enterprise Architect) ose ekuivalent.

- Nuk është argumentuar kërkesa e certifikimit si JAVA PROGRAMMER nga ORACLE në nivelin profesional OCP (Oracle Certified Professional, Java SE 8 Programmer) ose ekuivalent dhe nuk është argumentuar numri për 2 specialistë të këtij kualifikimi.

Ky kriter konsiderohet diskriminues për sa kohë nuk jemi në kushtet e implementimit të një projekti të ri.

- Nuk është argumentuar kërkesa e certifikimit si JAVA PROGRAMMER nga ORACLE në nivelin profesional OCA (Oracle Certified Associates, Java SE 8 Programmer) ose ekuivalent dhe nuk është argumentuar numri për 6 specialistë të këtij kualifikimi.

Në argumentimin e kriterëve për kapacitetin teknik grupi shprehet se nevojiten 2 specialistë, por në të vërtetë kanë vendosur 6 specialistë, kriter i cili ka kufizuar konkurrencën duke patur parasysh që kjo procedurë është zhvilluar me një pjesëmarrës.

Argumenti teknik që kanë paraqitur anëtarët në procesverbalin e mbajtur, për 3 kriteret më sipër është i njëjtë dhe pa shpjegim teknik se si është identifikuar lloji i kualifikimit si dhe numri i punonjësve të specilaizuar për secilin drejtim.

- Nuk është argumentuar kërkesa për 1 menaxher projekti të certifikuar PMP ose Scrum Master ose ekuivalente.

Ky kriter nuk është në përputhje me objektin e kontratës për sa kohë nuk jemi në kushtet e implementimit të një projekti të ri, ndërsa kërkesat për mirëmbajtjen mund të realizohen dhe me anë të kualifikimit ITIL, specifikuar në kriter për menaxhimin e mirëmbajtjes dhe SLA, përdorur dhe në procedura të tjera mirëmbajtje.

- Nuk qendron argumentimi teknik për 2 specialistë të kualifikimit në menaxhimin e mirëmbajtjes dhe SLA ITIL Certificate ose ekuivalente, nisur nga fakti se të gjitha kontrata e mirëmbajtjeve të sistemeve të rëndësishme janë për të paktën një periudhë 2 vjeçare.

Për sa më sipër, kriteret e veçanta hartuar nga grupi i hartimit të specifikimeve kanë sjellë kufizim të pjesëmarrësve në tender, me vetëm 1 pjesëmarrës, në kundërshtim me neni 26, pika 5, nenin 28, pika 2 dhe neni 61, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; si dhe nenin 46, pika 1 dhe 3 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi 3 anëtarët që kanë hartuar specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit: J.H, I.R, S.S.

13. Prokurim i parashikuar dhe realizuar, me objekt “Ngritja e sistemit për shkëmbimin e informacionit financiar me entitetet e huaja”, me datë zhvillimi të procedurës 11.06.2020, me referencë 58393.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës që është prokuruar

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është ndërtimi i një sistemi që do të kontribuojë në adoptimin dhe zbatimin e Shkëmbimit Automatik të Informacionit në llogaritë financiare për qëllime tatimore, sipas standardit të raportimit të përbashkët.

Standardi u kërkon qeverive (autoriteteve kompetente – në rastin e Shqipërisë është DPT) të marrin informacion të hollësishëm nga institucionet e tyre financiare dhe ta shkëmbejnë këtë informacion automatikisht me vendet e tjera (me autoritetet respektive) mbi bazë vjetore. Informacioni për t’u shkëmbyer përfshin balancat e llogarive financiare në fund të vitit që raportohet, fitimet kapitale (përfshirë interesat, dividendët, të drejtat dhe të ardhurat nga shitja e aseteve financiare), të raportuara te qeveritë nga institucionet financiare, duke mbuluar llogaritë e mbajtura nga individët dhe entitetet përfshirë trustet dhe fondacionet.

Sipas standardit, një gamë e gjerë e informacionit do të shkëmbehet mbi llogaritë offshore, duke përfshirë balancat e llogarive dhe të pronësisë. Kjo do të bëjë të mundur parandalimin e evazionit fiskal dhe trajtimin e mashtrimit fiskal, brenda logjikës së veprimtaria e evazorëve jo vetëm zvogëlon të ardhurat publike, por dhe dobëson besimin në drejtësinë e sistemit tatimor, si dhe rrit barrën mbi tatimpaguesit e ndershëm.

Informacioni që do të shkëmbehet nuk ka të bëjë vetëm me individët, por edhe me kompanitë dhe NFE-të (entitete jo financiare) pasive të cilat kanë pronar përfitues rezident në shtetet e tjera.

Më tej, raportimi duhet të bëhet për një gamë të gjerë të produkteve financiare, nga një gamë e gjerë institucionesh financiare, përfshirë bankat, institucionet depozituese, sipërmarrje të investimeve kolektive dhe kompanitë e sigurimeve.

Institucionet financiare raportuese janë:

- Institucionet financiare depozituese, të licencuara nga Banka e Shqipërisë.
- Shoqëri të kursim – kreditit, të licencuara nga Banka e Shqipërisë.
- Ente investuese, të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

- Shoqëritë e sigurimit dhe ri sigurimit, të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi: nr. 17, datë 18.05.2020	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: K.P E.M J.H YÇ	4. Komisioni i llogaritjes së fondit limit: K.P I.Sh B.Xh
2. Fondi Limit (pa TVSh) 98,444,667 lekë: Implementim 66,516,667 Lekë Mirëmbajtje 31,928,000 Lekë për 48 muaj.	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: E.S M.D D.Gj	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: S.K A.A D.Xh
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”, me mjete elektronike”	9. Operatori fitues: OE “I&C” sh.p.k. Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 89,900,000 lekë: Implementim 66,700,000 lekë Mirëmbajtje 23,200,000 lekë	10. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 8,544,667 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 11.06.2020	11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: S.&S I&C	12. Operatore të Kualifikuar: 1 (një)
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: S.&S I&C	12. Operatore të Kualifikuar: 1 (një)	13. Operatorë të s’kualifikuar: 1 (një)
14. Ankimimet: Nuk ka	15. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	16. Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka
17. Lidhja e kontratës: nr.3275 prot., datë 10.07.2020	18. Vlera e kontratës (me TVSh): 107,880,00 lekë	19. Afati i kontratës do të vazhdojë 4 muaj implementim dhe 48 muaj mirëmbajtje.

a. Identifikimi i nevojave për mallra dhe shërbime

Në vitin 2014 në mbledhjen e Forumit Global (Global Forum), Ministri i Financave nënshkroi marrëveshjen model shumëpalëshe të autoriteteve kompetente e cila është një marrëveshje kuadër, që siguron mekanizmin ligjor për shkëmbimin automatik, reciprok, të informacionit dhe do të hyjë në fuqi pasi vendet nënshkruese të bëjnë notifikimet e përcaktuara në këtë marrëveshje. Kjo marrëveshje u nënshkrua në zbatim të nenit 6 “Shkëmbimi Automatik i Informacionit” të Konventës për Ndihmën Administrative të Ndërsjellë në Çështjet Tatimore, të cilën Shqipëria e ka miratuar me ligjin nr.146/2013, datë 6.05.2013. Po në këtë kuadër Këshilli i Ministrave me VKM-në nr.178 datë 09.03.2016, ka miratuar “Marrëveshjen shumëpalëshe të Autoritetit Kompetent mbi Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarisë Financiare”.

Për të luftuar problemin e evazionit fiskal offshore dhe shmangien e grumbullimit të parave jashtë vendit, autoritetat tatimore, në bashkëpunim me vendet e G20 dhe OECD, krijuan një Standard Raportimit të Përbashkët (CRS) mbi Shkëmbimin Automatik të Informacionit (AEOI).

Standardi i raportimit të përbashkët kërkon që institucionet financiare të një juridiksioni raportues, të mbledhin dhe raportojnë informacion tek autoritetet e tyre tatimore në lidhje me mbajtësit e llogarive të cilët janë rezidentë të shteteve të tjera. Një informacioni i tillë duhet të transmetohet "automatikisht" për çdo vit. Detyrimin për shkëmbimin e informacionit e ka Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, e cila do të mbledhë të dhënat nga institucionet financiare dhe do ta shkëmbejë atë automatikisht me vendet e tjera nënshkruese të marrëveshjes.

Aktualisht, 108 juridiksione (shtete) kanë nënshkruar CRS MCAA, ndërsa 112 juridiksione janë angazhuar për të shkëmbyer informacion sipas CRS. Përkatësisht 49 juridiksione u angazhuan për të shkëmbyer informacion në vitin 2017; 51 në vitin 2018; 2 në vitin 2019; 7

juridiksione do të shkëmbejnë informacion në vitin 2020 dhe 3 juridiksione janë zotuar të shkëmbejnë informacion në vitin 2023.

b. Hartimi i specifikave teknike, përlllogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit

Fondi limit është përlllogaritur bazuar në pikën 2.a “Çmimet e tregut”, të nenit 59 në VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, rezulton të jetë 98,444,667 lekë nga të cilat implementim 66,516,667 lekë dhe mirëmbajtje 31,928,000 lekë.

Me shkresën nr.2318 prot., datë 13.05.2020, grupi i punës ka dokumentuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, ku për **kapacitetin teknik është kërkuar:**

Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar prej gjashtë muajsh nga data e fillimit të kësaj procedure, të paktën 12 persona të diplomuar për Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Informatike, Teknologji Informacioni, Informatike, Informatike Matematike, Inxhinieri Matematike dhe Informatike, Informatike Ekonomike ose Telekomunikacion, nga të cilët:

- Të paktën 5 persona të certifikuar për gjuhën e programimit që do të përdoret për ndërtimin e zgjidhjes. Certifikimet duhet të jenë lëshuar nga prodhuesi i teknologjive dhe instrumenteve që do përdoren.
- Të paktën 2 persona të certifikuar në nivel OCP ose OCE (per programim Java , Oracle), MCSD ose MCSE (për zhvillim aplikacionesh në Microsoft .NET), ose ekuivalente, në varësi të teknologjisë që do të përdoret për ndërtimin e sistemit. Certifikimet duhet të jenë të lëshuara nga prodhuesi i teknologjive dhe instrumenteve që do përdoren për prodhimin e sistemit.

Për zgjidhjen ekuivalente, operatori ekonomik duhet të ofrojë certifikatën nga prodhuesi përkatës i teknologjisë në të njëjtin nivel certifikimi, që mbulon aftësitë e përmendura më sipër.

- Të paktën 2 persona të certifikuar për zhvillim web servisesesh.
- Të paktën 2 persona të certifikuar për programim HTML5/CSS3/Javascript, lëshuar nga një certifikues i njohur në nivel ndërkombëtar (psh: Microsoft, Oracle ose ekuivalent).
- Të paktën 1 person të certifikuar për menaxhim të dhënash (Data Management Expert ose ekuivalente).
- Për të garantuar aftësitë e nevojshme për testimin e sistemit të ofruar, të paktën 1 person të certifikuar si testues software.
- Të paktën 1 person të certifikuar PMP ose ekuivalente nga një institucion i njohur në nivel ndërkombëtar, që do të luajnë rolin e menaxherit të projektit në të gjithë komponentët e tij.

Hartuesit e kriterëve të veçanta të kualifikimit kanë mbajtur procesverbal për argumentimin e kriterëve të vendosura mbi kapacitetin teknik.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e mbajtur nga grupi që ka hartuar kriteret e veçanta të kualifikimit, u konstatua se:

- Nuk është argumentuar kërkesa që Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë 3 viteve të fundit nga hapja e tenderit, shërbime të ngjashme me objektin e këtij prokurimi të paktën në vlerën totale 40% të fondit limit.
- Nuk është argumentuar numri i 12 punonjësve të diplomuar për Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Informatike, Teknologji Informacioni, Informatikë, Informatikë Matematike, Inxhinieri Matematike dhe Informatikë, Informatikë Ekonomike ose Telekomunikacion.
- Nuk është argumentuar numri i 5 punonjësve të certifikuar për gjuhën e programimit që do të përdoret për ndërtimin e zgjidhjes.
- Nuk është argumentuar numri për 2 punonjës të certifikuar për programim HTML5/CSS3/ Javascript, lëshuar nga një certifikues i njohur në nivel ndërkombëtar (p.sh.: Microsoft, Oracle ose ekuivalent).

- Nuk është argumentuar numri për 2 punonjës të certifikuar në nivel OCP ose OCE (per programim Java , Oracle), MCS D ose MCSE (për zhvillim aplikacionesh në Microsft .NET), ose ekuivalente, në varësi të teknologjisë që do të përdoret për ndërtimin e sistemit.

Për sa më sipër, kriteret e veçanta hartuar nga grupi i hartimit të specifikimeve kanë sjellë kufizim të pjesëmarrësve në tender, me vetëm 1 pjesëmarrës, në kundërshtim me neni 26, pika 5, nenin 28, pika 2 dhe neni 61, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; si dhe nenin 46, pika 1 dhe 3 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe për sa më sipër mbajnë përgjegjësi, anëtarët e grupit që kanë hartuar kriteret e veçanta të kualifikimit: K.P, I.Sh, B.Xh.

c. Zbatimi i kontratave dhe marrëveshjeve në nivel shërbimi

Me urdhrin nr.346, datë 30.10.2020 janë caktuar si ndjekës të kontratës me nr.3275, datë 10.07.2020, për ngritjen e sistemit për shkëmbimin e informacionit financiar me entitetet e huaja, specialistët:

- M.A- Specialist, Sektori i sigurisë së të dhënave, Drejtoria TIK e Tatimeve, zëvendësuar me E.N me urdhrin nr.8, datë 05.01.2022 të titullarit të AKSHI-t;
- E.R - Specialist, Sektori i Operacioneve, Drejtoria e TIK e Tatimeve, zëvendësuar me znj. E.B.

Kërkesat mbi raportimin janë përmbushur në afatet si më poshtë:

Raporti Fillestar është dorëzuar nga OE tek AKSHI, protokolluar me shkresën nr.3433, datë 17.07.2020, nënshkruar nga 2 specialistët ndjekës të kontratës, pra brenda afatit të përcaktuar në kontratë si dhe në grafikun e lëvrimit.

Raporti final si dhe manualët e përdorimit të sistemit janë dorëzuar nga OE tek AKSHI, protokolluar me shkresën nr.6007, datë 10.11.2020, i cili është nënshkruar nga 2 specialistët ndjekës të kontratës, pra brenda afatit të përcaktuar në kontratë si dhe në grafikun e lëvrimit.

Afati kohor për implementimin e projektit është zbatuar në përputhje me kohën e përcaktuar dhe sipas detyrave specifike që lindin nga ky projekt dokumentuar në specifikimet teknike.

Drafti i raportit përfundimtar nuk është dorëzuar tek AKSHI, në kundërshtim me pikën 6.1 të specifikimeve teknike, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi ndjekësit e kontratës.

14. Prokurim i parashikuar dhe realizuar, me objekt “Përmirësimi i sigurisë së informacionit për infrastrukturën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”, me datë zhvillimi të procedurës 17.12.2020, me referencë 79424.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës që është prokuruar

Ministria e Financave dhe Ekonomisë prej vitesh është duke modernizuar dhe përmirësuar shërbimet e ofruar prej saj nëpërmjet zhvillimit të sistemeve të reja, përmirësimit të sistemeve ekzistuese si dhe ndërveprimin e këtyre sistemeve me rrjetin e Govnet.

Si rezultat i ndryshimeve që kanë ndodhur dhe që janë planifikuar për t’u zhvilluar, lind nevoja e një infrastrukture rrjeti të disponueshme, të sigurt dhe me kapacitete të mjaftueshëm për të ndihmuar monitorimin e përdorueseve që përdorin këto shërbime.

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi: nr. 56, datë 16.11.2020	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: E.M S.S A.Q	4. Komisioni i llogaritjes se fondit limit: E.M S.S A.Q
2. Fondi Limit (pa TVSh) 92,422,167 lekë: Implementim 67,005,834 Lekë Mirëmbajtje 25,416,333 Lekë		

5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”, me mjete elektronike”	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: E.S M.D D.Gj	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Xh.H S.K A.O
8. Data e hapjes së tenderit: 17.12.2020	9. Operatori fitues: M.C Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 88,645,000 lekë: Implementim 64,285,000 Lekë Mirëmbajtje 24,360,000 Lekë	10. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 3,777,167 Lekë
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: F. MC	12. Operatore të Kualifikuar: 1 (një)	13. Operatorë të s’kualifikuar: 1 (një)
14. Ankimimet: Nuk ka	15. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	16. Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka
17. Lidhja e kontratës: nr. 126 prot, Datë 11.01.2021	18. Vlera e kontratës (me TVSh): 106,374,000 lekë	19. Afati i kontratës do të vazhdojë 4 Javë implementim dhe 24 muaj mirëmbajtje.

Procedura është hapur me datën 16.11.2020, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr.9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 83 ku citohet se “Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme mund të ndërmarrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor”.

a. Identifikimi i nevojave për mallra dhe shërbime

Nisur ka fakti që zhvillimet teknologjike sa vijnë dhe shtohen, siguria kibernetike mbetet prioriteti maksimal në MFE. Nisur nga fakti i softëareve dhe bazave të të dhënave që MFE ka në përdorim si dhe fakti që sulmet kibernetike në nivel botëror janë rritur ndjeshëm, do të implementojnë një sistem bazuar në Inteligjencën Artificiale, i cili monitoron dhe parandalon sulme dhe tentativa për thyerjen e aksesave si dhe hyrje të autorizuara në këto sistemeve kaq kritike.

Objektivi i këtij projekti është rritja e sigurisë së sistemeve duke bere te mundur menaxhimin online te incidenteve teknike dhe kibernetike.

Nëpërmjet këtij sistemit informatik kërkohet:

- Raportimi në kohë të problematikave/incidenteve;
- Menaxhim i shpejtë problematikave/incidenteve,
- Njoftim në kohë të ngjarjeve dhe zgjidhjeve të problemeve të renditura sipas rëndësisë;
- Marrja e informacionit nga përdoruesit rreth incidenteve të mundshëm dhe zgjidhjeve të tyre;
- Gjenerimi i raporteve rreth incidenteve dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre;
- Sistemi duhet të ruajë të gjitha eventet / incidentet të detajuara;

Pra, nëpërmjet këtij projekti synohet rritja e sigurisë së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë përmes kontrollit dhe monitorimit të aksesit në internet dhe lidhjeve me institucionet e tjera.

b. Hartimi i specifikave teknike, përlllogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit

Fondi limit është përlllogaritur bazuar në pikën 2.a “Çmimet e tregut”, të nenit 59 në VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, rezulton të jetë 92,422,167 lekë pa TVSH nga të cilat implementim 67,005,834 lekë dhe mirëmbajtje 25,416,333 lekë për 24 muaj.

Me shkresën nr. 5615 prot., datë 27.10.2020, grupi i punës ka dokumentuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, ku për **kapacitetin teknik është kërkuar:**

Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin tekniko-profesional të paktën 11 punonjës të diplomuar në Inxhinieri Elektronikë/ Informatikë/ Telekomunikacion si dhe të kenë certifikimet e mëposhtme:

- 1 punonjës të certifikuar për web server;
- 1 punonjës të certifikuar për sigurinë në rrjetat kompjuterike;
- 1 punonjës të certifikuar për programim në Java ose ekuivalente;
- 2 punonjës të certifikuar për Microsoft MCSA ose ekuivalent;
- Të paktën 6 punonjës të certifikuar për sigurinë kibernetike;
- 2 punonjës për storage që do të ofertohej;
- 3 punonjës të certifikuar për Microsoft MCP ose ekuivalente;
- 1 punonjës të certifikuar si projekt manager;
- 1 punonjës të certifikuar me ITIL ose ekuivalente;
- 1 punonjës i certifikuar për virtualizime;
- 1 punonjës i certifikuar për Rrjetat kompjuterike;
- 1 punonjës i certifikuar si inxhinier për routing;
- 1 punonjës i certifikuar për rrjetat wireless;

Hartuesit e kriterëve të veçanta të kualifikimit kanë mbajtur procesverbal për argumentimin e kriterëve të vendosura mbi kapacitetin teknik.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e mbajtur nga grupi që ka hartuar kriteret e veçanta të kualifikimit, u konstatua se:

- Nuk është argumentuar kërkesa për 11 punonjës të diplomuar në Inxhinieri Elektronikë/ Informatikë/ Telekomunikacion.
- Nuk është argumentuar kërkesa për 6 punonjës të certifikuar për sigurinë kibernetike.
- Nuk është argumentuar kërkesa për 3 punonjës të certifikuar për Microsoft MCP ose ekuivalente.
- Nuk është argumentuar kërkesa për 2 punonjës të certifikuar për Microsoft MCSA ose ekuivalent.
- Nuk është argumentuar kërkesa për 1 punonjës i certifikuar si inxhinier për routing, meqenëse tek argumentimi i grupit për këtë kriter thuhet se “Sistemi do të monitorojë 100% në kohë reale rrjetin aktual”.
- Nuk është argumentuar kërkesa për 1 punonjës i certifikuar për rrjetat wireless, meqenëse tek argumentimi i grupit për këtë kriter thuhet se “Sistemi do të monitorojë 100% në kohë reale rrjetat wireless”.

Për sa më sipër, kriteret e veçanta hartuar nga grupi i hartimit të specifikimeve kanë sjellë kufizim të pjesëmarrësve në tender, me vetëm 1 pjesëmarrës, në kundërshtim me neni 26, pika 5, nenin 28, pika 2 dhe neni 61, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; si dhe nenin 46, pika 1 dhe 3 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi, anëtarët e grupit që kanë hartuar kriteret e veçanta të kualifikimit: E.M, S.S, A.Q.

15. Prokurim i parashikuar dhe realizuar, me objekt “Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverash (data center), sistem telefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DRT/DPT (Faza 2) - për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”, me datë zhvillimi të procedurës 16.12.2020, me referencë 79368.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës që është prokuruar

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve aktualisht është modernizuar në shërbimet informatike me qëllim që t’i sigurojë stafit mjetet e duhura që ata kanë nevojë për të kryer detyrat dhe funksionet e tyre, për të qenë sa më efektivë dhe produktivë.

Si rezultat i këtyre ndryshimeve dhe implementimit të sistemeve të reja dhe bashkëkohore, kërkohet një performancë dhe besueshmëri më e lartë nga ana e pajisjeve të rrjetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe për drejtoritë rajonale.

Objektivi i këtij projekti është përmirësimi i pajisjeve dhe topologjisë së rrjetit, sistemit CCTV, sistemit të kontrollit të aksesit dhe atij telefonik VoIP për Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, duke i kthyer këto sisteme funksionale dhe në teknologji bashkohore.

Të dhënat e përgjithshme të prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 54, datë 12.11.2020	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: D.F M.V I.K	4. Komisioni i llogaritjes së fondit limit: D.F M.V I.K
2. Fondi Limit (pa TVSh) 110,833,310 lekë: Implementim 79,166,650 Lekë Mirëmbajtje 31,666,660 Lekë për 24 muaj.	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: E.S M.D D.Gj	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Y.Ç K.H A.A
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”, me mjete elektronike”	9. Operatori fitues: A.B sh.p.k. Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 105,290,000 Lekë: Implementim 75,590,000 Lekë Mirëmbajtje 29,700,000 Lekë	10. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 5,543,310 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 16.02.2020	11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: F. sh.p.k A.B sh.p.k	12. Operatore të Kualifikuar: 1 (një)
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: F. sh.p.k A.B sh.p.k	13. Operatore të s’kualifikuar: 1 (një)	14. Ankimimet: Nuk ka
14. Ankimimet: Nuk ka	15. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	16. Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka
17. Lidhja e kontratës: nr. 7047 prot, datë 28.12.2020	18. Vlera e kontratës (me TVSh): 126,348,000 lekë Implementim 90,708,000 Lekë Mirëmbajtje 35,640,000 Lekë	19. Afati i kontratës do të vazhdojë 4 muaj implementim dhe 24 muaj mirëmbajtje.

Procedura është hapur me datën 12.11.2020, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 83 ku citohet se “Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme mund të ndërmarrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor”.

a. Identifikimi i nevojave për mallra dhe shërbime

Shtimi i përdoruesve gjatë viteve ka çuar në shtimin e volumit të punës, gjë që ka sjellë vështirësi për t’u përballur me pajisjet aktuale të rrjetit LAN/WAN të Drejtorisë së përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale. Konfigurimi i tyre ka pësuar ndryshime minimale me kalimin e kohës, dhe nuk është përshtatur si duhet me ndryshimet e shpeshta të topologjisë. Pajisjet aktuale janë në përdorim prej 8 – 10 vjetësh dhe tejet e amortizuar. Një pjesë e konsiderueshme e tyre janë tashmë në pikën EOL (End of Life) dhe nuk kanë më suport nga prodhuesi. Me anë të këtij projekti synohet përmirësimi i mëtejshëm i rrjetit LAN/WAN, i sistemit telefonik edhe sistemit të survejimit në të gjitha degët rajonale të tatimeve.

Ky projekt është në regjistrin e planifikimit për vitin 2020 venë në dispozicion të grupit të auditimit.

b. Hartimi i specifikave teknike, përlogaritja e fondit limit, kriteret e veçanta të kualifikimit

Fondi limit është përlogaritur bazuar në pikën 2.a “Çmimet e tregut”, të nenit 59 në VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, rezulton të jetë 110,833,310 lekë pa TVSH, nga të cilat Implementim 79,166,650 lekë janë vlerë implementimi, ndërsa 31,666,660 Lekë pa TVSH është mirëmbajtje.

Me shkresën nr. 6040 prot., datë 12.11.2020, grupi i punës ka dokumentuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, ku për **kapacitetin teknik është kërkuar:** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

- NS-13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni;
- NS-14 A Impiante të brendshme elektrike telefoni radiotelefoni;

Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar mesatarisht të paktën 20 punonjës:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ose nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore ku të specifikohet numri i punonjësve.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë dhe të ketë pjesë të stafit të tij:

- 2 punonjës të certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve aktive të rrjetit.
- 1 punonjës të certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve të sigurisë firewall.
- 2 punonjës të certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve të kamerave që do të ofertojë.
- 2 punonjës të certifikuar nga prodhuesi i sistemit të akses kontrollit që do të ofertojë.
- 2 punonjës të certifikuar nga prodhuesi i centraleve telefonike që do të ofertojë.
- 1 punonjës i certifikuar nga prodhuesi i sistemit të menaxhimit qendror të sigurisë (VMS/PSIM) që do të ofertojë.
- 1 punonjës të certifikuar si database administrator.
- 1 punonjës të certifikuar si softëare developer.
- 1 punonjës të certifikuar si testues softëare ose ekuivalente.
- 1 punonjës të certifikuar për menaxhim projektsh në nivel PMP / Prince 2 ose ekuivalente.
- 5 punonjës teknike të pajisur me kartela të sigurimit teknik.

Hartuesit e kriterëve të veçanta të kualifikimit kanë mbajtur procesverbal për argumentimin e kriterëve të vendosura mbi kapacitetin teknik.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e mbajtur nga grupi që ka hartuar kriteret e veçanta të kualifikimit, u konstatua se:

- Nuk është argumentuar kërkesa që Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga hapja e tenderit, shërbime të ngjashme me objektin e këtij prokurimi të paktën në vlerën totale 40 % të fondit limit.

- Nuk është argumentuar kërkesa për 20 punonjës, ndërkohë që kualifikimet e kërkuara nëse do të llogariteshin për çdo punonjës 1 kualifikim do të mjaftonin 19 punonjës, megjithëse afati i zbatimit të kontratës është 4 muaj dhe 1 punonjës mund të ketë më shumë se një certifikim.

- Kriteret për:

NS-13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni;

NS-14 A Impiante të brendshme elektrike telefoni radiotelefoni;

Janë licencime që nuk janë në përputhje me objektin e prokurimit për arsye se këto licenca nevojiten për punime speciale ndërtimi, të cilat nuk janë pjesë e pikës 10 në specifikimet teknike “Planifikimi i buxhetit për ndërtimin e sistemit”.

- Kriteret për:

1 punonjës të certifikuar si database administrator;

1 punonjës të certifikuar si softëare developer;

1 punonjës të certifikuar si testues softëare ose ekuivalente;

Nuk janë në përputhje me objektin e prokurimit pasi me anë të këtij projekti synohet përmirësimi i mëtejshëm i rrjetit LAN/WAN, i sistemit telefonik edhe sistemit tëurvejimit në të gjitha degët rajonale të tatimeve cituar në paragrafin 1.3 të specifikimeve teknike, pra nuk do të zhvillohen sisteme nga OE, por një modul i thjeshtë raportimesh mbi orët e qëndrimit në punë të punonjësve. Kriteri për testues software nga auditimi konsiderohet i panevojshëm dhe kufizues i pjesëmarrjes.

- Kriteret për:

2 punonjës të certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve aktive të rrjetit;

2 punonjës të certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve të kamerave që do të ofertojë;

2 punonjës të certifikuar nga prodhuesi i sistemit të akses kontrollit që do të ofertojë;

2 punonjës të certifikuar nga prodhuesi i centraleve telefonike që do të ofertojë;

Janë argumentuar bazuar në faktin se janë 13 degë në të cilat do të ketë instalime dhe konfigurime. Vendosja e këtyre kriterëve nuk është e nevojshme në këtë sasi duke patur parasysh se implementimi do të bëhet për 4 muaj ose afërsisht 80 ditë pune ose afërsisht 6 ditë pune për një degë.

Nisur nga ky arsytim, vlerësojmë se do të mjaftonte dhe një punonjës i certifikuar për secilën kërkesë. Instalimet dhe konfigurimet e kryera nga këta punonjës kanë filluar dhe përfunduar brenda muajit prill që është dhe muaji i fundit i zbatimit të kontratës.

Për sa më sipër, kriteret e veçanta hartuar nga grupi i hartimit të specifikimeve kanë sjellë kufizim të pjesëmarrësve në tender, me vetëm 1 pjesëmarrës, në kundërshtim me neni 26, pika 5, nenin 28, pika 2 dhe neni 61, pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; si dhe nenin 46, pika 1 dhe 3 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e grupit që kanë hartuar kriteret e veçanta të kualifikimit D.F, M.V, I.K.

Nga auditimi u konstatua se në datën 25.09.2019 në APP është publikuar procedura e hapur me objekt “Shërbimet e ndërlidhjes së DPGJC me zyrat e saj rajonale” Për Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile me fond limit 196,975,408 lekë pa TVSH.

Ndërkohë në datën 15.10.2019 nga ana e njësisë së prokurimit është hartuar një Memo, drejtuar Drejtorit dhe zv. Drejtorit të Përgjithshëm të AKSHI-t, ku kërkohet fillimi i një procedure tjetër për mbulimin e lidhjes së DPGJC me zyrat e saj rajonale, deri në përfundimin e procedurës së hapur me këtë objekt prokurimi, pasi ofrimit të këtij shërbimi i kishte përfunduar afati.

Në datën 15.10.2019 është nënshkruar Urdhri i Prokurimit nr. 58, me nr. 6304 prot., datë 15.10.2019, duke zgjedhur llojin “Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, me po të njëjtin objekt “Shërbimet e ndërlidhjes së DPGJC me zyrat e saj rajonale” për Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile me fond limit 24,621,926 lekë pa TVSH. Zgjedhja e procedurës është bazuar në nenin 33 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pika 2/c, ku citohet “kur për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor, afati kohor i parashikuar në nenin 43 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 për njoftimin e kontratës për procedurat e hapura, të kufizuara ose me negociim, me publikim, nuk mund të respektohet. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktor. Kushtet dhe rrethanat e përdorimit të kësaj procedure përcaktohen në rregullat e prokurimit”.

Në vlerësimin e grupit të auditimit, ky rast nuk përbën aspak një rast të një nevoje ekstreme, shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme. Kontrata për këtë shërbim, e lidhur në vitin 2017, dhe e përfunduar në vitin 2019, nuk ka si të jetë e paparashikueshme që do të mbarojë në vitin 2019. Aq më tepër që po zhvillohet një procedurë e hapur për këtë shërbim, pra nuk ka se si të jetë e paparashikueshme. Madje për përfundimin e kontratës AKSHI është vënë në dijeni me shkresën nr. 1591 prot., datë 17.09.2019, protokolluar tek AKSHI me nr. 5539 prot., datë 18.09.2019. Në këtë shkresë ndër të tjera citohet se me shkresën nr. 1125 prot., datë 21.06.2019, Ministria e Brendshme ka njoftuar AKSHI-n lidhur me përfundimin e kontratave.

Në nenin e përmendur më sipër citohet se “*Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktor*”, ndërkohë ky rast është i tillë, pasi AKSHI ka qenë në dijeni të situatës prej datës 21.06.2019.

Mbi këtë analizë, vlerësojmë se AKSHI nuk duhet ta kishte zhvilluar këtë procedurë prokurimi me negociim pa shpallje. Madje të dyja procedurat e zhvilluara me këtë objekt, duhet të ishin zhvilluar si një e vetme. Vlera totale e fondit limit të dy procedurave është 221,597,334 lekë, vlerë e cila sipas nenit 8.1/a të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, klasifikohet mbi kufirin e lartë monetar. Referuar Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 3.28 “*Kufi monetar është vlera monetare, sipas së cilës, në përputhje me këtë ligj apo me rregullat e prokurimit publik, përcaktohet procedura e prokurimit që do të përdoret nga autoriteti kontraktor*”. Klasifikimi mbi kufirin e lartë monetar i një procedure prokurimi nisur nga përllogaritja e fondit limit, do të detyronte Autoritetin Kontraktor që për këtë procedurë prokurimi të ndiqeshin hapa të tjera referuar dispozitave ligjore. Saktësisht sipas Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar:

- Neni 38.2 “*Njoftimet për prokurimet me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, botohen në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në të paktën një gazetë me shpërndarje në Europë*”.

- Neni 43 “*Në procedurën e hapur, me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, afati për paraqitjen e ofertave është jo më pak se 52 ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik*”.

Ndarja e kësaj kontrate është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 28.2, ku citohet “*Nuk lejohet pjesëtimi apo ndarja e vlerës së kontratës publike për shmangien nga dispozitat e parashikuara në këtë ligj*”. Copëzimi i fondit ka sjellë shmangien e dispozitave ligjore të trajtuara më sipër, çka në këtë rast ka ndikuar në shmangien e konkurrencës së operatorëve ekonomik, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2/ç “*Qëllimi i këtij ligji është të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik*”.

Sa më sipër, për zhvillimin e procedurës së prokurimit me negociim pa shpallje, në kundërshtim me nenin 33 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe për copëzimin e fondeve buxhetor me qëllim shmangien e procedurave, në kundërshtim me nenin 28.2 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, mbajnë përgjegjësi njësia e prokurimit e përbërë nga E.S, M.D dhe D.Gj.

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:

Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit i është kërkuar nga Ministria e Brendshme me shkresën Nr. 1125 Prot., datë 21.06.2019 fillimi i procedurës së prokurimit për të siguruar vazhdimësinë e shërbimit të sipërcituar pasi kontrata ekzistuese ka përfunduar në muajin gusht 2019. Bazuar në kërkesën e Ministrisë së Brendshme, AKSHI ngriti grupin e punës për hartimin e specifikimeve teknike, realizimin e studimit të tregut, përllogaritjen e fondit limit si dhe hartimin e kriterëve të veçanta për procedurën. Pas përfundimit të termave të referencës nga grupi i punës i është përcjellë për dakordësim DPGJC-së në mënyrë që të vijohej më tej me procedurën e prokurimit nga ana jonë. DPGJC-ja ka dhënë dakordësimin në rrugë elektronike (e-mail) mbi termat e referencës të dërguara për dakordësim më datë 01.09.2019. Grupi i punës pasi mori miratimin nga DPGJC, vijoi më tej me testimin e tregut dhe hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Në përfundim të testimit të tregut dhe miratimit të fondit limit nga grupi i punës me anë të shkresës Nr. 5428 Prot., datë 12.09.2019, Ministrisë së Brendshme i është kërkuar konfirmim mbi fondin buxhetor të AKSHI-t për kryerjen e procedurës së prokurimit me objekt:

“Shërbimet e ndërlidhjes së DPGJC me zyrat e saj rajonale” pasi ishte ende e paqartë se në cilin institucion ishte disponibiliteti i fondeve.

Sa më sipër, theksojmë se AKSHI ka marrë masat dhe ka hartuar dokumentacionin e nevojshëm brenda afateve por përgjigja nga ana e Ministrisë së Brendshme ka ardhur vetëm në datë 12.09.2019.

Me anë të shkresës Nr. 1591 Prot., datë 17.09.2017 të Ministrisë së Brendshme, është kërkuar vazhdimësia e shërbimit në mënyrë emergjente pasi shkëputja e këtij shërbimi do të shkaktonte dështimin institucional të ofrimit të shërbimeve që lidhen me qytetarin dhe palët e treta. Gjithashtu Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me anë të shkresës Nr. 1591/1 Prot., datë 19.09.2019, kërkon marrjen e masave emergjente nga AKSHI që kohëzgjatja e këtij shërbimi të jetë i vazhdueshëm, edhe për këto 3 muaj, deri në përfundimin e procedurës së hapur të prokurimit.

Nisur nga fakti që jemi vendosur në këto kushte, AKSHI bazuar në kërkesën e Ministrisë së Brendshme dhe DPGJC-së, është i detyruar të kryej prokurimin bazuar “Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006”, i ndryshuar “Për Prokurimin Publik” Nr. Neni 33, pika 2. Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit, mund të përdoret për të gjitha llojet e kontratave publike si më poshtë:

c) kur për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor, afati kohorë i parashikuar në nenin 43 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 për njoftimin e kontratës për procedurat e hapura, të kufizuara ose me negociim, me publikim, nuk mund të respektohet. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktor. Kushtet dhe rrethanat e përdorimit të kësaj procedure përcaktohen në rregullat e prokurimit për të mundësuar prokurimin e këtij shërbimi deri në përfundim të procedurës së prokurimit të hapur dhe lidhjes së kontratës duke shmangur kështu shkëputjen e këtij shërbimi. E konsiderojmë këtë rekomandim si të pambështetur në ligj.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Pretendimet e paraqitura dhe dokumentet shoqëruese janë vlerësuar dhe marrë në konsideratë nga grupi i auditimit, duke bërë ndyshimet përkatëse në raportin përfundimtar të auditimit.

Titulli i gjetjes:	Përlllogaritje e gabuar e fondit limit me pasojë efekt financiar negativ në vlerën 5,204,656 lekë.
Situata:	Përlllogaritja e fondit limit për 3 muaj shërbim për procedurën me negociim pa shpallje “ <i>Shërbimet e ndërlidhjes së DPGJC me zyrat e saj rajonale</i> ” është kryer duke e krahasuar me vlerën e fondit limit të përlllogaritur për procedurën e hapur për 24 muaj. Pra nëse vlera limit për procedurën që do të zgjasë 24 muaj është 196,975,408 lekë, për 3 muaj është përlllogaritur matematikisht fondi limit 24,621,926 lekë. Së pari, nga verifikimi i dokumentacionit mbi zhvillimin e procedurave të mësipërme, u konstatua specifikimet teknike të procedurës përfshijnë edhe zëra të tjerë, krahas shërbimit të ndërlidhjes, si lëvrim dhe konfigurim të pajisjeve hardëare që do të përdoren për shërbimin, trajnim të punonjësve, implementim të linjave backup, instalim kamerash në çdo gjendje civile, instalimi i videoëall i përbërë nga 4 monitorë, workstation, softëare i menaxhimit të pamjeve etj. Pra vlera e fondit limit 196,975,408 lekë ka të përfshirë jo vetëm shërbimin e ndërlidhjes, por edhe disa elemente të tjerë që e rrisin vlerën, dhe pjesëtimi i vlerës me 24 muaj, me qëllim përcaktimin e vlerës mujore, nuk është i arsyetuar.

	<p>Së dyti, vlera limit e ofrimit të shërbimit të ndërlihdhjes në rastin e parë, është përcaktuar duke marrë në konsideratë edhe shërbimet shtesë sipas risive në kontratën e këtij viti, ndërkohë që ofrimi i shërbimit për 3 muajt e kontraktuar, vazhdon vetëm me infrastrukturën dhe pajisjet e mëparshme. Pra edhe në këtë këndvështrim, nëse nga vlera 196,975,408 lekë do të zbriteshin shërbimet dhe lëvrimet shtesë, përsëri pjestimi i vlerës së mbetur me 24 muaj, me qëllim përcaktimin e vlerës mujore, nuk do të ishte i arsyetuar.</p> <p>Së treti, nga njësia e prokurimit, është përlogaritur për 3 muaj vlera e fondit limit në shumën 24,621,926 lekë pa TVSH, edhe pse shërbimi kërkohet që të ofrohet deri në datën 31.12.2019. Pra edhe nëse kontrata do të ishte lidhur ditën kur u përlogarit vlera, koha e shërbimit do të ishte 2.5 muaj. Ndërkohë kontrata është lidhur me vlerën 23,487,600 lekë pa TVSH, në datën 22.10.2019 me afat deri në datën 31.12.2019, pra 2 muaj e 10 ditë. Nëse do të përdorim logjikën e përdorur nga njësia e prokurimit për përcaktimin e fondit limit mbi bazë mujore, atëherë fondi limit, duhet të ishte 19,150,386 lekë. Diferenca ndërmjet vlerës së kontratës së lidhur dhe fondit limit të përlogaritur nga grupi i auditimit prej 5,204,656 lekë (e llogaritur me TVSH) përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
Efkti:	Efekt financiar negativ në vlerën 5,204,656 lekë.
Shkaku:	Përlogaritje e gabuar e fondit limit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	AKSHI të analizojë situatën lidhur me përlogaritjen e gabuar të fondit limit, duke marrë masat e duhura për parandalimin e krijimit të efekteve financiare negative në të ardhmen.

Për këtë mbajnë përgjegjësi njësia e prokurimit e përbërë nga E.S, M.D dhe D.Gj.

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:

Me anë të shkresës Nr. 1591 Prot., datë 17.09.2017 të Ministrisë së Brendshme është kërkuar vazhdimësia e shërbimit në mënyrë emergjente pasi shkëputja e këtij shërbimi do të shkaktonte dështimin institucional të ofrimit të shërbimeve që lidhen me qytetarin dhe palët e treta. Gjithashtu Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me anë të shkresës Nr. Prot., 1591/1, datë 19.09.2019 kërkon marrjen e masave emergjente nga AKSHI që kohëzgjatja e këtij shërbimi të jetë i vazhdueshëm, edhe për këto 3 muaj, deri në përfundimin e procedurës së hapur të prokurimit.

Nisur nga fakti që jemi vendosur në këto kushte, AKSHI, bazuar në kërkesën e Ministrisë së Brendshme dhe DPGJC-së, është i detyruar të kryejë prokurimin bazuar “Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006”, ndryshuar “Për Prokurimin Publik” Nr. Neni 33, pika 2. Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit, mund të përdoret për të gjitha llojet e kontratave publike si më poshtë:

c) kur për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor, afati kohor i parashikuar në nenin 43 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 për njoftimin e kontratës për procedurat e hapura, të kufizuara ose me negociim, me publikim, nuk mund të respektohet. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktor. Kushtet dhe rrethanat e përdorimit të kësaj procedure përcaktohen në rregullat e prokurimit për të

mundësuar prokurimin e këtij shërbimi deri në përfundim të procedurës së prokurimit të hapur dhe lidhjes së kontratës duke shmangur kështu shkëputjen e këtij shërbimi.

Sa më sipër, ndodhur në këto kushte në vijim të kërkesave të përsëritura nga Ministria e Brendshme dhe DPGJC u morë për bazë përllogaritja e fondit të kryer nga grupi i punës për të shmangur vonesat e mëtejshme që do të sillte hartimi i termave dhe përllogaritja e fondit nga e para, vonesa që do të sillni një dëm shumë herë më të madh pasi pasi shkëputja e këtij shërbimi do të shkaktonte dështimin institucional të ofrimit të shërbimeve që lidhen me qytetarin dhe palët e treta.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Pretendimet e paraqitura dhe dokumentet shoqëruese janë vlerësuar, duke mos u marrë në konsideratë nga grupi i auditimit, përse i përket përllogaritjes, por vetëm, përgjegjësisë, kjo referuar argumentimit të sipërcituar nga ana juaj.

Titulli i gjetjes:	Vonesë në realizimin e kontratës.
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit mbi marrjen në dorëzim të zbatimit të kontratës me nr. 2497 prot., datë 13.05.2019 me objekt “Ngritja e regjistrat elektronik të ekspertëve” me vlerë 136,000,000 lekë me TVSH, u konstatua se afati i implementimit nuk është zbatuar. Pra dorëzimi i sistemit nuk është kryer në datën 13.08.2019, por në datën 13.12.2019, datë në të cilën është mbajtur akti i marrjes në dorëzim. Për këtë vonesë, AKSHI nuk ka mbajtur penalitet në vlerën 37,529,487 lekë (122 ditë x 0.004 x 76,904,687 lekë), vlerë e cila përbën veprime në kundërshtim me 3E ^{-të} dhe të paguhej nga OE “BN E shpk”.
Kriteri:	VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
Efekti:	Penalite të munguara në vlerën 37,529,487 lekë.
Shkaku:	Mosmbajtje penaliteti për zbatim të vonuar kontrate.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	AKSHI të marrë masa dhe të analizojë rastin me qëllim që në të ardhmen, të mos marrë në dorëzim jashtë afateve projekte/produkte, pa përcaktuar dhe kërkuar më parë përllogaritjen dhe mbajtjen e penaliteve. Për praktikën, të nxjerrë përgjegjësitë për mos kërkimin dhe arkëtimin nga subjekti “BN E shpk” të penaliteve për vonesa në dorëzimin në afat të produktit, sipas kontratës me nr. 2497 prot., datë 13.05.2019.

Për sa më sipër mban përgjegjësi E.S në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:

AKSHI ka ngritur një grup pune për verifikimin e rekomandimeve të lëna nga do të identifikohen përgjegjësit dhe do merren masat administrative përkatëse.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Gjetja dhe rekomandimi janë pranuar dhe subjekti ka marrë angazhimin për zbatimin në vijueshmëri të tyre.

Titulli i gjetjes:	Mos realizim i plotë i kontratës.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të sistemit “Ngritja e regjistrat elektronik të ekspertëve” me vlerë 136,000,000 lekë me TVSH, u konstatua se: 1. “Moduli i vlerësimit të aplikimit” nuk është si modul më vete, por pjesë e funksionaliteve të “Moduli i çështjeve gjyqësore”, në kundërshtim me pikën 13.1 të TORS;

	<p>2. Sistemi nuk ka modulet “Moduli i përditësimit të të dhënave dhe korigjimit të gabimeve” dhe “Moduli i çaktivizimit/pezullimit/heqjes së ekspertit nga regjistri”, në kundërshtim me pikën 13.1 të TORS;</p> <p>3. Në sistem nuk janë implementuar fushat “gjinia” dhe “vendlindja”, çka bën që të mos gjenerohet raport mbi këto fusha, sipas kërkesave të pikës 13.1/a të TORS mbi raportet e detyrueshme të sistemit.</p> <p>4. Raportet gjenerohen vetëm në formatin PDF, në kundërshtim me pikën 13.1/a të TORS.</p> <p>Marrja në dorëzim e sistemit duke mos qenë në përputhje me TORS është në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 77 “Mbikëqyrja e kontratës”, ku citohet: <i>“1. Gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor dhe organe të tjera shtetërore, të autorizuar me ligj, (nëse është rasti) mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe legjislacionin në fuqi. 2. Mos përmbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën shkak për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike sipas përcaktimeve të pikës 3/ç të nenit 13 të LPP-së. Në këtë rast, autoriteti kontraktor ka detyrimin të dërgojë në APP kërkesën për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike brenda 3 (tre) muajve nga zgjidhja e kontratës apo përfundimi i afatit të zbatimit të saj, përfshirë këtu edhe periudhën e garancisë. 3. Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, -sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi”.</i></p> <p>Sa më sipër, operatori ekonomik nuk e ka realizuar kontratën sipas parashikimeve, duke mos i përfunduar të gjitha modulet dhe kërkesat. Vlera e moduleve të cilat nuk janë realizuar është 17,497,938 lekë me TVSH, vlerë e cila përbën veprime në kundërshtim me 3E^{-të} dhe të paguhej nga OE “BN E shpk”.</p>
Kriteri:	VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
Efkti:	Mospërmbushje e kushteve të marrëveshjes në vlerën 17,497,938 lekë.
Shkaku:	Mos llogaritje e detyrimit nga mos zbatimi i marrëveshjes
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	AKSHI, të kryej verifikimin e zbatimit të kontratës si dhe të llogarisë diferencat midis TORS ^{ave} të kërkuara në marrëveshje/kontratë dhe sistemit të realizuar nga operatori “BN E shpk” në rast se janë kryer apo ka ndryshime ku sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion janë në vlerën 17,497,938 lekë me TVSH . Pas verifikimit dhe kontrollit të realizimit dhe funksionimit të sistemit, dhe në rast të konfirmimit të mosplotësimit të të gjitha kushteve të kontratës nga kontraktori të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës 17,497,938 lekë me TVSH nga operatori “BN E shpk”, duke e konsideruar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit pasi kushtet e kontratës rezultojnë të pa përmbushura dhe të pakonfirmuara nga personat përgjegjës.

Për këtë mbajnë përgjegjësi S.S, A.F dhe M.S, në cilësinë e grupit të marrjes në dorëzim.

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:

Sistemi është përdorur për aplikimin dhe trajtimin e aplikimeve për ekspertët.

Mos përdorimi i modulit të përzgjedhjes dhe vlerësimit nga gjykatat lidhet me kohën që po i merr KLGJ për të ndërtuar systemin e ri gjyqësor i cili do të ndërveprojë me sistemet qeveritare. Gjithashtu dëshirojmë të sjellim në vëmendjen tuaj se gjatë hartimit të termave të referencës së një sistemi, grupi i punës përbëhet edhe me përfaqësues të institucioneve përfituese. Këta të fundit janë ata që sjellin imputin lidhur me modulet që zhvillohen brenda një sistemi duke pasur parasysh shërbimet që ofron një institucion.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Gjetja dhe rekomandimi janë pranuar dhe subjekti ka marrë angazhimin për zbatimin në vijueshmëri të tyre.

Titulli i gjetjes:	Mos vënie në përdorim e sistemit.
Situata:	<p>Nga auditimi i vënies në përdorim të sistemit “Ngritja e regjistrit elektronik të ekspertëve”, u konstatua se nga ana e gjykatave/gjykatësve sistemi nuk përdoret. Si pasojë e mospërdorimit nga kjo hallkë e rëndësishme për funksionimin e sistemit, rezultoi se 3 nga 11 modulet e kërkuara në TORS janë të papopulluara:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. “Moduli i çështjeve gjyqësore”; 2. “Moduli i vlerësimit të ekspertit për çdo proces gjyqësor”; 3. “Moduli i përzgjedhjes së ekspertit nga gjykata”; <p>Mungesa e popullimit të moduleve të mësipërme, krahas mos vënies në përdorim të tyre sjell edhe mangësi në proceset e tjera të sistemit si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. “Moduli Arkiva/Dosjet” mbetet me të dhëna jo të plota për ekspertët, pasi nuk plotësohet informacioni lidhur me “vlerësimet, historikun dhe veprimtarinë e pikëzimit”; 2. 4 nga 11 raportet e kërkuara në TORS, mbeten të pa aplikueshme, saktësisht: <ul style="list-style-type: none"> - Raport për çështjet dhe numrin total të çështjeve ku ka marr pjesë një ekspert; - Raport të numrit të herëve që një ekspert është thërritur nga një gjykatë apo gjykatës; - Raport statistikor mbi rezultatet e ekspertëve bazuar në vlerësimet e bëra rast pas rasti sipas sistemit të miratuar të pikëzimit; - Raport – analize vjetore mbi të dhënat e sistemit të pikëzimit duke evidentuar gjetjet dhe problematikat ndaj ekspertëve; 3. Qëllimi i përcaktuar në pikën 2.2 të TORS “<i>Implementimi i një sistemi vlerësimi dhe pikëzimi me qëllim monitorim e kontroll më të lehtë si dhe transparencë të lartë të veprimtarisë së ekspertëve në gjykata</i>”, mbetet i pazbatueshëm. <p><u>Ndërkohë që sistemi pas rreth 2.5 viteve nga marrja në dorëzim mbetet i pa përdorur plotësisht nga gjykatat/gjykatësit, kontrata në lidhje me mirëmbajtjen e sistemit vazhdon të paguhet e plotë sikurse sistemi të ishte pa mangësi dhe plotësisht i përdorur.</u></p> <p>Sa më sipër vlerësojmë se e gjitha vlera e sistemit 107,047,200 lekë me TVSH, përbën përdorim pa efektivitet të fondeve buxhetore.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Efekti:	Përdorim pa efektivitet të fondeve në vlerën 107,047,200 lekë.
Shkaku:	Mosvënia në përdorim e sistemit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	AKSHI të analizojë arsyet që kanë shkaktuar mos përdorimin e sistemit, duke marrë të gjitha masat për vënien në funksion të tij sipas qëllimit për të cilin u ndërtua.

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:

Sistemi është përdorur për aplikimin dhe trajtimin e aplikimeve për ekspertët.

Mos përdorimi i modulit të përzgjedhjes dhe vlerësimit nga gjykatat lidhet me kohën që po i merr KLGJ për të ndërtuar systemin e ri gjyqësor i cili do të ndërveprojë me sistemet qeveritare.

Gjithashtu dëshirojmë të sjellim në vëmendjen tuaj se gjatë hartimit të termave të referencës së një sistemi, grupi i punës përbëhet edhe me përfaqësues të institucioneve përfituese. Këta të fundit janë ata që sjellin imputin lidhur me modulet që zhvillohen brenda një sistemi duke pasur parasysh shërbimet që ofron një institucion.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Gjetja dhe rekomandimi janë pranuar dhe subjekti ka marrë angazhimin për zbatimin në vijueshmëri të tyre.

Titulli i gjetjes:	Mos realizim i plotë i kontratës.
Situata:	<p>Nga auditimi i realizimit të sistemit “Sistemi i dixhitalizimit të monitorimit dhe raportimit të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve” për Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”, u konstatua se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mungon “Moduli GIS për shfaqjen në hartë të aseteve”, në kundërshtim me pikën 2.3 të TORS; 2. Për sa i përket “Modulit të inventarizimit fizik të aseteve të ujësjellës kanalizimeve”, mungon opsioni për “Dokumentimin me fotografi të të gjitha pasurive të dukshme”, si dhe aplikimi i “vendndodhjes fizike të secilit objekt në hartë” ishte i pamundur, në kundërshtim me pikën 13.1 të TORS; 3. Sistemi nuk kishte mundësinë e gjenerimit të raporteve: <ul style="list-style-type: none"> • Raporte për totalin e investimeve të ndërmarrja për çdo shoqëri të ujësjellës kanalizimeve; • Raporte për totalin e të ardhurave nga çdo shoqëri e ujësjellës kanalizimeve; • Raporte për detyrimet e çdo shoqërie të ujësjellës kanalizimeve; në kundërshtim me pikën 13.2 të TORS; 4. Sistemi nuk komunikonte me sistemet e QKB dhe ASIG, në kundërshtim me pikën 7 të TORS. <p>Marrja në dorëzim e sistemit duke mos qenë në përputhje me TORS, është në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 77 “Mbikëqyrja e kontratës”, ku citohet: “1. Gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor dhe organe të tjera shtetërore, të autorizuar me ligj, (nëse është rasti) mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe legjislacionin në fuqi. 2. Mos përmbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën</p>

	<p><i>shkak për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike sipas përcaktimeve të pikës 3/ç të nenit 13 të LPP-së. Në këtë rast, autoriteti kontraktor ka detyrimin të dërgojë në APP kërkesën për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike brenda 3 (tre) muajve nga zgjidhja e kontratës apo përfundimi i afatit të zbatimit të saj, përfshirë këtu edhe periudhën e garancisë. 3. Për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi”.</i></p> <p>Sa më sipër konstatohet se operatori ekonomik nuk e ka realizuar kontratën sipas parashikimeve. Për këtë arsye (duke qenë se vlera ekonomike se vlera e sistemit nuk është e ndarë sipas moduleve), AKSHI duhet të mbante vlerën e garancisë për sigurimin e kontratës 11,735,160 lekë nga OE “H shpk”, e cila në rastin që nuk i është mbajtur.</p>
Kriteri:	VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
Efekti:	Penalite të munguara në vlerën 11,735,160 lekë.
Shkaku:	Mos mbajtje penaliteti për zbatim të vonuar kontrate.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	AKSHI të marrë masa dhe të analizojë rastin me qëllim që në të ardhmen, të mos marrë në dorëzim jashtë afateve projekte/produkte, pa përcaktuar dhe kërkuar më parë përlllogaritjen dhe mbajtjen e penaliteve ndaj. Për praktikën, të nxjerrë përgjegjësitë për mos kërkimin dhe arkëtimin nga subjekti “H shpk” të penaliteve për vonesa në dorëzimin në afat të produktit, sipas kontratës.

Për këtë mbajnë përgjegjësi E.Z, A.Sh, A.J dhe J.O, në cilësinë e grupit të marrjes në dorëzim.

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:

Fakti që fatura është prerë me vonesë nga operatori ekonomik nuk nënkupton që nuk është kryer puna Brenda afatit.

Realizimi i kontratës brenda afatit vërtetohet nga raportet e nënshkruara dhe përdorimi i sistemit. Raportet e nënshkruara kanë qenë pjesë e dosjes së vendosur në dispozicion të grupit të auditimit.

Vlerësojmë se këtu nuk jemi në kushtet e kryerjes së kontratës jashtë afatit të përcaktuar.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Pretendimet e paraqitura nga ana juaj nuk merren në konsideratë pasi levrimi apo dorëzimi i mallit apo produktit detyrimisht shoqërohet me faturën përkatëse, pjese e pandarë e dokumentacionit vërtetues të zbatimit në kohë dhe sipas kushteve të kontratës.

Titulli i gjetjes:	Mos vënie në përdorim e sistemit.
Situata:	Nga auditimi i vënies në përdorim të sistemit “Sistemi i dixhitalizimit të monitorimit dhe raportimit të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve” për Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”, u konstatua se për gjithë periudhën kur sistemi ka funksionuar (afërsisht 2 vite), ka pasur një përdorim

	<p>mjaft të ulët në drejtim të popullimit të tij me të dhëna, çka ka cenuar realizimin e qëllimit për të cilin u ndërtua.</p> <p>Për këtë periudhë, ka pasur rreth 1800 log-ime, ndër të cilat shumica e tyre janë të Administratorit të sistemit, çka vërteton mungesën e angazhimit për vënien në efikasitet të sistemit. Kjo mungesë e angazhimit u konstatua edhe nga fakti i mos gjenerimit të një pjese të raporteve si pasojë e mungesës së rekordeve.</p> <p>Sipas relacioneve paraprahe për nevojën për këtë sistem dhe TORS, citohej:</p> <p><i>“Objektivi i Përgjithshëm</i></p> <p><i>Objektivi i përgjithshëm i projektit është ndërtimi i një sistemi të integruar informatik për administrimin e aseteve të ujësjellës-kanalizimeve. Përmes këtij sistemi do të mundësohet identifikimi, regjistrimi dhe më tej vlerësimi i gjendjes së aseteve të shoqërisë publike të ujësjellës-kanalizimeve, duke pasur në këtë mënyrë dhe një pasqyrë të investimeve të realizuara deri tani dhe planifikimin e nevojave për investime në të ardhmen.</i></p> <p><i>Ky objektivi lidhet me pritshmërinë që qeverisja qendrore do të krijojë një sistem për raportimin dhe monitorimin mbi gjendjen e aseteve ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve, investimeve të realizuara deri më tani dhe planifikimin e nevojave për investime në ndërtimin/rehabilitimin/zgjerimin e sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve, duke forcuar në këtë mënyrë kapacitetet e administratës publike për menaxhimin e zbatimit të masterplanit kombëtar sektorial.</i></p> <p><i>Qëllimi</i></p> <p><i>Sistemi ka për qëllim automatizimin e procesit të identifikimit, regjistrimit dhe mirëmbajtjes së aseteve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve për të ndihmuar në:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Zhvillimin e një platforme kombëtare të aseteve të ujësjellës-kanalizimeve dhe përdorimin e këtij informacioni për hartimin e programeve dhe politikave kombëtare të mbështetura në evidencë;</i> • <i>Bashkërendimi i përpjekjeve midis institucioneve në nivel qendror dhe vendor për përmirësimin e monitorimit të investimeve në këtë sektor dhe planifikimin në vijimësi;</i> • <i>Kontroll dhe monitorim i projekteve të financuara nga buxheti i shtetit ose donatorë në fushën e ujësjellës-kanalizimeve;</i> • <i>Programim të investimeve për sektorin bazuar në prioritetet e Masterplanit dhe projektet e depozituara në AKUM”.</i> <p>Aktualisht, edhe pse kanë kaluar rreth 2 vite nga marrja në dorëzim, objektivat dhe qëllimi i sistemit mbeten të pa materializuara, duke cenuar vlerën e investuar për ngritjen e sistemit. Ndërkohë kontrata në lidhje me mirëmbajtjen e sistemit vazhdon të paguhet e plotë sikurse sistemi të ishte pa mangësi dhe plotësisht i përdorur, pagesa të cilat në këto kushte vlejné më shumë për përmbushjen e kontratës nga ana e AK, se sa në dobi të sistemit dhe përdoruesve.</p> <p>Sa më sipër vlerësojmë se e gjitha vlera e sistemit përbën përdorim pa efektivitet të fondeve buxhetore.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
Efkti:	Përdorim pjesërisht pa efektivitet të fondeve
Shkaku:	Mosvënia në përdorim e sistemit.

Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	AKSHI në bashkëpunim me AKUM, të analizojnë arsyet që kanë shkaktuar mos përdorimin e sistemit, duke marrë të gjitha masat për vënien në funksion të tij sipas qëllimit për të cilin u ndërtua.

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:

Sistemi është përdorur për modulet që janë parë të arsyeshme nga institucioni kërkues dhe përfitues. Modulet e tjera janë në pritje të ndërveprimit nga sistemet e ndërmarrjeve të ujësjellës kanalizimeve në Bashki. Gjithashtu dëshirojmë të sjellim në vëmendjen tuaj se gjatë hartimit të termave të referencës së një sistemi, grupi i punës përbëhet edhe me përfaqësues të institucioneve përfituese. Këta të fundit janë ata që sjellin imputin lidhur me modulet që zhvillohen brenda një sistemi duke pasur parasysh shërbimet që ofron një institucion.

Pra në rastin konkret, modulet e krijuara janë ato të kërkuara nga institucioni përfitues i shërbimit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Pretendimi se modulet e krijuara janë ato të kërkuara nga institucioni përfitues i shërbimit, merret në konsideratë edhe pse arsyet e mospërdorimit nuk janë të evidentuara.

Titulli i gjetjes:	Përlllogaritja e fondit limit për kontratat e mirëmbajtjes që përsëriten.
Situata:	Nga auditimi në procedurat e mirëmbajtjes u konstatua se Autoriteti Kontraktor në asnjë rast nuk ka argumentuar mënyrën e zgjedhur për përlllogaritjen e vlerës limit sipas opsionit 2.a të nenit 59 në VKM nr.914, datë 29.12.2014, duke patur parasysh që jemi në kushtet e një procedure prokurimi për mirëmbajtje të një sistemi ekzistues dhe fondi limit mund të përlllogaritej dhe bazuar në pikën 2.b të të njëjtit nen.
Kriteri:	VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 59.
Efekti:	Fond limit më i lartë se në procedurat e mëparshme zhvilluar për të njëjtin qëllim.
Shkaku:	Mos marrja në konsideratë e pikës 2.b të nenit 59 në VKM nr.914, datë 29.12.2014.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Në përlllogaritjen e fondit limit, për procedurat e mirëmbajtjes të cilat përsëriten çdo 1 apo 2 vjet, AKSHI duhet të konsiderojë, analizojë, vlerësojë dhe argumentojë përlllogaritjen e vlerës limit bazuar në kontratat e ngjashme të cilat janë kontratat e mëparshme, me qëllim menaxhimin e fondeve të mirëmbajtjes në mënyrë sa më eficiente dhe me ekonomikitet.

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:

Bazuar në nenit 59, pika 2 germa a) të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i cili ka parashikuar:

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

c) çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës.

Së pari AKSHI si AK ka mbështetur mënyrën e përlllogaritjes së fondit limit në gjermën a) të nenit të sipërcituar si dhe përpara nxjerrjes së çdo urdhri prokurimi dokumenton përlllogaritjen e vlerës së kontratës.

Së dyti, pas miratimit të dokumentacionit teknik, realizohet testimin e tregut, i bazuar në ofertat ekonomike të marra për llogaritjen e fondit limit.

Gjithashtu vlen për tu mbajtur në konsideratë se fusha e teknologjisë së informacionit ndryshon me ritme të shpejta brenda një viti gjë e cila nuk të jep mundësin të marrësh për bazë kontratat e mëparshme. Dëmi që mund të shkaktohet nga pasja e infrastrukturave/sistemeve me parametra jo të azhornuara do të ishte shumë i madh.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Pretendimet

Titulli i gjetjes:	Hartimi i kriterëve të veçanta si dhe procesverbali argumentues.
Situata:	<p>Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimit, u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në të gjitha rastet janë vendosur kriterë të cilat janë të panevojshme për realizimin me sukses të procedurës, duke ndikuar negativisht në pjesëmarrjen e gjerë të operatorëve ekonomikë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike”, pika 1 dhe 2, ku citohet: “1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara” dhe “2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik”, si dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” nenin 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, ku citohet “Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”. - Në të gjitha rastet procesverbali argumentues është hartuar si rezultat i formalitetit dhe jo argumentimit pasi u konstatuan mangësi në argumentimin e kriterëve duke filluar me vlerën e realizuar për kontratat e mëparshme e në vazhdim për secilin prej tyre. Megjithëse është bërë përpjekje në argumentimin e kriterit, në disa raste nuk janë argumentuar numri i punonjësve të kërkuar për secilin kriter apo numri i punonjësve total që i nevojiten OE.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
Efekti:	Ndikim negativ në pjesëmarrjen e gjerë të operatorëve ekonomik.

Shkaku:	Vendosja e kriterëve të panevojshme.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	AKSHI të analizojë rastet e audituara, si dhe të marrë masa për argumentimin dhe dokumentimin e të gjitha kërkesave që lindin nga referencat ligjore në lidhje me procesverbalin argumentues në të cilin nevojitet të shpjegohet cdo kërkesë për realizimin e procedurës me sukses. Gjithashtu, të analizohen, monitorohen dhe të eliminohen kriteret e panevojshme për realizimin e procedurave, me qëllim zgjerimin e pjesëmarrësve në procedurat e prokurimit.

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:

APP përpara publikimit kryen një verifikim paraprak lidhur me formën dhe përmbajtjen e DST, kriterëve për kualifikim dhe argumentimeve të dhëna nga AK + fusha e përgjegjësisë së AKSHI-t për vetë natyrën specifike që ka, kërkon nga OE plotësimin e kriterëve më specifike në përmbushje të objektit që prokuron.

Në zbatim të përcaktimeve ligjore, çdo kriter i vecantë dhe specifikim teknik është i argumentuar teknikisht dhe ligjorisht.

Bazuar në standartet e Agjencisë Kombëtare së Shoqërisë së Informacionit, si një autoritet me një rëndësi kritike në menaxhimin e mbarëvajtjes së sistemeve dhe infrastrukturave qeveritare i kushton shumë nëse operatori ekonomik nuk ka kualifikimet e nevojshme dhe dështon në realizimin e kontratës, sikurse është e përcaktuar qartasi në specifikimet teknike/termat e referencës të çdo projekti, Komplexiteti i sistemeve që janë ndërtuar dhe komunikimi me disa sisteme të tjera njëherësh, e bënë të detyrueshme në bazë të arsyetimit se OE për të realizuar kontratat në cilësi, sasi e kohë duhet të plotësojë kriteret e kërkuara, të cilat bazuar në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar janë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, duke mos cënuar kështu kualifikimin e operatorëve ekonomikë, dhe nuk përbëjnë diskriminim.

Në 97% të rasteve nuk ka pasur ankesë nga asnjë prej operatorëve ekonomik, referuar dokumentave të tenderit pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në përputhje me Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, pra DST janë pranuar dhe nuk kufizojnë në pjesëmarrje asnjë OE.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Pretendimet

2.7 Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe Auditit të Brendshëm

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit është krijuar sipas “Vendimit nr. 673, datë 22.11.2017 “Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit””. Kjo agjenci është bërë funksionale me emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të saj në Shtator të vitit 2007.

Objekti i veprimtarisë së AKSHI-t është:

- Zbatimin e politikave e të strategjive, për zhvillimin e sektorit të shoqërisë së informacionit (më poshtë SHI) dhe në veçanti të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (më poshtë TIK);
- Bashkërendimin e programeve në fushën e SHI-së dhe në veçanti të TIK-ut;
- Nxitjen e investimeve në fushën e SHI-së;

- d) Hartimin e praktikave për ushtrimin e kompetencave që i jepen ministrit nga legjislacioni në fushën e komunikimeve elektronike;
- e) Promovimin e teknologjive të reja në fushën e SHI-së;
- f) Dhënien e kontributit në edukimin dhe nxitjen e përdorimit të TIK-ut nga publiku

Strategjia Ndërsektoriale për AKSHI-n ka në fokus 3 drejtime kryesore sipas objektivave të mëposhtme:

- Së pari, për shtimin dhe promovimin e shërbimeve elektronike për qytetarët, biznesin dhe administratën.
- Së dyti, për përdorimin e TIK në edukim për të kapërcyer hendekun dixhital dhe për të aftësuar rininë. Përmirësimi dhe zgjerimi i kapaciteteve njerëzore në mënyrë që të rritet numri i përdoruesve dhe të promovohet zhvillimi i ofruesve të e-shërbimeve.
- Së treti, konsolidimi i infrastrukturës dixhitale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke respektuar me rigorozitet parimet evropiane të konkurrencës së lirë e të ndershme.
- Në përmbushje të kërkesave të pikës të nenit 18/1, nenit 19, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, “Nëpunësi autorizues i çdo njësie të qeverisjes së përgjithshme, në bazë të vetëvlerësimit depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt aktual”.

Kështu, Agjencia Kombëtare se Shoqërisë së Informacionit, në bazë të nenit 19 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, ka hartuar pyetësorin vjetor të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2021 me shkresat nr. 1115, datë 28.02.2022, drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët e kontrollit të brendshëm në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Nga auditimi u konstatua se AKSHI ka ngritur Ekipin e Menaxhimit të Programit në zbatim të udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të përgatitjes së PBA-së “ paragrafi 2.5 pika 1/a në njësitë shpenzuese të nivelit të dytë që zbatojnë një program buxhetor të vetëm. Drejtues programi si rregull është respektivisht nëpunësi autorizues i njësisë publike.

Në zbatim të udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 paragrafi 2.5 pika 5 citohet se “Drejtuesi i programit (Drejtori Ekzekutiv) dërgon tek të gjithë anëtarët e Ekipit të Menaxhimit të Programit (a) Udhëzimin e Përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, (b) përshkrimin e Misionit (c) propozimin e anëtarëve të Ekipit të Menaxhimit të Programit dhe (d) kalendarin për fazën e parë të hartimit të kërkesave buxhetore etj.” Veprimet e AKSHI-t janë në linjë me kërkesat e mësipërme.

Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit përmban: Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; politikat menaxheriale dhe stilin e punës; strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

a. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.

Me shkresën nr. 576 datë 08.04.2015 është miratuar “Kodi i Sjelljes dhe Etikës” për institucionin për udhëheqjen e punës së përditshme i cili nuk është përditësuar me ndryshimet

pas miratimit të VKM nr. 673 datë 27.11.2017 “Për riorganizimin e AKSHI-t” dhe nuk është përshtatur e ndryshuar në koherencë me rregulloren e brendshme të institucionit .

b. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Nga auditimi u konstatua se rregullorja e brendshme e institucionit AKSHI e miratuar nga Këshilli i Ministrave me nr.1900 datë 16.04.2020 nuk përmban përshkrimin e punës për të gjithë pozicionet e strukturës së miratuar si dhe nuk është e përditësuar me Strukturën aktuale të AKSHI-t. Rregullorja e brendshme nuk përmban nene që përcaktojnë Kodin e Etikës në institucion , apo nene që përcaktojnë raste të konfliktit të interesit. Gjithashtu nuk pasqyrohen të plota detyrat e punonjësve pasi nga auditimi ka rezultuar që disa punonjës kryejnë detyra të cilat nuk parshikohen në rregullore.

c. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.

Nga auditimi ka rezultuar se struktura ka shumë pozicione vakante duke krijuar pengesa në kryerjen e punës me eficiencë pasi shpeshë herë për vijimin e punës, menaxherët (niveleve drejtues) dhe specialistët janë autorizuar për ushtrimin e përgjegjësisë dhe detyrave në dy pozicione paralele në të njëjtën kohë.

d. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore. Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi janë kryer vlerësimet e punonjësve çdo 6 mujor.

e. Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve

Nga auditimi u konstatua se nuk është realizuar për punonjësit trajnimi mbi menaxhimin e riskut, element ky shumë i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si dhe referuar kapitullit III të “Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.

Stafi përgjithësisht, zhvillon trajnime në bashkëpunim me AKSHI-n dhe nuk ka buxhet të dedikuar për trajnime.

Menaxhimi i riskut

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin për ngjarje dhe situata të mundshme, të cilat kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave kryesore të institucionit, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme për përmbushjen e objektivave. Titullari i institucionit miraton strategjinë për menaxhimin e riskut dhe cakton koordinatoren e riskut.

Nga auditimi u konstatua se, ky institucion ka miratuar regjistrin e riskut, pra ka bërë vlerësimin dhe kontrollin e risqeve për vitin 2021. Gjithashtu në regjistrin e riskut janë futur të gjitha aktivitetet e institucionit përfshirë proceset më me risk për institucionin megjithatë për vitin 2021 nuk janë kryer proceset e rishikimit për të parë nëse risku ekziston akoma, nëse risku është rritur, nëse ndikimi i riskut ka ndryshuar, përmbajtja e raportit ka ndryshuar në përputhje me prioritetet dhe është arritur siguria në efektivitetin e kontrollit.

AKSHI ka hartuar strategjinë për menaxhimin e riskut sipas pikës 2, neni 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ku citohet se, titullari i njësive publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut.

Nuk konstatohet të ketë ndonjë urdhër të veçantë për ngritjen e grupit të menaxhimit të riskut apo përcaktimin e koordinatoreve të deleguar në çdo njësi. GMS për vitin 2021 nuk ka kryer takimet periodike, nuk është mbledhur të paktën katër herë në vit si dhe nuk ka regjistruar dhe dokumentuar vendimet e marra, në kundërshtim me nenin 27 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” pikën 2.2.6 “Grupi për menaxhimin strategjik” të Manualit mbi zbatimin e MFK-së si dhe pikën 2.2.4 “Roli i Grupit të Menaxhimit Strategjik në sistemin e MFK” të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësive publike”.

Për vitet objekt auditimi nuk janë kryer takime me stafin menaxherial mbi çështjet e

menaxhimit të riskut, diskutimin e problematikave dhe dokumentimin e veprimtarisë së përditshme të menaxhimit të riskut.

Aktivitetet e kontrollit

Nga auditimi është konstatuar se nuk janë hartuar gjurmët e auditimit sipas kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 me ndryshime “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 16 “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit” pika 2, si dhe Manualit të Menaxhimit financiar dhe kontrollit, miratuar me vendimin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016 anekset 2, 3 dhe 4.

Nga auditimi u konstatua se në funksion të kontroleve parandaluese është kryer ndarja e detyrave, për saktësimin e të dhënave të përfshira në një dokument ushtrohet sistemi me të paktën dy firma, në lidhje me kryerjen e transaksioneve financiare, kryerja e pagesave autorizohet pas firmosjes së nëpunësit zbatues dhe nëpunësit autorizues. Janë vendosur rregulla të brendshëm për të rritur sigurinë e sistemit IT. Nga AKSHI janë hartuar harta e proceseve të punës në të cilat janë përshkruar; procesi, nën proceset, objektivi i procesit, struktura përgjegjëse, përshkrimi i procesit, njësitë dhe strukturat që përfshihen në proces, kuadri ligjor dhe afati kohor sipas Manualit.

Informim komunikimi

Nga auditimi u konstatua se, përgjithësisht komunikimi me titullarin dhe nëpunësit e tjerë është bërë në formën dhe kohën e duhur, për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësi. Titullari është informuar nga drejtuesit me anë të mbledhjeve, nëpërmjet relacioneve dhe raporteve rreth këtyre mbledhjeve. Sektori i Financës nuk ka hartuar raporte monitorimi mujore, tremujore apo vjetore të Buxhetit. Punonjësit brenda institucionit vijnë të komunikojnë me postë elektronike dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme, pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik. AKSHI ka faqen e saj zyrtare në internet dhe nëpërmjet kësaj të fundit të gjithë të interesuarit mund të informohen rreth punës së përditshme të institucionit.

Monitorimi

Nga auditimi konstatohet se për periudhën objekt auditimi nuk janë hartuar raportet e monitorimit 4-8-12 mujore të buxhetit të AKSHI në kundërshtim me pikën 23/1 të nenit 4 të ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Raportet e monitorimit 4-8-12 mujore si dhe relacionet shpjeguese asistojnë në monitorimin e performancës financiare të objektivave të politikës së programit të synuara dhe produkteve të parashikuara në buxhetin vjetor, si dhe marrjen e masave korrigjuese që duhet të ndërmerren për përmirësimin e situatës, sipas pikës 42 kapitulli III të 41.2 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”.

Auditi i brendshëm:

Nga auditimi është konstatuar se për periudhën objekt auditimi vitet 2017-2021 nuk ka pasur personel të auditit të brendshëm të punësuar në institucionin e AKSHI-t. Për rrjedhojë titullarit të institucionit nuk i jepet siguri e arsyeshme, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë e sektorit publik. Nga auditimi ka rezultuar se sektori i auditit të brendshëm është i miratuar në strukturën e miratuar të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, dhe është i përbërë nga përgjegjësi i sektorit dhe 2 specialistë por në rregulloren e brendshme të institucionit të AKSHI-t miratuar me nr. 1900 datë 16.04.2020 nuk janë përcaktuar detyrat e këtij sektori.

Titulli i gjetjes:	Problematika të rezultuara nga auditimi i MFK dhe Auditimit të brendshëm:
Situata:	<p>Nga auditimi i sistemeve të Menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe Auditit të brendshëm, kanë rezultuar disa problematika si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për periudhën objekt auditimi nuk ka pasur personel të auditit të brendshëm të punësuar për të zhvilluar aktivitet auditues në institucionin e AKSHI-t. Për rrjedhojë titullarit të institucionit nuk i jepet siguri e arsyeshme, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë e sektorit publik. Nga auditimi ka rezultuar se sektori i auditit të brendshëm është i miratuar në strukturën e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit në varësi të drejtpërdrejt, dhe është i përbërë nga përgjegjësi i sektorit dhe 2 specialistë por në rregulloren e brendshme të institucionit të AKSHI-t miratuar me nr. 1900 datë 16.04.2020 nuk janë përcaktuar detyrat e këtij sektori. - Nga auditimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në AKSHI rezultoi se nuk janë implementuar si duhet kërkesat e ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, për arsye se: për periudhën objekt auditimi institucioni ka funksionuar me rregullore të brendshme të pa azhurnuar duke qenë se struktura dhe organika e institucionit ka pësuar ndryshime; nuk ka hartuar Kodin Etik të azhurnuar; nuk është ngritur grupi i menaxhimit strategjik dhe nuk ka kryer takimet periodike; nuk janë hartuar gjurmët e auditimit si dhe nuk janë hartuar raportet e monitorimit 4-8-12 mujore të buxhetit të AKSHI në kundërshtim me pikën 23/1 të nenit 4.
Kriteri:	nenin 7, ligji nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” ; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.
Efekti:	Mungesa e efciences në zbatimin e sistemeve të Menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe Auditit të brendshëm .
Shkaku:	Nuk janë zbatuar dispozitat ligjore.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	<ul style="list-style-type: none"> - Titullari i institucionit, të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim, pëditësimin dhe miratimin e Rregullores së Brendshme dhe Kodin Etik për organizimin dhe funksionimin e institucionit referuar ndryshimeve që ka pësuar struktura vitet e fundit, me qëllim mirë funksionimin dhe mirë organizimin e institucionit në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe kushtetuese. Nga AKSHI, të merren masa për hartimin dhe miratimin e dokumentit institucional të gjurmës së auditimit si dhe zhvillimin dhe dokumentimin e takimeve të realizuara nga GMS. - Titullari i institucionit, të bëjë të mundur plotësimin e organikës me auditues me përvojë, në mënyrë që të bëhet më mirë përshtatja e gjetjeve nga auditimi me rekomandimet e lëna.

Pretendimet e subjektit të audituar: Subjekti i audituar, AKSHI, ka paraqitur me shkresën nr. 212, datë 13.01.2023, administruar nga KLSH me nr. 730/13, datë 09.03.2023, pretendimet lidhur me gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, duke arsyetuar se:

Është ezauruar në pikën 6 dhe pikën 34.

Gjatë viti 2022 janë shpallur disa herë vendet vakante për përgjegjës sektori dhe specialist pranë Sektorit të Auditimit të Brendshëm, të cilat janë mbyllur pa asnjë aplikues ose pa asnjë fitues për shkak të mosplotësimit të kriterëve/kërkesave të përcaktuara në njoftim për vend të lirë pune.

Vendosja në efikasitet dhe të gjithë sektorëve dhe drejtorive përkatëse që kanë pozicione vakante është dhe mbetet një ndër prioritetet kryesore në përmbushjen e objektivave dhe fushës së përgjegjësisë së AKSHI-t.

Në zbatim dhe të rekomandimeve të lëna gjatë auditimeve të mëparshme, AKSHI do të vijoj ti rishpalli përsëri këto pozicione të lira pune deri në plotësimin e tyre përgjatë gjithë vitit 2023.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Pretendimet

KONKLuzioni I PëRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi pasqyrat financiare të AKSHI-it (Opinion i kualifikuar)

Nga auditimi i pasqyrave financiare të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2020, pasqyrën e përformancës financiare, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit Financiar, përsa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti AKSHI, të ligjit mbi kontabilitetin, udhëzimeve e kushteve të vendosura apo termave mbi raportimin financiar, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit financiar*), u evidentua se pasqyrat financiare janë në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi, por konstatohen edhe raste të klasifikimit të gabuar të llogarive apo rastet të mospërputhshmërisë, të cilat janë materiale, por jo të përhapura në llogaritë vjetore të institucioni, për të cilin japi **opinionit të kualifikuar**¹.

Baza për opinionin:

Ne kemi audituar veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe ISSAI 1700², 2000 dhe ISSAI 4000³.

Auditimi u krye në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI), Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 64, datë 22.06.2020, si edhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI-P 10, Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së.

¹ Sipas **Manualit të Auditimit Financiar** të KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 64, datë 22.06.2020, kapitulli 4.2.2, fq 139: “Një opinion i kualifikuar jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Formulimi i opinionit zakonisht tregon një rezultat të kënaqshëm të subjektit të auditimit në një deklaratë të qartë dhe konçize të çështjeve të mospajtimit ose të pasigurisë, duke çuar në opinionin e modifikuar. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

²ISSAI 1700- Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

³ISSAI 4000 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen opinionit të kualifikuar, ku ka rezultuar se gabimet janë materiale, por jo të përhapura sipas përkrahimit të çështjeve të mëposhtëm:

Cështjet krvesorë:

Nga auditimi i zërave të aktiveve afatgjata u konstatua se:

- Vlera e paraqitur në Formatin nr. 7/a ‘Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)’ të Llogarisë 214 ‘Instalime Teknike makineri, pajisje’, nuk përputhet me vlerën e konstatuar nga ‘Komisioni i Inventarizimit’, e cila rezulton në vlerën prej 4,584,430,819, me një diferencë në shumën bruto prej 72,721,176 lekë më pak se vlera e paraqitur në pasqyrën financiare.

- Në Formatin nr.7/a ‘Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)’ nga sektori i financës pakësimi është pasqyruar në vlerën 552,881,443 lekë me një vlerë më shumë prej 137,725,298 lekë, vlerë për të cilën nuk ka asnjë koment dhe dokumentacion shoqërues.

- Llogaria 24 ‘Aktive afatgjata të dëmtuara’ paraqitet në vlerën neto prej 36,371,970 lekë dhe mbartet nga viti paraardhës. Nga inventarizimi kjo vlerë është dalë në shumën prej 30,695,701 lekë, me një diferencë prej 5,676,269 lekë më pak se sa është paraqitur në Formatin nr.7/a ‘Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike).’

- Në llogarinë 24 ‘Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të Ministrisë së Linjës’ është kontabilizuar shuma prej 1,564,222 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me blerje ‘pajisje zyre’ dhe jo me materiale të dëmtuara.

Opinionin e auditimit mbi përputhshmërinë

Nga auditimi mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë të Informacionit” për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2021, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky projekt realizon qëllimin e tij, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar⁴.

Baza për opinionin e kualifikuar.

-Nga auditimi është se në një rast është bërë copëtimi i fondeve të prokuruar për vlerën prej 24.621 mijë lekë;

-Në 3 procedura prokurimi të audituara, rezultuan mangësi dhe shkelje në planifikimin e fondit limit, dhe veprimeve në kundërshtim me kriteret e vlerësimit;

-Në 4 procedura prokurimi kemi konstatuar përdorim pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike në shumën 161,517 mijë lekë;

-Nga auditimi i zbatimit të 3 kontratave për realizim dhe mirëmbajtje sistemesh, është evidentuar dëm ekonomik në vlerën 18,441 mijë lekë.

Përgjegjësitë e drejtuesve të AKSHI:

Strukturat drejtuese të AKSHI^t, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (Kriteret e vlerësimit).

Gjithashtu, strukturat drejtuese të AKSHI^t janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, për procesin e raportimit financiar, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimeve.

Përgjegjësitë e Audituesve Shtetëror të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Përgjegjësia jonë (Audituesit e KLSH-së) është që nëpërmjet auditimit të realizuar: Të vlerësojmë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (ISSAI 4000 dhe 4100), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit,

⁴ Opinioni i kualifikuar shprehet kur ka të dhëna të mjaftueshme se parregullsitë janë materiale, por jo të përhapura

si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Ne, si Auditues Shtetëror do të shprehemi me një opinion mbi përputhshmërinë e aktivitetit të institucionit, si dhe përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare prej tij. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde ne aplikojmë gjykimin dhe skepticismin tonë profesional në punën audituese.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 30 “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin dhënien e opinionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

I. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi:

1. Nga auditimi konstatohet se, për vitet objekt auditimi, mungojnë raportet e monitorimit 4-8-12 mujore të buxhetit të AKSHI-it, të cilat dërgohen në ministrinë e linjës.

Monitorimet dhe raportimet për ekzekutimin e buxhetit konsistojnë në rakordimet mujore dhe vjetore me degën e thesarit, duke mos lidhur realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre. Mungesa e raporteve të monitorimit 4-8-12 mujore, si dhe relacioneve shpjeguese cenojnë monitorimin e performancës financiare të objektivave të politikës së programit të synuara dhe produkteve të parashikuara në buxhetin vjetor, si dhe mungesën e marrjeve të masave korrigjuese që duhet të ndërmerren për përmirësimin e situatës.

Sa më sipër, veprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 65, si dhe me Udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore” pikën 41 dhe 42 kapitulli III.

2. Nga auditimi i shkresave /kërkesave të bëra nga AKSH për rialokim/rishpërndarje fondi gjatë një periudhe ushtrimore konstatohet mungesa e argumenteve nga njësia të rishpërndarjes së tyre, edhe pse një pjesë e këtyre rialokim/rishpërndarje fondi kanë prekur parashikimet e bëra në PBA-të. Veprime këto në kundërshtim me:

Udhëzimin Plotësues të Ministrit të Financave nr. 1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019” pika 35, nr. 2, datë 20.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020” pika 33 dhe nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021” pika 34.

3. Gjithashtu u konstatua se, AKSHI nuk ka evidentuar detyrimet e prapambetura, si ato të trashëguara ashtu edhe ato të krijuara rishtazi. Trajtimi i tyre duhet të konsiderohet si prioritet, duke e bashkëshoqëruar me paraqitjen e argumenteve lidhur me krijimin e tyre si edhe masat që parashikohet të merren për likuidimin e tyre. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin Plotësues nr. 2 datë 19.01.2018 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018”, Udhëzimin Plotësues të Ministrit të Financave nr. 1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, Udhëzimin Plotësues të Ministrit të Financave nr. 2, datë 20.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020” dhe Udhëzimin Plotësues të Ministrit të Financave nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021” kapitulli III ‘Raportimi i detyrimeve të prapambetura..’”
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 6 -14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: AKSHI të marrë masa në vazhdimësi, që të përpilojë raportet e monitorimit 4, 8, 12 mujore, ku të përcaktohet në lidhje me realizimin e treguesve në raport me parashikimin, si dhe në raportet 8 mujore të jepen informacionet shtesë për parashikimin e realizimeve të pritshëm deri në fund të vitit, si për produktet edhe për shpenzimet, për të evidentuar nëse ky parashikim është më i lartë apo më i ulët se plani fillestar i parashikuar, me qëllim menaxhimin sa më efektiv të fondeve buxhetore, si dhe ndërmarrjen në kohë të veprimeve korigjuese duke ndryshuar alokimin e burimeve, si dhe duke evidentuar impaktin e mundshëm në performancën e objektivave të lidhura me to.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi marrëveshjet e nënshkruara ndërmjet AKSHI-t dhe institucioneve u konstatua se ato janë të njëjta për nga përmbajtja në të gjitha rastet pavarësisht specifikave që ka secili institucion në lidhje me shërbimet IT të katalogut të shërbimeve miratuar me VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 14 -17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: AKSHI, si institucion ofrues i shërbimeve TIK, të marrë masa për ri konceptimin e marrëveshjeve aktuale të nënshkruara me institucionet duke vendosur në marrëveshje zërat specifikë dhe të detajuar të shërbimit që i ofrohen realisht institucioneve bazuar në specifikat që kanë.

Menjëherë

2.2 Rekomandimi: AKSHI të marrë masa për dokumentimin si pjesë e marrëveshjes, të komunikimeve/ndërveprimit elektronik të të dhënave ndërtuar për secilin sistem të çdo institucioni, ndarja e përgjegjësisë mbi këto të dhëna, mënyrat se si garantohen këto të dhëna si dhe vazhdimësia e ofrimit të shërbimit në rast ndërprerje duke siguruar në këtë mënyrë institucionet përfituese të shërbimeve TIK për integritetin e të dhënave dhe ruajtjen e tyre.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e marrëveshjeve, rezulton se:

-Nuk është dokumentuar asnjë agjendë periodike kontrollesh e dokumentuar nga AKSHI me secilin subjekt që disponon një marrëveshje dhe asnjë dokumentim nëse janë realizuar kontrollet, ashtu sikurse citohet në marrëveshje, të cilat janë përmendur më sipër;

-Nuk përcaktohet për specialistët TIK të AKSHI-t, të drejtat që kanë në të dhënat nën administrimin e institucioneve krijuar me ligjet e tyre organike.

-Në përshkrimet e punës së punonjësve, u konstatua se në disa raste ata kanë detyra funksionale/përshkrime pune jo në përputhje me shërbimet e katalogut të miratuar me VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar dhe jo në përputhje me marrëveshjen në ato raste që disponohet.

Disa nga rastet ku punonjësit kanë në detyrat e tyre sektoriale apo individuale tejkalim të kompetencave që parashikon VKM nr. 673 si dhe marrëveshja ndërmjet palëve janë:

Në drejtorinë TIK të MFE

-Përpunimi i informacionit financiar në Ministrinë e Financave si dhe dizenjimi, implementimi, administrimi, përditësimi dhe mirëmbajtja e bazës së të dhënave financiare si dhe aplikacionit financiar mbështetur në kërkesat funksionale të drejtorive përkatëse dhe mënyrën e shkëmbimit të informacionit në këto drejtori;

- Parashikon investimet e reja, bazuar në zgjidhje bashkëkohore, hardware dhe software;

- Krijimi dhe gjenerimi i raporteve të reja nga sistemet financiare të Ministrisë së Financave, në varësi të kërkesave të drejtorive përkatëse;

Në sektorin TIK të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

- Përgjegjësi i sektorit planifikon nevojat për software, hardware të institucionit;

- Specialisti siguron këshillim teknik dhe planifikim sistemesh;

Agjencia e Prokurimit Publik

- Përgjegjësi i sektorit planifikon nevojat për software, hardware të institucionit;
- Specialisti siguron këshillim teknik për planifikim sistemesh;

(Më hollësisht trajtuar 2.2, faqet 14 -17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: AKSHI, si institucion dhënës i shërbimeve TIK, të marrë masa për dokumentimin e kontroleve periodike që kryejnë specialistët e tij në institucionet ku ofrohen shërbime të TIK.

Në vijimësi

3.2 Rekomandimi: AKSHI të rishikojë dhe ripërcaktojë detyrat funksionale të punës që kryen çdo punonjës i AKSHI^t që ofron shërbime TIK institucioneve publike, me qëllim përcaktimin e saktë dhe të qartë të përgjegjësiive individuale, profesionale e institucionale që ka AKSHI ndaj institucioneve përfituese të shërbimit.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Rregullorja e brendshme e AKSHI-t është miratuar nga Këshilli i Ministrave me nr.1900 datë 16.04.2020 dhe gjatë kësaj kohe nuk është përshtatur me ndryshimet në strukturën organizative dhe Kodin e Etikës duke mos ndihmuar në mirëfunksionimin e brendshëm të saj. Nga auditimi është konstatuar se, në rregulloren e brendshme nuk është përcaktuar qarte përshkrimi i punës për çdo pozicion, duke bërë të vështirë identifikimin e detyrave dhe te drejtave që ka çdo punonjës i agjencisë. Janë përcaktuar vetëm funksionet apo detyrat e disa pozicioneve dhe jo përshkrimi i punës për çdo pozicion. Rregullorja e brendshme vazhdon të jetë e njëjta sipas organizimit të mëparshëm të agjencisë pavarësisht se ka pasur ndryshime të strukturës organizative. Gjithashtu, nga auditimi është konstatuar se si pasojë e krijimit të pozicioneve vakante disa punonjës krahas detyrave funksionale të ushtrojnë përgjegjësi dhe detyra të një pozicioni tjetër të autorizuar nga titullari. Ndjekja e kësaj praktike, nuk është e parashikuar dhe e trajtuar në Rregulloren e Brendshme të AKSHI-t. Për menaxhimin e punës në institucion, është e rëndësishme që në Rregulloren e brendshme të trajtohen praktikatat që do të ndiqen në rast se një pozicion pune është vakant dhe është pozicion kyç për të cilin duhet të zëvendësohet në mënyrë të përkohshme deri në momentin e rekrutimit të një punonjësi të ri.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet 18 -22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Titullari i institucioni, të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim, përditësimin dhe miratimin e Rregullores së Brendshme dhe Kodin Etik për organizimin dhe funksionimin e institucionit referuar ndryshimeve që ka pësuar struktura vitet e fundit, me qëllim mirë funksionimin dhe mirë organizimin e institucionit në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe kushtetuese.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të eksportuara nga SIFQ në lidhje me pagesat e kryera nga AKSHI për periudhën objekt auditimi, u konstatuan gjithsej **3005 raste** në vlerën totale **10.4 miliard** lekë, pagesat e të cilave janë kryer në tejkalim të afatit 30 ditor nga data e furnitorit, veprim në kundërshtim me Ligjin Nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7, afatet për autoritet publike, pika a) parashikon që “kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit dhe procesimit të pagesës”. Moskryerja në kohë e detyrimeve kontraktuale, krahas shkeljes së dispozitave ligjore, ndikon negativisht në akumulimin e detyrimeve të prapambetura, çka mund të krijojë vështirësi në zbatimin e buxhetit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 42-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Sektori i Financës në vijimësi të marrë masa për shlyerjen brenda afatit 30 ditor të detyrimeve të lindura, me qëllim shmangien e krijimit të detyrimeve të prapambetura.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave të urdhër shpenzimeve për muajt e përzgjedhur mbi bazë risku, u konstatua se mungon dokumentacioni i plotë justifikues i shpenzimit të kryer nga ana e AKSHI-t, në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 30, datë 27.12.2011 të Ministrisë të Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 35, 36 dhe 52, si dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Neni 77 “Mbikëqyrja e kontratës”, pika 3. Konkretisht:

- Për të gjitha praktikat e pagesave ku është përfituar një mall apo shërbim nga një procedurë prokurimi, mungon urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim (përfshijë këtu rastet ku grupi është përcaktuar në kontratë);

- Mungon procesverbali i marrjes në dorëzim në 424 raste. Kjo problematikë është më e theksuar gjatë viteve 2017 – 2019 dhe ulet në vitet në vijim;

- Mungon dokumentacioni i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për kryerjen e shpenzimeve të rasteve të udhëtimeve jashtë vendit në 7 raste.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 42-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Sektori i Financës në vijimësi të marrë masa për plotësimin e praktikave të urdhër shpenzimeve me dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si procesverbali i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, fletëhyrje origjinale, procesverbal i marrjes në dorëzim të mallit, etj.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se AKSHI për periudhën objekt auditimi ka paguar vlerën **574,991 lekë** shërbimin e telefonisë nga 3 operatorë ekonomikë privat, në mungesë të kantatës, dhe pa kryer procedurë prokurimi, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 4 “Fusha e zbatimit”.

Konkretisht për “V. A.” janë paguar 190,134 lekë, për “Al Sa” janë paguar 174,000 lekë, dhe për “A. T”, janë paguar 210,857 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 42-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: Në vijimësi AKSHI të marrë masa për kryerjen procedurës së prokurimit për shërbime të cilat janë objekt i ligjit për prokurimin publik.

Sektori i Financës në vijimësi të marrë masa për mos likuidimin e faturave në mungesë të kontratave të lidhura.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan 3 raste të pagesave pjesore të faturave, në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku njohja e shpenzimit bëhet në çastin e konstatimit dhe pagesa e tij bëhet brenda 30 ditëve. Evidentimi i këtyre rasteve u krye nga të dhënat e SIFQ, duke e kryer testimin mbi masën totale. Konkretisht:

-USH nr. 668, datë 11.10.2019, me anë të të cilit i kërkohet thesarit kryerja e pagesës 47,900,000 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur konstatohet se fatura tatimore e paraqitur nga operatori ekonomik ka vlerën 137,766,948 lekë.

-USH nr. 912, datë 31.12.2019, me anë të të cilit i kërkohet thesarit kryerja e pagesës 75,000 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur konstatohet se fatura tatimore e paraqitur nga operatori ekonomik ka vlerën 95,000 lekë.

-USH nr. 1536, datë 31.12.2020, me anë të të cilit i kërkohet thesarit kryerja e pagesës 6,439,362,000 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur konstatohet se fatura tatimore e paraqitur nga operatori ekonomik ka vlerën 38,699,046 lekë.

Pagesat pjesore ka efekt në krijimin e detyrimeve të prapambetura në kushtëzimin e procesimit të transaksioneve të pjesshme në sistem, veprime që nuk japin siguri për vlerën reale të shpenzimeve apo investimeve të raportuara.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 42-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: Në vijimësi Sektori i Financës të konfirmojë çdo angazhim të ndërmarrë nga AKSHI, duke siguruar ekzistencën e fondeve, duke shmangur riskun për pagesat pjesore e për pasojë krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se për vitin 2021, janë zhvilluar 2 procedura me vlerë të vogël, me objekt dhe mallra të ngjashme, duke copëzuar fondin. Konkretisht “Blerje dollapë, dollapë klasifikator dhe dosje për dollapë klasifikator” me vlerë kontrate 650,000 lekë dhe “Blerje pajisje për zyrat” me vlerë kontrate 810,000 lekë. Vlera e tyre totale e kalon limitin e blerjeve me vlera të vogla, në kundërshtim me neni 28 pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 42-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: Njësia e prokurimit në vijimësi të tregojë kujdes gjatë zhvillimit të procedurave me vlera të vogla, duke respektuar limitin total vjetor të mallrave të njëjta apo të ngjashme.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zërave të aktiveve afatshkurta u konstatua se llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” nga AKSHI është paraqitur në vlerën 0 lekë çdo vit financiar.

Nga analiza e pagesave të realizuara në SIQF u konstatua se AKSHI në vitin:

- 2018 ka likuiduar fatura të lëshuara në vitet 2015, 2016 dhe 2017;
- 2019 ka likuiduar fatura të lëshuara në vitet 2016, 2017 dhe 2018;
- 2020 ka likuiduar fatura të lëshuara në vitet 2019 dhe 2018,

vlerat e të cilave nga institucioni duhet të ishin kontabilizuar si detyrime në momentin e lëshimit të faturave tatimore nga furnitori (të marrjes së mallrave dhe shërbimeve në dorëzim), dhe jo në momentin e momentin e likuidimit të faturave ndaj palëve të treta.

Sa më sipër, AKSHI ka njohur shpenzimet në momentin e likuidimit të faturave ndaj palëve të treta dhe jo në momentin e konstatimit të detyrimit veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Paragrafi 3.3 “Klasa 4 përfaqëson në përgjithësi ngjarjet apo fenomenet që kanë ndodhur dhe duhet të trajtohen kontabilisht, sipas parimit të të drejtave e detyrimeve të konstatuara”.

Nga pikëpamja e kontabilitetit, regjistrimet për detyrimet e prapambetura nga AKSHI duhet të ishte pasqyruar duke:

- Debituar llogarinë përkatëse 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura” dhe
- Kredituar llogarinë përkatëse 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 40 -53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1 Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa në vazhdimësi, që në momentin e pranimit të dokumentacionit financiar nga palët e treta, të bëjë regjistrimin kontabël duke kredituar llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në debi të llogarive të shpenzimeve dhe investimeve sipas detyrimeve të konstatuara.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zërave të aktiveve afatgjata u konstatua se:

- Llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene” paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën neto prej 63,208,109 lekë. Gjatë vitit 2020 ka pësuar rritje në vlerën bruto prej 59,872,164 lekë, si rezultat i kalimit kapital pa pagesë, nga APP të pajisjeve për sistemin e ri dhe të vjetër të Prokurimit Elektronik (site primare) vendosur në “Datacenter server” në vlerën 57,763,993 lekë, si dhe i kalimit kapital pa pagesë, nga Ministria e Kulturës të sistemit të biletarisë

elektronike (vendosur në datacenter server), të cilat kanë të bëjnë me server dhe licenca të regjistruara nga magazina në vlerën neto prej 2,108,171 lekë.

Këto aktive janë keq klasifikuar që në momentin e regjistrimit, pasi nuk kemi të bëjmë me toke, troje terrene, por me aktive, të cilat janë implementuar në sisteme ekzistuese, të cilat kanë rritur vlerën e tyre. Mos pasqyrimi dhe kontabilizimi i saktë i aktiveve ka ndikuar në vlerën e fondit neto të institucionit si dhe vlerën neto të aktiveve.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, Klasa 2 “Aktivet Afatgjata”, me paragrafi 3.6 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto” dhe me VKM-në nr. 25, datë 20.01.2011 “Për disa ndryshime të vendimit nr. 248 datë 10.04.1998 për miratimin e planit kontabël publik “.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 40 -53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1 Rekomandimi: Sektori i financës së AKSHI-it të marrë masa për sistemimin e shumës 59,872,164 lekë nga llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene” në llogarinë 214 “Instalime Teknike makineri, pajisje”, zë në të cilën janë regjistruar “Datacenter-at”.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zërave të aktiveve afatgjata u konstatua se Vlera e paraqitur në Formatin nr. 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” nuk përputhet me vlerën e konstatuar nga Komisioni i Inventarizimit, e cila rezulton në vlerën prej 4,584,430,819, me një diferencë në shumën bruto prej 72,721,176 lekë më pak se vlera e paraqitur në pasqyrën financiare, vlerë për të cilën komision nuk ka bërë krahasimi me vlerën e regjistruar në librat përkatës të sektorit të financës, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 85 germa b.

- Gjithashtu nga analiza e lëvizjes së aktiveve me kalim kapitali pa pagesë u konstatua se, AKSHI ka të dokumentuar me dokumentacion bashkëngjitur, bazuar në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, në kapitullin III të udhëzimit “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, vetëm vlerën prej 4,934,277 lekë. Nga komisioni i inventarizimit të “Datacenter” është vendosur shuma prej 410,221,868 lekë, si dalje nga magazina pa numër sasive, vlerë e cila është e pa dokumentuar me dokumentacion justifikues.

- Në Formatin nr.7/a ‘Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)’ nga sektori i financës pakësimi është pasqyruar në vlerën 552,881,443 lekë me një vlerë më shumë prej 137,725,298 lekë, vlerë për të cilën nuk ka asnjë koment dhe dokumentacion shoqërues.

Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre” dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, Klasa 2 “Aktivet Afatgjata”, me paragrafi 3.6 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 40 -53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1 Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të AKSHI-it të analizojnë rezultatin e dalë nga komisioni inventarizimit dhe për diferencat e konstatuara, nga krahasimi i vlerës së aktiveve të pasqyruara në pasqyrat financiare dhe atyre të rezultuara nga inventarizimi për llogarinë 214 “Instalime Teknike makineri, pajisje” në vlerën prej 72,721,176 lekë, të nxjerrin arsyet dhe përgjegjësitë ndaj personave përgjegjës.

- Nëpunësi Zbatues dhe Sektori i Financës së AKSHI-it të marrin masat, që përpara se të bëjë reflektimin e pakësimit të aktive në kontabilitet nga lëvizjet kapitale pa pagesë brenda apo jashtë sistemit, të disponojë të gjithë dokumentacionin përkatës të kalimit kapital të aktiveve, me qellim evidentimin e saktë të vlerave të aktiveve në kontabilitet.

Gjithashtu të marrin masa për të analizuar dhe të argumentuar vlerën e reflektuar në llogarinë 214 “Instalime Teknike makineri, pajisje” më shumë prej (137,725,298) lekë, duke nxjerr arsyet dhe përgjegjësitë ndaj personave përgjegjës.

Sa më sipërm bazuar në vendimmarrjen e këtyre strukturave të bëhen sistemimet në kontabilitet dhe për diferencat e paargumentuara ligjërisht të ndiqet masat në organet e tjera ligj zbatuese.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zërave të aktiveve afatgjata u konstatua se:

- Llogaria 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara” paraqitet në vlerën neto prej 36,371,970 lekë dhe mbartet nga viti paraardhës. Nga inventarizimi kjo vlerë është dalë në shumën prej 30,695,701 lekë, me një diferencë prej 5,676,269 lekë më pak se sa është paraqitur në Formatin nr.7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”.

Komisioni i inventarizimit është shprehur se nuk ka diferenca mes kontabilitetit dhe inventarizimit. Si rrjedhojë komision nuk ka bërë krahasimin e vlerës së këtyre aktiveve me vlerën e regjistruar në librat përkatës të sektorit të financës, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, pika 85 germa b.

- Në llogarinë 24 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të Ministrisë së Linjës” u konstatua kontabilizimi i shumës prej 1,564,222 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me blerje “pajisje zyrash” bërë hyrje nga AKSHI në magazine me datën 25.11.2019.

Sa më sipërm institucioni ka vepruar në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, paragrafi 2.3, Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik pika 18. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 40 -53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1 Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të AKSHI-it të analizojnë rezultatin e dalë nga komisioni inventarizimit dhe për diferencat e konstatuara, nga krahasimi i vlerës së aktiveve të pasqyruara në pasqyrat financiare dhe atyre të rezultuara nga inventarizimi për llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara” në vlerën prej 5,676,269 lekë, të nxjerrin arsyet dhe përgjegjësitë ndaj personave përgjegjës.

- Sektori i financës të marrë masa menjëherë, për sistemimin e shumës prej 1,564,222 lekë, duke debituar llogarinë përkatëse 218 ‘Inventar ekonomik’ dhe duke kredituar llogarinë përkatëse 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”.

- Sektori i financës të marrë masa për të sistemuar të gjithë aktivet e regjistruara në l24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”, pasi nuk kemi të bëjmë me aktive të dëmtuara po me aktive të cilat janë gjendje punë dhe janë të transferuara si kalim kapital pa pagesë nga institucionet e tjera.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zërave të pasqyrës së aktivitetit për vitet 2019 - 2020 u konstatua se, një pjesë e aktiveve, që nga momenti i blerjes nuk janë klasifikuar në llogarinë e duhur, duke ndikuar në vlerën e fondit neto të institucionit si dhe vlerën neto të aktiveve, për faktin se amortizimi është llogaritur mbi vlerën kontabël të llogarive dhe jo në bazë grupi për secilën nga aktivet, por pa ndikim materiale në rezultatin e pasqyrave financiare.

- Gjatë analizës së zërave për secilën llogari u konstatua se një pjesë e pajisjeve “Pajisjeve kompjuterike, si kompjuter, printer, fotokopje etj” janë klasifikuar në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, pika 36, dhe me VKM-në nr. 25, datë 20.01.2011 “Për disa ndryshime të vendimit nr. 248 datë 10.04.1998 për miratimin e planit kontabël publik”. Për këto aktive është llogaritur amortizimi vjetor 20% dhe jo 25% mbi vlerën e mbetur duke ndikuar në vlerën e fondit neto të institucionit si dhe vlerën neto të aktiveve.

- Gjithashtu u konstatua se institucioni pas procesit të vlerësimit ka vlerësuar për jashtë përdorimi aktivet e llogarisë 214 në vlerën neto prej 9,936,898 lekë (amortizim i akumuluar 118,773,171 lekë) dhe e llogarisë 218 në vlerën neto 1,856,289 lekë (amortizim i akumuluar 9,866,856 lekë) raportuar me raportin përmbledhës me nr. 8176, datë 31.12.2019. Nga AKSHI këto vlera janë lënë ende tek zërat e aktiveve gjendje pune, **duke ndikuar në mos pasqyrimin e drejtë të fondit neto të institucionit si dhe vlerën neto të aktiveve.**

Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, Paragrafi 103-109. Aktivët kalojnë në llogarinë 24 pasi ato janë vlerësuar për jashtë përdorimi dhe deri në momentin e asgjësimit apo të tjetërsimit të tyre mbahen nga institucioni duke bërë daljen nga Inventari i institucionit dhe mbajtjen e tyre në magazinë me një fletë hyrje rikupero.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 40 -53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1 Rekomandimi: Sektori i Financës së AKSHI-it të marrë masat për klasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël dhe vlerësimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve.

- Sektori i Financës së AKSH-it të marrë masa për kreditimin e llogarisë 214 ‘*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*’ në vlerën bruto prej 128,710,069 lekë dhe llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*” në vlerën bruto prej 11,7129,145 lekë dhe debitimin e llogarisë 219 “*Amortizimi i akumuluar i aktiveve afatgjata*” në vlerën 128,640,027 lekë dhe të llogarisë 24 “*Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara*”, për vlerën neto prej 11,793,187 lekë, të cilat janë vlerësuar jashtë përdorimi.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i fondeve të konsoliduar në “*Pasqyrën e pozicionit financiar*” të AKSHI-it u konstatua se llogaria nr. 12 “*Rezultati i mbartur nga funksionimi*” paraqitet në vlerën 0 lekë. Në fakt kjo llogari duhet çdo vit të pasqyrohet sa “*Rezultati i ushtrimit nga funksioni*” + “*Rezultatet e mbartura*” të periudhës ushtrimore paraardhëse. Në fillim të vitit ushtrimor, nga AKSHI duhet të saktësohej pozicioni i çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm (2019) dhe të realizohej transaksioni i transferimit të tepicës së llogarisë 85 “*Rezultat i veprimtarisë ushtrimore*” në llogarinë 12, “*Rezultat i mbartur*”. Veprime këto në mospërputhje me Udhëzimin i MFE nr. 8, datë 09.03.2018, paragrafi 2.3, “*Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik*”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 40 -53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1 Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masat për të kryer sistemet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, duke tranzituar rezultatin e viti ushtrimor në llogarinë 85, “*Rezultati i veprimtarisë ushtrimore*”, si dhe duke tranzituar shumat e evidentuara në llogarinë 85, të vitit paraardhës në llogarinë 12 “*Rezultate të mbartura nga funksioni*”, për një pasqyrim më të drejtë të kundër partisë së disponibiliteteve në thesar, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të inventarizimit u konstatua se:

- Komisionit të Inventarizimit nuk ka mbajtur procesverbal, me përgjegjësin materiale, ku të ishte fiksuar numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljes së fundit, si dhe hapja dhe mbyllja e magazinës në prani të komisionit dhe përgjegjësit material, veprime në kundërshtim me paragrafin 82 të UMFE nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar.

- Komisioni i vlerësimit i ngritur me urdhrin e titullarit me nr. 752, datë 14.11.2018 ka vlerësuar për jashtë përdorimi aktivët e llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” në vlerë të mbetur 7,050,946 lekë (amortizim të akumuluar 108,900,353 lekë.) dhe aktivët e llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*” në vlerë të mbetur 2,416,765 lekë (amortizim të akumuluar 9,249,240 lekë.)

Për vitin 2019, komisioni i vlerësimit i ngritur me Urdhrin e Titullarit me nr. 7417, datë 02.12.2019 ka vlerësuar për jashtë përdorimi aktivët e llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” në vlerë të mbetur 9,936,898 lekë (amortizim të akumuluar 118,773,171 lekë.) dhe aktivët e llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*” në vlerë të mbetur 1,858,269 lekë (amortizim të akumuluar 9,866,856 lekë).

Komisioni i vlerësimit për aktivët e institucionit në fund të procesit të vlerësimit, **nuk ka mbajtur procesverbale në vete për secilin aktiv të vlerësuar të dëmtuar dhe jashtë përdorimi,**

ku të ishin përcaktuar shkaqet e daljes jashtë përdorimi të këtyre aktiveve, vlera e mbetur e tyre pas amortizimit të akumuluar, si dhe kriterin mbi bazën e të cilit është bërë vlerësimi i aktiveve, veprime në kundërshtim me paragrafin 102-105 të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar. Në fund të procesit komisioni i vlerësimit ka mbajtur relacionin e vlerësimit, por nuk ka relatuar procedura e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës, veprime në kundërshtim me paragrafin 106 të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 40 -53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1 Rekomandimi: Komisioni i vlerësimit i ngritur nga Titullari i Institucionit të AKSHI-it të marrë masa në vazhdimësi, që për çdo aktive të vlerësuar të dëmtuar dhe jashtë përdorimi, të mbajë procesverbale në vete, ku të përcaktohet shkaqet e daljes jashtë përdorimi të aktiveve, vlerën e mbetur të tyre pas amortizimit të akumuluar, si dhe kriterin mbi bazën e të cilit është bërë vlerësimi i tyre.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në datën 25.09.2019 në APP është publikuar procedura e hapur me objekt “*Shërbimet e ndërlidhjes së DPGJC me zyrat e saj rajonale*” për Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile me fond limit 196,975,408 lekë pa TVSH.

Ndërkohë në datën 15.10.2019 nga ana e njësisë së prokurimit është hartuar një Memo, drejtuar Drejtorit dhe zv. Drejtorit të Përgjithshëm të AKSHI-t, ku kërkohet fillimi i një procedure tjetër për mbulimin e lidhjes së DPGJC me zyrat e saj rajonale, deri në përfundimin e procedurës së hapur me këtë objekt prokurimi, pasi ofrimit të këtij shërbimi i kishte përfunduar afati.

Në datën 15.10.2019 është nënshkruar Urdhri i Prokurimit nr. 58, me nr. 6304 prot., datë 15.10.2019, duke zgjedhur llojin “Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, me po të njëjtin objekt “*Shërbimet e ndërlidhjes së DPGJC me zyrat e saj rajonale*” për Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile me fond limit 24,621,926 lekë pa TVSH. Zgjedhja e procedurës është bazuar në nenin 33 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, pika 2/c.

Kontrata për këtë shërbim, e lidhur në vitin 2017, dhe e përfunduar në vitin 2019, nuk ka si të jetë e paparashikueshme që do të mbarojë në vitin 2019. Aq më tepër që po zhvillohet një procedurë e hapur për këtë shërbim, pra nuk ka se si të jetë e paparashikueshme. Madje për përfundimin e kontratës AKSHI është vënë në dijeni me shkresën nr. 1591 prot., datë 17.09.2019, protokolluar tek AKSHI me nr. 5539 prot., datë 18.09.2019. Në këtë shkresë ndër të tjera citohet se me shkresën nr. 1125 prot., datë 21.06.2019, Ministria e Brendshme ka njoftuar AKSHI-n lidhur me përfundimin e kontratave. Në nenin e përmendur më sipër citohet se “*Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktor*”, ndërkohë ky rast është i tillë, pasi AKSHI ka qenë në dijeni të situatës prej datës 21.06.2019.

Vlera totale e fondit limit të dy procedurave është 221,597,334 lekë, vlerë e cila sipas nenit 8.1/a të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, klasifikohet mbi kufirin e lartë monetar. Referuar Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 3.28 “*Kufi monetar është vlera monetare, sipas së cilës, në përputhje me këtë ligj apo me rregullat e prokurimit publik, përcaktohet procedura e prokurimit që do të përdoret nga autoriteti kontraktor*”. Klasifikimi mbi kufirin e lartë monetar i një procedure prokurimi nisur nga përllogaritja e fondit limit, do të detyronte Autoritetin Kontraktor që për këtë procedurë prokurimi të ndiqeshin hapa të tjera referuar dispozitave ligjore.

Ndarja e kësaj kontrate është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, neni 28.2, ku citohet “*Nuk lejohet pjesëtimi apo ndarja e vlerës së kontratës publike për shmangien nga dispozitat e parashikuara në këtë ligj*”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet 53-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17.1 Rekomandimi: AKSHI të analizojë situatën e mësipërme, duke argumentuar zhvillimin e procedurës me negociim pa shpallje e cila është zhvilluar, jo në përputhje me kushtet e parashikuara në dispozitat ligjore, me qëllim shmangien e kësaj problematike në të ardhmen.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në procedurat e mirëmbajtjes u konstatua se Autoriteti Kontraktor në asnjë rast nuk ka argumentuar mënyrën e zgjedhur për përlllogaritjen e vlerës limit sipas opsionit 2.a të nenit 59 në VKM nr.914, datë 29.12.2014, duke patur parasysh që jemi në kushtet e një procedure prokurimi për mirëmbajtje të një sistemi ekzistues dhe fondi limit mund të përlllogaritej dhe bazuar në pikën 2.b të të njëjtit nen.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet 53-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1 Rekomandimi: Në përlllogaritjen e fondit limit, për procedurat e mirëmbajtjes të cilat përsëriten çdo 1 apo 2 vjet, AKSHI duhet të konsiderojë, analizojë, vlerësojë dhe argumentojë përlllogaritjen e vlerës limit bazuar në kontratat e ngjashme të cilat janë kontratat e mëparshme, me qëllim menaxhimin e fondeve të mirëmbajtjes në mënyrë sa më eficiente dhe me ekonomikitet.

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimit, u konstatua se:

Në të gjitha rastet janë vendosur specifikime teknike të cilat nuk përshkruajnë saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertues, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike”, pika 1 dhe 2 si dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” nenin 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet 53-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1 Rekomandimi: AKSHI të analizojë rastet e audituara, si dhe të marrë masa për të vendosur dhe argumentuar specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemeve të Menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe Auditit të brendshëm, kanë rezultuar disa problematika si më poshtë:

-Për periudhën objekt auditimi nuk ka pasur personel të auditit të brendshëm të punësuar për të zhvilluar aktivitet auditues në institucionin e AKSHI-t. Për rrjedhojë titullarit të institucionit nuk i jepet siguri e arsyeshme, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë e sektorit publik. Nga auditimi ka rezultuar se sektori i auditit të brendshëm është i miratuar në strukturën e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit në varësi të drejtpërdrejt, dhe është i përbërë nga përgjegjësi i sektorit dhe 2 specialistë por në rregulloren e brendshme të institucionit të AKSHI-t miratuar me nr. 1900 datë 16.04.2020 nuk janë përcaktuar detyrat e këtij sektori.

Nga auditimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në AKSHI rezultoi se nuk janë implementuar si duhet kërkesat e ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, për arsye se: për periudhën objekt auditimi institucioni ka funksionuar me rregullore të brendshme të pa azhurnuar duke qenë se struktura dhe organika e institucionit ka pësuar ndryshime; nuk ka hartuar Kodin Etik të azhurnuar; nuk është ngritur grupi i menaxhimit strategjik dhe nuk ka kryer takimet periodike; nuk janë hartuar gjurmët e auditimit

si dhe nuk janë hartuar raportet e monitorimit 4-8-12 mujore të buxhetit të AKSHI në kundërshtim me pikën 23/1 të nenit 4.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqet 115 -119 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

20.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit, të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim, përditësimin dhe miratimin e Rregullores së Brendshme dhe Kodin Etik për organizimin dhe funksionimin e institucionit referuar ndryshimeve që ka pësuar struktura vitet e fundit, me qëllim mirë funksionimin dhe mirë organizimin e institucionit në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe kushtetuese. Nga AKSHI, të merren masa për hartimin dhe miratimin e dokumentit institucional të gjurmës së auditimit si dhe zhvillimin dhe dokumentimin e takimeve të realizuara nga GMS.

Menjëherë

20.2 Rekomandimi: Titullari i institucionit, të bëjë të mundur plotësimin e organikës me auditues me përvojë, në mënyrë që të sigurohet një monitorim dhe raportim i vazhdueshëm mbi aktivitetin financiar të institucionit.

Menjëherë

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i vënies në përdorim të sistemit “Sistemi i dixhitalizimit të monitorimit dhe raportimit të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve” për Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”, u konstatua se për gjithë periudhën kur sistemi ka funksionuar (afërsisht 2 vite), ka pasur një përdorim mjaft të ulët në drejtim të popullimit të tij me të dhëna, çka ka cenuar realizimin e qëllimit për të cilin u ndërtua.

Për këtë periudhë, ka pasur rreth 1800 log-ime, ndër të cilat shumica e tyre janë të Administratorit të sistemit, çka vërteton mungesën e angazhimit për vënien në efikasitet të sistemit. Kjo mungesë e angazhimit u konstatua edhe nga fakti i mos gjenerimit të një pjese të raporteve si pasojë e mungesës së rekordeve.

Aktualisht, edhe pse kanë kaluar rreth 2 vite nga marrja në dorëzim, objektivat dhe qëllimi i sistemit mbeten të pa materializuara, duke cenuar vlerën e investuar për ngritjen e sistemit. Ndërkohë kontrata në lidhje me mirëmbajtjen e sistemit vazhdon të paguhet e plotë sikurse sistemi të ishte pa mangësi dhe plotësisht i përdorur, pagesa të cilat në këto kushte vlejné më shumë për përmbushjen e kontratës nga ana e AK, se sa në dobi të sistemit dhe përdoruesve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet 53 -115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

21.1 Rekomandimi: AKSHI në bashkëpunim me AKUM, të analizojnë arsyet që kanë shkaktuar mos përdorimin e sistemit, duke marrë të gjitha masat për vënien në funksion të tij sipas qëllimit për të cilin u ndërtua.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se pagesa për faturën tatimore me nr. 223066595 datë 16.05.2017 me vlerë 548,218.6 lekë nuk është bërë e plotë pasi operatori ekonomik “E.G Shpk” ka dorëzuar 200 copë A4 (me vlerë 68,001 lekë) më pak nga sa kërkuar, vërtetuar kjo me procesverbalin e marrjes në dorëzim dhe fletëhyrjes së magazinës nr. 20 datë 16.05.2017. Për këtë arsye në vitin 2017 janë paguar në favor të “E.G Shpk” vetëm 480,217 lekë. Pas një korrespondence ndërmjet OE dhe AKSHI-t, është kryer pagesa e mbetur e faturës fillestare të dorëzuar nga OE, por nuk ka dokumentacion që të vërtetojë se është plotësuar diferenca e mallit të munguar. OE kërkon vlerën e mbetur pasi pretendon se fatura e tij me vlerë 548,218.6 lekë është nënshkruar nga marrësi në dorëzim, ndërkohë sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim dhe fletëhyrjes në magazinë kanë ardhur vetëm mallra në vlerën 480,217 lekë.

Në të tilla kushte, duke qenë se fatura është nënshkruar, edhe pse lëvrimi nuk rezultoi të jetë i rregullt, është paguar vlera **68,001 lekë**. Kjo vlerë përbën **dëm ekonomik** për buxhetin e shtetit pasi është përfituar pa të drejtë nga OE “E.G Shpk”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 22-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: AKSHI të kërkojë në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës **68,001 lekë** nga “E.G Shpk”. Kjo vlerë përbën dëm ekonomik pasi është paguar për një furnizim të pa kryer.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave të kryera në zbatim të kontratës nr. 715, datë 11.02.2019 të lidhur ndërmjet AKSHI-t dhe OE “I.MB”, me vlerë 730,060 lekë pa TVSH ose 876,072 lekë me TVSH, u konstatua se operatori ekonomik nuk ka dorëzuar raporte shërbimi, në kundërshtim me nenin 6 të kushteve të veçanta të kontratës “Kërkesat e raportimit”, ku citohet “Gjatë zgjatjes së kontratës, kontraktori duhet të sigurojë raportime mujore për Autoritetin Kontraktor sipas formularit të mëposhtëm: procesverbal sipas përcaktimeve të specifikimeve teknike bashkëlidhur kontratës”. Gjithashtu mungojnë procesverbalet e marrjes në dorëzim dhe faturat nuk janë të nënshkrimit nga personat përgjegjës për zbatimin e kontratës, në kundërshtim me nenin 8 të kushteve të veçanta të kontratës, ku për kryerjen e pagesës citohet “Pas konfirmimit nga personi i autorizuar nga AKSHI për ndjekjen e kryerjes së shërbimeve dhe do të kryhet me këste mujore”.

Sa më sipër, duke qenë se kushtet e kontratës rezultojnë të pa përmbushura dhe të pakonfirmuara nga personat përgjegjës, vlerësojmë se vlera e paguar prej **876,072 lekë** me TVSH për vitin 2019 është e pajustificuar dhe përbën **dëm ekonomik** për buxhetin e shtetit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 22-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: AKSHI të kërkojë në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimin e vlerës **876,072** nga operatori “I.MB”. Kjo vlerë përbën dëm ekonomik pasi kushtet e kontratës rezultojnë të pa përmbushura dhe të pakonfirmuara nga personat përgjegjës.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i realizimit të sistemit “Ngritja e regjistrit elektronik të ekspertëve” me vlerë 136,000,000 lekë me TVSH, u konstatua se:

1. “Moduli i vlerësimit të aplikimit” nuk është si modul më vete, por pjesë e funksionaliteteve të “Moduli i çështjeve gjyqësore”, në kundërshtim me pikën 13.1 të TORS;

2. Sistemi nuk ka modulet “Moduli i përditësimit të të dhënave dhe korrigjimit të gabimeve” dhe “Moduli i çaktivizimit/pezullimit/heqjes së ekspertit nga regjistri”, në kundërshtim me pikën 13.1 të TORS;

3. Në sistem nuk janë implementuar fushat “gjinia” dhe “vendlindja”, çka bën që të mos gjenerohet raport mbi këto fusha, sipas kërkesave të pikës 13.1/a të TORS mbi raportet e detyrueshme të sistemit.

4. Raportet gjenerohen vetëm në formatin PDF, në kundërshtim me pikën 13.1/a të TORS.

Marrja në dorëzim e sistemit duke mos qenë në përputhje me TORS është në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 77 “Mbikëqyrja e kontratës”.

Sa më sipër, operatori ekonomik nuk e ka realizuar kontratën sipas parashikimeve, duke mos i përfunduar të gjitha modulet dhe kërkesat. Vlera e moduleve të cilat nuk janë realizuar është **17,497,938 lekë me TVSH** dhe përbën **dëm ekonomik** për buxhetin e shtetit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet 53 -115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: AKSHI, të kryej verifikimin e zbatimit të kontratës si dhe të llogarisë diferencat midis TORS^{ave} të kërkuara në marrëveshje/kontratë dhe sistemit të realizuar nga operatori “BN E shpk” në rast se janë kryer apo ka ndryshime ku sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion janë në vlerën **17,497,938 lekë me TVSH**.

Pas verifikimit dhe kontrollit të realizimit dhe funksionimit të sistemit, dhe në rast të konfirmimit të mosplotësisë të të gjitha kushteve të kontratës nga kontraktori të kërkohej në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës **17,497,938 lekë me TVSH** nga operatori “BN E shpk”, duke e konsideruar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit pasi kushtet e kontratës rezultojnë të pa përmbushura dhe të pakonfirmuara nga personat përgjegjës.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Përlllogaritja e fondit limit për 3 muaj shërbim për procedurën me negociim pa shpallje “*Shërbimet e ndërlidhjes së DPGJC me zyrat e saj rajonale*” është kryer duke e krahasuar me vlerën e fondit limit të përlllogaritur për procedurën e hapur për 24 muaj. Pra nëse vlera limit për procedurën që do të zgjasë 24 muaj është 196,975,408 lekë, për 3 muaj është përlllogaritur matematikisht fondi limit 24,621,926 lekë.

Së pari, nga verifikimi i dokumentacionit mbi zhvillimin e procedurave të mësipërme, u konstatua specifikimet teknike të procedurës përfshijnë edhe zëra të tjerë, krahas shërbimit të ndërlidhjes, si lëvrim dhe konfigurim të pajisjeve hardware që do të përdoren për shërbimin, trajnim të punonjësve, implementim të linjave backup, instalim kamerash në çdo gjendje civile, instalimi i videowall i përbërë nga 4 monitorë, workstation, software i menaxhimit të pamjeve etj. Pra vlera e fondit limit 196,975,408 lekë ka të përfshirë jo vetëm shërbimin e ndërlidhjes, por edhe disa elemente të tjerë që e rrisin vlerën, dhe pjesëtimi i vlerës me 24 muaj, me qëllim përcaktimin e vlerës mujore, nuk është i arsyetuar.

Së dyti, vlera limit e ofrimit të shërbimit të ndërlidhjes në rastin e parë, është përcaktuar duke marrë në konsideratë edhe shërbimet shtesë sipas risive në kontratën e këtij viti, ndërkohë që ofrimi i shërbimit për 3 muajt e kontraktuar, vazhdon vetëm me infrastrukturën dhe pajisjet e mëparshme. Pra edhe në këtë këndvështrim, nëse nga vlera 196,975,408 lekë do të zbriteshin shërbimet dhe lëvrimet shtesë, përsëri pjesëtimi i vlerës së mbetur me 24 muaj, me qëllim përcaktimin e vlerës mujore, nuk do të ishte i arsyetuar.

Së treti, nga njësia e prokurimit, është përlllogaritur për 3 muaj vlera e fondit limit në shumën 24,621,926 lekë pa TVSH, edhe pse shërbimi kërkohej që të ofrohet deri në datën 31.12.2019. Pra edhe nëse kontrata do të ishte lidhur ditën kur u përlllogarit vlera, koha e shërbimit do të ishte 2.5 muaj. Ndërkohë kontrata është lidhur me vlerën 23,487,600 lekë pa TVSH, në datën 22.10.2019 me afat deri në datën 31.12.2019, pra 2 muaj e 10 ditë. Nëse do të përdorim logjikën e përdorur nga njësia e prokurimit për përcaktimin e fondit limit mbi bazë mujore, atëherë fondi limit, duhet të ishte 19,150,386 lekë. Diferenca ndërmjet vlerës së kontratës së lidhur dhe fondit limit të përlllogaritur nga grupi i auditimit prej **5,204,656 lekë** (e llogaritur me TVSH) përbën **efekt financiar negativ** për buxhetin e shtetit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet 53 -115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: AKSHI të analizojë situatën lidhur me përlllogaritjen e gabuar të fondit limit, duke marrë masat e duhura për parandalimin e krijimit të efekteve financiare negative në të ardhmen.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i vënies në përdorim të sistemit “Ngritja e regjistrimit elektronik të ekspertëve”, u konstatua se nga ana e gjykatave/gjykatësve sistemi nuk përdoret. Si pasojë e mospërdorimit nga kjo hallkë e rëndësishme për funksionimin e sistemit, rezultoi se 3 nga 11 modulet e kërkuara në TORS janë të papopulluara:

1. “Moduli i çështjeve gjyqësore”; 2. “Moduli i vlerësimit të ekspertit për çdo proces gjyqësor”;
3. “Moduli i përzgjedhjes së ekspertit nga gjykata”;

Mungesa e popullimit të moduleve të mësipërme, krahas mos vënies në përdorim të tyre sjell edhe mangësi në proceset e tjera të sistemit si:

1. “Moduli Arkiva/Dosjet” mbetet me të dhëna jo të plota për ekspertët, pasi nuk plotësohet informacioni lidhur me “*vlerësimet, historikun dhe veprimtarinë e pikëzimit*”;

2. 4 nga 11 raportet e kërkuara në TORS, mbeten të pa aplikueshme, saktësisht:

- Raport për çështjet dhe numrin total të çështjeve ku ka marr pjesë një ekspert;
- Raport të numrit të herëve që një ekspert është thërritur nga një gjykatë apo gjykatës;
- Raport statistikor mbi rezultatet e ekspertëve bazuar në vlerësimet e bëra rast pas rasti sipas sistemit të miratuar të pikëzimit;
- Raport – analize vjetore mbi të dhënat e sistemit të pikëzimit duke evidentuar gjetjet dhe problematikat ndaj ekspertëve;

3. Qëllimi i përcaktuar në pikën 2.2 të TORS “*Implementimi i një sistemi vlerësimi dhe pikëzimi me qëllim monitorim e kontroll më të lehtë si dhe transparencë të lartë të veprimtarisë së ekspertëve në gjykata*”, mbetet i pazbatueshëm.

Ndërkohë që sistemi pas rreth 2.5 viteve nga marrja në dorëzim mbetet i pa përdorur plotësisht nga gjykata/gjykatësit, kontrata në lidhje me mirëmbajtjen e sistemit vazhdon të paguhet e plotë sikurse sistemi të ishte pa mangësi dhe plotësisht i përdorur.

Sa më sipër vlerësojmë se vlera e sistemit 107,047,200 lekë me TVSH, përbën përdorim pa efektivitet të fondeve buxhetore.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet 53 -115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: AKSHI të analizojë arsyet që kanë shkaktuar mos përdorimin e sistemit, duke marrë të gjitha masat për vënien në funksion të tij sipas qëllimit për të cilin u ndërtua.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi marrjen në dorëzim të zbatimit të kontratës me nr. 2497 prot., datë 13.05.2019 me objekt “Ngritja e regjistrimit elektronik të ekspertëve” me vlerë 136,000,000 lekë me TVSH, u konstatua se afati i implementimit nuk është zbatuar. Pra dorëzimi i sistemit nuk është kryer në datën 13.08.2019, por në datën 13.12.2019, datë në të cilën është mbajtur akti i marrjes në dorëzim. Për këtë vonesë, AKSHI nuk ka mbajtur penaltet në vlerën **37,529,487 lekë** (122 ditë x 0.004 x 76,904,687 lekë).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet 53 -115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: AKSHI të marrë masa dhe të analizojë rastin me qëllim që në të ardhmen, të mos marrë në dorëzim jashtë afateve projekte/produkte, pa përcaktuar dhe kërkuar më parë përlllogaritjen dhe mbajtjen e penalteteve ndaj. Për praktikën, të nxjerrë përgjegjësitë për mos kërkimin dhe arkëtimin nga subjekti “BN E shpk” të penalteteve për vonesa në dorëzimin në afat të produktit, sipas kontratës me nr. 2497 prot., datë 13.05.2019.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i realizimit të sistemit “Sistemi i dixhitalizimit të monitorimit dhe raportimit të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve” për Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”, u konstatua se:

1. Mungon “Moduli GIS për shfaqjen në hartë të aseteve”, në kundërshtim me pikën 2.3 të TORS; 2. Për sa i përket “Modulit të inventarizimit fizik të aseteve të ujësjellës kanalizimeve”, mungon opsioni për “Dokumentimin me fotografi të të gjitha pasurive të dukshme”, si dhe aplikimi i “vendndodhjes fizike të secilit objekt në hartë” ishte i pamundur, në kundërshtim me pikën 13.1 të TORS; 3. Sistemi nuk kishte mundësinë e gjenerimit të raporteve:

- Raporte për totalin e investimeve të ndërmarra për çdo shoqëri të ujësjellës kanalizimeve;
 - Raporte për totalin e të ardhurave nga çdo shoqëri e ujësjellës kanalizimeve;
 - Raporte për detyrimet e çdo shoqërie të ujësjellës kanalizimeve;
- në kundërshtim me pikën 13.2 të TORS;

4. Sistemi nuk komunikonte me sistemet e QKB dhe ASIG, në kundërshtim me pikën 7 të TORS.

Marrja në dorëzim e sistemit duke mos qenë në përputhje me TORS, është në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 77 “Mbikëqyrja e kontratës”.

Sa më sipër konstatohet se operatori ekonomik nuk e ka realizuar kontratën sipas parashikimeve. Për këtë arsye (duke qenë se vlera ekonomike dhe vlera e sistemit nuk është e ndarë sipas moduleve), AKSHI duhet të mbante vlerën e garancisë për sigurimin e kontratës **11,735,160 lekë** nga OE “H shpk”, e cila në rastin që nuk i është mbajtur.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet 53 -115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: AKSHI të marrë masa dhe të analizojë rastin me qëllim që në të ardhmen, të mos marrë në dorëzim jashtë afateve projekte/produkte, pa përcaktuar dhe kërkuar më parë përlllogaritjen dhe mbajtjen e penalteteve ndaj. Për praktikën, të nxjerrë përgjegjësitë për mos kërkimin dhe arkëtimin nga subjekti “H shpk” të penalteteve për vonesa në dorëzimin në afat të produktit, sipas kontratës.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

Bazuar në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Kontratën Kolektive të Punës dhe kontratën individuale të punës, *i rekomandohet* Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, vlerësimi i problematikave dhe shkeljeve të përshkruara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi dhe dhënia e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna” për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT